



**United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization**

**Komentar i Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut**

përgatitur për .....

**Marjana Sinani**  
**Milika Dhano**  
**Prof.As. Vasilika Hysi**  
**Pranvera Kamani**  
**Eralda Methasani, LL.M.**  
**Zhulieta Harasani, MA**

## VËREJTJE E UNESCO-s

Autorët kanë përgjegjësinë për zgjedhjen dhe paraqitjen e fakteve të përfshira në këtë libër si dhe për opinionet e shprehura në të, që nuk janë domosdoshmërisht të UNESCO dhe nuk e detyrojnë organizatën. Paraqitja e materialit si dhe përmbajtja e tij përgjatë këtij botimi, nuk implikon në asnjë mënyrë shprehjen e ndonjë opinioni të UNESCOs përsa i përket statusit juridik të ndonjë shteti, territori, qyteti, zone, apo të pushtetmbajtësve të tyre, ose që ka të bëjë me caktimin e kufijve, të jashtëm apo të brendshëm.

© UNESCO, 2008

## Tabela e Përmbajtjes

<i>Shkurtime</i> .....	
<i>Shpjegime</i> .....	
Parathënie .....	
Neni 1 - Liri, barazi, vëllazëri.....	
Neni 2 - Mosdiskriminimi.....	
Neni 3 - E drejta për një jetë të lirë e sigurim vetjak.....	
Neni 4 - Ndalimi i skllavërisë dhe tregtisë së skllavëve.....	
Neni 5 - Mostrajtimi i egër, jonjerëzor ose poshtëruës.....	
Neni 6 - E drejta e personalitetit juridik.....	
Neni 7 - Barazia para ligjit.....	
Neni 8 - E drejta për mjete të frytshme juridike.....	
Neni 9 - Ndalimi i arrestimit, ndalimit ose internimit arbitrar.....	
Neni 10 - E drejta për një proces të rregullt gjyqësor.....	
Neni 11 - Prezumimi i pafajësisë.....	
Neni 12 - Privatësia.....	
Neni 13 - Liria e qarkullimit dhe banimit.....	
Neni 14 - E drejta të kërkosh dhe gëzosh azil .....	
Neni 15 - E drejta e shtetësisë.....	
Neni 16 -E drejta për të lidhur martesë dhe krijuar familjen.....	
Neni 17 - E drejta e pronës.....	
Neni 18 - Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit.....	
Neni 19 - Liria e mendimit, e shprehjes dhe e informacionit.....	
Neni 20 - Liria e mbledhjes dhe bashkimit paqësor.....	
Neni 21 - E drejta për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit.....	
Neni 22 - E drejta për sigurim shoqëror dhe realizim të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore.....	
Neni 23 - E drejta për punë dhe për të krijuar sindikatë	
Neni 24 - E drejta për pushim dhe kohë të lirë.....	
Neni 25 - E drejta për një nivel të mjaftueshëm jetese; dhe kujdes i posaçëm për nënat dhe fëmijët.....	
Neni 26 - E drejta e shkollimit.....	
Neni 27 - Liria e pjesëmarrjes në jetën kulturore të bashkësisë; liria e gëzimit të arteve dhe e përfitimit nga përparimi shkencor; e drejta e autorit.....	
Neni 28 - E drejta për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar ku realizohen të drejtat....	
Neni 29 - Detyrimet ndaj bashkësisë.....	
<i>Aneksi I: Teksti i DUDNJ-së</i> .....	
<i>Aneksi II: Listë e shkurtuar e të drejtave dhe lirive të DUDNJ-së</i> .....	

## **SHKURTIME**

DUDNJ      Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

**KREU I:**

**SHPJEGIME**

## **KREU II:**

## **PARATHËNIE**

Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi dhe shpalli Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut. Pas kësaj Asambleja ftoi të gjitha shtetet anëtare që ta shpallin tekstin e Deklaratës dhe të përpiqen që ta përhapin, lexojnë dhe ta shpjegojnë, sidomos në shkolla dhe institucione të tjera edukuese, në të gjitha vendet dhe shtetet pa marrë parasysh statusin e tyre politik.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut është dokumenti ndërkombëtar bazë që shpall të drejta të pandashme dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore. Kjo Deklaratë u shpall si ‘standard i përbashkët arritjeje për të gjithë njerëzit dhe kombet’ për respektimin e të drejtave të njeriut. Ajo rendit të drejta të shumta civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të cilat i gëzojnë njerëzit.

DUDNJ u parapri nga një Kartë e Kombeve të Bashkuara e cila përcaktonte procedurat dhe veprimet e Kombeve të Bashkuara. Karta u krijua kryesisht si një reagim ndaj tmerreve të Luftës së Dytë Botërore dhe si një ndërmarrje e përbashkët e kombeve që ato të mos ndodhnin përsëri. Edhe pse Karta e KB-së e përfshinte nevojën për të mbrojtur të drejtat e njeriut ajo nuk sqaronte termat që përdorte. Kështu lindi nevoja që të përpunoheshin termat që flisnin për të drejtat e njeriut dhe të deklarohesh qartë e dukshëm përkushtimi ndaj mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kjo gjë u realizua nëpërmjet Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

Në hartimin e Deklaratës kanë dhënë kontributin e tyre shumë vende. Me hartimin e saj janë të lidhur ngushtë shumë emra të shquar të historisë së të drejtave të njeriut të njerëzimit, si John Humphrey, Kanadez, Rene Cassin nga Franca, Eleanor Roosevelt nga SHBA-ja, Dr. Charles Malik nga Libani dhe Dr. P.C. Chang nga Kina, anëtarë të Komitetit për Hartimin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut i krijuar nga Komisioni i KB-së për të Drejtat e Njeriut (UNCHR). Siç shihet edhe nga këto emra, hartimi i DUDNJ-së ishte vërtet një përjekje ndërkombëtare.

DUDNJ u konceptua si deklaram objektive që duhen ndjekur nga qeveritë, dhe si e tillë DUDNJ nuk ishte pjesë e të drejtës së detyruar ndërkombëtare. Pavarësisht nga kjo, ajo është një dokument i fuqishëm për të ushtruar presion moral dhe diplomatik ndaj shteteve që shkelin parimet e saj. Me kalimin e kohës ajo u shndërrua në një normë të së drejtës zakonore ndërkombëtare. Në vitin 1968, Konferenca Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut ra dakord që Deklarata “përbën një detyrim për anëtarët e komunitetit ndërkombëtar” për të mbrojtur dhe ruajtur të drejtat e qytetarëve të tyre.

Deklarata në të gjithë përmbajtjen e saj i referohet legjitimitetit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ajo thekson që çdo njeri ka të drejtën të “promovojë dhe luftojë për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”. Theksohet që kjo e drejtë mund të gëzohet individualisht dhe me të tjerë. Gjithashtu, theksohet se mbrojtësit e të

drejtave të njeriut kanë të drejtë të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky është një sqarim i rëndësishëm që nënvizon legjitimitetin e punës së të drejtave të njeriut pavarësisht nga kufijtë që ekzistojnë. Shumë mbrojtës të të drejtave të njeriut mund të përballen me situata të vështira në nivel vendor apo rajonal apo ndërkombëtar. Kështu, lobimi për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në një vend të caktuar, në nivel rajonal apo ndërkombëtar, për shembull në Komisionin e të Drejtave të Njeriut të KB-së, është një aktivitet legjitim që mbështetet në qëllimet dhe parashikimet e Deklaratës.

Deklarata përmban nene të shumta, përveç preambulës, që nënvizojnë të drejtat e njeriut të njerëzve, ndër të cilat përfshihen të drejta të tilla themelore si: e drejta për jetën, lirinë dhe sigurinë personit, e drejta për arsim. e drejta për të marrë pjesë plotësisht në jetën kulturore, liria nga tortura, trajtimi apo ndëshkimi kriminal, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

#### *Vendet që e nënshkruan Deklaratën*

Meqë Deklarata nuk është ligjërish e detyrueshme, nuk kishte vende nënshkruese të saj. Në fakt Deklarata u ratifikua me një shpallje të Asamblesë së Përgjithshme më 10 dhjetor 1948, me 48 vota pro, asnjë kundër dhe 8 abstenime. Për kohën, kjo u konsiderua si triumf, meqë vota unifikoi qëndrimin e vendeve me regjime shumë të ndryshme politike, madje edhe në konflikt me njëra-tjetrën.

#### *Ku bazohet Deklarata?*

Deklarata bazohet në ‘dinjitetin e brendshëm’ të të gjithë njerëzve dhe afirmon të drejtat e barabarta të të gjithë grave dhe burrave si dhe të drejtën për të qenë të lirë. Deklarata i jep prioritet të drejtave të njeriut përkundërt pushtetit të shteteve. Ndërsa shtetet lejohen të rregullojnë të drejtat, ato ndalohen t’i shkelin ato.

#### *Ç’është Karta e të Drejtave të Njeriut?*

Deklarata Universale e Njeriut, së bashku me Protokollin Shtesë dhe Paktet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut përbëjnë atë që quhet Kartë e të Drejtave të Njeriut. Është e rëndësishme të theksojmë se krijimi i DUDNJ-së ishte vetëm një pjesë e mandatit të trefishtë të grupit të punës që hartoi DUDNJ-në. Përveç një deklaratë parimesh, komisioni duhej të hartonte dy akte të tjera mbi të drejtat e njeriut ligjërish të detyrueshme. Paktet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut janë traktate, realizimin dhe respektimin e të cilave e marrin përsipër shtetet palë në to. Këto dy akte janë Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe si Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile e Politike, të hapura për nënshkrim nga Asambleja e Përgjithshme në Dhjetor 1966 dhe që hynë në fuqi në vitin 1976. Paktet njohin dhe detajojnë më tej të drejtat e përcaktuara në DUDNJ. Protokollin Shtesë është një dokument i cili ndryshoi paktin në 1966 dhe që ka hyrë në fuqi në vitin 1976.

#### *Pse është e rëndësishme Deklarata?*

DUDNJ është universale si në përmbajtje edhe në zbatim. Ajo thekson se “qeniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta” dhe shërben si forca lëvizëse e shumë legjislacioneve që kanë si bazë të drejtat e njeriut si p.sh. edhe

Kushtetuta e vendit tonë. Deklarata ka frymëzuar krijimin e dokumenteve pasues ndërkombëtar të tilla si Kartën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve, por edhe dokumente rajonalë, si Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Më tej, kjo Deklaratë e bën mbrojtjen e të drejtave të njeriut, një pjesë të rëndësishme të ligjit ndërkombëtar. Gjithashtu, ajo shërben si bazë referimi për vëzhgues të të drejtave të njeriut të tillë si Amnesty International. Së fundi, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut vendos një standard arritjeje për të gjitha kombet që të luftojnë për këto të drejta e liri.

*Pse është Deklarata e rëndësishme për vendin tonë?*

Në Kushtetutën tonë, që në hyrjen e saj kanë zënë vend shumë nga parimet e të drejtat e përmendura në Deklaratë. Më tej në përmbajtjen e Kushtetutës ka një kapitull të tërë me të drejta e liri të cilat janë reflektim i të drejtave e lirive të Deklaratës Universale. Po kështu, Shqipëria e ka të deklaruar tashmë prej vitesh dëshirën dhe vullnetin e saj shtetëror, por edhe vetë shqiptarët si individë, për të pasur një vend ku të drejtat dhe liritë e njeriut të njihen, respektohen e garantohen maksimalisht.

*Pse është e rëndësishme Deklarata për ne si individë?*

Deklarata përfshin parime dhe vlera të tilla si dinjiteti i individit, ndershmëria dhe barazia në trajtim, liria, toleranca, pranueshmëria e të ndryshimeve, dhe parimet e pjesëmarrjes demokratike. Të gjitha këto janë vlera të cilat çdo qenie njerëzore i ka të rëndësishme dhe i kërkon që të ekzistojnë e respektohen.

*A duhen dokumente të tjerë mbi të drejtat e njeriut kur kemi DUDNJ-në?*

Deklarata nuk është dokument ligjor i detyrueshëm për t'u zbatuar. Është shumë e nevojshme që të ketë dokumente të tjerë që të detyrojnë shtetet të respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të kërkojnë llogari për mos respektimin e tyre nga ana e shteteve. Kështu, ekzistojnë dy dokumente kryesorë të Kombeve të Bashkuara, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat dhe Liritë Civile e Politike si dhe Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat e Liritë Sociale, Ekonomike e Kulturore. Po kështu, rajone të ndryshme të botës, nisur nga parimet e ngjashme me të cilat jetojnë dhe kërkesat po ashtu të ngjashme që kanë për nivelin në të cilin kërkojnë që të respektohen të drejtat e njeriut, kanë miratuar dokumente rajonalë për këtë. E së fundi, çdo shtet, nisur nga veçoritë e tij mund të miratojë një dokument të detyrueshëm ligjor mbi të drejtat e njeriut i cili specifikisht i referohet shtetasve të këtij shteti apo edhe të huajve që jetojnë në atë shtet. Kështu, DUDNJ është si një frymëzuese e të gjitha këtyre dokumenteve të tjerë mbi të drejtat e njeriut që janë miratuar.

*Ç'kuptim ka Deklarata për fëmijët dhe rininë?*

Meqë Deklarata zbatohet universalisht, të drejtat e përfshira në të zbatohen jo vetëm në çdo vend të botës, por edhe për çdo fëmijë dhe të rinj. Megjithatë, përveç Deklaratës, për hir të statusit të ndjeshëm dhe jo shumë të fuqishëm që kanë në shoqëri, për fëmijët është miratuar një Konventë e Posaçme, në vitin 1959. Konventa rithekson disa nene të DUDNJ-së ashtu siç zbatohen tek fëmijët, duke shtuar se fëmija 'ka nevojë për elementë



të veçantë sigurie dhe kujdesi, përfshirë këtu mbrojtjen ligjore të përshtatshme, si para ashtu edhe pas lindjes ".

Sot, pas shumë vitesh që nga miratimi i DUDNJ-së, pavarësisht se janë bërë shumë luftëra e debate në çdo rajon të botës, është bërë progres i dukshëm në zhvillimin ligjor, moral e institucional në përputhje me parimet e shpallura në DUDNJ. Kështu, këtij dokumenti i referohen shpesh organizatat jo fitimprurëse që t'i kërkojnë llogari qeverisë për politikat dhe veprimet e tyre.

### Kreu III – NENET

#### **Neni 1.**

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi.

- *Trajtim ligjor*

Kjo është trajta definitive e nenit të parë që hap deklaratën universale, trajtë që qytetarët e globit njohin, kanë pranuar, dhe tentojnë ta përmbushin. Ky nen, ka një status të vecantë në tërësinë e neneve [gjithsej - 30] që përbëjnë deklaratën universale. Statusi i vecantë i nenit në fjale, lidhet dhe përcaktohet, për më shumë se një argument:

Lidhet me statusin që ky nen i jep “*qënies njerëzore*” si një specie e vecantë, me vetëdije dhe arsye, për të cilën vlen një dokument universal në mbrojtje të kësaj specie.

Lidhet dhe përcaktohet nga mesazhi gjithëkohor që përcjell: liri-barazi-frymë vëllazërore.

Lidhet dhe përcaktohet nga procesi që u ndoq dhe koha që kërkoi për t’u formuluar.

Lidhet dhe përcaktohet nga faktoret gjithëkulturore e etnopsikologjik, që u përfshinë në formulimin e këtij neni.

Neni 1 i DUDNJ është nen me karakter filozofik. Ai tregon se në të gjithë lindim të lirë e të barabartë me njëri-tjetrin e megjithatë nuk prezanton ndonjë të drejtë të cilën ne e gëzojmë për hir të të qenit njeri. Pra ky nen, është konsideruar se nuk shpall të drejta të realizueshme.

Neni 1 është mjaft i rëndësishëm. Për të janë përdorur terma të tillë si ‘parim bazë’, ‘gur themeli’, ‘djepi’ i DUDNJ-së, apo edhe ‘bazë’ apo themel’ për të drejtat e ndryshme të DUDNJ-së. Ky nen është konsideruar si neni që prezanton një parim që qëndron në themel të të gjitha të drejtave të parashikuara në nenet pasuese të DUDNJ-së.

Ky nen parashtron idenë që e drejta e të qenit të lirë e të barabartë është e bartur që nga momenti i lindjes e për këtë njerëzit duhet të trajtohen njësoj. Kjo është një doktrinë publike mbi gjendjen morale të çdo qenie njerëzore dhe kjo doktrinë është pranuar politikisht gjerësisht në botë. Ky qëndrim ka të bëjë me justifikimin e universalitetit të të drejtave të njeriut, pra të të qenit të drejta të përgjithshme për të gjithë njerëzimin. Qëndrimi është filozofik por jo me mbështetjen në besimin fetar - Zot apo në natyrë apo në natyrën njerëzore, edhe pse secila prej tyre mund të jetë e mirëpritur në interpretimin e këtij neni nga cilido. Neni kështu përcakton përcaktimin themelor të DUDNJ-së, që njeriu është qenie morale dhe racionale dhe se ai është kështu i ndryshëm nga krijesat e tjera në tokë, të cilat nuk mund të gëzojnë të drejta e liri të cilat njerëzit i gëzojnë.

Gjithshka u tha më lart duhet kuptuar qartë, sepse ne vërtet kemi lindur të lirë, por ama kemi edhe detyrime të cilat ne nuk i zgjedhim, por i gjejmë të atilla nga shoqëria e duhet t’i respektojmë. Kështu, duhet të respektojmë ligjin e t’i nënshtrohemi atij. Të drejtat më

të rëndësishme si p.sh të trajtuarit me dinjitet apo edhe e drejta për të mos u vrarë janë të drejta që qeniet njerëzore i gëzojnë që me lindjen e në mënyrë të barabartë të gjithë e që i gjejmë në çdo shoqëri ndoshta. Por, ne kemi lindur në vende të ndryshme dhe ligjet e zakonet e një vendi ndryshojnë, e kështu edhe të drejtat e individëve të këtij apo atij vendi ndryshojnë. Pra, ky nen nuk duhet kuptuar që siguron bazën për të drejta absolutisht të njëjta të të gjitha qenieve njerëzore kudo ku janë, por si një bazë mjaft e mirë që të gjitha vendet të kenë parasysh kur i njohin në nivel ligjor të drejtat e liritë e individëve të shoqërisë së tyre.

Kështu, neni 1 siguron një bazë të domosdoshme që në çdo rajon të botës të ketë një konsensus të qëndrueshëm mbi të drejtat e njeriut. Ky nen është hartuar që të mos përjashtojë njerëzit që i nënshtrohen çfarëdolloj feje apo tradite të shumicës.

- *Aspekte edukative*

#### *Pak histori*

Procesi i përgatitjes dhe formulimit të këtij neni, në trajtën që ne njohim, ka marrë shumë kohe, shume energji profesionistesh, shume ekspertizë, e cila i është nënshtuar një procesi të gjatë debati dhe opionence.

Ky nen është rezultante e një debati, konsensusi dhe kompromisi mes ekspertësh të pesë kontinenteve, vendeve, përfaqësuese të etno-psikologjive e kulturave të ndryshme, të cilët tentonin të përcillnin në nenin e parë, frymen, kulturën dhe projeksionet e kontinentit prej nga vinin. Në kohe, ky nen ka marrë rreth tre vjet, rreth 70 seanca, shume formate dhe formulime të cilat u seleksionuan, redaktuan deri në trajtën përfundimtare të gjithëpranuar, që ne njohim.

Frymën universale dhe të gjithëpranuar, të nenit – parë, dhe të deklaratës në tërësi e vet, e favorizoi konteksi historik në të cilën ajo u formulua. Njerëzimi kishte dalë nga dy luftërat botërore, i cilitur, i tjetërsuar, i dhunuar në identitetin e vet, me dëshirën pothuajse, instiktive, për të mbijetuar dhe për të instaluar paqen në planetin toke.

Është shume e dukshme fryma, *mbi dhe përtej* teorise së darvinizmit social, e Neni – 1 të deklaratës universale, teori që kishte sunduar, shekullin 19-të, sipas së cilës “.... *si organizmat biologjike dhe shoqëria njerëzore, luftojnë mes tyre, për mbijetesë, dhe se shoqëria perëndimore, ja ka dale në krye, duke arritur të mbijetoje ....* “ fq.609, *Antonym Gidens*.

Teoria në fjalë, ishte përdorur nga ithtarët e saj, për të stimuluar e përcuar idene e racës superiore kundrejt asaj inferiore. Neni 1 i DUDNJ-sw e konsideroi të tejkaluar këtë ide, kur theksonte se: ... *njerëzit janë të lindur të lire dhe të barabartë pavarësisht nga raca.*

#### *Karakterit aksiomatik i nenit - 1*

Tiparet e nenit të parë dhe dimensionet e tij, percjellin dhe i japin identitet gjithë dokumentit në fjalë, DUDNJ-së, ndaj merr kuptim të analizojme e trajtojmë **karakterin** e nenit – 1. Ky nen, për karakterin, natyrën e tiparet e tij, i cel rruge dhe i ben

universalisht të pranueshme, të aplikueshme, të përthyeshme, gjithë nenet që pasojne dokumentin.

Ky nen nuk ka, por dhe nuk mund të argumentohet, vecse të pranohet si aksiomë.  
Ky moment, shenoi dhe kerkoi, konsensusin e gjithë eksperteve te perfshire ne procesin e hartimit te nenit.

*Tiparet e nenit:*

### ***Deklarativ***

Tipar i dukshëm i nenit të parë është “deklarativiteti” i nenit. “*të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe të drejtave*”. Neni, ka natyre deklarative, pohuese, që nuk lë hapësire për të diskutuar për statusin e qënjes njerëzore.

### ***Mistik***

Neni i parë operon me termin “*qënie njerëzore*” të cilat lindin të lira dhe të barabarta {nga kush?.....} { të lirë dhe të barabartë ..... në raport me c’farë?..... me kë?..... dhe si mund të përmbushet kjo liri, barazi dhe fryme vëllazërore}.  
Ky nen, dukshëm dhe qëllimshëm, sanksionon statusin e vecantë të qënies njerëzore në raport me speciet e tjera, me argumentin e të qënies, *specie të pajisura me vetëdije e arsye*.

### ***Përtej-religjoze***

Ato {qëniet njerëzore .....të pajisur me arsye dhe vetëdije ..... nga kush ..... krijuesi....?} Gjatë procesit të hartimit të nenit, evitohen të gjitha përpjekjet e grupeve pjesëmarrëse, për të sjellë në përmbajtje të nenit – 1, fjalën “krijuesi”.  
Kjo i jep nenit të parë, fryme mbi dhe përtej religjioze, duke bërë që, religjonet e ndryshme, të qëndrojnë jashtë, dhe te evitohet cdo mundësi për të manipuluar me statusin e kesaj specie-njeriut, si specie e krijuar nga zoti. Dhe kjo e beri universalisht të pranuar, nenin ne fjalë.

### ***Përtej regjimeve politike***

Neni i parë shmang cdo hapësire apo mundësi për t’u trajtuar dhe kuptuar në frymen e regjimeve politike, të majta apo të djathta. I formuluar ne kontekstin e pas luftës së dytë botërore, tenton të qëndroje përtej regjimeve politike, dhe e arrin ta realizojë natyrën mbi dhe përtej tyre.

### ***Konsensual***

Ato {qëniet njerëzore ..... të barabarte ne dinjitetin dhe te drejtat.....} Vallë janë të lira qëniet njerëzore në momentin kur lindin, të jesh i lirë do të thote te jesh i ndwrgjegjshwm, apo e kundërta....} të qëniet i ndërgjegjshëm është mundësi për të qënë i lirë *apo prangim* i mundësisë për të qënë i lirë....Ky nen është rezultante e nje konsensusi mes ekspertësh, për të sanksionuar lirine dhe barazine e kesaj specie, si premisë dhe mundësi që kjo specie t’i garantohet me tej dinjiteti i mundshëm dhe i nevojshëm.

### ***Përtej gjinor***

Ato (qëniet njerëzore ..... të pajisur me arsye dhe vetëdije të veprojnë ndaj njera-tjetres në një fryme vëllazërore..... (pse jo motrore). Debati rreth formulimit “fryme vëllazërore” mori mjaft kohe në grupet e ekspertëve të përfshirë, deri në konsensusin përfundimtar për të ruajtur trajtën “frymë vëllazërore” me argumentin se me këtë term ishte operuar dhe në të gjithë librat e shënjtë, dhe se ky term nuk do të nxiste diskutime në të kundërtën dhe se nuk do të krijonte premise negative për seksin femëror.

Qëniet njerëzore nuk përfaqësojnë një gjini respektive, ato i përmbajnë të dyja dhe qëndrojnë mbi e përtej tyre. Termi vëllazëror përdoret vetëm në kontekstin e frymës së bashkëpunimit, por jo të gjinisë së mirëfilltë.

Keqkuptimet e mundëshme, apo mundësitë për të manipuluar në emër të seksit të fortë, {mashkullit}, u evituan tërësisht, në nenin – 2, ku deklarohen të drejta të plota dhe liri për çdo njeri, pavarësisht nga seksi.

### ***Universalisht i aplikueshm***

Ato (qëniet njerëzore, si një specie e vecantë në shumëllojshmerinë e të gjallës, me arsye dhe vetëdije, të lindur të lire dhe të barabartë, përtej seksit dhe përtej besimit....) kjo sipas Chang, eksperti kinez, e bëri universalisht të aplikueshëm nenin në fjalë.

Duke qënë *përtejreligjuz dhe përtejgjinor*, neni-1 fitoi automatikisht, dhe tiparin, universalisht i aplikueshem.

Në nenet 1 – 10 operohet me termat:

- ***Qënie njerëzore***
- ***Individ***
- ***Njeri***
- ***Person***

Ky fakt nuk mund të konsiderohet rastësor. Ekspertët kanë qënë të qëllimtë në përzgjedhjen dhe përdorimin e termave. Fakti që neni i parë, *dhe vetëm neni -1*, zgjedh të operojë me termin ***“qënie njerëzore”***, përcjell idenë se kjo, ka status të vecantë në tërësinë e specieve të gjalla që njihen deri me sot. Në asnjë nga nenet që pasojnë deklaratën universale nuk operohet më, me termin *“qënie njerëzore”*

Termi ***“individ”*** përcjell idenë e të qënies unikal, i papërsëritshëm brenda species, llojit, dhe si i tillë, vlen të mbrohet individualiteti dhe unikaliteti i çdo qënie njerëzore, brenda species së vet.

Termi ***“njeri”*** përcjell idenë se kjo specie e vecuar nga tërësia e gjallesave, e quajtur *“njeri”* mbart dhe prodhon qëllimshëm, pjesën – *“soft”*: emocionet dhe ndjenjat, dhe se është e aftë, jo vetëm t’i prodhojë, por dhe t’i përcjellë e përthyejë ato, në raport me veten, të tjeret, dhe pse wshtw e arsyeshme dhe e vetëdijshme, disponon mekanizmin e pasurimit e menaxhimit të tyre.

Termi ***“person”***, përcjell idenë se, çdo njeri prej tyre, individ, brenda species, është unikal, i pajisur me arsye, vetëdije, pjesëtar i species së përzgjedhur, gjinisë njerëzore, dhe si i tillë, {përfaqëson një personalitet}, ndaj, vlen, të ruhet dhe të mbrohet në unikalitetin e tij nga institucione të tjera, të prodhuara nga shoqëria. Termi ***“person”*** aplikohet në të

gjitha rastet kur, nenet ftojnë, për t'u marrë në mbrojtje kjo specie - qënia njerëzore, nga institucionet e ngritura po nga shoqëria.

*Neni – I i DUDNJ dhe kurrikula shkollore në ciklin e mesëm*

I mundswm dhe i nevojshëm për t'u përdorur në lëndët:

**Vecmas: Njohuri për shoqërine; Edukim Ligjor; Filozofi; Biologji; Histori .**

Lëndët e lartpërmendura, por jo vetëm ato, iu lind nevoja, dhe iu krijohet mundësia, të operojne me termat individ, qënie njerëzore, person, njeri, liri, e drejtë, i barabartë, unikal, vetëdije, etj, terma dhe koncepte me të cilat operon neni i parë i DUDNJ-së.

Është tërësisht e mundur dhe e nevojshme, të silllet në klasë fryma e këtij dokumenti, vecmas e nenit të parë, që sanksionon statusin e vecantë të gjinisë njerëzore, species së përzgjellur, dhe argumentet pse kjo ka ndodhur.

Mësuesit e lëndëve të mësipërme, mund të sjellin ne perspektivat e lendes se tyre nenin e parë të DUDNJ-së dhe të nxisin nxënësit si të kuptojne përmbajtjen dhe mesazhin e këtij neni nga:

- **Perspektiva e biologjise:** {Qënia njerëzore në raport me speciet e tjera, epërsitë që ne njohim ne raport me të tjerat}
- **Perspektiva e filozofise:** {Qënia njerëzore: e arsyeshme dhe e vetëdijëshme për sjelljet e saj dhe të tjereve}
- **Perspektiva e sociologjise:** Kuptimi individual dhe kolektiv per lirine. Qënia njerëzore formulon nje kuptim per veten dhe per te tjeret dhe mbi kete bazë vendos nje raport me lirinë ndaj vetes dhe grupit. Qënia njerëzore si e vetmja që zotëron mekanizmin e menaxhimit të lirisë, dhe skllavërsisë.
- **Perspektiva e ligjit:** {qënia njerëzore, mbrohet dhe ndeshkohet njekohësisht, nga ligji}. Ligji prodhohet nga shoqëria në emër të mbrojtjes se njeriut, apo....?
- **Perspektiva e historise:** Si e shikon qënia njerezore të djeshmen e vet. {Qënia njerëzore në evolucionin historik. Qënia njerëzore dhe projeksionet e saj per ngjarjen historike dhe mekanizmi i saj per t'u perballur me ngjarjen historike, dhe, për të projektuar perspektiven mbi të retrospektiven}

**Përmbyllje:**

Neni i parë i DUDNJ-së është NEN, që udheheq gjithë nenet e tjera. Në këtë kuptim, mund të konsiderohet si thembra e Akilit, apo filli i Penelopës. Të gjitha përmasat dhe mesazhet e neneve që vijojnë në DUDNJ, derivojnë prej këtij neni, vihen në zbërthim dhe në funksion të tij, i japin kuptim cdo fjale të përfshirë në nenin e parë.

**Koherenca dhe interferenca,** janë dy parimet bazë, mbi të cilin është ndërtuar gjithë DUDNJ-ja. Këto parime, identifikohen vetëm në rastet kur kërkohen lidhjet mes nenit të parë dhe 29-neve të tjera.

Nenet që vijojnë në dokumentin në fjalë, nuk kanë natyrë deklarative, as, mistike. Ato vihen në funksion të të kuptuarit dhe aplikimit të nenit të parë të DUDNJ-së. Ndaj të kuptuarit e thelbit, mesazhit, dhe përmasave të nenit të parë, është para-kusht për të percjelle *sa dhe si* duhet përmbajtjen e gjithë neneve të tjera, dhe frymen e DUDNJ-së në tërësi.

*Detyrë:*

1. Nga Kushtetuta e RSH-së, Identifikoni nenet që percjellin frymën e nenit të parë të DUDNJ-së. Sillni arsyetimin tuaj për këtë
2. Nga perspektiva juaj, arsyetoni, dy parimet mbi të cilat është ndërtuar DUDNJ-ja: koherenca, interferenca.
3. Nga perspektiva juaj, arsyetoni, përmbajtjen e termit “qënie njerezore” në nenin e parë të DUDNJ-se.
4. Ndani klasën në dy grupe të barabarta. Emërtoni njërin grup ‘Elita’ dhe tjetrin “Të thjeshtët”. Jepini “Elitës” privilegje pa ndonjë arsye të dukshme (jo sepse ata bënë diçka për t’i fituar këto privilegje, por vetëm sepse kështu ju pëlqen ju).

Këto privilegje mund të përfshijnë të tilla si :

të marrësh pushimin mes orëve kur të duash dhe sa herë të duash,  
të mund të mos vish në mësim ditën e fundit të javës dhe ditën e parë të javës,  
të mund të ulesh ku të duash dhe me kë të të pëlqejë në çdo orë,” etj.

Bëjeni këtë për gjysmën e kohës së caktuar për këtë aktivitet, qoftë kjo një ditë apo disa orë. Grupet e dinë se si janë ndarë dhe se ç’privilegje ka grupi “Elita”.

Për gjysmën e dytë të kohës që ju keni caktuar ndryshoni grupet, pra “Elita” bëhet “Të thjeshtët” e “Të thjeshtët bëhet “Elita”. Mos i njoftoni për këtë ndryshim grupet në fillim të këtij aktiviteti.

Kërkojini nxënësve të shkruajnë një ese të shkurtër për mënyrën se si kjo ndarje i bëri ata të ndiheshin dhe pse është e rëndësishme që gjithkush të trajtohet si i lirë dhe i barabartë.

5. Mundësi për diskriminim: Nga perspektiva juaj sillni përmbajtjen e konceptit “i lirë”; “i barabartë” .

## Neni 2

**Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.**

- *Trajtim ligjor*

Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjendet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit.

Deklarata Universale njih detyrimin që shtetet të promovojnë respektin dhe njohjen universale të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore pa dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, besimi fetar, mendimi politik, origjine kombëtare, pasurie etj. Kjo deklaratë përcakton standarde të përbashkëta për tu arritur, që synojnë njohjen dhe respektimin efektiv të të drejtave të njeriut. Një shtet që është palë në një traktat ndërkombëtar të të drejtave të njeriut ka detyrimin që t'i sigurojë këto të drejta të gjithë individëve që jetojnë e gjenden në juridiksionin e tij, dhe të sigurojë mbrojtje dhe dëmshpërblim efektiv në raste shkeljesh të tyre.

Neni 2 i DUDNJ-së synon të zhdukë ato dallime që kanë ekzistuar përgjatë historisë së njerëzimit në lidhje me gëzimin e të drejtave të caktuara. P.sh., të drejtën për të zgjedhur nuk e kanë gëzuar gratë, apo ato që nuk kishin një nivel të caktuar pasurie. Këtë Deklaratë nuk e toleron më. Të gjithë duhet të gëzojnë këtë të drejtë pavarësisht nga gjinia. Po kështu, Deklarata nuk toleron asnjë trajtim të ndryshëm të personave për shkaqet e tjera që ajo rendit.

Shkaqet për mosdiskriminim janë të renditura në mënyrë jo të shterrueshme në këtë Deklaratë. Ato që janë përmendur aty janë shkaqe që përgjatë kursit të historisë janë hasur në shoqëri të ndryshme dhe që kanë qenë të pranishme më shpesh, por nuk janë të vetmet. Deklarata shumë qartë thotë që mund të ketë edhe ndonjë shkak tjetër që një shoqëri mund ta përdorë për të mos i njohur një të drejtë apo liri dikujt apo një grupi shoqëror, dhe që edhe ai shkak, cilido qoftë, nuk duhet të tolerohet.

Gjithashtu Deklarata thekson se shtetet kanë përgjegjësi prioritare promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Për këtë, shtetet duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë edhe miratimin e garancive ligjore, për të siguruar që kushdo mund të gëzojë këto të drejta në praktikë, individualisht dhe së bashku me të tjerët. Në vazhdë të këtij detyrimi të përgjithshëm për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut, shtetet duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme që të drejtat dhe liritë e veçanta të mbrojtësve të të drejtave të njeriut të garantohen veçanërisht.



Përveç detyrimeve që vendos ky nen i Deklaratës për shtetet, kërkon që askush të mos diskriminojë. Të gjitha të drejtat i takojnë të gjithëve pavarësisht nga ndryshimet që kanë këta njerëz.

#### Kushtetuta dhe mos diskriminimi

Kushtetuta e vendit tonë parashikon që në nenin e parë të kapitullit që i referohet të drejtave e lirive të njeriut se të drejtat janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe se qëndrojnë në themel të rendit juridik.

#### *- gëzimi i të drejtave njëloj nga të gjithë që jetojnë në vend - territori*

Të gjitha të drejtat e parashikuara në Kushtetutë e ligje vlejnë njëloj për të gjithë që ndodhen në territorin e vendit. Pra Kushtetuta njeh trajtimin njëloj të kujtdo në Shqipëri, pavarësisht nga shtetësi, edhe pse vetë Kushtetuta ruan një hapësirë për shtetin të rregullojë ndryshe me ligj gjendjen e gëzimit të të drejtave dhe lirive nga të huajt e personat pa shtetësi.

#### *- barazia para ligjit*

DUDNJ kërkon që të gjithë të trajtohen njësoj para ligjit. Kushtetuta jonë në nenin 18 thekson se ‘të gjithë janë të barabartë para ligjit’ e vijon duke renditur disa shkaqe për mosdiskriminim, të cilat janë renditur më poshtë. Ka një dallim mes Kushtetutës sonë dhe DUDNJ-së në këtë renditje sepse DUDNJ e lë të hapur listën, ndërkohë që Kushtetua jonë ka një listë që nga përmbajtja duket e shteruar, si më poshtë:

#### **Lista e shkaqeve në bazë të të cilave nuk mund të diskriminohet askush sipas DUDNJ-së dhe Kushtetutës sonë**

MOSDISKRIMINIMI		
sipas DUDNJ	sipas Kushtetutës sonë	
Raca	raca	
Ngjyrës	.....- nuk përmendet	
Gjinisë	gjinia	
Gjuhës	gjuha	
besimit fetar	feja	
mendimit politik ose tjetër	bindje politike, fetare apo filozofike	
origjinës kombëtare a shoqërore	etnia	
pasurisë	gjendja ekonomike	
lindjes	përkatësia prindërore	
.... - nuk përmendet	gjendja arsimore, sociale	
tjetër	nuk lihet e hapur	

Parimi i barazisë para ligjit gjen vend në shumë ligje të vendit tonë. Kështu, Kodi i Procedurave Administrative, ligji i cili parashikon rregulla të funksionimit të organeve

shtetërore apo publike në vend, thekson në Nenin 11 të tij kërkon që “në marrëdhënie me personat privatë, administrata publike udhëhiqet nga parimi i barazisë në kuptimin që askush nuk duhet të privilegjet apo diskriminohet për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë. Ky parim gjendet në bazë të Kodit të Punës, Ligjit për arsimin e lartë dhe atë për arsimin parauniversitar.....

#### *Përjashtimi nga mosdiskriminimi dhe diskriminimi pozitiv*

Vërtet Kushtetuta kërkon që askush të mos diskriminohet, por ajo lë hapur edhe mundësinë e një diskriminimi apo privilegji, atëherë kur ka një përligje të arsyeshme dhe objektive. Kjo në gjuhën e akteve ligjore të miratuara në mbarë botën njihet me termin diskriminim pozitiv apo veprim pohues. Kjo do të thotë që Kushtetuta jonë lejon që shteti të ndërmarrë masa të cilat mund të jenë një privilegj për një grup të caktuar të shoqërisë dhe kjo konsiderohet si e lejuar. Duhet kuptuar që kjo situatë, që në vetvete shkel parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, lejohet për sa kohë është e përkohshme dhe për sa kohë synon marrjen e masave të cilat synojnë të balancojnë efektet e diskriminimeve në të kaluarën, të shuajnë diskriminimin aktual dhe të promovojnë mundësi të barabarta për të gjitha grupet sociale (p.sh. mes burrave dhe grave) veçanërisht në lidhje me situata apo pozicione në të cilat anëtarët e njërit grup janë dukshëm të papërfaqësuar. Nuk preferohet që të tilla ligje të jenë shumë afatgjata, sepse përndryshe do të krijonin ato vetë diskriminim të një tjetër grupi të shoqërisë përkundrejt atij që privilegjet.

Në vendin tonë ka shembuj të ligjeve të cilat kërkojnë një trajtim më të diferencuar të ndonjë kategorie të caktuar të shoqërisë. Kështu, p.sh. në Ligjin Nr.7995, datë 20.9.1995, “Për Nxitjen e Punësimit”, Neni 15, kërkohet që punëdhënësit të punësojnë një person me aftësi të kufizuar për çdo 25 punonjës të personelit të tij, duke krijuar kështu një favorizim punësimi për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, me qëllim integrimin e tyre në shoqëri.

Edhe partitë politike, si fillesa të institucioneve apo bartëse të politikave të mundshme të vendit, kanë përshtatur rregulla të diskriminimit pozitiv. Ka shembuj nga partitë tona që kanë pranuar që një përqindje e caktuar (30%) e kandidatëve për deputetë në Kuvend të jenë domosdoshmërisht femra, me qëllim rritjen e numrit të grave në jetën politike të vendit dhe në pozicione vendimmarrëse.

#### • *Aspekte edukative*

Neni – 2, gjendet i formuluar në dy pjesë.

Tipar i dukshëm i këtij neni, është fakti që ai derivon tërësisht nga neni i parë, por, ndryshe prej tij, nuk është aksiomatik, dhe nuk ka tipare deklarative, as mistike. Neni – 2, garanton statusin e vecantë të qënies njerëzore si qenie unikalë, duke mos shtuar argumente të tjera, vec të qënës i arsyeshëm dhe i vetëdijshëm. Neni - 2. pika1. deklaron se: *për arsye dhe, ne vijim te statusit që i është dhënë qënies njerëzore, dhe me arsyet e përmendura në nenin e parë, {Ato... – qëniet njerëzore, gëzojnë të gjithë liritë e shpallura, pa asnjë dallim, vecanarisht për nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, opinioni*

*politik, ose cdo opinion tjetër, ose cdo situatë tjetër}. Thënë ndryshe ato i gëzojnë të gjithë të drejtat, pikërisht, se janë qenie njerëzore me vetëdije dhe të arsyeshme. Nëse neni- i parë deklaron të qenët i lirë dhe i barabartë në dinjitet, të qënjes njerëzore, Neni 2, pika 1, zgjeron dhe ofron mundësi të kuptohen dimensionet dhe fryma e nenit të parë.*

Aty thuhet:

*“secili mund (por nuk përmendet fjala – duhet) të gëzojë të gjitha të drejtat dhe të gjitha liritë e shpallura në deklaratë ... përcjell idenë se (potencialisht secili mund të gëzojë liritë e shpallura, por jo domosdoshmerisht...secili mund të gëzojë liritë e shpallura në deklaratë, por në varësi të situatës në të cilën gjendet).*

Pasi jo të gjithë njerëzit janë njësoj të arsyeshëm dhe të vetëdijshëm për të gëzuar liritë e shpallura në deklaratë, rrethanat personale, politike, sociale, ekonomike, arsimore jo gjithmone të krijojnë mundësi dhe të favorizojnë të gëzosh të drejtat dhe liritë e shpallura në deklaratë. Liritë nuk mund të gëzohen, përmbushen gjithmone, në të njëjtën cilësi, por në varësi të rrethanave, grupit ku bën pjesë, individualitetit, dhe personalitetit, grupit etno-psikokulturor ku bën pjesë, dhe të asaj që vetë njeriu, përfaqëson.

*Tipare të nenit – 2*

Operohet me fjalën “secili”, që do të thotë se, është ndërtuar me një frymë gjithëpërfshirëse

Operon me fjalën “duhet” por shmang fjalën “mundet”

Operon me fjalën “liritë e shpallura në deklaratë” që do të thotë se gëzon të drejtën e liritë të shpallura në deklaratë por, jo të cdo lloj lirie. Ka një lloj kufizimi, kuptimin e të cilit, mund t’u fitojmë më pas në nenet që vijojnë.

Operon me termin “gëzon të gjithë të drejtat e shpallura në deklaratë” pa asnjë dallim nga:

### **Raca**

Neni – 2 vecmas paragrafi – 1, krijon mundësi për të evituar dallimet me bazë ngjyren, duke evituar përfundimisht, dallimet racore, si burim potencial luftërash dhe diskriminimi social në planetin tonë.

### **Ngjyra**

Neni – 2 vecmas paragrafi – 1, shmang dhe mbyll gjithë parahistorinë e diskriminimit racor në vende të ndryshme dhe sjell një erë të re vecmas në kontinentin e Amerikës. Neni -2 vecmas paragrafi-1, krijon mundësi për kohezion dhe bashkëpunim racor, në pesë kontinentet. Ky nen mbyll cdo mundësi për të inicuar genocid apo fenomenin “aparteid” për shkak të ngjyrës.

### **Seksi**

... eviton cdo mundësi për parapëlqime apo preferenca me pikënisje seksin duke sjellë një frymë të re emancipimi shoqëror duke krijuar hapësira të reja për pjesëmarrje të seksit femër. Ky nen u be pikënisje për të formuluar me vone dokumentin unikal në

mbrojtje te grave: Konventen per mbrojtje te gruas - dokument qe ngrihet mbi parimin “diskriminim pozitiv gjinor”

### **Gjuha**

Ky nen i jep status të vecantë të gjitha gjuhëve të folura pavarësisht nga historia e shkrimit të saj, apo numri i përdoruesve, gjuha e folur nuk do të përbente barrierë për të shpallur dhe mbrojtur individualisht dhe ne kolektiv, të drejtën e gëzimit të lirive, duke evituar, teorite e racave dhe gjuhëve superiore.

### **Feja**

Besimi dhe perkatësia fetare kapërcehet tërësisht dhe secili individ gëzon të drejtat dhe liritë e shpallura në deklaratë. Besimet fetare dhe aplikuesit e feve respektive, si dhe perkatesite fetare, janë njëlloj të barazlanguar nga nenet e përfshira në DUDNJ.

### **Opinionit politik**

Duke ju referuar kontekst historik kur u formulua DUDNJ-ja pasojat e luftës së dytë botërore, DUDNJ-ja i la mjaftueshmerisht hapësire të menduarit pluralist politik, dhe përkatësisë politike. Ato nuk përbejne barrierë për secilin individ apo grup kur është fjala për të gëzuar të drejtat dhe liritë e shpallura në Deklaratë. Ky nen, kapërcen “murin e ftohte” që u vendos pas luftës së dytë botërore, liritë e shpallura në deklaratë i gëzon cdo individ jashtë sistemeve politike ku ata gjenden.

#### *Paragrafi 2 i nenit -2*

*2. Vec asaj, nuk duhet të behet asnje dallim mbi bazën e statusit politik, juridik apo ndërkombëtar të vendit ose territorit, shtetësine e të cilit ka një person, qoftë kur ky vend ose territor është i pavarur, nën kujdestari, jo autonom, ose i kufizuar në ndonjë mënyrë në sovranitetin e tij.*

Ky paragraf fokusohet tek e drejta e secilit ne pikëpamjen e statusit politik, juridik, ndërkombëtar, dhe merr ne mbrojtje jo theshte, qënien njerëzore, por, “shtetasin”, qoftë ky në një vend të pavarur, kujdestari, joautonom, i kufizuar ne sovranitetin e tij.

Merr kuptim dhe fiton rendesi termi “shtetas” Lirite dhe te drejtat e individit ne momentin kur trajtohet “shtetas” trajtohen ne nje kend te ri. Si individ gëzojme liri dhe te drejta te tjera, nga ato që gëzojme si “shtetas”. Jo përhere shteti të garanton të gjitha liritë që individi gëzon si i tillë. Lirite dhe te drejtat e si “shtetas” kuptohen ne raport me ato që shteti ku individi ben pjese, ka shpallur dhe deklaruar.

Ky paragraf vecmas merret vetem me statusin që ka secili si shtetas duke shpallur të drejtat e secilit në dhe brenda shtetit të tij.

Fakti që i kushton nje paragraf të plote statusit politik dhe juridik të personit percjell idene se individet kanë shume nevojë të mbrohen nga shtetet e tyre në rradhe të parë.

#### ***Tipar i paragrafit***

#### **Përmasa hapësinore**

Shpall në mbrojtje cdo individ, shtetas, qoftë në një shtet autonom, i varur, në kujdestari, i kufizuar.

### **Karakter normativ**

Paragrafi – 2 i nenit – 2, operon me fjalinë, “*nuk duhet të behet asnjë dallim mbi bazën e statusit politik, juridik, nderkombëtar*”

Paragrafi ne fjalë nuk “garanton” mbrojtje, por nuk “lejon” shkelje të shpallura në deklaratë.

Paragrafi 2 i nenit – 2, zgjell te operojë me termin “person” “shtetas”

### **Veprimtari**

1. Vereni dhe komentoni tabelen e “Mosdiskriminimit” sipas DUDNJ dhe Kushtetutws sw Shqipwrisw:
  - a. Komentoni diferencat mes dy dokumenteve, DUDNJ-se dhe Kushtetuses se RSH
  - b. Organizohohuni ne dy grupe dhe gjeni argumente pse ka ndryshim mes dy dokumenteve
2. Nga perspektiva juaj:
  - a. diskutoni sa eshte i vertete pohimi që vijon
  - b. sillni argumente pro dhe kunder
  - c. ballafaqoni me mundesite per te gezuar lirite e shpallura ne deklarate me veten

”Rrethanat personale, politike, sociale, ekonomike, arsimore jo gjithmone të krijojnë mundësi dhe të favorizojnë të gëzosh të drejtat dhe lirite e shpallura në deklaratë. Liritë nuk mund të gëzohen, përmbushen, gjithmone, në të njejtën cilësi, por në varësi të rrethanave, grupit ku bën pjesë, individualitetit, dhe personalitetit, grupit etno-psikokulturor ku ben pjese, dhe të asaj që vetë njeriu, përfaqëson.”

2. Duke u nisur nga përmbajtja e nenit-2, paragrafi/2 projektoni, statusin e nje qytetari kosovar në kushtet e qeverisjes nga UMNKU-t dhe qeverisjes vendore.
  - a. Cilat nga lirite gezohen, permbushen, ne varesi te situates ne te cilen ndollen, ne mungese te nje shteti te pavarur.
  - b. Duke ju referuar këtij paragrafi sillni kuptimet tuaja rreth “përmasave” dhe “fuqise” që merr termi “qytetar”, “shtetas” “person” në rastin ne fjalë, si dhe termat: status politik, juridik, autonom.
3. Listoni deri tri te drejta që gezoni si individe të lire, dhe tri te drejta që gezoni si shtetas.
  - a. Krahasoini ato mes tyre
  - b. Sillni argumente pse ndryshiohen te drejtat si individ me te drejtat si shtetas.

4. Nga perspektiva juaj sillni komente pse neni ne fjale parapelqen te operoje me fjalën “duhet” por shmang te perdore fjalën “mundet”

### **Situata rasti**

1. Në shtetin {X} është miratuar një ndryshim në ligjin mbi Imigrimin dhe depërtimin nga vendi. Liigji parashikon disa rregulla mbi statusin e të huajve të martuar me shetas të vendit X, gjithashtu, parashikohet se të huajt burra të martuar me gratë shtetase të shtetit {X} nuk gëzojnë statusin e rezidentit në shtetin X, ndërkohë nuk ishte kështu gjendja e personave që ishin martuar me burra shtetas të shtetit X.

Para miratimit të këtij ndryshimi, kushdo që martohej me shetas të shtetit X fitonte statusin e rezidentit në shtetin X. Më tej, parashikohet që për rastin e martesave me shetas të vendit dhe refuzimit të dhënies së lejes së qëndrimit nuk ekzistonte e drejta e ankimit në gjykatë.

### **Nga perspektiva juaj ky ligj:**

- a. Diskriminon në bazë të seksit gratë në vend
  - b. Cenon të drejtën për të krijuar një familje
2. Në Komisionin e Bashkimit Evropian, ndër dokumentat e tjera që duhen dorëzuar për t’u punësuar, është dhe një test (konfidencial) i HIV/AIDS. Qytetari A.F aplikon për t’u punësuar si daktilograf për një periudhë 6 mujore dhe në kuadrin e plotësimit të dokumentacionit kryen edhe testin HIV/AIDS. Rekomandimi mjekësor sugjeron se kandidati nuk është i përshtatshëm për vendin e punës. Ky konkluzion, ndër të tjera, ishte bazuar në faktin e “numërimit të limfociteve T4/T8-test ky i gjakut, i cili zakonisht aplikohet për të vlerësuar ndikimin (indirekt) të infeksionit HIV”. Qytetari, A.F. i refuzohet vendi i punës.

Nga perspektiva juaj dhe e DUDNJ-se :

Qytetari nuk gëzon te drejtat e parashikuara ne DUDNJ

3. D.H, shtetas amerikan (SHBA) i martuar dhe rezident në Zvicër kish emigruar nga Çekosllovakia në vitin 1968. Për shkak se ai u konsiderua nga autoritetet përkatëse Çekoslloake se kish emigruar në mënyrë të paligjshme nga vendi, ai u dënua me burg, në mungesë, dhe e gjithë pasuria e tij u konfiskua.

Në vitin 1990, me vendim gjykate të Pilsenit , D.H. rehabilitohet dhe kështu nis procesin për të rimarrë pronat e konfiskuara më parë nga shteti Çekoslovak. Por të gjitha përpjekjet e tij dështojnë. Kjo për arsye se në vitin 1992 Qeveritë e Federatës Ceke e Slloake miratojnë një ligj sipas të cilit duhet të jesh shtetas i kësaj Federate që të përfitosh nga kthimi i pasurive të konfiskuara apo të marra në mënyrë të padrejtë.

A ka diskriminim në trajtimin nga ligji për kthimin e pronave të personave të cilët për arsye të ndryshme janë larguar nga Çekosllovakia dhe kanë ndryshuar shtetësinë? Nëse po, mbi ç’baza?

### Neni 3

#### Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.

- *Trajtim ligjor*

- *Asepkte edukative*

Neni – 3 është në koherencë dhe ne vijim të nenit të parë ku thuhet: “qëniet lindin të lira...” ndaj kanë të drejtën e jetës. Ky nen vazhdon të përmbushë kuptimin dhe përmasat e nenit të parë, duke vecuar në një nen të posacëm, tri të drejta themelore:

të drejtën e jetës,

të lirisë,

të sigurisë së personit.

Neni – 3 parashtron tri kollonat themelore të drejtave, si pika e nisjes, pa të cilat nuk garantohet egzistenca dhe vazhdimësia e gjinise “njerëzore”

Secila nga tre të drejtat e përfshira në nenin – 3, janë të barazvlerëshme, por vetëm e drejta e parë, ajo e jetës, është *e patjersueshme*. Të tre të drejtat e formuluarat në nenin – 3 përfaqësojnë të drejta burimore:

#### Që do të thote se:

- E drejta për t’a jetuar jetën është vetëm dhe vetëm e personit, se jetën e nje personi nuk mund t’a gëzoje askush tjetër.
- E drejta e jetes kuptohet si: e drejta për banese, ushqim, riprodhim, e cila nuk mund të transferohet nga një person tek tjetri, ato i gëzon vetëm personi vetë.
- Liria e personit *varet* por nuk *kushtezohet* nga liria e tjetrit.
- Siguria e personit, duhet kuptuar si siguria dhe mbrojtja nga: tortura dhe skllaveria dhe *tjersimi i bashkësisë njerëzore*.

E shprehur me konfigurativisht mund të jetë si vijon:

E drejta e jetës	E drejta e lirisë	Sigurisa e personit të vet
Neni – 3 nuk tenton të theksoje jetën në kuptimin <i>biologjik</i> , përndryshe mund të ishte operuar me termin “ <i>egzistencë</i> ”.	Neni - 3 tenton të përjashtojë çdo mundësi që liria e nje individi të kushtëzohet nga e nje individi, tjetër.	Ka të beje me sigurimin e e lirisë së nevojshme për të realizuar të drejtën e jetës ne kushte të cilat nuk të tjetersojne dhe shfityrojnë bashkësinë njerëzore.
E drejta e jetës sipas këtij neni është e <i>patjetersueshme</i> . Nuk mundet, jeten time ta	<i>Liria e individit, mund të varet, por jo të kushtezohet.</i>	Sklavëria, dhunimi, e tjer, e tëhuazojnë njeriun dhe e nxjerrin nga bashkësia e vet.

gëzoje dikush tjetër, dhe anasjellëtas.		
-----------------------------------------	--	--

## **E drejta e jetës.**

**Një nga çështjet më të diskutueshme:** Nga cili moment deklarata mbron të drejtën e jetës?

**Së pari:** A mbrohet e drejta e jetës që nga momenti i “konceptimit” të fetusit, apo nga momenti i lindjes?

Ka pasur këndvështrime të ndryshme lidhur me momentin e mbrojtjes së jetës. Disa ekspertë sillnin argumente se, mbrojtja fillon në momentin e konceptimit të fetusit, duke denuar abortin e provokuar. Të tjerë, sillnin argumente se mbrojtja e jetës fillon në momentin e lindjes së individit.

Duke mos arritur në një marrëveshje mes eksperteve, DUDNJ-ja merr në mbrojtje individin që nga momenti i lindjes. Në shumë vende lejohet e drejta e abortit. Në mbrojtje të idesë për t’u mbrojtur individin që në konceptim ka qënë për një kohë të gjatë institucionin i Vatikanit, me idene se jeten e sjell krijuesi dhe se njeriu, nuk është vecse, pjelle e tij, *ndaj, nuk gëzon të drejtën ta marrë jetën e askujt.*

Edhe KEDNJ-ja, në praktikën e veta, nuk ka dhënë një mbrojtje të fetusit që prej momentit të konceptimit.

**Se dyti:** Deri kur mbrohet jeta e individit sipas DUDNJ-së?

Një nga çështjet e debatueshme ka qënë se deri në c’farë momenti i duhet asistuar një individ që vuan një sëmundje të pashërueshme. Veprimi apo mosveprimi në raport me individin në fjalë quhet “eutanazi”.

Argumentet kanë qënë diverse nga këndvështrime të ndryshme. Por DUDNJ-ja e konsideron cënim të nenit – 3 mos asistencën mjekësore tek individ që vuan sëmundje të pashërueshme. Ende vazhdon të jetë pikë e debatueshme e nenit – 3.

**Së treti:** E drejta e jetes në pikëpamjen e mbrojtjes nga veprimet arbitrarë të shtetit. Denimi me vdekje. Në shumë shtete është përjashtuar nga legjislacionet themelore si kushtetuta denimi me vdekje i i individit. Deklarata nuk e denon plotësisht dhe përjashtimisht denimin me vdekje, përveçse atë të individëve deri 18 vjec dhe grave shtatëzana.

KEDNJ –ja në protokollin e 6v – të saj, dënon dënimin me vdekje në kohë paqeje. Shqipëria ka evituar denimin me vdekje në vitin 1996, dhe në vitin 2000 ky dënim u hoq nga kodi penal civil. Zbatimi i dënimit me vdekje në kohe lufte është i kufizuar.

**Së katërti:** Mundet që jeta e nje personi {shtetasi} të kercënohet nga një person {shtetas} tjetër. Çështje e diskutueshme mbetet, nese shteti i garanton apo jo, mbrojtje të jetës një personi në rrezik dhe deri në c’farë momenti dhe për sa kohe, kjo duke i vene roje personale apo menyra të tjera.



E drejta e jetes

Sillni raste kur e drejta e jetes i mohohet dikujt

*Rasti i denimit me vdekje a është një mohim i nenit – 3 të DUDNJ-së*

*Evitimit i denimit me vdekje a tenton të sjelle fryme emancipimi në jetën e shoqërisë apo...?*

*Sillni deri tre argumente pse duhet të evitohet rasti i denimit me vdekje.*

*Sillni tre argumente pse e mbajnë shtete te caktuara këtë formë denimi.*

*Pse në koe lufte denimi me vdekje merr nje tjetër kendshikimi dhe intrepretimi?*

E drejta e lirise

Veconi deri tri të drejtat te mundëshme që gezon nje i burgosur politik

Sillni tri të drejta {kodi penal} Vasilika

*Mundesi per diskutim*

### **Situatë rasti - 1**

Infermjerja {x} përmbush lutjet e pacientit të saj për të mos marrë morfinen e nevojshme per qetësim të dhimbjes. Këtë e ben ne emër të lutjeve që vine nga pacienti i cili vuan pa asnje shprese shpetimi, prej nje kohe shume të gjatë.

Pacienti insiston të mbylli ciklin e jetes së tij, i pashpresë.

Infermierja, del përtej detyrës së saj njerëzore dhe qytetare...apo përmbush dëshirën e pacientit të saj

### **Komentoni dhe ndahuni në dy grupe:**

Sillni argumente te mjaftueshme pro dhe kunder veprimit të infermieres

Sillni argumente nga pikpamja e pacientit

Sillni argumente nga pikëpamja e DUDNJ-së

Komentoni “eutanzine”

Pozicionohuni permes argumentesh personale

Sillni raste të ngjashme

### **Situatë rasti – 2**

Prej 17 vjetësh pacienti jeton ne gjendje kome. Jeta e tij eshte vecse biologjike. Jeton në saj të asistences dhe kujdesit mjeksor. Nga perspektiva juaj, pacienti ne fjale, jeton apo jo.

A vlen te jetoje....?

Komentoni cilesine biologjike dhe sociale te jetes se pacientit

Komentoni jeten e individit ne fjalë nga pikepamja e DUDNJ-se

Komentoni jeten e pacientit ne fjale nga pikepamja e religjonit

**Detyre:**

Nga perspektiva juaj sillni kuptimet per:

te drejta burimore

të drejta te patjetersueshme

te drejta te barazvlereshme

**Situata rasti**

Në shtetin X ligji lejon dënimin me vdekje. A-ja për shkak të kryerjes së një krimi shumë të rëndë për të cilin ligji parashikonte dënimin me vdekje si dënim, dënohet me vdekje. Por, gjykimi i tij u bë në mungesë të një mbrojtje të vazhdueshme ligjore të A-së. Ndërkohë që A-ja ishte në burg duke pritur ditën e ekzekutimit, autoritetet e burgut ushtruan dhunë fizike mbi të aq sa i shkaktuan vdekjen A-së.

Diskutoni:

a lejohet dënimi me vdekje?

a duhej shteti të siguronte që dënimi i tij të kalonte nëpërmjet një procesi shumë të rregullt?

a shkakton shkelje të së drejtës së jetës ushtrimi i dhunës fizike nga autoritetet e burgut?

a duhet shteti të marrë masa për të siguruar të drejtën e jetës?

#### **Neni 4**

Asnjëri nuk duhet të mbahet si skllav ose çifçi; skllavëria dhe tregtia e skllavëve janë të ndaluara në të gjitha format.

- *Trajtim ligjor*

Skllavëria dhe robëria kanë ekzistuar në kohën e hartimit të DUDNJ. Për fat të keq ajo ekziston në ditët tona, por me forma të reja ose moderne si: shfrytëzimi i fëmijëve dhe grave për prostitucion, për punë të detyruar dhe veprimtari të tjera ilegale.

Për herë të parë dënimi i skllavërisë ka filluar në vitin 1814 me Traktatin e Parisit. Si hap i parë ka qënë ndalimi i tregëtisë së skllavëve. Në 1926 miratohet Konventa për Skllavërinë e cila jep edhe kuptimin e nocionit “skllavëri” dhe “tregëti e skllavëve”. Kështu në nenin 1 të saj jep përkufizimin e termit skllavëri dhe tregëti e skllavëve. Sipas tij tregëtia e skllavëve përfshin çdo akt kapjeje, blerjeje, ose cedim të një individi për qëllim skllavërimi: çdo akt blerjeje i një skllavi me qëllim shitjeje ose këmbimi; çdo akt cedimi me anë të shitjes ose këmbimit i një skllavi të blerë me qëllim që të shitet apo të këmbëllet si dhe në përgjithësi çdo akt tregëtimi ose transportimi skllavërisht.<sup>1</sup> Ndërsa me skllavëri do të kuptohet “statusi i një gjendje e tillë e personit mbi të cilin ushtrohet një osë më gjitha pushtetete bashkëlidhura me të drejtën e pronësisë”.<sup>2</sup>

Nëse lexojmë më vëmendje përmbajtjen e nenit 4 të DUDNJ shohin se deklarata nuk bën dallim për asnjë person, pra ndalimi i skllavërisë dhe formave të tjera të nënshtimit është një e drejtë që nuk mund të kufizohet ndaj asnjërit dhe në asnjë rrethanë.

Deklarata përdor termat “skllavëri” dhe “formë tjetër nënshtimi”. Në fakt termi i dytë nuk është trajtuar me gjerësisht në deklaratë, por në shumë dokumenta të mëvonshme të frymëzuara nga deklarata dhe në praktikën e krijuar nga GjEDNJ ka interpretime të formave të nënshtimit.

Në pjesën e dytë të nenit bëhet fjalë edhe për “tregëtia e skllavëve”. Ky term është përdorur edhe një një periudhë të shkurtër kohe pas miratimit të deklaratës dhe më pas është zëvendësuar me termin trafikimi dhe shfrytëzim e fëmijëve dhe grave për qëllime prostitucioni, puna e detyruar e fëmijëve.

Sesa i ka frymëzuar deklarata hartuesit e konventave dhe dokumentave të tjerë ndërkombëtarë të mëvonshme po sjellim disa shembuj. Pas miratimit të DUDNJ u miratuan një sërë dokumentash të cilët synojnë ndalimin e skllavërisë qoftë në format e vjetëra dhe moderne. Ndër to mund me rëndësi janë Pakti për të drejtat Civile dhe Politike (neni 8) , Konventa për ndalimin e tregëtisë së njerëzve dhe shfrytëzimit e prostitucionit nga të tjerët, Konventa për të drejtat Civile dhe politike dhe Konventa për

<sup>1</sup> Për më shumë shih Koventa lidhur me skllavërinë, nënshkruan në Gjenevë në 25 shtator 1926 dhe hyrë në fuqi më 1927; Konevta ka ndryshuar në 1953, botuar në “Përmbledhje aktesh ndërkombëtare”, botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Tiranë, 1993, f.158

<sup>2</sup> Lassen, N. “neni 4, botuar në punimin” .....

të drejtat Ekonomike, Sociale dhe kulturore, Konventa për të drejtat e fëmijës, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, etj.

Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike bën edhe dallimin mes skllavërisë dhe robërisë. Kjo e fundit përmbledh të gjitha format e mundshme të dominimit të një personi mbi tjetrin.

Konventa plotësuese lidhur me heqjen e skllavërisë, tregëtisë së skllavëve dhe të institucioneve e praktikave të ngjashme me skllavërinë, e vitit 1957 i kërkon shteteve që të marrin masa legjislative dhe të tjera për të hequr ose braktisuar format e ngjashme me skllavërinë ose forma të tjera të shfrytëzimit që nuk janë përfshirë deri në atë periudhë në termin “skllavëri” si: robërimi për borxhe, bujkërobëria, një grua që martohet kundrejt dhënies së të hollave, ose në natyrë që u jepet prindërve, të drejtat e bashkëshortit për të cënuar gruan me vdekjen e të shoqit grua mund t’i jepet një personi tjetër; kur një fëmijë nën 18 vjeç i dorëzohet nga prindi ose një personi tjetër kundrejt pagesës me qëllim që ta shfrytëzojë të punojë. Kjo konventë bën edhe një rregullim të përkufizimeve të termave “skllavëri”, “persona në gjendje skllavëri” dhe “tregëtia e skllavëve”.

Duke qënë se puna e detyruar shumë herë është një formë skllavërie në vitin 1932 hyri në fuqi Konventa për punën e detyruar<sup>3</sup>. Në nenin 2 të saj jepen përkufizimet e “punës së detyruar ose të detyrueshme” sipas të cilit kuptohet çdo punë ose shërbim që i kërkohet një individ duke e kërcënuar atë me një dënim të çfarëdoshëm dhe të individit në fjalë nuk e ka pranuar më dëshirë. Konventa përmend disa lloj punësh që nuk quhen punë e detyruara si: kur puna ose shërbimi kërkohet në bazë të ligjeve (shërbimi ushtarak), detyrimet qytetare morale të shtetasve të një vendi që qeverisin vet, puna ose shërbimi si rredhje e një dënimi të dhënë me vendim gjyqësor kur ka forca madhore, fatkeqësi ose rreziqe të natyrës punët e vogla të fshatit. Detyrimi për punë mund të vijë nga autoritetet qendrore dhe lokale. Në fakt në nenin 4 të DUDNJ nuk thuhet asgjë për punën e detyruar.

Konventa “Për heqjen e punës së detyruar” e cila ka hyrë në fuqi në 1959 në nenin 1 të saj detyron shtetet të heqin punë e detyruar si masë shtrengimi ose edukimi politik ose masë ndërkohë ndaj personave që shprehin mendime politike ose shfaqin mospajtimin e tyre ideologjik, si metodë mobilizimi në përdorimi të fuqisë punëtore për interes të zhvillimit ekonomik, si masë disiplinore në punë, si ndëshkim për pjesëmarrje në greva dhe masë e diskriminimit racial, shoqëror kombëtar dhe fetar (neni 1 i Konventës”<sup>4</sup>.

Konventa “Për ndjekjen e tregëtsisë së qënieve njerëzore dhe të shfrytëzimit të prostitucionit të tjerëve”, miratuar në vitin 1951 sipas nenit 2 të të cilit dënohet çdo person që mban drejton ose me vetdije financon ose kontribuon në financimin e një shtëpie prostitucioni jep me qira me vetdije tërësisht ose pjesërisht një ndërtesë apo një vend tjetër me qëllime prostitucioni të tjerëve dënohet. Kjo konventë dënon edhe veprimet përgatitore për veprat e mësipërme.

*Ja se si gjen zbatim kjo deklaratë në disa prej ligjeve që zbatohen në vendin tonë*

<sup>3</sup> Për më shumë shih Konventa mbi punën e detyruar, botuar, po aty, f.172.

<sup>4</sup> Për më shumë shih Konventën “Për heqjen e punës së detyruar” po aty. f.184.

Sipas nenit 32, paragrafi 1 të Konventës “Për të drejtat e fëmijës” shtetet palë njohin të drejtë e fëmijës për t’u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e ‘do pune që paraqet rreziqe ose cënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Paragrafët etjerë të këtij neni përcaktojnë se çfarë duhet të bëjnë konkretisht shtetet në këtë drejtim

Sipas nenit 34, paragrafi i 1 i kësaj konventë shtetet palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme shfrytëzimi seksual dhe keqtrajtimi seksual.

Kushtetuta e RSH, neni 26 sanksion se “Askujt nuk mund t’i kërkohet të kryejë një punë të detytruar, përveç në rastet e ekzkeutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjëndje lufte, nga një gjëndje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve”.

Konventa për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve emigrantë dhe të anëtarëve të familjes në nenin 11..... sanksion se.....

- *Aspekte edukative*

Nenet – 4,5, janë në funksion të nenit - 3 dhe tentojnë të zgjerojnë përmbajtjen dhe përmasat e nenit – 3. Të dy nenet, 4-5, fokusohen në të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë se personit, por me një dallim nga neni – 3.

Nëse neni – 3, deklaron të drejtat e njeriut {themelore}, dy nenet që vijojnë operojnë me termin “askush” dhe për më tepër të dy nenet fillojnë me “askush” nuk mund ..., që do të thote se nenet, operojnë qëllimshëm, me terma përjashtimore.

Askush, me cilindo status që mund të ketë, nuk mund të privoje askend nga e drejta e lirisë duke ushtruar skllaveri, apo formë tjetër skllavërimi.

Përdorimi i termit “skllavëri” mundet aktualisht të tingëllojë i vjetëruar në fillimin e shekullit 21, por në kohën kur u përdor kishte kuptim dhe fuqinë e nevojshme.

Edhe aktualisht njerezimi vuan forma të tjera skllavërimi të njeriut, shume më të sofistikuar. Trajtimi i njerëzve si “plackë” dhe e drejta e shitjes së skllerverve nga pronarët, konsiderohet si proces i kaluar dhe reminiscence e koherave që lamë pas.

Por, edhe në kushtet e shoqërisë së hapur duket se shoqëria “prodhon” dukurine e shitjes së të drejtave të një individi tek një tjetër.

Dukuria “*tregëti e mishit të bardhe*” është një nga format e skllavërimit në shoqërinë posindustriale. Parë nën ndricimin e kohës sone, ky nen ka fuqinë dhe argumenta të plota për t’u marrë në konsideratë.

Neni – 3 në një kuptim përfaqëson preambulën e Konventes së Palermos, viti 2000, kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

*Pak histori.*

Për herë të parë dënimi i skllavërisë daton, vitin 1814 me Traktatin e Parisit, ku specifikohet ndalimi i tregëtisë së skllavëve. Në 1926 miratohet Konventa për Skllavërinë e cila jep edhe kuptimin e nocionit “skllavëri” dhe “tregëti e skllavëve”. Kështu neni 1 i saj jep përkufizimin e termit skllavëri dhe tregëti e skllavëve. Sipas këtij neni, tregëtia e skllavëve përfshin:

*çdo akt kapjeje, blerjeje, ose cedim të një individi për qëllim skllavërimi,*

*çdo akt blerjeje i një skllavi me qëllim shitjeje ose këmbimi,*

*çdo akt cedimi me anë të shitjes ose këmbimi i një skllavi të blerë me qëllim që të shitet apo këmbehe,*

*çdo akt tregëtimi ose transportimi skllavërisht,*

Ndërsa me skllavëri do të kuptohet “statusi i personit”, në një gjendje të tillë mbi të cilin ushtrohet një osë të gjitha pushtetet të bashkëlidhura me të drejtën e pronësisë”.

Duke lexuar qëllimshëm, përmbajtjen e nenit 4 të DUDNJ konstatojmë se, deklarata nuk bën dallim për asnjë person, pra ndalimi i skllavërisë dhe formave të tjera të nënshtrimit është një e drejtë që nuk mund të kufizohet ndaj asnjë personi, dhe në asnjë rrethanë.

Deklarata përdor termat “skllavëri” dhe “formë tjetër nënshtrimi”.

Në fakt termi i dytë nuk është trajtuar në deklaratë, por në shumë dokumenta të mëvonshme të frymëzuara nga deklarata dhe në praktikën e krijuar nga GjEDNJ ka interpretime të formave të nënshtrimit.

Në pjesën e dytë të nenit bëhet fjalë edhe për “tregëtia e skllavëve”. Ky term është përdorur edhe në një periudhë të shkurtër kohe pas miratimit të deklaratës dhe më pas është zëvendësuar me termin trafikimi dhe shfrytëzim të fëmijëve dhe grave për qëllime prostitucioni, pune të detyruar.

Neni-4 i DUDNJ ka inspiruar një sërë dokumentash që synojnë ndalimin e skllavërisë në trajtat e vjetëra apo moderne. Ndër to, me rëndësi janë Pakti për të drejtat Civile dhe Politike (neni 8), Konventa për ndalimin e tregëtisë së njerëzve dhe shfrytëzimit të prostitucionit nga të tjerët, Konventa për të drejtat Civile dhe politike dhe Konventa për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe kulturore, Konventa për të drejtat e fëmijës, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, etj.

Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike bën edhe dallimin mes skllavërisë dhe robërisë. Kjo e fundit përmbledh të gjitha format e mundshme të dominimit të një personi mbi tjetrin.

Konventa plotësuese lidhur me heqjen e skllavërisë, tregëtisë së skllavëve dhe të institucioneve e praktikave të ngjashme me skllavërinë, e vitit 1957 i kërkon shteteve që të marrin masa legislative dhe të tjera për të hequr ose braktisuar format e ngjashme me skllavërinë ose forma të tjera të shfrytëzimit që nuk janë përfshirë deri në atë periudhë në termin “skllavëri” si:

*Robërimi i nje personi për borxhe,*

*Bujkërobëria,*

*Një grua që martohet kundrejt dhënies së të hollave,  
Një grua që martohet kundrejt shperblimit në natyrë të prindërve,  
Të drejtat e bashkëshortit për të cënuar gruan  
Me vdekjen e bashkëshortit, gruaja mund t'i jepet një personi tjetër,  
Një fëmijë nën 18 vjeç dorëzohet te një person tjetër kundrejt pagesës me qëllim shfrytëzimi,*

Kjo konventë bën edhe një rregullim të përkufizimeve të termave “skllavëri”, “persona në gjendje skllavërie” dhe “tregëtia e skllavërve”.

### **Puna e detyruar.**

Shumë here, puna e detyruar, përben dhe një formë skllavërie, me këtë argument, në vitin 1932, hyri në fuqi Konventa për punën e detyruar. Në nenin 2 të saj, jepen përkufizimet e “punës së detyruar ose të detyrueshme” sipas të cilit, çdo punë ose shërbim që i kërkohet një individ duke e kërcënuar, përben “punë të detyruar”

Konventa liston disa lloje punësh që nuk konsiderohen “punë e detyruar” si:

*Shërbimi ushtarak,*

*Detyrimet qytetare e morale të shtetasve të një vendi që qeverisin vet,*

*Sherbime si rredhajtje e një dënimi të dhënë me vendim gjyqësor,*

*Sherbime në raste fatkeqësishë natyrore,*

Në nenin-4 të DUDNJ nuk trajtohet termi “punë e detyruar”.

Konventa “Për heqjen e punës së detyruar” e cila ka hyrë në fuqi në 1959 në nenin 1 të saj detyron shtetet të heqin punë e detyruar si masë shtërgimi ose edukimi politik ose masë ndërshkruse ndaj personave që shprehin mendime politike ose shfaqin mospajtimin e tyre ideologjik, si metodë mobilizimi në përdorim të fuqisë punëtore për interes të zhvillimit ekonomik, si masë disiplinore në punë, si ndëshkim për pjesëmarrje në greva dhe masë e diskriminimit racial, shoqëror kombëtar dhe fetar (neni 1 i Konventës)<sup>5</sup>.

Konventa “Për ndjekjen e tregëtsisë së qënive njerëzore dhe të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve”, miratuar në vitin 1951, sipas nenit 2, dënohet çdo person që: mban drejton ose me vetdije financon, kontribuon në financimin e një shtëpie prostitucioni,

jep me qira, me vetdije tërësisht ose pjesërisht një ndërtesë apo një vend tjetër me qëllime prostitucioni të të tjerëve,

Kjo konventë dënon edhe veprimet përgatitore për veprat e mësipërme.

### **Si gjen zbatim kjo deklaratë në disa prej ligjeve që zbatohen në vendin tonë:**

Sipas nenit 32, paragrafi 1 të Konventës “Për të drejtat e fëmijës” shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për t’u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe, cënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, morall dhe shoqëror. Paragrafët e tjerë të këtij neni, përcaktojnë se ç’farë duhet të bëjnë konkretisht shtetet në këtë drejtim

Sipas nenit 34, paragrafi i 1 i kësaj konvente shtetet palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme shfrytëzimi seksual dhe keqtrajtimi seksual.

Detyre:

Komentoni në grup dhe arsyetoni nenin 26 të kushtetutës së RSH:

Duke ballafaquar nenin e kushtetutës me nenin – 4 të DUDNJ-së

<sup>5</sup> Për më shumë shih Konventën “Për heqjen e punës së detyruar” po aty. f.184.

Sillni nje perifrazim tuajin rreth punes së detyruar në kushte të caktuara  
Listoni deri tre arsye, pse neni 26 i kushtetutës së RSH, nuk përfaqëson forma  
‘skllaverimi’ dhe “pune të detyruar”

*“Askujt nuk mund t’i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveç në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjëndje lufte, nga një gjëndje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve”.*

**Mundesi per diskutim:**

Nga perspektiva juaj perse disa lloj punësh si:

*Shërbimi ushtarak,*

*Sherbime si rredhojë e një dënimi të dhënë me vendim gjyqësor,*

*Sherbime ne raste fatkeqësishë natyrore,*

... nuk konsiderohen “punë e detyruar...”

Situata rasti

Në shtetin X policia gjeti që një grup individësh, shtetas të Kinës, mbaheshin në ambiente të mbyllura dhe përdroreshin për punë në një fabrikë prodhimi pëlhurash. Këta shtetas mbaheshin të mbyllur gjithë kohës tjetër gjatë së cilës nuk punonin dhe në ambientin ku qëndronin u sillej për të ngrënë dhe për t’u veshur. Jetesa e tyre në ambientin ku mbaheshin mbyllur ishte në nivele minimale.



## **Neni 5**

Asnjeri nuk duhet t'i nënshtrohet mundimit, veprimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtërues.

### Trajtim ligjor

Megjithëse kanë kaluar shumë kohë dhe bëhen përpjekje të vazhdueshme, tortura dhe trajtimet çnjerëzore, poshtëruese dhe degraduese vazhdojnë të ekzistojnë. Në disa vende zbatohen forma të torturës si pjesë e traditës dhe zakoneve të këtyre vendeve. Megjithatë, tortura shfaqet jo vetëm në vendet e pazhvilluara, por edhe në ato të zhvilluara e vendet demokratike. Sipas raporteve të organizatave të të drejtave të njeriut ose komisioneve të monitorimit të konventave të ndryshme, tortura kryhen me shpesh gjatë konflikteve dhe luftërave të armatosura, gjenocidive dhe në vendet e paraburgimit dhe në burgje.

Përse disa vende vazhdojnë të përdorin torturën?

Sipas studiuesve arsytet janë të ndryshme si: për të marrë nga personi informacione ose personi të pranojë diçka (zakonisht kjo ndodh në polici ose në pyetjen e një personi të dyshuar për një krim ose që ka dijeni për një informacion të rëndësishëm); për të shkatërruar ose degraduar personalitetin e një personi (zakonisht sot kjo haset më shpesh në vendet e paraburgimit dhe në burgje) dhe për të ruajtur në çdo kusht pushtetin.

Në nenin 5 të DUDNj nuk jepet sqarime ose komente lidhur me format e ushtrimit të torturës ose përkufizimin e saj. Megjithatë ky nen ka shërbyer si një bazë për hartimin e një sërë dokumentash të tjerë ndërkombëtarë qoftë të KB ose të Këshillit të Europës si dhe për ngritjen e mekanizmave minitorues lidhur me ndalimin e torturës.

Një nga vështirësitë që haset sot është dallimi mes veprimeve të lejuara në kuadër të përdorimit të forcës nga një autoritet publik siç është policia në rastet e vendosjes së rendit dhe të qetësisë publike dhe asaj që quhet torturë. Për herë të parë nocioni torturë jepet në nenin 1 të Deklaratës për mbrojtjen e të gjithë personave kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese dhe në nenin 1 të Konventës e OKB-së “Kundër Torturës dhe dënimeve dhe trajtime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, hyrë në fuqi në 26 qershor 1987

**Sipas saj me torturë kuptohet “** ..... (përkufizimi është shumë i gjatë a do të vendosim????, f,217 e ligjit

Cilat janë konventat ndërkombëtare kundër Torturës?

Konventa kundër gjenocidit e vitit 1948 (kjo konventë dënon çdo akt që ka për qëllim zhdukjen tërësisht ose pjesërisht të grupeve etnike, raciale dhe fetare duke shkaktuar dëme trupore serioze ose mendore ose vrasje të drejtëpërdrejta të pjesëtarëve të tyre, pavarësisht se janë kryer në kohë paqeje ose lufte.

Konventa e Gjenevës e vitit 1949 dhe protokollet. Kjo konventë zbatohet në të gjitha situatat e konfliktit të brëndshme të armatosur. Sipas saj torturë është eksperimente shkencore ose mjekësore. Konventa i njeh të drejtën Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq të vizitohet vendet e paraburgimit në vendet që janë në konflikte.

Pakti për të Drejtat Politike dhe Civile dhe pakti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore avancojnë me shumë se DUDNJ dhe përmbushin një nga boshllëqet e saj ndalimin e eksperimenteve shkencore dhe mjekësore. Sipas PDCP tortura ndalohet dhe shtetet detyrohet të marrin masa për një trajtim human të personave të paraburgosur.

**Konventa kundër Torturës dhe trajtimit ose dënimit tjetër çnjerëzor**, johuman dhe degradues kjo konventë hyri në fuqi në vitin 1987 (ë sipërcituar). Pjesa më e madhe e neneve të saj kanë të bëjmë me parandalimin e torturës, një pjesë me torturën dhe trajtimet çnjerëzore, johumane dhe poshtëruese. dërkohë. Konventa krijon Komitetin kundër Torturës.

Konventa “Për të drejtat e Fëmijës” ka hyrë në fuqi në 1990. Ajo përmban një nen të veçantë për ndalimin e torturës ose trajtimit çnjerëzor, antihuman dhe poshtërues. Konventa përmban rregulla për mënyrën e trajtimit të fëmijëve të paraburgosur ose të cilëve u është privuar liria.

Protokolli alternativ i konventës Kundër Torturës sipas të cilit krijohet një komitet i OKB-së për vizitat në vendet e paraburgimit

Në nivel rajonal, në vitin 1950 është miratuar Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut e cila në nenin 3 të saj saksion ndalimin e torturës. Konventa ka krijuar një komitet që monitoron zbatimin e saj dhe GJEDNJ ka pasuar dhe zhvilluar me tej ncionin torturë, trajtim çnjerëzor, poshtërues dhe degradues. Këshilli i Europës miratoi Konventën Europiane për Parandalimin e Torturës (1987). Mes vizitave në vendet e paraburgimit dhe në burgje, spitale psikiatrike,

### ***Ja si ka gjetur rregullim neni 4 i DUDNJ në legjislacioni shqiptar***

Edhe Kushtetura e RSh përmban një nen që ndalon përdorimin e torturës (neni 25)

**Kodi penal ka dy nene lidhur me ndalimin e torturës dhe në vitin 2007, ky nocion është përmirësuar në përputhje me rekomandimet e Komitetit European kundër Torturës. Sipas ndryshimeve të berë.....**

### Aspekte edukative

Kanë kaluar mëse nje gjysëm shekulli dhe ky nen, jo vetëm përlligjet por merr funksione të reja edhe ne “shoqërite postindustriale” dhe “shoqërine e hapur”.

Torturat, trajtimet ç’njerëzore, poshtëruese, degraduese vazhdojnë të shfaqen here ne forma të torturës si pjesë e traditës, te etno-psikologjisë, të zakoneve që përfaqësojnë nënkulturat e ndryshme. Tortura në forma të ndryshme, shfaqet jo vetëm në vendet relativisht të pazhvilluara, por dhe në ato të zhvilluara, si dhe ne shoqërite demokratike.

Raportet e organizatave të të drejtave të njeriut e komisionet e monitorimit të konventave të ndryshme, identifikojnë tortura që kryehen gjatë konflikteve dhe luftërave të armatosura, gjenocidive, gjatë paraburgimit dhe vecmas në burgje.

Studiuesit sjellin arsye të ndryshme si:

për të siguruar nga personi informacione për qëllime të ndryshme,  
{zakonisht kjo ndodh në polici, në pyetjen e një personi të dyshuar për një krim ose që ka dijeni për një informacion të rëndësishëm);  
për të depersonalizuar një person,  
(haset më shpesh në vendet e paraburgimit dhe në burgje)

Në nenin 5 të DUDNj nuk jepet sqarime ose komente lidhur me format e ushtrimit të torturës ose përkufizimin e saj. Megjithatë ky nen ka shërbyer si pikënisje, për hartimin e një sërë dokumentash të tjerë ndërkombëtarë qoftë të KB ose të Këshillit të Europës si dhe për ngritjen e mekanizmave minitorues lidhur me ndalimin e torturës.

Një nga vështirësitë që haset sot është dallimi mes *veprimeve të lejuara* në kuadër të përdorimit të forcës nga një autoritet publik siç është policia në rastet e vendosjes së rendit, dhe të qetësisë publike dhe asaj që quhet *torturë*.

Mundësitë për të spekuluar janë të shumta. I zgjeruar në gjithë përmasat e veta neni -5, i DUDNj, gjendet në “Deklaratën për Mbrojtjen e të gjithë personave kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese”, dokument që daton në 26 qershor 1987.

Cilat janë konventat ndërkombëtare kundër Torturës?

#### **Konventa kundër gjenocidit e vitit 1948**

Kjo konventë dënon çdo akt që ka për qëllim zhdukjen tërësisht ose pjesërisht të grupeve etnike, raciale dhe fetare duke shkaktuar dëme trupore serioze, mendore ose vrasje të drejtëpërdrejta të pjesëtarëve të tyre, pavarësisht nëse janë kryer në kohë paqeje ose lufte.

#### **Konventa e Gjenevës e vitit 1949**

Kjo konventë zbatohet në të gjitha situatat e konfliktit të brëndshme të armatosur. Sipas saj, torturë konsiderohen eksperimentet shkencore ose mjekësore që mund të behen gjatë situatave të konfliktit. Për të monitoruar situatat dhe për të evituar cdo spekulim, Konventa i njeht të drejtën Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq të vizitojë vendet e paraburgimit në vendet që janë në konflikte.

#### **Paktet për të Drejtat Politike e Civile/Ekonomike, Sociale dhe Kulturore**

Avancojnë me shumë se DUDNj dhe përmbushin një nga boshllëqet e saj ndalimin e eksperimenteve shkencore dhe mjekësore. Sipas PDCP tortura ndalohet dhe shtetet detyrohen të marrin masa për një trajtim human të personave të paraburgosur.

#### **Konventa “Për të drejtat e Fëmijës”**

Ka hyrë në fuqi në 1990. Ajo përmban një nen të veçantë për ndalimin e torturës ose trajtimit çnjerëzor, antihuman dhe poshtëruës. Konventa përmban rregulla për mënyrën e trajtimit të fëmijëve të paraburgësuar ose të cilëve u është privuar liria.

#### **Protokolli alternativ i konventës Kundër Torturës**

Sipas të cilit krijohet një komitet i OKB-së për të vizituar qendrat e paraburgimit

#### **Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, 1950**

Neni 3 i saj saksion ndalimin e torturës. Konventa ka krijuar një komitet që monitoron zbatimin e saj dhe GJEDNJ ka pasuar dhe zhvilluar me tej nocionin torturë, trajtim çnjerëzor, poshtëruës dhe degradues. Këshilli i Europës miratoi Konventën Europiane për Parandalimin e Torturës (1987). Mes vizitave në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, spitale psikiatrike,

#### **Mundesi per diskutim:**

**“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve mizore, cnjerëzore ose degraduese”**

Nga perspektiva juaj, neni ne fjale duhet konsideruar:

Kapercim i lirive te individit ....

Utopik ....

Hipotetik ....

I mundeshem .....

Organizohuni ne grupe sipas argumenteve qe sillni dhe mbronni ato nga perspektiva juaj

#### **Detyre:**

Komentoni perdorimin e fjales “askush” ne formulimin e ketij neni. Sillni kuptimet tuaja.

#### **Situata rasti**

A-ja u dënua me 15 vjet burgim, punë të rëndë dhe me nga 10 gjuajtje të shkopit të gomës për shkak të mbajtjes pa leje të armëve, vjedhje me dhunë dhe plagosje me qëllim. Dënimin e tij, A-ja e kaloi në një burg të sigurisë ë lartë në vend. ndërkohë që ishte në burg ai i nënshtrohej vazhdimisht punës së vështirë dhe gjuajtjeve me shkop. Gjuajtja me shkop, ishte e parashikuar si një masë dënimi në ligje si dhe në rregulloret burgut, edhe pse ekzekutimi saj ishte shumë më abuziv, më i egër dhe më shumë se sa parashikohej si në vendimin e gjykatës ashtu edhe në rregulloret e shkruara të burgut. Ndërkohë në rregulloren e burgut parashikohej që nga koha kur ishte caktuar ora e gjuajtjes e deri në kryerjen e këtij dënimi duhej pritur pak (gjë që shkaktonte ankth), të pranishëm duhet të ishin persona të tjerë që të shihnin ekzekutimin këtij dënimi, si dhe zhveshja lakuriq. Kjo gjendje vazhdoi për gjatë gjithë kohës kur A-ja ishte në burg. Dita kur A-ja do të lirohej për shkak se se kishte kryer të gjithë dënimin e tij ishte 1 maji. Një ditë më parë të gjithë

policët e burgut erdhën së bashku për ta vizituar. Ata e nxorën A-në nga qelia e vet dhe e çuan në një seksion tjetër të burgut. Kur A-ja kuptoi që ekzekutimi i qëllimit më shkop do të fillonte, ai protestoi, por mori një gjuajtje shumë të fortë në stomak. Më pas atë e kapën, ia mbyllën sytë dhe u urdhërua të hiqte rrobat, Më pas atë e çuan në një vend ku pjesën e tij intime filluan ta gjuanin dhe ta shtypnin veçanërisht. Në atë kohë të pranishëm ishin rreth 25 oficerë të burgut, të gjithë duke u përfshirë në një mënyrë apo tjetër. Të gjithë ndërkohë përdorin fjalë shumë fyese dhe gjuanin pjesët e trupit të A-së duke u përqendruar kryesisht në pjesët intime.

A-ja pretendon që përdorimi i këtyre lloj dënimeve, pra ai i ndëshkimit trupor, si dhe zbatimi i egër e këtij ndëshkimi, është çnjerëzor, poshtërues dhe është një ndëshkim denigrues për individin.

## **Neni 6.**

Gjithkush ka të drejtë që t'i njihet kudo personaliteti juridik.

### Trajtim ligjor

Neni 6 synon të mundësojë njohjen para ligjit të personave. Kjo do të thotë që individët të kenë një status të caktuar që t'i njihet para ligjit. Ky status synon që personat të konsiderohen si subjekte të ligjit, pra si persona të cilët kanë mundësi të kryejnë veprime, të fitojnë të drejta e të kenë edhe detyrime ligjore. E thënë ndryshe neni mundëson individët që të kenë aftësinë të ushtrojnë të drejtat të cilat ndërkohë duhet t'i njihen dhe të marrin përsipër edhe detyrime dy apo më shumë palëshe. Të kesh të drejta e detyrime në të njëjtën kohë është shumë e rëndësishme, sepse do të ishte pa kuptim të themi që ndërkohë që ne blejmë një send, p.sh. një shtëpi, palët të kishin vetëm të drejtën për ta blerë shtëpinë apo për ta shitur atë secila. Mendoni për një çast që shtëpia të mos ishte pronë e personit që jua shiti. Mendoni se sa lehtë do të ishte për personin që mashtrio nëse ai do të kishte vetëm të drejtën për të shitur dhe jo edhe detyrimin që të shesë pronën e tij dhe jo të dikujt tjetër. Ju do të ishit në një telash të madh.

Neni 6 duke kërkuar që gjithkush të ketë personalitet juridik e ky personalitet juridik t'i njihet, kërkon që gjithkush të ketë të drejta e detyrime civile. Të kesh të drejta e detyrime civile do të thotë të kesh mundësinë të lidhësh kontrata, të fitosh pronë, të mund të martohesh e trashëgosh, të mund të deklarosh falimentimin nëse biznesi/tregtia nuk ecën mirë dhe nuk përmbush detyrimet financiare, e kështu me radhë. Ky është qëllimi i nenit 6, qëllim i cili e ka bazën në historinë e njerëzimit përgjatë të cilët kategori të caktuar njerëzish shiheshin si qenie që eksitojnë për të përmbushur një funksion të caktuar dhe shërbyer të tjerëve e që mund të shiten e të blihen njësoj si sendet, dhe jo si qenie që meqenëse kanë lindur si të tillë janë të lirë të bëjnë zgjedhjet e tyre e të mund të jetojnë jetën e tyre lirisht. Kjo nuk do të thotë aspak që qeniet njerëzore nuk kanë detyrime ndaj njëri-tjetrit, sepse kjo është e përfshirë në kuptimin e nenit.

### *Njerëzit janë subjekte të ligjit e jo vetëm objekte*

Për të shpjeguar më tej atë që sapo u th anë lidhje me nenin 6, ky nen ka pasur si referim periudhën e skllavërisë, pra periudhën kur njerëzit trajtoheshin si objekte dhe jo si subjekte. Të trajtohesh si objekt do të thotë që nuk ka rëndësi ajo që ti je dhe ajo që ti si individ dëshiron të kesh, por ka rëndësi ajo që t'i duhet të bësh, pra puna që t'i kryen apo funksioni për të cilin t'i përdorësh. Këtë neni 6 synonte të zhdukte. Kështu ky nen në thelb do të thotë që kushdo prej qenieve njerëzor duhet pranuar si person, si individ që nuk do mund të jetonte pa mundur të jetonte i lirë, të bënte zgjedhjet e veta, të mund të lidhte kontrata apo marrëveshje të ndryshme, bënte shitblerje, të mund të përdorte ligjin në interes të tij duke respektuar kërkesat ligjore apo të mund të punësohej lirshëm. Këto, sipas Rene Cassin, një prej autorëve të DUDNJ-së, ishin të drejta themelore të cilat gjithkush duhet t'i gëzonte dhe jo vetëm një grup i caktuar i shoqërisë.

*Mos është neni 6 përsëritje e neneve të mëparshme?*

Neni 6 edhe pse ka një lidhje të pandashme nga nenet e tjera të DUDN, e sidomos me nenin që ndalon skllavërinë, nenin që ndalon diskriminimin apo kërkon barazi para ligjit, sigurisht që ka një qëllim të dallueshëm nga nenet e tjera dhe një vlerë të shtuar. Ky nen vërtet mund të themi që nënkupton heqjen e skllavërisë, moslejimin e diskriminimit dhe trajtimin e barabartë të njerëzve, por të gjitha këto nënkuptohen nga konteksti në të cilin u shtruan diskutimet për nenin si dhe nga ajo që përmbahet në të. Neni së pari synon që të mundësojë që njerëzit të trajtohen si të tillë nga ligji, pra që ligji t'i konsiderojë ato si qenie njerëzore, duke kërkuar që kjo të ndodhë me këdo, kudo e kurdo. Ky nen synon së pari të njohë të drejtat e njerëzve që të gjithë pa përjashtim të kenë mundësi të hyjnë në marrëdhënie me njëri-tjetrin dhe të përfitojnë nga këto marrëdhënie, të kenë mundësinë gjithashtu që t'i drejtohen të gjithë drejtësisë në rastet kur i shkelen apo dhunohen të drejtat apo interesat e tyre. Ky nen së pari synon të mundësojë njohjen e të drejtave të tilla civile si e drejta për të lidhur kontrata, për t'u martuar, zgjedhur lirisht punën, trashëguar e kështu me radhë. Thënë me terminologjinë juridike ky nen synon të deklarojë ekzistencën e qenies njerëzore që me lindjen (madje që me konceptimin, pra ekzistencën e embrionit) dhe të deklarojë që qeniet njerëzore kanë të drejtë të hyjnë në qarkullimin civil e të fitojnë të drejta e bartin detyrime me veprimet apo mosveprimet e tyre.

#### *Neni 6 i referohet vetëm personave/qenieve njerëzore*

Duhet kuptuar që neni 6 zbatohet vetëm për qeniet njerëzore, pra për personat natyrorë. Ky nen nuk synon të mbrojë personat e ndryshëm që këta persona natyrorë mund të krijojnë, dmth shoqatat apo organizatat e ndryshme që krijojmë ne si individë, apo shoqëritë tregtare që krijohen, e që me gjuhën e ligjit njihen si persona juridikë. Megjithatë, vetë fakti që këto persona juridikë krijohen nga qeniet njerëzore, gjithsesi passjell mbrojtjen e njohjen ligjore edhe të personave juridikë. Megjithatë, ka një ndryshim shumë të madh midis tyre dhe qenieve njerëzore që qëndron në faktin që qeniet njerëzore ekzistojnë pavarësisht njohjes me ligj apo rregullave ligjore, kurse personat juridikë ekzistojnë vetëm në sajë të rregullimeve ligjore e kështu edhe të drejtat e detyrimet e tyre janë të parashikuara në ligje gjithmonë dhe duhen shkruar gjithmonë në rregulla ligjore.

#### *Personat të kenë trajtim ligjor bazë të njëjtë kudo*

Neni 6 kërkon që njohja para ligjit si person të jetë njësoj në të gjitha vendet. Pra ajo njohja që personi mund të fitojë të drejta e të bartë detyrime me veprimet e veta duhet të njihet nga të gjitha vendet dhe personit t'i njihen po e njëjta mundësi të fitojë të drejta e bartë detyrime me veprimet e veta në të gjitha vendet e botës njësoj. Nuk ndodh kështu kudo, pra jo të gjitha vendet personat trajtohen njësoj. Ka shumë vende në të cilat ajo që mundëson ligji, nuk mundësohet për të gjithë njësoj. Prandaj është më e drejtë të thuhet që këtë trajtim të ndryshëm ky nen synon ta pakësojë e pse jo ta kufizojë në minimumin e mundshëm. Kështu, p.sh. themi që të huajt nuk lejohen të marrohen apo të fitojnë pasuri në një vend të caktuar, apo edhe të kenë akses në drejtësinë e një vendi. Në fakt ka shumë vende ende sot që përcaktojnë disa kufizime në gëzimin e përfitimeve ligjore që ekzistojnë në vend. Kjo është e lejueshme kryesisht sepse çdo vend gëzon sovranitet, ka si qëllim që në radhë të parë t'i ofrojë mbrojtje shtetasve të vet dhe për hir të mbrojtjes së

interesit publik të vendit të vet të kufizojë të drejtat e përfitimet për të huajt. Deri më tani tërësia e të drejtave e përfitimeve të të huajve në një vend është përcaktuar në ndonjë ligj apo dokument të posaçëm të miratuar në bazë të reciprocitetit mes dy vendeve. Ka pasur gjithmonë një hapësirë në këtë tërësi që nuk është diskutuar, madje vazhdon të mbetet e tillë. Kjo ka të bëjë me zgjedhjet politike të vendit. Kështu, edhe në Kushtetutën tonë thuhet që “vetëm shtetasit shqiptarë kanë të drejtë të zgjedhin e të zgjidhen”. Ndërkohë të huajt në vendin tonë kanë të drejtë të kërkojnë informacion, të krijojnë persona juridik’, si p.sh. shoqëri tregtare apo organizata jofitimprurëse, të punësohen edhe pse jo në administratën publike shqiptare, të gëzojnë përfitimet nga sigurimet shoqërore e shëndetësore, të organizohen e manifestojnë, e kështu me radhë. Por, të huajt në vendin tonë nuk kanë të drejtë të blejnë tokë bujqësore. Të tilla kufizime ka çdo vend, dhe kufizimet kryesisht kanë të bëjnë me zgjedhjet politike, organizimin e drejtimin e shtetit apo edhe çështje të pronësisë.

Ka edhe një orientim tjetër të kësaj çështje. Tanimë janë miratuar një sërë traktesh apo konventash nga organizma rajonale apo ndërkombëtare që mundësojnë lehtësira ligjore apo trajtim të njëjtë ligjor për të huajt. **Kështu p.sh. Këshilli i Evropës ka miratuar Konventën për Shtetësinë**

#### *Neni 6 është një nen që i referohet të drejtave civile*

Duhet kuptuar drejt që neni 6 synon të heqë trajtimet jo njerëzore apo të ndryshme të njerëzve por ama në fushën e qarkullimit civil, pra në atë hapësirë ku njerëzit hyjnë në marrëdhënie me njëri-tjetrin. Jo më kot kufizimet më të mëdha që u sollën si shembull më lart kishin të bënin me të drejta politike, si e drejta për t’u zgjedhur e për të zgjedhur, apo me fusha që lidhen me politikën, si p.sh. punësimi administratën publike. Këto ky nen nuk merr përsipër t’i rregullojë. Ajo që ky nen synon të garantojë është që njerëzit mundën për shembull të blejnë e shesin jo vetëm me shtetas të shtetit të vet, apo me shtetas që kanë një moshë të caktuar, apo me shtetas që janë të një gjinie apo statusi të caktuar ekonomik. Këtë të drejtë ata mund ta ushtrojnë me të huaj apo të moshuar, apo me persona të cilët nuk kanë gjendje ekonomike të mirë. Kjo e drejtë ju njihet gjithkujt pavarësisht se çfarë moshe, gjinie, apo statusi ekonomik, tej, ka. Megjithatë duhet kuptuar që për interesa ekonomike ka vende që mund të caktojnë kritere të caktuara për të ushtruar këtë të drejtë, si rasti i vendit tonë që ndalon shitblerjen e tokës bujqësore të huajve. Kjo sepse të gjitha të drejtat e përmendura në këtë Deklaratë balancohen me detyrimet që kemi ndaj bashkësisë dhe të drejtat e liritë mund të kufizohen me ligj.

#### *A është nen që synon të zhdukë diskriminim?*

Po, neni 6 synon të mundësojë trajtim në bazë të ligjit të të gjithë personave, apo njerëzve. Duke synuar këtë pa dyshim që një koncept i cili u pranua gjerësisht ishte edhe barazia para ligjit. Kështu, neni synon të krijojë një bazë të njëjtë konsiderimi, trajtimi e pranimi të të gjithë njerëzve. Kështu, ky nen jo vetëm që nuk pranon më skllavërinë e trajtimin e njerëzve si skllavër, por synon të heqë edhe trajtimet e ndryshme të njerëzve të themi për shkak të shtetësisë, apo gjendjes ekonomike. Ka shtete të cilat nuk lejojnë fitimin e pronësisë nga të huajt, apo qoftë edhe lidhjen e martesës, ose edhe aksesin në drejtësi nga të huajt. Sigurisht që çdo vend ka për detyrë që të mbrojë interesat e



shtetasve të vet në radhë të parë, por DUDNJ synon që në qendër të çdo ligji të jetë personi, qenia njerëzore dhe jo shtetasi. Kjo do të thotë që edhe pse nuk je shtetas i një shteti të caktuar, ligji i atij shteti nuk duhet të diskriminojë ndaj teje në fushën e të drejtave civile. Kjo sepse njerëzit janë të lirë të lidhin kontrata me kë të duan, të krijojnë familje me kë të dëshirojnë, t'i lënë trashëgim një pronë personave që dëshirojnë, t'i shesin sendet që kanë në pronësi kujt të duan e kështu me radhë. Dhe këto të drejta i njihen të gjithëve njësoj.

### *E drejta e personit për të ushtruar të drejtat/detyrime ligjore dhe aftësia për ta realizuar këtë*

Në kuptimin e nenit 6 nuk duhet ngatërruar e drejta e personit për të hyrë në marrëdhënie të caktuara me të tjerët, pra të themi për të blerë, shitur, ndërtuar, kryer një shërbim, lënë trashëgimi, me aftësinë për t'i realizuar të gjitha këto. Ka raste kur një person nuk e ka të mundur të ushtrojë këto të drejta. Kështu p.sh. fëmijët nuk mund të blejnë një pronë të paluajtshme, dmth një shtëpi, por mund të bëhen farë mirë trashëgimtarë të saj. Ose një person me aftësi të kufizuara mendore nuk mund të kryejë këto veprime. Kjo nuk do të thotë që këto persona nuk gëzojnë këto të drejta, por ushtrimi apo realizimi i këtyre të drejtave në rastin e tyre mundësohet me ndihmën e dikujt, që mund të jetë prindi apo një kujdestar i caktuar. Të tilla rregullime nuk duhen konsideruar si përjashtime nga rregulli i nenit 6, por duhen konsideruar pjesë e këtij neni. Gjithsesi gjithmonë duhet kuptuar që të tilla përfaqësime të të drejtave apo veprime në emër të një tjetri do të bëhen vetëm nga personat që me ligj janë caktuar të tillë. Kështu, është Kodi i Familjes që përcakton që fëmijët përfaqësohen nga prindërit në të tilla raste, me përjashtim të rasteve kur prindërit kanë abuzuar me të drejtën prindërore dhe ajo u është hequr. Në rastet e fundit apo në rastet kur një person nuk ka prindër, atij i caktohet nga gjykata apo nga një institucion i caktuar shtetëror, një kujdestar i cili do të kujdeset për ushtrimin sa më mirë të të drejtave e detyrimeve të personit që nuk i ushtron dot vetë ato.

### **Aspekte edukative**

Pikënisje për të formuluar nenin në fjalë duhet të ketë shërbyer koha kur individi konsiderohej vetëm *objekt i ligjit dhe jo subjekt i tij*. Kuptimi i thelbit të këtij nenin, ka të bëjë me atë se si duhet ta konsiderojmë individin; objekt apo subject të ligjit, apo, dhe object dhe subjekt të ligjit.

T'a konsiderosh individin *objekt të ligjit* do të thotë që, ai lipeset të vlerësohet jo nga vetja por vetëm nga të tjerë, se ai vlerësohet për atë që përfaqëson dhe që është, jo për atë që dëshiron, jo për atë që synon të arrijë, por për atë që, mund të kryente, për atë që mund të përdorej, nga të tjerë, thënë ndryshe, *individit nën fokusin e të tjerëve, jo nën fokusin e përmbushjes së vetes*.

Neni – 6 tenton të konsiderojë individin subjekt të ligjit, që do të thotë se i garantohet atij, {individit}, e drejta për të

- Realizuar vetë martësen,
- Lidhur një kontratë

- Zgjellur lirisht një proces pune,
- Trashëguar pasurinë,
- Për të shitur dhe blere, e tjer.

Neni – 6 ka koherencë të plotë dhe vihet në zgjerim të nenit për skllaverinë, si dhe te neneve 3,4,5,6, dhe vecmas nenit -7,ku thuhet ... I barabarte para ligjit, dhe mbrojtje pa asnje dalim para ligjit. Ndaj DUDNJ-ja formulon nje nen të posacëm per t'I hapur rrugë legjislacioneve të vendeve të tjera të cilat duhet të ndërtonin ligje locale mbi këtë parim:

**individit subject dhe object I ligjit.**

Neni – 6 per frymen që përcjell për thelbin e tij, tenton të universalizojë idene e individit subject I ligjit, dhe të stopojë së konsideruari individin, vetem objekt I ligjit.

Neni 6 operon me termin “personalitet juridik” që do të thotë se ky nen I referohet vetëm qënieve natyrale-njeriut, por jo shoqatat, organizatat që krijohen nga njeriu. Këto të fundit njihen me termin “persona juridik”

Është shume me rëndesi të kuptohen dhe te diferencohen termat “personalitet juridik” dhe “person juridik”. Dallimi thelbesor mes tyre është se: personaliteti juridik-njeriu, ekziston pavarësisht nga ligji, ndërsa personin juridik {nje shoqatë} duhet ta njohë ligji.

*Personaliteti juridik* ekziston jashtë dhe pavarësisht nga ligji, dhe se ligji vetem I garanton atij funksionimin dhe zhvillimin, ndërsa *personin juridik* duhet të njihet nga ligji.

Ka nje argument të pakundërshtueshem pse neni – 6 është pjese e DUDNJ-së. Synimi për t’I garantuar personalitetit juridik, {individit}, të drejtat civile bazë si: e drejta e martesës, e trashëgimisë, e shitblerjes e bërjes së kontratave, jo vetëm brenda kufinjve të tij shtetror por dhe pertej tyre, tjer. Në këtë këndvështrim neni – 6 behet universalisht i aplikueshëm. Ne nenin – 6 perdoriet dhe togfjalëshi “ *ne cdo kohe dhe ne cdo vend*”, pra personaliteti juridik duhet te njihet kudo dhe kurdohere. Cdo personalitet juridik pavarësisht nga “ombredha shtetore” ku gjendet duhet te gëzoje te drejta civile bazë. Por nuk ndoll keshu me te drejtat politike bazë.

Ndaluni dhe arsyetoni:

Nje i huaj nuk lejohet të martohet me nje person nga vend tjetër i huaj. Neni – 6 tenton t’i garantoje të drejtën për të realizuar martese me të, si e drejtë civile baze, si e drejtë themelore e nje “personaliteti juridik”. E drejta për martese, konsiderohet si e drejtë themelore që buron dhe eshte ne permbushje te personalitetit te individit, dhe ligji ne kete rast, behet i pafuqishëm ose i paarsyeshem. Kjo ben që, nje shtet nuk gëzon asnje të drejtë, të paragjykoje, diskriminojë një individ shtetas të vetin, përshkak se ka realizuar nje martese me nje shtetase tjetër.

E drejta për martese është e drejtë natyrore dhe eshte ne permbushje të nevojave natyrore te tij.

Trajtoni raste që dini ne kenveshtrimin e nenit – 6

Ballafaqoni kushtetuyen tone me nenin – 6.

Megjithë frymen pannjerzire që ofron neni – 6 jo të gjitha legjislacionet e vendeve kanë përmbushur mesazhin e nenit – 6. Ka shtete të caktuara që nuk lejojnë shitblerjen e tokës, pasurisë, nuk njohin te drejtën e trashëgimise, e tjer.

Sa u perket te drejtave baze politike, shtetet janë më të ngurta. E drejta për të zgjellur dhe për t'u zgjellur ju njihet vetëm shtetasve të vendit dhe jo të huajve. Këtu kemi te bejme me interesa të ashtuquajtura shteterore dhe kombetare. Të votosh president te vendit tend apo minister, nje te huaj, nuk je mjaftueshmerisht i garantuar se do te permbushen cilesisht obligimet qe shtetasit kerkojne.

Keshtu, kushtetutat e vendeve të ndryshme, qoftë dhe ato më të zhvilluarat, nuk kane toleruar ose kane lejuar fare pak, përmbushje te drejtave politike, bazë.

Nje shtetas {x} i dëbur për arsye pikepamjesh politike, nga vendi i origjines, ka gjetur strehim dhe trajtim në shtetin {y} por kjo nuk ka qënë argument që ky shtats të fitoje te drejta politike te shtetit ku gjendet i strehuar.

Nga kenveshtrimi juaj

Sillni argumente nese ky është nje personalitet juridik

Sillni raste që ju dini dhe arsyetoni rreth tyre ne frymen e nenit – 6

Kjo do te thote se shtetasi {x} gëzon vetëm disa të drejta kudo dhe kurdohere, pra, edhe ne rastet kur nuk gjendet ne vendin e origjines, por jo cdo te drejte mund t'i garantohet.

Mundësi për diskutim

a. Nga perspektiva juaj si të kuptojmë:

individin objekt të ligjit

individin subject të ligjit

cdo të thotë të konsiderosh individin për atë që dëshiron te jete,

cdo të thotë ta konsiderosh individin për atë që mendon se është,

b. Nga perspektiva juaj beni dallimin mes:

personalitetit juridik

personit juridik

Situatë rasti

1. Në shtetin {x} femrave nuk ju njihet e drejta e pasurisë së paluajtshme. Per rrjedhoje, nuk perfitojne te dreten per te trasheguar, dhuruar.

Nga perspektiva juaj:

Shteti ne fjale nuk operon sakte dhe drejet me termin “personalitet juridik” sic e kerkon fryma e nenit – 6,

Komentoni diskriminimin që i behet ”personalitetit juridik” ne fjale, per arsyen e vetme se eshte femer.

2. Shtetësja A.G. e martuar me O.R. divorcohet nga bashkeshorti, pas disa vitesh martese. Per shkak te marteses ajo kishte fituar shtesine britanike. Me te hollat e fituara nga puna e saj, dhe vetem e saj, {disponon dokumente per kete} kishte blere nje banese komode. Pas divorcit kthehet ne shtetin e origjines.

Kerkon t'i njihet pasuria dhe t'i kthehet asaj. Por askush nuk ja njeh pasurine.

Nga perspektiva juaj dhe fryma e nenit – 6

Si mund te rregullohet rasti ne fjale?

### **Neni 7.**

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë.

### Trajtim ligjor

Kuptim më i thjeshtë i këtij neni është që ligji i konsideron të gjithë njësoj, i trajton ato njësoj dhe i mbron njësoj të drejtat e kujtdo duke mos lejuar diskriminimin e askujt në gëzimin e të drejtave. Vëreni që neni 7 i referohet një parimi, i cili është shumë i rëndësishëm për të drejtat e njeriut, parimi të barazisë para ligjit. Në fakt, neni 7 i referohet edhe një parimi tjetër po aq të rëndësishëm siç është parimi i mosdiskriminimit në gëzimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, edhe pe përfshirja e këtij parimi nuk është qëllimi kryesor i tij. Neni 7 është shumë i qartë kur deklaron barazi të të gjithëve para ligjit dhe jo një barazi absolute për të gjithë. Kështu, neni 7 i jep karakter ligjor çështjes së barazisë duke e garantuar atë vetëm në lidhje me ligjin.

*Parimi i barazisë para ligjit dhe ai i mosdiskriminimit, dy parime themelore në mbrojtjen e garantimin e të drejtave të njeriut*

Si parimi i barazisë të cilin ky nen e ka në fokusin e tij ashtu edhe parimi i mosdiskriminimit, të cilin ky nen e përmend, si dhe mundësia e mbrojtjes në rast se këto shkelen, janë parime themelore për garantimin e ekzistencës dhe mbrojtjes, gëzimit të të drejtave të njeriut. Parimi i barazisë kërkon që të gjitha shtetet në territorin e tyre juridiksional t'i sigurojnë kujto njësoj njohjen e njëjtë nga ligji dhe trajtimin e njëjtë të tyre. Komiteti për të Drejtat e Njeriut duke diskutuar për parimin e barazisë ka theksuar se parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit kanë karakter themelor dhe të përgjithshëm, edhe pse këto parime mund t'i shohim të lidhura me nene që rregullojnë çështje të caktuara. Edhe në kësi rastesh gjithsesi të dy këto parime ekzistojnë si parime që mbulojnë edhe ato raste në të cilat nuk përmenden shprehimisht këto dy parime.

*A është neni 7 përsëritje e neneve të tjera të DUDNJ-së?*

DUDNJ edhe në nene të tjera të saj i referohet parimit të barazisë së gëzimit të të drejtave e lirive të përfshira në të. Kështu neni 2 i DUDNJ-së, siç tashmë është theksuar, parashikon që çdokush ka të drejtë të të gëzojë të gjitha të drejtat e liritë e përfshira në deklaratë pa asnjë dallim. Më tej, neni 8 i DUDNJ-së thekson që çdokush ka të drejtë t'i referohet mjeteve ligjore efikase, pra të mbrohet para organeve kompetente të vendit në rastet kur të drejtat e liritë e tij shkelen.

Edhe pse në këto nene gjejmë aspekte të përbashkëta, secili prej tyre ka një qëllim të veçantë. Neni 2 ka synim të ndalojë diskriminimin e çdo lloji në vetvete duke i vënë çdo shteti detyrimin që të marrë masa të sigurojë që çdokush në territorin e tij dhe subjekte të juridiksionit të tij të gëzojnë njësoj të drejtat e liritë e parashikuara në DUDNJ. Ndërkohë

këtë neni 7 e merr të mirëqenë tashmë që askush nuk duhet diskriminuar, sepse në fakt kjo, është përfshirë tashmë në nenin 2. Për këtë, neni 2 i referohet më shumë një parimi tjetër, atij të barazisë para ligjit, duke theksuar që të gjithë jo vetëm trajtohen njësoj nga ligji por edhe duhet të mbrohen njësoj para tij. Për çdo diskriminim që mund të vijë nga zbatimi i padrejtë apo jo njësoj i të drejtave apo lirive të njeriut neni 7 i referohet të drejtës së kujt do që të mbrohet, pa iu referuar ndonjë mjete mbrojtjeje të mundshëm duke e lënë në fakt ndoshta të paplotësuar mundësinë e mbrojtjes. Neni 7 thjesht mbetet në deklarin e mundësisë së kujt do për t'u mbrojtur njësoj nga çdo kufizim apo shkelje e deklaratës, apo thënë më qartë, e të drejtave e lirive që ajo përmban në vetvete. Ndërkohë neni 8 i DUDNJ-së plotëson edhe atë hapësirë që kishte mbetur me qëllim që të mundësojë një mbrojtje efektive. Është qëllimi i nenit 8 që të përcaktojë detyrimin e çdo shteti që të parashikojë mjete efektive juridike ku çdokush të ketë të drejtën të drejtohet për të siguruar mbrojtjen nga shkeljet apo kufizimet e të drejtave e lirive.

*A sjell interpretimi i nenit 7 ngurtësimin e interpretimit dhe zbatimit të DUDNJ-së?*

Mund të mendohet që Neni 7, duke mbrojtur të drejtën e të gjithëve nga çdo diskriminim që cënon deklaratën si dhe çdo nxitje për një diskriminim të tillë mund të bëjë që interpretimi i DUDNJ-së të jetë i ngurtë. Kjo do të thotë që mund të mendohet që kjo DUDNJ nuk mbështet ndryshimet në zbatimet e saj, duke mos lejuar p.sh. kufizime në të drejtën për të votuar. Do të ishte e çuditshme që kjo të ishte interpretimi i këtij neni, sepse do ta bënte DUDNJ-në një dokument që nuk mund të konsiderohet lehtë universale. Të qenit universal kërkon pa dyshim fleksibilitet në interpretimin e saj sepse zbatimi i saj në të gjithë botën do të thotë në të njëjtën kohë implikime praktike.

*Dokumente të tjerë që parashikojnë po ato parime e rregullime si edhe neni 7 DUDNJ-së*

**Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile e Politike: Neni 26 i këtij Pakti i cili thekson që**

**Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtën e mbrojtjes efektive dhe të barabartë pa kurrfarë diskriminimi kujt do. Ky nen rendit edhe shkaqe për të cilat nuk lejohet diskriminimi të cilat janë të njëjta me ato të DUDNJ-së**

**Konventa Ndërkombëtare për Eliminim e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial: përmend gjithashtu barazinë si parim bazë dhe mosdiskriminim edhe pse këtë term e lidh ngushtësisht me termin racial, duke ndaluar pra diskriminim racial. si**

**KEDNJ-ja nuk e përfshin parimin e mosdiskriminimit si parim më vete. Ajo e përshin në nene të cilat i referohen**

### Aspkete edukative

Neni – 7 i adresohet drejtpësdrejt shtetit, i cili ka detyrimin të garantojë një mbrojtje të barabartë cdo individit në cdo rrethanë, pavarësisht nga: mosha, statusi social, gjinia, raca, perkatësia fetare, statusi politik, e tjer, {dukshem nenet permbushin njeri tjetrin}.

Automatiksht, cdo individ sipas këtij neni, ka të garantuar mbrojtje të barabartë para ligjit pavarësisht ku gjendet.

Neni – 7, është i formuluar në trajtën *“të gjithë janë të barabartë para ligjit ... bie ne sy fakti që, evitohet fjala “duhet” dhe “mundet” të jenë te barabartë, dhe artikullohet në trajtë definitive, “të gjithë janë të barabartë”, duke përcjelle një artikulum definitiv, faktik, detyrues, për të gjitha shtete që e kanë nënshkruar DUDNJ-në.*

Cdo shtet që ka nënshkruar DUDNJ-në, ka detyrimin të **përthyeje në nivel lokal**, frymen e neni – 7, që do të thote se neni në fjalë përcjell fryme dhe detyrim universal, dhe se shtete respektive kanë detyrimin të formulojnë ligjin lokal dhe institucionet respektive për t’i garantuar cdo individ, mbrojtje te barabarte para ligjit.

**Ne zberthim te neni – 7 te DUDNJ-se,**

Kushtetuta e Shqipërisë, në pjesën *“Parime te pergjithshme”*, shpall se: *“të gjithë janë të barabartë para ligjit” dhe se “askush nuk mund të diskriminohet padrejtesisht për shkaqe të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, ose perkatësia prinderore”*

### **Mundësi për diskutim:**

Nga perspektiva juaj:

Arsyetoni pse neni – 7 i DUDNJ-se i adresohet shteteve

Arsyetoni pse shteti dhe vetem ai mund të garantojë mbrojtje te barabarte para ligjit

Arsyetoni çfarë perfaqëson për ju “mbrojtje e barabarte” para ligjit

Argumentoni trajtën e formuluar te neni -7, pse është evituar fjala “duhet” dhe “mundet”

Sillni argumente cdo të thotë të përthyesh në nivel lokal neni – 7 të DUDNJ-se

### **Detyrë:**

Komentoni zgjerimin që Kushtetuta e Shqipërisë i ka bërë konceptit “e drejte e individit”t pavarësisht nga:

*{...etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, ose perkatësia prinderore}*

DUDNJ-ja nuk ka përfshirë {gjendjen ekonomike, arsimore, sociale, ose perkatesi prinderore}

Pse Kushtetuta e shqipërisë e ka zgjeruar konceptin barazi para ligjit pavaresisht nga ...

### **Situata rasti**

Kompania e ndërtimit A ka marrë një leje ndërtimi nga autoriteti përkatës i qeverisjes vendore . Kjo leje ndërtimi është marrë në shkelje të ligjit. Kompania e ndërtimit B kërkon nga i njëjti autoritet të pajiset me leje ndërtimi, duke qenë në të njëjtën situatë në shkelje të ligjit si dhe kompania A. Kompanisë B i refuzohet kjo leje.

Diskutoni a është shkelje e barazisë para ligjit ky trajtim i ndryshëm që i bën të njëjtës situatë autoriteti i qeverisjes vendore?

## **Neni 8**

Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet.

### ○ *Trajtim ligjor*

### ○ *Aspekte edukative*

Thelbi i këtij neni të DUDNJ-se është mbrojtja që i garanton kushtetuta, ligji dhe gjykata kombëtare çdo njeriu, në përputhje me frymen e DUDNJ-së dhe konkretisht të nenit -8. Por... kushtetuta, gjykata dhe ligji {x}, e merr në mbrojtje personin, jo nga cdo lloj dhunimi, por vetëm, nga ato të drejta themelore që garantojnë në kushtetutën dhe ligjin respektiv.

Kjo vlen të kuptohet në esencë, pasi, DUDNJ-ja nuk shpall të drejta dhe liri pa kufi të individit, por të drejta dhe liri deri në kufinj të ku... realizohet personaliteti i tij/saj, ruhet dinjteti, dhe ... nuk çënohet jeta dhe personaliteti i tij/saj...

Mundësi për diskutim

Identifikoni “kufinjte” e nenit – 8 të DUDNJ-së

Neni – 8 operon me tog-fjalëshin “.. të drejtave themelore që i siguron atij/asaj kushtetuta apo ligji”

Nga perspektiva juaj sillni argumente PSE?

Arsyetoni:

Njeriu është i prirur të zgjerojë hapësirat e tij të të drejtave dhe lirive, shumë here me shumë se, ato të përfshira në DUDNJ- në, por institucionet ndërkombëtare dhe lokale jo të gjitha i marrin përparësi t’i mbrojnë dhe jo çdo e drejtë që individi pretendon, garantohet në ligjin ndërkombëtar apo lokal ...

PSE ...?

Situatë rasti

Nxënësit A.F dhe B.K përdorin gjuhë dialektale në shkollë megjithatë mësuesit ju kanë tërhequr vëmendjen disa here për këtë. Te dy nxënësit insistojnë se është e drejtë e tyre të operojnë me dialektin e krahinës prej nga vijnë dhe jo vetëm në gjuhën e folur por dhe në atë të shkruar.

- Mësuesit sjellin argumente të tjera, gjuhë e folur dhe vecmas ajo e shkruar është detyrim i çdo nxënësi në shkollë, detyrim që rrjedh nga vendimi për të folur të gjithë trajtën e gjithëpranuar. Mardhenia mes dy palëve, mësuesve dhe nxënësve, ka mbërritur në një pikë konflikti.



- Mësuesit pretendojnë se kanë të drejtë dhe po bëjnë cilësisht detyren, Ata ngulin këmbë në këtë.
- Nxënësit, pretendojnë se kanë të drejtë të operojnë me trajten dilektale [gjuhe me te cilën janë rritur} dhe se ata gjenden te privuar nga kjo e drejte që rrjedh nga vendi dhe kultura ku janë rritur dhe prej nga vine.

Mundësi për diskutim:

Nga perspektiva juaj ballafaqoni të drejtat që servirin të dy palët.

Nga perspektiva e nenit – 8, dhe e të drejtave të parashikuara në DUDNj-në ballafaqoni të drejtat që pretendon secila pale.

A kemi të bëjme me një të drejtë themelore, apo me një spekulim të së drejtës themelore – përdorimin e gjuhes në trajtë dilektale?

Identifikoni ligjin lokal që rregullon këtë mardhenie.

## **Neni 9**

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose internimit.

### ○ **Trajtim ligjor**

Ky nen operon në rrafshin e mbrojtjes juridike të personit. Termat kyç janë: ndalim, arrestim, dhunim, arbitraritet. Kuptimi i lirise së personit në rastin në fjale trajtohet nga pikepamja e shtetit. Ndalimin, dhunimin e arrestimin e personit përgjithësisht e kryejnë institucionet legale që janë pjesë e shtetit. Por dhe shteti gëzon të drejta të kufizuara mbi personin.

Shteti nuk mund t'i ushtroje ato në mënyrë arbitrare. Neni – 9 merr në mbrojtje çdo person nga arbitrariteti. Thelbi i këtij neni është marrja në mbrojtje e personit nga arbitrariteti.

- Arbitrariteti dhe absurditeti
- A përfaqësojnë të njëjten gjë.

Si mund dhe si duhet kuptuar ky raport?

### **Situatë rasti**

”Një grup ekspertësh në fushën e edukimit, do të vizitonin Libanin konform një programi të planifikuar më parë nga institucionet pritëse. Personi M.Gj. pjesë e grupit të ekspertëve u ndalua në aeroportin pritës ku qëndroi për 39 orë në zyrat e policisë së aeroportit, duke mos u lejuar të vazhdonte viziten e punës si pjesë e grupit. Pas 39 orësh, ajo kthehet në aeroportin e Rinasit përmes një linje ajrore tjetër. Asnjë argument as koment për ndalimin e personit. Hetimet ishin rreth një vize izrealite që gjendej në pasaportën e personit të ndaluar. Demi ishte shkaktuar. Vizita nuk ishte realizuar dhe stresi dhe paniku i personit në fjale dhe i gjithë grupit gjithashtu...”

### **Diskutoni dhe ...**

- Komentoni ndalimin arbitrar të personit
- Ballafaqojeni ndalimin me nenin në fjale të DUDNJ-së
- Si mund të evitohet ndalimi arbitrar
- Cilat mund të jenë ”pretekset” e autoriteteve të aeroportit.

### **Situatë rasti**

Polici ndaloi një person rreth të 40-tave në hollin e hotelit qëndror të kryeqytetit. As gadishmeria e personit për të treguar dokumentin e identifikimit, dhe as rezistenca e tij për të sqaruar personin e shërbimit, nuk e evituan dërgimin e personit në zyrat e policisë së rajonit. Rreth 50 min me pas personi në fjalë ishte i lire. Demi ishte shkaktuar. Personi kishte humbur takimin e planifikuar, për të cilin kishte udhëtuar prej nga shumë larg.

### **Diskutoni**

- A kemi një ndalim arbitrar
- Luani rolin e policit deri në fund

- Luani rolin e personit të demtuar, deri ne fund
- Zhvilloni me tej ngjarjen si mund të kete rrjedhur
- Kundërshtoni ndalimin arbitrar të policit përmes argumenteve tuaja
- Diferenconi ndalimin nga arrestimi dhe dhunimi

Detyre:

Nga perspektiva juaj a është e mundur të realizohet nje gjykim ne kushtet “sterile”

- Jashtë cdo para dhe pasgjykimi...
- Jashtë cdo parapëlqimi apo preference...
- Jashtë cdo favorizimi....

Detyre

Nga perspektiva juaj ...

- Si duhet kuptuar ideja qe te realizojme “shqyrtim te ceshtjes”... jo i individit.

Mundësi për diskutim:

**Për mësuesit:**

Sentenca te shkeputura nga Martin Luterking

**Sentenca e parë**

“... ka dy lloj ligjesh, të drejta dhe të padrejta. Cdo njeri ka përgjegjësi ligjore dhe morale për të mos iu bindur ligjeve të padrejta. I tillë është cdo ligj që nuk mbështetet në ligjet natyrore dhe të përjetëshme...”

Veconi fjalët e nenvizuara dhe italike dhe...

- Ballafaqonjini ato me kuptimin tuaj per natyrën morale dhe ligjore të vetë ligjit,
- Karakterin e përjetshëm dhe natyror të ligjit
- Pse vetëm një ligj që ka karakter natyror dhe të përjetëshëm vlen t’I bindësh?

Për mësuesit

**Sentenca e dytë**

“... Ai që thyen nje ligj të padrejtë duhet ta beje kete në mënyrë të hapur e dashamirëse si dhe të jete I gatshëm për të pranuar dënimin. Cdo individ që thyen një ligj me vetëdije, duke e denoncuar atë si të padrejtë, por, që nga ana tjetër, është i gatshëm të pranojë burgimin me qëllim që të zgjojë vetëdijen kolektive ndaj padrejtësive, është shprehje reale e respektit më të thelle per ligjin...”

Veconi fjalët e nenvizuara dhe italike dhe...

- Nga perspektiva juaj cdo të thotë “i gatshëm për të pranuar dënimin”
- ... shprehje reale e respektit më të thelle për ligjin...
- Duke e ballafaquar me DUDNJ-jë idene e Luterkingut, cili eshte kuptimi i tij per lirine dhe te drejta e individit ...?
- Cdo të thotë sipas këtij këndi “të përballësh me intolerancën që vjen nga ligji”

### Situatë rasti

.... E mitura {x} ka mbetur shtatzane ne kushte të diktuar, produkt i një përdhunimi në grup.

E traumatizuar, ajo nuk guxon ta abortojë fëmijën pasi gjendet e kërcënuar nga pjesëtarët e grupit. Fëmija është paraprakisht i shitur...

Nga perspektiva e juaj:

- e drejta e të miturës për të abortuar është e drejtë e patjetersueshme,
- e paarsyeshme,
- e mundëshme,
- nëse fëmija, produkt i kësaj situate, mbijeton, cila është marrdhenia e tij me nenen

Ballafaqoni situatën me nenet: 4- 5 të DUDNJ-së

Organizohuni ne dy grupe dhe luani rolin e:

- Nenes së mitur,
- Punonjeses sociale,
- Te trupit gjykues,

### **Neni 10**

Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

#### **• *Trajtim ligjor***

Neni 10 përcakton të drejtën për një gjykim të drejtë. Përmbajtje e nenit 10 të DUDNJ është konçiz dhe jo shumë i detajuar. Në dokumentat e mëpushëm ndërkombëtar kjo e drejtë është trajtuar në mënyrë më të detajuar. Ndryshe nga KEDNJ në këtë nen nuk përmenden se cilat janë të drejtat e personit në një proces. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) me precedentët e saj e ka zgjeruar dhe interpretuar nenin 6 të KEDNJ i cili e ka zanafillën në nenin 10 të DUDNJ.

Para së gjithash, ky nen përcakton parimin e *barazisë së plotë të palëve* në një proces. Kjo arrihet kur respektohem dy aspekte të rëndësishme: procedura gjyqësore dhe kur organizimi gjyqësor është me të vertetë i pavarur.

Një elementë i rëndësishëm i kësaj dispozite është që *të drejtën për gjykim* e ka vetëm gjykata. Ligji i një shteti përcakton mënyrën e krijimit dhe të funksionimit të gjykatave.

DUDNJ kërkon që gjykimi nuk mund të bëhet nga çdo lloj gjykate për vetëm nga *gjykata që janë të pavarura*. Në këtë deklaratë nuk jepet kuptimi i pavarësisë së gjykatës. Aat janë trajtuar me në detaje në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. GJEDNJ mban parasysh disa kritere që vlerësojnë pavarësinë e gjykatës si: mënyra e emërimit të gjyqtarëve dhe kohëzgjatja në detyrë e tyre, ekzistenca e garancive që gjyqtarët të jetë të mbrojtur nga presionet e jashtme, paarsia e gjykatës nga pushteti ekzekutiv dhe nëse organi përfaqëson në dukje një pavarësi objektive. Ka shumë kritere të vlerësimit të sistemit gjyqësor në shqipëri nga organizma monitorues ndërkombëtare.

DUDNJ kërkon që gjykata të jenë jo vetëm të pavaruara, por *edhe të paanshme*, pra personi të mos paragjykohet nga gjykata, gjykata të kërkojë prova të njëanshme, respektimi i prezumimit të pafajësisë. Në rast se për një arsye ose tjetër, një gjyqtar i caktuar mund të ketë lidhje me njërën nga palët ose interesa të tjera me çështjet ai duhet të tërhiqet nga gjykimi i saj dhe të garantojë në këtë mënyrë paanshmërinë. Paanshmëria duhet të jetë objektive dhe subjektive.

Që të ketë një gjykim të drejtë, personi ka *të drejtë të dëgjohet në gjykatë*. Megjithatë, jo gjithnjë është e nevojshme presenca e tij, pasi në mungesë të tij a mund të përfaqësohet nga një avokat të zgjedhur prej tij ose të caktuar kryesisht nga gjykata. Megjithatë, dëshmia në seancë ka vlera për një proces të rregullt gjyqësor dhe përdorimi i leximit të thënieve në një seancë paraprake varet shumë nga cilësia e mbrojtjes.

Gjykimi duhet të bëhet brenda *një kohe të arsyshme*. Ky është një nga kriteret e nenit 6 të KEDNJ dhe nuk gjenden në përmbajtjen e nenit 10 të DUDNJ. Ndonëse në konventë dhe praktika e GJEDNJ nuk ka përcaktuar një kohë fikse (afatet e gjykimit të çështjeve penale përcaktohen në legjislacionin e secilit vend. Megjithatë, GJEDNJ ka trajtuar shumë raste ku ka gjetur se është shkelur neni 6 i KEDNJ për shkak të vonesa të parsyeshme për gjykimin e një çështjeje.

Deklarata përcakton se gjykata duhet të vendosë përsa i përket *të drejtave dhe detyrimeve të personit*. Deklarata nuk shtjellon në detaje nëse bëhet fjalë për këto të drehta në çështje civile apo edhe në ato publik. Trajtime ose kufizime të tyre janë bërë në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata duhet të vendosë edhe për themelsinë e *çdo akuze penale*. Pra deklarata nuk bën dallim nëse akuza është për një vepër penale të rëndë apo të lehtë. Edhe në dokumentat e mëvonshëm është rruajtur ku përcaktim i bërë në nenin e 10 të DUDNJ.

### ***Si ka gjetur zbatim neni 10 i Deklaratës në legjislacionin shqiptar***

Konventa Europiane e të drejtave të Njeriut neni 6, paragrafi 1 i Konventës thotë se.....

Kushtetuta e RSh në nenin 33, 31

Kodi i procedurës penale, etj.

#### **• *Aspekte edukative***

Neni 10 i DUDNJ fokusohet tek një e drejte specifike e personit:

E drejta për t'u gjykuar në kushtet e drejtësisë së plotë. Kjo do kuptuar që një person gjykohet për një implikim të tij në një veper penale, në kushte "sterile".... pra....

Jashtë cdo para dhe pasgjykimi.

Jashtë cdo parapelqimi apo preference.

Jashtë cdo favorizimi.

Neni 10 i DUDnj-se, duhet lexuar si parimi universal që tenton të ruajë ekuilibrin mes personit të akuzuar, palës akuzese, procesit të gjykimit, deri tek vendimi.

Garantimi i këtij ekuilibri, kërkon shqyrtim të çështjes, jo të individit.

Shqyrtim me:

drejtesi,

publikisht të hapur,

të pavarur,

të paanshëm,

ballafaqim të drejtave dhe detyrimeve te personit të implikuar,

Si gjithë nenet e tjera të DUDNJ-së, neni 10, nuk futet në detaje, se cilat janë të drejtat e një personi në proces. Neni 6 i KEDNJ merr pikenisje nga neni 10 i DUDNJ dhe përmbush dhe zhvillon përmbajtjen e tij.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) me precedentët e saj e ka zgjeruar

DUDNJ nënvizon, idene që: gjykimi nuk mund të bëhet nga çdo lloj gjykate, por, vetëm nga *gjykata që janë të pavarura*. Në këtë deklaratë nuk jepet kuptimi i pavarësisë së gjykatës se c'farë dhe si të kuptojmë pavarësinë e gjykatës si:

- *mënyra e emërimit të gjyqtarëve,*
- *kohëzgjatja në detyrë e tyre,*
- *garancitë që gjyqtarët të mbrohen nga presionet e jashtme,*
- *pavarësia e gjykatës nga pushteti ekzekutiv,*

Sistemet gjyqësore në demokraci të reja si ajo në Shqipëri, monitorohen, nga organizma ndërkombëtare.

Neni 10 i DUDNJ-së kërkon jo vetëm gjykim të pavarur por dhe të paanshëm.

### **Si të kuptojmë paanshëmërinë gjatë gjyqimit?**

#### **Të garantosh gjykim të paanshëm do të thotë që personi:**

- *të mos paragjykohet nga gjykata,*
- *gjykata të mos kërkojë prova të njëanshme,*
- *të respektohet prezumimi i pafajësisë,*
- *gjyqtari/ët, anëtarë të trupit gjykues të mos kenë lidhje me njërin nga palët,*
- *personi ka të drejtë të dëgjohet në gjykatë,*
- *në mungesë të ti, personi mund të përfaqësohet nga një avokat i zgjedhur prej tij,*

Megjithatë, dëshmia në seancë ka vlera për një proces të rregullt gjyqësor dhe përdorimi i leximit të thënieve në një seancë paraprake varet shumë nga cilësia e mbrojtjes.

Neni 6 të KEDNJ, elaboron me tej përmbajtjen e nenit 10 të DUDNJ-së, kur kërkon që gjykimi i personit të përfshirë në çështje të realizohet brenda *një kohe të arsyshme*. Ky është një nga kriteret që nuk gjenden në përmbajtjen e nenit 10 të DUDNJ. Ndonëse në konventë dhe praktika e GJEDNJ nuk ka përcaktuar një kohë fikse (afatet e gjyqimit të çështjeve penale përcaktohen në legjisllacionin e secilit vend. Megjithatë, GJEDNJ ka trajtuar shumë raste ku ka gjetur se është shkelur neni 6 i KEDNJ për shkak të vonesave të paarsyeshme për gjykimin e një çështjeje.

### **Neni 11**

Kushdo që është i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit dhe në një proces publik në të cilin ka pasur të gjitha garancitë e duhura për mbrojtjen e vet.

Asnjëri nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk përbëjnë një vepër penale, sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, në kohën kur janë kryer. Gjithashtu nuk mund të vendoset një dënim më i rëndë nga ai që ka qenë zbatuar në kohën kur është kryer vepra penale.

#### ○ **Trajtim ligjor**

Neni 11 i Deklaratës është i ndërtuar në dy paragrafë të cilët janë të lidhur dhe duhen lexuar së bashku.

Në paragrafin e parë të këtij neni parashikohen disa të drejta themelore që duhen zbatuar gjatë një procesi penal që ka filluar ndaj një personi që akuzohet se ka kryer një vepër penale (në kohën e miratimit të Deklaratës njihej me emrin “vepër keqbërëse” sot në shumë ligje penale vepra të tilla quhen “penale”).

Edhe pse të rënda e me pasoja në ndëshkim, pavarësisht rregullave të shoqërisë, ka individë që i cenojnë rregullat e përfshira në ligje penale. Për këtë ata i nënshtrohen një procesi penal. Çdo proces zhvillohet duke respektuar një minimum rregullash të përcaktuara në nenin 11 të DUDNJ.

Në paragrafin e dytë të nenit parashikohen dy parime themelore:

parimi i ligjshmërisë së zbatimit të një ligji penal ndaj një personi që akuzohet se ka kryer një vepër penale;

parimi i kufizimit të dënimit brenda kuadrit të parashikuar dhe përcaktuar në ligj.

Neni 11 i DUDNJ është garanci për çdo person të akuzuar, pasi i detyron organet e akuzës dhe gjykatat që të mos veprojnë në mënyrë arbitrare.

### **Elementë të nenit 11**

Sipas paragrafit të parë, ky nen zbatohet ndaj **çdo personi të akuzuar**, pra nuk bëhet dallim për shkaqe të ndryshme, mjafton që ai të jetë e akuzuar. Kuptohet që në këtë rast bëhet fjalë për akuza që bën një institucion publik (**prokuroria, kush tjetër???**) dhe jo për akuza personale që mund t'i bëjnë njerëzit njëri-tjetrit në marrëdhëniet e përditshme mes tyre.

Personi duhet të akuzohet për **një vepër keqbërëse**, ose me fjalë të tjera për një vepër penale. Për të mësuar nëse një vepër është penale, referenca në ligj është e domosdoshme. Natyra e një veprë keqbërëse duhet të përcaktohet në një ligj penal si “vepër penale”. Deklarata përcakton se vepra mund përcaktohet si “penale” nga ligji i vendit ose një ligj ndërkombëtar. Sot ligjet ndërkombëtare janë aktive në përcaktimin e veprave penale pasi edhe aktiviteti ndërkombëtar i individëve dhe organizatave është rritur së tepërmi. Për rrjedhojë, hetimi i tyre, kur kryhet në një vend a disa vende njëherazi, kërkon që parimet e përgjithshme të hetimit, gjykimit dhe dënimit të përafrojnë sa më shumë mes tyre. Kur



bëhet fjalë për vepra penale të parashikuar nga Konventat Ndërkombëtare, gjykimi i tyre bëhet nga gjykatat ndërkombëtare. Neni 11 i DUDNJ merr një rendësi të veçantë pikërisht edhe për këtë dimension të veprimtarisë gjyqësore.

E drejta bazë që garantohet nga ky nen është parimi i **prezumimit të pafajësisë**. Me fjalë të tjera, personi i akuzuar nuk mund të quhet “fajtor” për veprën që akuzohet, edhe kur duket që ai është autori dhe ka dëshmitarë që flasin për të. Fajësia e personit **provohet ligjërisht**, vetëm kur ka prova të cilat të njihen si të tilla nga ligji dhe të jenë marrë në bazë të kërkesave të ligjit.

Ky nen përmend se **gjykimi i personit duhet të jetë publik**, duke rritur kështu kërkesat dhe garancitë për një gjykim objektiv. Deklarata nuk përmend se kush janë organet që bëjnë gjykimin, por kuptohet që ata caktohen nga ligjet e brendshme të shtetit.

Sigurimi i së **drejtës së mbrojtjes** është një element tjetër i rëndësishëm i deklaratës. Ajo garanton kufizimin e akuzës, abuzimin me personin dhe i krijon mundësi atij të jetë i mbështetur gjatë procesit gjyqësor.

Në paragrafin e dytë parashikohet se askush **nuk mund të dënohet për një veprë që nuk konsiderohet nga ligji si veprë penale** në kohën kur personi e ka kryer atë. Kjo garanton një garanci që ligji nuk mund të ketë një efekt veprimi kohë më parë. Nga ana tjetër, një parim i rëndësishëm i cili gjendet në të gjitha ligjet penale moderne është se për veprën penale të kryer personi do të dënohet vetëm me dënimet që ligji parashikon për veprën e kryer dhe ndaj tij nuk mund të zbatohen një dënim që është më i rëndë se ai që parashikon ligji.

Në themel të problematikës së përditshme në jetën shkollore ndeshen shumë nga konceptet themelore të këtij neni. Shpeshherë kërkohen procese të drejta, të paanshme, të painfluencueshme gjykimi, duke patur parasysh dimensionin civil të koncepteve kryesore të nenit që janë:

**Kushdo i akuzuar:** është term përmbledhës, që nuk lejon interpretime të kundërta. Kushdo është përgjithësim absolut që lejon të përfshihen në të të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht racës, moshës, gjinisë, besimit, etnisë, nacionalitetit, profesionit, kontributit publik, hierarkisë, etj.

**Pafajshmëria:** është status që gëzon gjithkush para akuzave dhe akuzuesve, që i jep të drejtën të kërkojë mbrojtjen e duhur dhe t'i nënshtrohet një procesi të drejte gjykimi. Pafajshmëria jepet për të garantuar edhe drejtësinë ndaj individit edhe paanshmërinë e gjykatës.

**Prezumi i pafajësisë** është një nga garancitë profesionale të procesit të drejtë gjyqësor. Edhe pse konceptet e mëposhtme lidhen me procesin gjyqësor, ato kanë domethënie të tyre në botën e sjelljes së fëmijëve.

*Vepër penale:* neni mbron të drejtën e kujtdo të akuzuar për vepra penale, duke lënë të hapur mundësinë që vendet të caktojnë vetë se ç'do të thotë “*vepër penale*”, për të pasur një proces të drejtë gjykimi. Duke deduktuar nga neni në jetën civile të shkollës mund të pritet që grupet e nxënësve të caktojnë vetë se çdo të thotë për ta dhe mjedisin e tyre “*vepër penale*”.

*Vërtetim i fajësisë* në bazë të ligjit dhe në proces publik: Neni krijon mundësinë e rishikimit të ligjeve, të verifikimit të drejtësisë se tyre në publik. Publiku dhe ligji nuk janë parë në çështjen e drejtësisë të shkëputur nga njeri tjetri. Nga ky nen në praktikën e shkollës mund të derivohen përpjekje për të formuar shprehje të sjelljes sociale.

*Garancitë e duhura për mbrojtje:* E drejta e mbrojtjes ndaj akuzave është çështje themelore e se drejtës. Ajo gjen mëshirim të plotë në organizimin e grupeve të vogla sociale në shkollë. Publiku, ligji dhe gjykata japin garanci se do të lejojnë mbrojtjen e të akuzuarit për vepra penale. Paanshmëria është kërkesë e apeluar në gjykimin e situatave të akuzës ose konfliktit në shkollë.

#### ○ *Aspekte edukative*

Neni 11 i Deklaratës Universale të të drejtave të Njeriut njihet ndryshe si neni i prezumimit të pafajshmërisë. Fuqizimi i individit për të gëzuar këtë status fillon në shkollë. Në aspektin edukativ, individët, qofshin nxënësit në shkollë qofshin figura të sjella në tekste, kanë nevojë të konsiderohen të pafajshëm derisa t’iu vërtetohet fajësia në një gjykim publik të drejtë.

Në shumë tekste të të gjitha cikleve të shkollimit, çështjet e deklarimit të fajësisë në bazë të ligjit, nga organet kompetente, në një proces të drejtë e publik, ku i akuzuari i ka pasur garancitë dhe mundësinë e mbrojtjes profesionale, janë çështje të injoruara. Në tekste të historisë apo letërsisë, shpallja e armiqve, veprimet armiqësore dhe identifikimi i fajtorëve shpesh bëhen pa treguar se një status të tillë individit e merr pas një gjykimi të drejtë ku të ketë pasur mundësi të mbrohet. Shpalljen “fajtor” e bën gjykata. Nxënësit nga praktikat e trajtimit apo nga tekstet mësimore duhet të kenë shansin të kuptojnë se kjo e drejtë i rezervohet gjykatës pas një procesi të drejtë gjykimi. Askush tjetër, as shkrimtarë e historianë, as mësues e aktorë të tjerë në shkollë nuk mund të akuzojnë mbi bazën e moralit civil a politik apo fakteve inkriminuese që mund të zotërojnë. Nxënësve iu duhen modeluar proceset e paanshme të gjykimit. Mësuesit nuk e kanë të lehtë të krijojnë shanse të edukimit me ndjenjën dhe shprehitë e gjykimit të drejtë të fajtorëve, pasi shpesh prezantimet në tekste modelojnë të kundërtën.

Në to, më së shumti, nxënësit njihen më konkluzionet e gjykimeve aprioristike të bëra gjatë viteve të historisë dhe jo me vetë gjykimet. Një pjesë e fajësimeve që ende sillen në tekste janë politike. Çështja e endepranishmërisë së tyre në tekste është e padiskutuar. Mësuesit kanë shans të reflektojnë vetë, por edhe me nxënësit. Në mësim të tilla, nxënësit duhet të kërkojnë fakte mbi rrugën e gjykimit që iu është bërë figurave të prezantuara.

**Aktivitetet:**

Reflektoni nëse janë të mjaftueshëm materialet e bëra publike mbi drejtësinë e gjykimeve mbi individë të shpallur në kurrikulën shkollore si të fajshëm. C'bëni për ta pasuruar informacionin mbi fajësinë/pafajësinë e tyre?

Diskutoni në grupe nxënësish nëse ndonjë prej tyre ka prejardhje nga ish-familje të deklasuara. Ndani me nxënësit e tjerë domethënien e konceptit të asokohe “*familje e dekluar*”. Provokoni reagime ndaj dënimeve kolektive politike.

Sillni në klasë hartën e botës. Ndhmoni nxënësit të mësojnë se në cilat vende vazhdon akoma genocidi njerëzor.

Në Gjakovë gjithshka ishte e trishtë në vjeshtën e vitit 1999. Ushtria serbe kish djegur jo vetëm shtëpitë, bizneset, dyqanet dhe gjithshka tjetër, por, më keq akoma, dhjetëra e dhjetëra burra, gra, fëmijë e pleq ishin vrarë. Shumë gjakovarë nuk kishin informacion për të afërmit e humbur.

Përcaktoni se cila do të ishte rruga e drejtë e shpalljes fajtor për masakruarit.

Mungesa e informacionit mbi fajësinë dhe pafajësinë e personave publike apo figurave historike është ngacmuese. Në tekstet e historisë, organizata si ajo e Ballit Kombëtar apo Legalitetit, Konferenca e Mukjes dhe pjesëmarrësit në të konsiderohen fajtorë. Ndaj tyre nuk përmendet në tekste të ketë procese gjyqësore që t'i kenë shpallur të tillë dhe as fakte të mjaftueshme që të ndihmojnë nxënësit të nxjerrin konkluzione mbi fajin e tyre në Luftën II Botërore.

Organizoni nxënësit të mbledhin fakte mbi mënyrën e shpalljes së tyre “*fajtor*” mes metodologjisë së mësimin gojor të historisë.

Organizoni nxënësit të mbledhin fakte dhe kundërfakte që dëshmojnë “fajësinë” e organizatave të krahut të djathtë gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Nëse është pamundur të mbledhni fakte në zonën tuaj, zhvillojeni mësimin në role. I vendosni nxënësit në rolin e përfaqësuesve të organizatave nacionaliste dhe politike që morën pjesë në Luftën e Dytë Botërore. Ndhimjini të bëjnë një prezantim të arsyeve pse janë në atë pozicion ndaj Luftës. Pjesa tjetër e klasës udhëhiqet përgjatë procedurave të gjykimit të drejtë. Sigurohuni që nxënësit gjykatës të mos influencohen nga konkluzionet e tekstit.

Për popullin shqiptar në Kosovë, Milloshevic ishte sinonimi i së keqes. Masivisht ata e dënonin si armik. Miloshevic përfundoi të gjykohej në Gjykatën e Hagës.

A do të ishte e drejtë që ai të dënohej nga gjykata në Serbi?

Në Kosovë?

Në Shqipëri?

Pse duhet ligji ndërkombëtar?

Vazhdoni të reflektoni dhe të zhvilloni aktivitete me nxënësit lidhur me ruajtjen e statusit të pafajësisë deri në gjetjen fajtor të individit nga një organ që ka mandat ta bëjë këtë gjë. Transferojini diskutimet për situata analoge në shkollë, ku dikush është “shpallur” fajtor pa të drejtë.

Provokoni diskutime.

Aktivizoni qeverinë e nxënësve, këshillin e klasës, mediatorët, bordin prindërve. (Sigurisht, në shkollë nuk ka individë që kanë kryer vepra penale. Diskutimi synon të kuptuarit e gabimit të ngutjes për të shpallur emocionalisht ose moralisht fajtor dikë pa faj).

Në shkolla është bërë një punë e konsiderueshme për edukimin me meditacionin dhe shprehi të tjera të zgjidhjes së konflikteve. *Mediatorët u trajnuan* në shkolla. Ata kanë ndihmuar në zgjidhjen paqësore të konflikteve të vërteta si dhe krijimin e një kulturë të tolerancës dhe respektit për të drejtat e njeriut në shkollë. Kjo nismë serioze zgjati vite duke krijuar në vend një masë kritike mediatorësh të rinj dhe të rritur.

Identifikoni mediatorë dhe sillini të ndajnë me nxënësit në shkollë përvojën e tyre.

Me përmirësimin e praktikave të punës në shkolla u krijuan edhe *qeveritë e nxënësve (studentore)* të cilat aktualisht shikohen si instrumente të zhvillimit të shkollës, të rritjes së nivelit të pjesëmarrjes së nxënësve nëpër aktivitete dhe jo drejtpërdrejt të krijimit të proceseve të drejta në shkollë. Fakti që edhe emri është “qeveri” i ngatërron punët e vendosjes së të drejtës.

Provoni të ngrini në shkollë “*këshilla*” që të krijojnë kulturën e të drejtuarit organeve të drejtësisë në rastet kur shkelen të drejtat.

Shumë sjellje të dhunshme në shkolla e familje rezultojnë pikërisht nga ngutja për të shpallur dhe gjykuar pa dëgjuar fajtorët, pa ia nënshtuar sjelljen e tyre një gjykimi të paanshëm, të drejtë, pa iu dhënë mundësinë të mbrohen përballë akuzave.

Ftojini nxënësit të gjykojnë mbi autoritarizmin e kulturës familjare në pjesën më të madhe maskuliniste, e cila i imponohet fëmijës, gruas me heshtjen kur gjykohet, duke krijuar kështu një precedent për të injoruar nevojën e gjithkujt për t’u mbrojtur në një proces të drejtë gjykimi.

Avokatia për individin e konsideruar “fajtor” shpesh herë konsiderohet si “bërje palë”. Diskutoni rreth situatave kur në krah të një të akuzuari në shkollë ka dalë dikush i quajtur nga mësuesët dhe nxënësit “palë” dhe jo një ndihmës në gjetjen e së drejtës në gjykim.

Vizitat në gjykata janë thuajse inekzistente. Edukimi ligjor tashmë sporadik mund të kthehet në një nismë në shkollë si hap drejt edukimit me të drejtat e njeriut. Programi i edukatës shoqërore të klasës së shtatë që synon njohjen e organeve gjyqësore është në

fakt një lëndë që ka edhe materiale në ndihmë të mësuesit, ndaj praktika e zhvillimit të saj duhet të jetë ndërvepruese. Forma të tilla si simulimi, mësimi në role, mock trial, hearing, etc, duhet të jenë edhe më shumë prezente në zhvillimin e kësaj lënde. Provoni të organizoni një gjyq në miniaturë.

Diskutoni mbi domethënien e dilemave të mëposhtme. Identifikoni informacionin që duhet për të vijuar më tej me zgjidhjen e tyre.

- Gjykata dënoi dikë që nuk e pranoi asnjëherë fajin e tij, po që nuk kish as argumente dhe fakte të hidhte poshtë akuzën. Procesi gjyqësor zgjati mjaftueshëm, e përfundimisht ai u dënua. Ai në burg i pohoi këshillueses (psikologes) se është i pafajshëm. nuk ka faj. Si duhet të veprojë ajo?
- Një grua u dënua se vrau vjehrrën e saj në grindje e sipër. Gjykata i dha dënimin e parashikuar në ligj. Gjatë këshillimit, këshilluesja e burgut mësoi se gruaja nuk ishte autorja e vërtetë e krimin, po i dashuri i saj. Vjehrra i kishte parë të dy dhe i dashuri e kishte vrrarë. I dashuri i gruas ishte i lirë në qytet. C’duhet të bëjë këshilluesja?
- Në një takim në Vjenë Papa Benedikt XVI: Papa shprehu shqetësimin e madh për eutanazinë, të ashtuquajturën “ndihmë aktive për të vdekur”, siç tha: “Përgjigja e drejtë ndaj vuajtjes në fund të jetës është kujdesi i dhembshur, shoqërimi drejt vdekjes – në veçanti edhe me ndihmën e mjekësisë për zbutjen e dhimbjeve – e jo një “ndihmë aktive për të vdekur”. Natyrisht, kjo kërkon një impenjim të madh të shteteve për t’u siguruar këtyre pacientëve dhe familjarëve të gjithë mbështetjen për të cilën kanë nevojë. Diskutoni rreth eutanazisë dhe abortit. E kujt është e drejta e jetës?

***“Asnjëri nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk përbëjnë një vepër penale, sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, në kohën kur janë kryer. Gjithashtu nuk mund të vendoset një dënim më i rëndë nga ai që ka qenë zbatuar në kohën kur është kryer vepra penale” është pjesa e dytë e nenit.*** Kjo pjesë e nenit mundëson zhvillimin e aktiviteteve me bazë proceset hetimore, kohën dhe fuqinë prapavepruese të ndëshkimit gjyqësor.

Në lëndën e historisë mund të diskutohet mbi dukurinë e lejimit të fajtorëve të pandëshkuar. Në disa vende, gjykatat janë treguar hezitante në dënimin e njerëzve me dosje të inkriminuar. Gjykatat në vendet e tyre asnjëherë nuk kanë marrë përsipër të dënojnë fajtorët pavarësisht detyrimit që kanë organet hetimore të sigurojnë drejtësinë ndaj njerëzve të dëmtuar.

Në shumë vende të tjera, gjykatat janë aktive bashkë me organet e prokurorisë. Sjellja e kazuseve në klasë nga këto vende do të ishte e rëndësishme. Theksimi i edukimit ligjor në shkollë në varësi të moshës së nxënësve, në përputhje me zhvillimin e tyre moral, ndihmon në njohjen e nxënësve me probleme të sipërfaqësisë, anashkalimi dhe injorimit

të çështjeve të së drejtësi si dhe të sigurimit të drejtësisë dhe lirisë në shumë vende të botës. Sjellja e tyre në klasë ndihmon në formimin e qytetarëve të së nesërme.

*Mbrojtja në kushtet e gjykimit ndërkombëtar* është një çështje interesante për t'u sjellë në klasë. Çështja e emigrantëve shqiptarë të gjykuar në shtetin grek pa patur mbrojtjen e duhur, jo në gjuhën e tyre dhe çështje të tjera të dënimit të padrejtë mund të bëhen kazuse konstruktive për mësimin e nxënësve me kërkesat që lindin nga ky nen.

Aktivitetet për nenin 11 të DUDNJ, *dënimi i gjenocidit dhe i akteve mizore* në rrethana luftime mund të jenë interesante. Dënimi i kriminelëve të luftës në Kosovë, dënimi i tyre dhe dënimi i atyre që kanë kryer krime gjatë epokës së komunizmit në Shqipëri janë gjithmonë burime të hapura për diskutim.

Po aq të hapura mbeten edhe çështje të *njohjes se azilit* dhe të drejtës për të fituar azil. UNHCR në Shqipëri ka strehuar dhe vazhdon të strehojë azilantë nga Kina, Kurdistanin e nga vende të tjera në varësi të natyrës së rasteve është një çështje totalisht e heshtur në kurrikulën e shkollës parauniversitare. Parashtrimi i çështjeve të azilit, të të drejtave të azilkërkuësve, të dyshetësisë, të lejes së qëndrimit etj. janë çështje që mund të ndikojnë në zgjerimin e njohurive nga e drejta e mbrojtjes deri tek rrethanat rënduese të dënimit. Media dhe rastet e sjella në të mund të jenë raste shumë të mira diskutimi dhe ndërgjegjësimi për të rinjtë.

Çështja e mësimin të historisë është shumë kritike, sidomos e pjesës së historisë së Shqipërisë së shekullit XX. Në tekstet e historisë, mbreti Zog, krijimi i organizatave të Ballit Kombëtar dhe Legalitetit shikohen me ngjyrimë denigruese, ndërkohë që ekzaltohen zhvillimet e ngjyrimin komunist. Eksponentët e tyre konsiderohen njerëz që i sollën dëm/fat fateve të atdheut. Gjykimi i tyre është i padrejtë ndërkohë që organizatorët e aktiviteteve të Ballit dhe Legalitetit në kohën që kryenin veprimtarinë e tyre nuk kanë qenë të jashtëligjshëm.

Teknika të historisë gojore mund të ndihmojnë që mësuesi të kompensojë defektet e teksteve të historisë në favor të një gjykimi të drejtë historik, por edhe të lartimit të të drejtave të njerëzve që ushtronin aktivitetin e tyre politik në ato vite.

## **Neni 12**

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtën të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla.

### ○ **Trajtim ligjor**

Çdo individ e ka jetën të mbrojtur me ligj. Që nga koha kur u shpall Deklarata e deri më sot, kanë ekzistuar dhe ekzistojmë shumë mundësi të ndërhyrjes në jetën private dhe familjare të një personi nga përfaqësues të shtetit ose persona të tjerë privatë. Rreziku i cënimit të jetës private të personit është rritur shumë për shkak të rritjes së teknologjisë së komunikimit, përdorimit të internetit, veprimeve në bankë, mbajtjes së të dhënave personale të personave nga përfaqësues të organeve të ndryshme të shtetit (gjendja civile, dosje për aplikime për bursa ose kredi, për punë, të dhëna për pajisjen me pasaporta,) etj.

Nga ana tjetër, janë miratuar ligje të cilat parashikojnë kufizime ose ndërhyrje në këtë sferë për qëllime të përligjura dhe sipas procedurave ligjore. Edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të njeriut në nenin 8, paragrafi i dytë i saj parashikon të drejtën e autoritetit publik për të ndërhyrë në ushtrimin e kësaj të drejte në një shkallë të përcaktuar nga ligji. Në një shoqëri demokratike, përcaktimi i masës së ndërhyrjes është i domosdoshëm për sigurimin kombëtar, sigurinë publike, mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve, por edhe për mbrojtjen e vetë individit.

Duke qenë se mbrojtja e jetës private është shumë e rëndësishme dhe rreziku për të ndërhyrë në të i madh, neni 12 i DUDNJ mbron aspekte të veçanta të jetës private. Ky nen së bashku me nenet e mëparshme të po kësaj deklarate që garantojnë moscënimin e lirisë dhe garantimin e të drejtave të një personi që akuzohet për një vepër penale dhe me nene të tjera të konventës të cilat do të trajtohen në vijim, kontribuojnë në ruajtjen e jetës individuale të personit nga ndërhyrjet e paligjshme ose tejkalimi i të drejtave që ligji iu ka dhënë autoriteteve shtetërore.

### **Elemente të nenit 12**

Para së gjithash, nocioni “*jetë private*” nuk jepet në këtë nen të deklaratës, por nga leximi i kujdesshëm i saj kuptohet që në jetën private përfshihen shumë elemente ndër të cilët më të rëndësishmit janë: familja, banesa, korrespondenca, jeta intime, morali, nderi dhe reputacioni i personit. Mund të ndodhë që këto fusha të ndërthuren më njëra tjetrën. Për këtë arsye, ato janë përfshirë në një nen të përbashkët. Kështu, koncepti i jetës private sipas kuptimit të deklaratës është i vështirë pasi në ndonjë rast cënimi i banesës mund të jetë edhe cënim i jetës private të personit pasi në banesë mund të ketë dokumente me përmbajtje intime ose private, fotografi etj.

Një çështje e rëndësishme që kërkon vëmendje është nëse DUDNJ ndalon absolutisht çdo ndërhyrje, jo vetëm ndërhyrjet e padrejta, arbitrare ose abuzimet, por edhe ndërhyrjet e drejta që ligji ia jep një autoriteti. Nga leximi me kujdes e përmbajtjes së këtij neni del

se hartuesit e tij e kanë përdorur termin “*ndërhyrje arbitrare*” dhe termin “*cenim në jetën private*”.

Për të kuptuar përmbajtjen e nenit 12 të deklaratës rëndësi ka të kuptohet termi “*banesë*”. Banesë është shtëpia ku banon personi, qoftë banesa e përhershme ose e përkohshme e tij, por mund të jetë edhe një zyrë që ndodhet në një nga dhomat e shtëpisë së tij private<sup>6</sup>

Nocioni “*korrespondencë*” sipas deklaratës nënkupton kontrollin që i bëhet formave të ndryshme të komunikimit. Në kohën e sotme mjetet e komunikimit janë të shumta si: letra të shkruara dhe të dërguara ose që priten të dërgohen me postë, telegrame, e-mail, marrja e të dhënave mbi telefonatat e bëra, kur dhe me kë (për shembull sot mund të përmendim listën e telefonatave të bëra me celular ose nga telefonat fiks), përgjimi i telefonatave, etj.

Ndonëse kjo e drejtë mbrohet nga deklaratata dhe nga një sërë konventash të miratuara më pas, ajo hyn në të drejtat të cilat një shtet mund t’i kufizojë me ligj dhe me rregulla të përcaktuara qartë në ligj. Kjo gjë nuk thuhet shprehimisht në këtë nen të deklaratës, por kuptohet nga termi “*ndërhyrje arbitrare*”. Për shembull, në rast të hetimeve, një person mund të përgjohet, por duke marrë më parë leje nga organet kompetente, ose letrat dhe korrespondenca e një personi të arrestuar ose të dënuar mund të kontrollohet në raste të përcaktuara me ligj. Nëse nuk ka arsye të përligjura, atëherë kjo cilësohet si shkelje e nenit 12 të Deklaratës.

***Cënimi i nderit dhe reputacionit*** është një çështje mjaft me rëndësi në ditët tona. Në momentin e përfshirjes së këtyre dy sferave, ka pasur debate nga hartuesit se mos parashikimi në ligj i këtij ndalimi cënonte të drejtën e fjalës së lirë. Deklarata nuk jep përkufizim të këtyre termave, por nëse i referohemi fjalorit të sotëm të gjuhës shqipe gjejmë se “*nder*” do të thotë: tërësia e vetive a tipareve morale të njeriut që burojnë nga parime të caktuara, që cmohen nga shoqëria dhe që shfaqen në sjelljet dhe veprimet e tij në rrugë të drejtë; pastërtia morale e dikujt, ndershmëria dhe besinkëria (zakonisht për gratë); “*reputacion*” nuk gjendet në fjalorin e gjuhës shqipe, por në të folurit e përditshëm ai është sinonim i tipareve të akumuluarra përmes sjelljeve profesionale të cilat njihen dhe respektohen nga pjesa tjetër e komunitit. Ndryshe ai njihet edhe emër i mirë i krijuar duke i qenë i drejtë në jetën e përditshme dhe atë profesionale.

Sipas studiuesve të së drejtës penale<sup>7</sup>, “*nderi*” dhe “*reputacioni*” mund të cënohen me anë të shpifjeve ose fyerjeve publike në sytë e njerëzve të tjerë të punës, shoqërisë ose në publik.

***Detyrim i shtetit për të mbrojtur jetën private*** nuk do të thotë vetëm krijimi i kushteve për të bërë një jetë të qetë, por edhe nxitja e mbrojtjes së jetës private të shtetasve të vet. Një nga problemet që haset sot është prania e të dhënave të njerëzve në shumë dosje, si pranë zyrave ku deklarohet konflikti i interesave, pasuria, ku aplikohet për pajisjen me pasaportë, në vendet ku aplikohet për punë. Sot ka diskutime lidhur me faktin nëse

<sup>6</sup> Për më shumë shih ... faqe 262

<sup>7</sup> Për më shumë shih Elezi, I



vendosja e kamerave në vende publike, si restorante, metro, autobusë apo institucione, marrja e analizës së ADN-së, marrja e gjurmëve të gishtave janë shkelje të së drejtës private. Në fakt, masa ose veprime të tilla janë ndërhyrje në jetën private. Për të gjykuar nëse ato janë ndërhyrje në jetën private dhe në kundërshtim me këtë nen të Deklaratës, duhet të gjykohet rast pas rasti, duke parë nëse ka shkaqe të përligjura dhe nëse janë respektuar procedurat e ligjit në marrjen e tyre. Është pranuar se këto aspekte janë pjesë e jetës private të personit, por për hir të nevojave të shoqërisë (të cilat u përmendën më lart), për t'u mbrojtur rendin dhe qetësinë publike, disa të drejta janë kufizuar me ligj sipas procedurave të përcaktuara qartë.

Kjo e drejtë e përcaktuar nga deklaratat ka evoluar dhe përfshirë edhe aspekte të reja të sjelljes njerëzore. Praktika e Gjykatës Evropiane mbron orientimin seksual të personit (pra konsiderohet cenim i jetës private nëse dikush në media shkruan se një person i caktuar është homoseksual). Është kjo arsyeja që në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, marrëdhëniet homoseksuale mes personave të rritur që dikur dënoheshin, sot janë të lira. Ligji dënon vetëm rastet kur këto marrëdhënie kryhen me dhunë dhe kundër dëshirës së personit.

Sot, Këshilli i Evropës ka miratuar një sërë rekomandimesh që synojnë të mbrojnë sigurinë e të dhënave në disa sektorë<sup>8</sup>. Të drejtat e përcaktuara nga neni 12 i Deklaratës janë të sanksionuara në nenet 35-37 të Kushtetutës së RSh dhe në nene të caktuara të Kodit Penal të RSh.

### Aspekte edukative

Sistemi ligjor mbron të drejtën e privatësisë në të gjitha format e saj, por fakti që jeta publike dhe politike është e mbushur me detaje të privatësisë njerëzore dhe kur mungojnë ndëshkimet për sjellje të tilla nuk krijohen kushte për një edukim të drejtë mbi privatësinë. E për më tepër në kushtet kur liria e medias është e brishtë dhe në publik krijohet përshtypja se ruajtja e lirisë së saj është më e shenjtë se ruajtja e lirisë së individit përpjekja për edukimin më ruajtjen e privatësisë së personit është shkurajuese.

### ***Aktivitetet:***

a. TV lokal nxori një lajm se policia kishte kapur tre persona të dyshuar për trafik droge/vjedhje. Fytyrat e tyre, emrat dhe pozicionet e punës dolën në TV I gjithë qyteti i pa. Pas disa javësh, gjykata i la të lirë për mungesë provash.

Ç'të drejta iu shkelen personave që dolën në TV?

Si mund të mbrohen ata?

Nëse ju do të gjykonit situatën, në c'konkluzione do të arrini?

A mund të organizoni një tryeze të rumbullakët në shkollën tuaj ku të trajtoni situatën të ngjashme konkrete dhe të thërrisni median lokale për t'ju dëgjuar.

A mund t'i shkruani një letër Avokatit të Popullit në emër të individëve të pafajshëm reputacioni i të cilëve është dëmtuar nga media?

Mësuesja ndëshkon një nxënës si kopjac. Në fakt është shoku i tij ai që ka kopjuar. Kjo u zbulua pas një jave.

---

<sup>8</sup> Këshilli i Europës ka miratuar rekomandimin >...

Si e korrigjon mësuesja fajin e saj?

Si ndihmohet nxënësi i pafajshëm të rregulloje reputacionin e tij në klase?

Si e siguron media të drejtën për të informuar në kohë publikun.

A duhet të lejojë policia filmimin e personave të dyshuar si fajtorë ndërkohë që ata janë duke mbledhur fakte mbi veprat penale?

Kush e shpall individin fajtor: media, policia apo gjykata?

A mendoni se ndonjëherë gazetarët nguten të ngarkojnë me faj persona që nuk janë vërtetuar ende se janë të tillë?

Privatësia në shkollë ka të bëjë më shumë praktika të përditshme.

A është vlerësimi një çështje privatësie?

A duhet të jenë rezultatet e provimeve, vlerësimet përfundimtare publike pa miratimin e vetë nxënësit apo prindit.

A mund të vendosen në faqen e internetit për arsye të mbrojtjes së dinjitetit të institucioneve rezultatet private të nxënësve?

Çështja e mbledhjes së informacionit mbi gjendjen familjare të fëmijëve shpeshherë mund të marrë dimensione të shkeljes së të drejtave të fëmijëve. Shumë mësuese, duke e perceptuar veten gabimisht si nënë e dytë, sidomos në klasat e ulta, mbledhin informacion nga jeta private e fëmijës duke shkelur të drejtën e komunikimit të privilegjuar. Dhe duket se informacioni mbledhet për arsye tërësisht private dhe jo të ndihmës profesionale të fëmijës.

Fakti që edhe ligji në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve për të cilët mësohet informacion komprometues duke ushtruar detyrën, rekomandon që “informacioni të raportohet pranë njësisë të shërbimit social në pushtetin lokal, apo prokurorisë së qytetit,” duket se e komprometon privatësinë e fëmijëve. Edhe kur duan të mbrojnë fëmijën, pasi kanë mësuar një informacion privat kërcënues për cilësinë e jetës dhe kërcënues për zhvillimin e fëmijës, shumë mësues nuk dinë as ku e as si të raportojnë atë që mësojnë mbi fëmijën.

*Komunikimi i privilegjuar* në shkollë ende nuk mbrohet me ligj ose me ndonjë rregullore të brendshme apo me dispozita normative. Fëmijët detyrohen të tregojnë duke shkelur kështu të drejtën e komunikimit të privilegjuar tek ata.

### **Neni 13.**

**1. Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti.**

**2. Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.**

#### Trajtim ligjor

Ky nen përfshin disa të drejta e liri të veçanta:

të lëvizjes apo qarkullimi brenda vendit: kjo do të thotë që gjithkush që ndodhet brenda kufijve të një shteti ka të drejtë të shkojë nga një zonë apo tjetrën të këtij shteti lirshëm.

Pra si të themi kemi të bëjmë me lirinë e qarkullimit të brendshëm;

të banimit brenda një shteti: kjo do të thotë që çdo njeri që jeton në një shtet të caktuar ka të drejtë të ketë një strehë, të ketë një vend ku të banojë në këtë shtet.

e largimit nga cilido shtet, përfshirë këtu edhe shtetin shtetas i të cilit je: pra, kurdoherë askush nuk mund të të ndalojë të largohesh nga një vend i caktuar dhe ndoshta nëse përdoren fjalët ‘e drejta e emigrimit’ mund të kuptohet më mirë kjo e drejtë;

e drejta e kthimit në vendin tënd: pra çdo kush ka të drejtën që nëse është larguar nga shteti i vet, të rikthehet, të hyjë në të. Kjo e drejtë mund të njihet edhe si e drejta e imigrimit.

Së pari neni 13 synon të garantojë që një shtet t’i lejojë njerëzit të lëvizin nga një zonë në tjetrën brenda tij. E drejta për të lëvizur është një e drejtë që pranohet edhe nga diktaturat, edhe nga shtetet demokratike. Por, një shtet diktatorial është një shtet që kontrollon shumë individët e tij, dhe lëvizjen dhe vendbanimin e tyre, ndërsa në një shtet demokratik, liria e lëvizjes mendohet si liri e cila jo vetëm është e qenësishme për qenien njerëzore, por edhe e rëndësishme për zhvillimin e vendit.

Kushdo që ndodhet në një shtet të caktuar e ka lirinë e lëvizjes. Kjo do të thotë që kushdo, qoftë shtetas i një vendi apo i huaj, nëse gjendet në një territor të caktuar, ka lirinë të lëvizë lirisht në territorin e këtij shteti.

Vini re që ky nen synon të garantojë të drejtën të lësh vendin tënd apo edhe cilindo vend tjetër, të hysh në vendin tënd dhe të lëvizësh lirshëm në vendin në të cilin ti je, si dhe të mund të banosh në vendin në të cilin je. Por, ky nen nuk garanton të drejtën të hysh në cilindo shtet tjetër. Pra, ndërsa ke të drejtë të largohesh kurdoherë nga vendi yt, nuk ke të drejtë të hysh kurdoherë në një vend tjetër. Por, ama, nëse je në një vend tjetër ke kurdoherë të drejtë të largohesh prej tij. Pra, ky nen në qendër të tij ka shtetin tënd, në të cilin ti je shtetas. është shumë e rëndësishme për individin të qarkullojë, lëvizë, sepse të gjithë ne duam të shkojmë nga një qytet në tjetrin, nga një fshat në tjetrin dhe madje të zgjedhim ku do banojmë. Por ama, këtë e realizojmë lirshëm sepse jemi në shtetin tonë. Ne e kuptojmë që të gjithë mund të dalim kur të duam nga shtëpia jonë, por në shtëpinë e tjetrit do hyjmë me lejen e tjetrit. Të gjithë ne duam të shohim vende të tjera të botës dhe këtë fillon të garantojë DUDNJ me nenin 13 edhe pse nuk e realizon plotësisht sepse është shumë e kuptueshme që çdo shtet ka për detyrë të ruajë kufijtë e shtetit të tij, të

mundësojë organizimin sa më mirë të jetës në territorin e tij për shtetasit e vet për mirëqenien e të cilëve ai shtet është krijuar. Dhe këtë çdo shtet do ta realizojë pa ndërhyrjen e të tjerëve.

Neni 13 nuk mund të kuptohet si nen i cili lejon lëvizjen e kujtdo në çdo hapësirë të vendit. Ka kufizime, të cilat të ndalojnë të hysh në një zonë të caktuar, për shkak se ka interesa kombëtare, për hir të sigurisë së vendit, interesave publike, mbrojtjes së shëndetit apo moralit, apo edhe të të drejtave e lirive të të tjerëve, apo parandalimin e krimit. Kjo nuk nënkupton vetëm kufizime të lirisë së lëvizjes në aspektin gjeografik, pra të ndalohej lëvizja në një hapësirë të caktuar por edhe për individë të caktuar. Megjithatë këto lloj kufizimesh gjithmonë bëhen me ligj, pra bëhen nga rregulla të përgjithshme që miratohen nga parlamenti.

Po kështu, nuk mund të pretendohet që për hir të lirisë së lëvizjes të kesh të drejtën të hysh në pronën e tjetrit. Këtu, e drejta e pronës dhe siguria e personit, janë të drejta të cilat mbizotërojnë ndaj lirisë së lëvizjes.

Neni 13 garanton edhe lirinë e vendbanimit. Kjo do të thotë që personi që gjendet në territorin e një shteti, mund të zgjedhë lirshëm vendbanimin e tij. Pra, askush nuk mund të imponojë të kesh një shtëpi në një vend apo tjetër. Sigurisht ka kufizime në zgjedhje sepse për shembull nuk mund të ndërtohet shtëpinë tënde në pronën e tjetrit apo në zona ushtarake apo zona të cilat kanë një mbrojtje apo kufizim të veçantë nga shteti. Një tjetër çështje që mund të shtrohet për diskutim në lidhje me të drejtën e vendbanimit është ajo e detyrimit të shtetit për t'i siguruar kujto shtetasi një strehë. Neni 13 duhet kuptuar drejt që ka të bëjë me lirinë e zgjedhjes së vendbanimit nga individët dhe jo me të drejtën për të pasur një banim gjithmonë e për më tepër me detyrimin e shtetit për të siguruar një të tillë kujtdo shtetasi të tij.

Më tej, Neni 13 garanton edhe të drejtën të largohesh nga çdo shtet dhe të kthehesh në vendin tënd. E drejta të largohesh nga çdo shtet është përgjithësisht e njohur edhe pse ka pasur diskutime në lidhje me këtë pjesë të nenit 13. Kjo sepse shtetet kanë hezituuar vazhdimisht që të kenë kufijtë e tyre të hapur plotësisht për këdo. Gjithsesi, kjo e drejtë nënkupton që shtetet së pari të pajisin shtetasit e tyre me dokumentet e domosdoshme të udhëtimit, apo që shteti në të cilin ndodhesh të mos ndërhyjë në planet e tua të largimit, pra në lirinë e largimit. Edhe në lidhje me këtë të drejtë ka kufizime si p.sh. nëse je duke vuajtur një dënim penal apo nëse duhet të kryesh një shërbim të caktuar ushtarak apo nëse ka një vendim gjyqësor që të ndalon largimin, nuk mund të pretendosh se ke të drejtën për t'u larguar dhe se ajo duhet respektuar edhe në kësi situatash.

Së fundi, e drejta e kthimit në vendin tënd është një e drejtë që njihet përgjithësisht dhe respektohet pa shumë probleme. Mund të ketë raste të veçanta kur ndalohej hyrja e shtetasve në vend, si p.sh. rasti i familjes mbretërore Zog të cilës gjatë periudhës së socializmit i ndalohej të hynte në shtetin shqiptar. Këto raste janë shumë të rralla dhe ndodhin me vendime të posaçme të shtetit përkatës për shkaqe të sigurisë publike apo ruajtjes së rendit, e zakonisht kanë baza politike. Po kështu, edhe shtetasit që kanë kryer

një krim në një vend tjetër e kanë të drejtën të kërkojnë kthimin në vendin e tyre për të vuajtur atje dënimin për veprën e dënueshme që kanë kryer.

E drejta e largimit dhe e kthimit janë të lidhura ngushtë me të drejtën e hyrjes. Pra, të largohesh nga një vend sigurisht do hysh në një vend tjetër. Sigurisht që DUDNJ duke i përfshirë këto të drejta thekson se individët për nga natyra janë të lirë të lëvizin dhe se shtetet nuk mund t'i mbajnë me detyrim individët në një vend apo tjetër. Por duhet kuptuar që kur flet për kthim apo hyrje, DUDNJ i referohet hyrjes në shtetin e vet të çdokujt, sepse siç e thamë më lart çdo shtet ka detyrimin të ruajë kufijtë e vet dhe t'i sigurojë qetësi shtetasve të vet.

Së fundi duhet thënë që të drejtat e nenit 13 janë një lehtësi shumë e madhe për mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Sigurisht lëvizja mundëson më mirë veprimtarinë e tyre dhe më shumë efektivitet në veprimtarinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

**Të gjitha të drejtat e nenit 13 të DUDNJ-së gjenden edhe në shumë dokumente të tjera ndërkombëtare, si në:**

**Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike**

**Konventën Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut**

**Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.**

**Në Kushtetutën e vendit tonë kemi disa nen të cilat i referohen këtyre të drejtave:**

**Neni 38:**

1. Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit.
2. Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit.

**Neni 39:**

1. Asnjë shtetas shqiptar nuk mund të dëbohet nga territori i shtetit.
2. Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor.
3. Ndalohet dëbimi kolektiv i të huajve. Dëbimi i individëve të huaj lejohet në kushtet e përcaktuara me ligj.

**Neni 40**

1. Të huajt kanë të drejtën e strehimit në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit.

### Aspekte edukative

1. Ndaloni të kuptoni dimensionin e të drejtave që burojnë nga neni 13 në situatat e mëposhtme:

Ch.S., shtetas britanik, i lindur në 1960, ka qenë rezident i Kanadasë që nga moshja 7 vjeçare. Pas shumë vitesh qëndrimi në Kanada ai përballet me deportimin/largimin nga Kanadaja. Në Kanada ai ka nënën e moshuar e të sëmurë si dhe vëllain, të sëmurë

mendor. Ch.S. ka dy fëmijë të cilët jetojnë me të ëmën e tyre, e ndarë prej Ch.S. që prej vitit 1989. Ch.S. është dënuar 42 herë të parë për kryerjen e veprave penale jo të rënda dhe për shkeljen e rregullave të qarkullimit.

Edhe pse legjislacioni kanadez lejonte aplikimin për marrjen e shtetësisë të personave rezident në Kanada dhe kriteret ishin vërtet të lehta, Ch.S. asnjëherë nuk kish aplikuar për t'u bërë shtetas kanadez.

Në vitin 1990 ndaj tij Zyra e Imigrimit fillon një hetim administrativ, në bazë të Aktit mbi Emigracionin. Në përfundim të hetimit ndaj Ch.S. u mor vendimi i largimit nga Kanadaja. Ai u ankua në organet përkatëse të vendit ndaj këtij vendimi. Të gjitha këto organeve lanë në fuqi vendimin e Zyrës së Imigrimit. Për shkak të ligjeve të Kanadasë të cilat ndalonin kthimin në të të personave të larguar pa pëlqimin e Ministrit të Punës dhe Imigracionit si dhe pa precedentë penalë, Ch.S. nuk do kish më mundësi të kthehej në Kanada. Ch.S. pretendon se Akti mbi Imigracionin dhe vendimi i marrë ndaj tij ishte në shkelje të së drejtës të mos largohesh nga vendi yt dhe të kthehesh në vendin tënd.

Diskutoni:

A ishte Kanadaja vendi i Ch.S. (shtetas britanik)?

A do të sillte vendimi për largim humbjen e të gjitha lidhjeve me Kanadanë?

A përbën Akti i Imigracionit shkelje të së drejtës për të qëndruar në vend dhe për t'u kthyer në të?

Shqyrtoni nëse vendimi është ose jo shkelje e te drejtave të garantuara nga neni 13.

b. A.C., qytetar francez, ka punuar në Madagaskar për shumë vite si avokat: ligjet e vendit e lejojnë këtë. Pas disa vitesh pune, A.C. përballet me një vendim përjashtimi/expulsion nga autoritetet e Madagaskarit. A.C. kish ngritur një zyrë avokatie prej vitesh, prestigjioze dhe kish mbrojtur edhe anëtarë të opozitës në vend, madje edhe emra të shquar të saj. Dy herë ai ishte ndaluar nga Policia Politike e vendit DGM, dhe ishte liruar të dyja herë pas një dite. Në vitin 1982, policia e arrestoi dhe e mbajti në dhomat e saj për një ditë dhe të nesërmen i lajmëroi largimin nga Madagaskari, duke i dhënë kohë 2 orë të mblidhte plaçkat e tij. Shteti i Madagaskarit pretendon se këtë vendim e mori në bazë të legjislacionit të vendit për shkak se A.C. përbënte shkelje të paqes e rrezikonte sigurinë e publikut.

Diskutoni a ka shkelje të lirisë së qarkullimit e banimit si dhe lirisë së qëndrimit një vendim i tillë.

Po koha e shkurtër prej 2 orësh a ndikon në shkallën e rëndë të dënimit të dhënë.

A është në proporcion me shkeljen një vendim i tillë?

*“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti”* është një e drejtë që më në fund shqiptarët duket se po i gëzohen. Zgjedhja e vendbanimit brenda vendit është një çështje tërësisht e realizueshme. Por, me sa duket vendimet për të lëvizur janë ende të adultëve. E drejta e fëmijës për të pranuar zhvendosjen nga vendi i banimit duket se është e injoruar. Edhe fakti që atje ku shkon fëmija mund të përballet për disa ose shumë vite me praktika më të vështira rritjeje duket se nuk i prek adultët të marrin vendimet e zhvendosjes së banimit.

Zhvendosja duket se iu sjell probleme edhe strukturave të stabilizuara urbane. Pakësimi i resurseve komunitare, ngushtimi i hapësira në publike, pavarësisht vendimeve se si merren, duken në fakt se injorohen përballë të drejtës për të respektuar lirinë e zgjedhjes së vendbanimit personal. Në shkolla klasat janë shumë më të dendura, pranojnë shumë më tepër fëmijë se sa normativat në kushtet e dyndjes në emër të lëvizjes së lirë drejt qendrave urbane.

Po ashtu, e drejta e lëvizjes së lirë kufizohet edhe nga rregulloret e qarkullimit të kufizuar. Zgjedhja e zonave të kufizuara për qarkullim është domosdoshmëri, po në fakt e rëndon trafikun tashme të çrregulluar të Tiranës.

### **Aktivitete**

Andi ishte me babanë në makinë. Ata duhej të ktheheshin me ngut në shtëpi se vëllai i vogël kish bërë aksident, po në trafik kish shumë shenja të qarkullimit të kufizuar ose të ndalimit të kalimit. Babi u nxeh!” Edhe këta! tha, gjithandej qarkullim i lejuar vetëm për zyrtarët! Mjerë populli i thjeshtë!” Andi, megjithëse ishte në ankth për vëllanë mendoi ta sillte çështjen e kufizimit të ndalimit në grupin e diskutimit të të drejtave të njeriut.

Kush vendos për zonat me qarkullim të kufizuar?

A janë ato pjesë të qytetit?

A duhet Andi dhe shokët të mësojnë më shumë si qytetarë mbi të drejtat e lirisë së qarkullimit në qytetin e tyre dhe të drejtat e pushtetarëve për të patur ekskluzivitetin e qarkullimit në zona të caktuara?

Në një fshat të Librazhdit mësohet se po ngjan një gjë e çuditshme. Banorët autoktone nuk iua lëshojnë ujin banoreve të ardhur rishtazi në fshat. Gjysma e fshatit vuan për ujë. Askush nuk duket se po bën gjë.

A munden nxënësit e klasës suaj ta bëjnë çështje të drejtën e banorëve të zhvendosur? Si?

Entela jeton me mamanë dhe 5 motrat më të vogla në një fshat afër Tiranës. Ato lëvizin këtu nga një zonë e thellë e Tropojës. Po nuk ishin me fat,. Babi shumë shpejt i la. Vdekja e tij ishte një traumë e vërtetë. Për shumë muaj me radhe mamaja dhe Entela bisedonin nëse duhej të ktheheshin përsëri në fshatin e tyre në Tropojë, apo të jetonin në Tiranë. Tirana është e madhe dhe rreziku po aq! Donte të iknin, po ku? Shtëpinë e vogël në fshat e kishin shitur. Mamaja nuk dinte as si të bënte pasaportizimin në Tiranë! Ndonjëherë i kapte ankthi se mos i kthenin! Mamaja ishte shumë e trembur. Fakti që kish vetëm vajza e bënte të pasigurt. Entela kish dëgjuar se njerëzit në Shqipëri janë të lirë të jetojnë ku të duan. Ajo kish dëgjuar edhe për programet sociale në ndihmë të atyre që zhvendosen dhe kanë probleme familjare si familja e saj.

Po ku të drejtohej?

Perpiquni të ndihmoni Entelen.

Vendosja e praktikave të vizave si një instrument i së drejtës ndërkombëtare është një handikap i lëvizjes së lirë jashtë vendit. Mësoni mbi kërkesat e pranimit që aplikon çdo vend i komunitetit evropian.

Ndarja e çifteve/familjeve është fenomen i hasur dendur në vendin tonë. Ai nuk duket se ka sjellë gjë të mirë familjeve këtu apo emigrantëve jashtë. Shumë prej tyre duan të bashkohen.

Cila është rruga për të ndjekur?

Ndarja e prindërve emigrantë nga fëmijët që rriten duket se me kalimin viteve po tregon që ka patur një kosto jo të vogël. Ata duan të bashkohen.

Përmendni koston e bashkimit dhe rregullat e bashkimit familjar që përdorin vende të ndryshme.

Çështja e shkollimit të fëmijëve në gjuhën amtare ose në gjuhën e vendit emigrator duket se në vendet ku emigrojnë shqiptarët bëhet me vështirësi. Pothuajse në asnjë vend nuk ka shkolla në gjuhën shqipe, pavarësisht numrit të madh apo nivelit të përqendrimit të popullsisë së emigruar shqiptare. Edhe në rastin kur nismat kanë qenë private, zyrtarizmi i shkollimit në gjuhë amtare është një problem i hapur. Me sa duket zgjedhja e praktikave asimiluese të kulturimit, në favor të praktikave multikulturore është një sëmundje e rajonit.

Diskutoni rreth të drejtës për t'u arsimuar në gjuhën amtare të fëmijëve që kanë emigruar nga Shqipëria drejt vendeve evropiane.

Kejsi është një vajze e bukur 12 vjeç. Ajo jeton me të ëmën në Itali. Prindërit e saj u ndanë kur Kejsi ishte fare e vogël. Babi jeton në Tiranë dhe ka krijuar familje të re. Kejsi ka tre motra nga babai. Ajo do t'i vizitojë gjatë pushimeve të verës, po mamaja nuk e lejon. "Sa herë kthehesh nga Tirana, i thotë ajo, je më e dobësuar. Plus, ke edhe huqe të reja!"

Si e siguron Kejsi të drejtën e saj për të lëvizur drejt familjes së të atit?

Besa jeton me të ëmën në Tiranë. Prindërit e saj janë divorcuar kur Besa ishte fare e vogël. Ajo nuk e mban mend të atin se ai kish emigruar herët jashtë vendit. Atje babai ende nuk kish dokumente të rregullta. I bëri dy herë ftesë Besës, po ambasada nuk i dha vizë. Besa është 13 vjeç dhe ende nuk e ka parë babanë.

Komentoni të drejtat e Besës. Si mund ta plotësojë ajo dëshirën për të parë babanë.

Thërrisni në shkollën tuaj një punonjës të një ambasade të Komunitetit Evropian.

Flisni me të për regjimin e vizave dhe të drejtën për të lëvizur lirshëm nga një shtet në tjetrin dhe për tu kthyer në vendin e vet.

### **Situata 1**

Ch.S., shtetas britanik, i lindur në 1960, ka qenë rezident i Kanadasë që nga moshja 7 vjeçare. Pas shumë vitesh qëndrimi në Kanada ai përballet me deportimin/largimin nga Kanadaja. Në Kanada ai ka nënën e moshuar e të sëmurë si dhe vëllain, të sëmurë mendor. Ch.S. ka dy fëmijë të cilët jetojnë me të ëmën e tyre, e ndarë prej Ch.S. që prej vitit 1989. Ch.S. është dënuar 42 herë për kryerjen e veprave penale jo të rënda dhe për shkeljen e rregullave të qarkullimit.



Edhe pse legjislacioni Kanadez lejonte aplikimin për marrjen e shtetësisë të personave rezident në Kanada dhe kriteret ishin vërtet të lehta, Ch.S. asnjëherë- nuk kish aplikuar për t'u bërë shtetas Kanadez.

Në vitin 1990 ndaj tij Zyra e Imigrimit fillon një hetim administrativ, në bazë të Aktit mbi emigracionin. Në përfundim të hetimit ndaj Ch.S. u mor vendimi i largimit nga Kanadaja. Ai u ankua në organet përkatëse të vendit ndaj këtij vendimi. Të gjitha këto organeve lanë në fuqi vendimin Zyrës së Imigrimit. Për shkak të ligjeve të Kanadasë të cilat ndalonin kthimin në të të personave të larguar pa pëlqimin e Ministrit të punës dhe Imigracionit si dhe pa precedentë penalë, Ch.S. nuk do kish më mundësi të kthehej në Kanada.

Ch.S. pretendon se Akti mbi Imigracionin dhe vendimi i marrë ndaj tij ishte në shkelje të të drejtës të mos largohesh nga vendi yt dhe të kthehesh në vendin tënd.

Diskutoni:

a ishte Kanadaja vendi i Ch.S. (shtetas britanik)

- A do të sillte vendimi për largim humbjen e të gjitha lidhjeve me Kanadanë?

A përbën akti i Imigracionit shkelje të së drejtës për të qëndruar në vend dhe për t'u kthyer në të?

**Vendimi: nuk është shkelje !!!**

## **Situata 2**

A.C., qytetar francez, ka punuar në Madagaskar për shumë vite si avokat: ligjet e vendit e lejojnë këtë. Pas disa vitesh pune, A.C. përballet me një vendim përjashtimi/expulsion nga autoritet e Madagaskarit. A.C. kish ngritur një zyrë avokatie prej vitesh, prestigjioze dhe kish mbrojtur edhe anëtarë të opozitës në vend, madje edhe anëtarë të shquar të saj. Dy herë ai ishte ndaluar nga Policia Politike e vendit \_DGM, dhe ishte liruar të dyja herë pas një dite. Në vitin 1982, policia e arrestoi dh, mbajti në dhomat e saj për një ditë dhe të nesërmen i lajmëroi largimin nga Madagaskari, duke i dhënë kohë 2 orë të mblidhte plaçkat e tij. Shteti i Madagaskarit pretendon se këtë vendim e mori në bazë të legjislacionit të vendit për shkak se A.C. përbente shkelje të paqes e rrezikonte sigurinë e publikut.

Diskutoni a ka shkelje të lirisë së qarkullimit e banimit si dhe lirisë së qëndrimit një vendim i tillë. Po koha e shkurtër prej 2 orësh a ndikon në shkallën e rëndë të dënimit të dhënë. A është në proporcion një vendim i tillë?

#### **Neni 14.**

- 1. Gjithkush ka të drejtë të kërkojë dhe gëzojë në vende të tjera azil nga ndjekjet.**
- 2. Këtë të drejtë nuk mund ta gëzojë askush në rast se ndiqet për krime jopolitike ose për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.**

#### Trajtim ligjor

Të drejtat e nenit 13 kanë lidhje të ngushtë me të drejtat e parashikuara në nenin 14 të DUDNJ-së. Kjo sepse neni 14 flet për kërkimin dhe gëzimin e azilit, pra strehimit, nga përndjekja politike apo edhe për arsye të tjera në shtete të tjera. Kështu, duke garantuar të drejtat e lëvizjes, largimit nga vendi, hyrjes në të, si dhe të drejtat e kërkimit të hyrjes në një shtet tjetër për t'u mbrojtur nga përndjekja e shtetit, DUDNJ plotëson shumë mirë një kuadër të rëndësishëm për mbrojtje të individit nga shteti.

Të gjithë ne kemi parë apo dëgjuar histori se si njerëzit, individualisht apo në grup largohen prej vendit të tyre për arsye të trajtimit shumë të keq politik që i bëhej atyre. Kryesisht në shekullin që kaloi kjo ka ndodhur shpesh. Por, që këta njerëz të mos mbeteshin pa një mbrojtje ligjore në vendin ku shkonin, u ndërmorën hapa në nivel ndërkombëtar duke filluar që me DUDNJ-në.

Sipas nenit 14 të DUDNJ-së, çdokujt i lejohet të kërkojë dhe hyjë për mbrojtje në një vend tjetër. Kjo mbrojtje mund të kërkohet për arsye të ndryshme: në shtetin e vet personit i shkelen të drejtat e tij, keqtrajtohet për shkak të fesë, mendimit politik, racës, apo tjetër. Pra, shkaqet mund të jenë nga më të ndryshmet, edhe pse neni, duke përmendur fjalën 'krime jopolitike' duket sikur sugjeron që kryesisht këto shkaqe kanë të bëjnë me arsye politike, por jo vetëm. Nëse përdorim termin refugjatë mund të kuptohet më mirë se për ç'farë kategorie individësh bëhet fjalë në këtë nen.

Në fakt Kombet e Bashkuara nuk e kishin përfshirë vetëm në nenin 14 interesimin e tyre për refugjatët. Ishin miratuar dhe vazhduan të miratoheshin një sërë dokumentesh për këtë qëllim, madje është krijuar edhe në zyrë të posaçme të cilës mund t'i adresoheshin të gjithë refugjatët në raste nevojë qoftë individuale apo kolektive, UNHCR, Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët. Të gjithë ne jemi dëshmitarë se si kjo zyrë u vendos, dhe vazhdon të ekzistojë, në Shqipëri, në kohën kur kosovarët për shkak të keqtrajtimit dhe përndjekjeve nga **shteti i tyre Serb, Ish-Federata Jugosllave**, u detyruan të linin shtëpitë e tyre dhe të shpërnguleshin në shtetet fqinje. Kjo zyrë u mor pikërisht me sistemimin dhe mbrojtjen e tyre për sa kohë ata, kosovarët, ishin të detyruar të qëndronin larg vendit të tyre.

Ka pasur diskutime të shumta a duhej apo jo një nen i tillë në DUDNJ. Kjo sepse disa shtete ruanin një pozicion i cili synonte të garantonte një mbrojtje sa më të madhe të kufijve të një shteti dhe kërkonin një garantim sa më të paktë të së drejtës së azilit, si p.sh. Rusia apo edhe Filipinet. Ndërkohë që organizatat joqeveritare ishin përkrahëse të qëndrimit tjetër, pra të një garantimi sa më të fortë të kësaj të drejte duke e konsideruar atë si e drejtë e lidhur ngushtë me të drejtën e jetës. Pas shumë diskutimesh, azili u

konsiderua si një çështje e të drejtave të nejrëtu dhe u njoh si e drejta për të kërkuar ashtu edeh e drejta për të gëzuar azilin nga ndjekjet.

#### *Rregulla të ndryshme të shteteve të ndryshme*

Azili është rregulluar në mënyra të ndryshme nga legjislacionet e vendeve të ndryshme. Kështu, ka vende të cilat aplikojnë vende të posaçme për të mbajtur azilantët. Ka vende të cilët përdorin baza të caktuara ushtarake për këtë qëllim, si p.sh. SHBA-ja që përdor bazën e vet në Kubë për këtë qëllim. Politikave e vizave për kontrollimin e njerëzve që hyjnë e dalin nga një shtet është tipike e vendeve për të kontrolluar edhe hyrjen e azilkërkuesve në vend. Politika të tilla u aplikuan edhe si rezultat i rritjes drastike të numrit të azilkërkuesve me kalimin e viteve. Ndërkohë ka edhe një rregullim tjetër nga komuniteti ndërkombëtar për azilkërkuesit: është krijuar një e ashtuquajtur zonë e sigurisë' e cila gjendet në shtet mëmë të personit që kërkon azil, siç ishte rasti i zonës në Irakun e Veriut për të mbrojtur kurdët nga sulmet e forcave Irakene. Sigurisht që të gjitha këto lloje rregullimesh janë të atilla që ose synojnë kufizimin e ushtrimit të së drejtës së azilit (apo edhe pse jo të mos abuzimit me të) ose janë masa të atilla që nuk rezultojnë efikase duke mos garantuar ashtu sic duhet të drejtën për të gëzuar azilin.

Ka edhe një tjetër politike për rregullimin e situatave të azilantëve, që është ajo e shtetit të tretë të sigurt. Kjo do të thotë që nëse azilanti ka kaluar nëpër një shtet tjetër para se të mbërrijë në destinacionin përfundimtar ku do kërkojë azil, mund të kthehet në këtë shtet nga shteti fundit dhe azili t'i njihet në shtetin e ndërmjetëm të ashtuquajtur shtet i tretë i sigurt.

#### *Rregullimi në vendin tonë*

Në Kushtetutën e vendit tonë përfshihen dy nen të cila tkanë të bëjnë me rregullimin e qëndrimit të të huajve në vendin tonë. Neni 40 parashikon që të huajt kanë të drejtën e strehimit në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit. është miratuar një ligj i posaçëm mbi azilin në vendin tonë, Ligji Nr. 8432, datë 14.12.1998, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", me anën e të cilit vendi ynë i njeh të drejtën për azil apo mbrojtje të përkohshme të gjithë të huajve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, qofshin këta refugjatë apo persona të tjerë dhe që kërkojnë azil në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

Kushtetua jonë i ofron një mbrojtje edhe më të lartë të huajve duke lejuar ekstradimin vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor, si dhe duke ndaluar dëbimin kolektiv të të huajve. Dëbimi i individëve të huaj lejohet vetëm në përputhje me ligjin.

#### *Dokumente të tjerë ndërkombëtarë*

Janë miratuar një sërë dokumentash ndërkombëtare që rregullojnë çështjen e azilit, si p.sh.:

Konventa mbi Statusin e Refugjatit (1951): konventa kryesore mbi të drejtat e refugjatëve, e cila përcaktoi përkufizimin e termit refugjat dhe vendosi standarde të trajtimit të refugjatëve nga ana e shteteve

Konventa kundër Torturës e Trajtimit apo Dënimit tjetër të Rëndë, jonjerëzor e Degradues, Neni 3 parashikon parimin e moskthimit në një vend ku individit është në rrezik t'i nënshtrohet torturës.

Konventa e Gjenevës (1949) e cila rregullon të njëjtën çështje në situatat e konflikteve të armatosura

Konventa Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut (1969) parashikon të drejtën për të kërkuar azil në territorin e huaj në përputhje me legjislacionin e vendit

KEDNJ nuk ka referim tek kjo e drejtë

### Aspekte edukative

Me hapjen e shoqërisë shqiptare, me demokratizimin e saj është përherë e më e vështirë të përcaktosh se në ç'raste kërkohet azil nga ndjekjet.

Diskutoni hapur rreth çështjeve të mëposhtme:

A konsiderohet arsye e mjaftueshme për t'u konsideruar i përndjekur në vendin tënd nëse ke një sjellje atipike?

A është arsye e mjaftueshme të kërkosh azil në një vend tjetër për shkak të një kurrikule të zyrtarizuar dhe centralizuar në nivelin e mungesës së kurikulës alternative apo mungesës së shërbimeve me programe të individualizuara në vendin tënd?

A jepet azil në rastet kur individit nuk mund të përballojë fuqinë mbytëse të opinionit publik për shkak të një sjelljeje atipike, si për shembull seksualiteti brenda gjinisë, farëzimi artificial, etj ?

Klasifikimi i çështjeve të tilla të përndjekjes a ndjekjes në kushtet e një shoqërie qytetare, të hapur e demokratike, me një legjislacion të përafërt me atë perëndimor nuk sillen në kurrikulën shqiptare, madje as në opinionin publik. Edukimi me të drejtën e mbrojtjes përmes azilit do të mund të bënte të zgjidhshme shumë situata që përfundojnë tragjikisht. Kërkoni mundësinë e trajtimit të heshtjeve të tilla në aktivitetet me nxënësit.

Diskutoni mbi të drejtat e parashikuara në nenin 14 të DUDNJ në situatat e mëposhtme:

Arjana nuk ka fëmijë. Ajo ka shumë vite martuar, por nuk koncepton dot një fëmijë. Ajo shkojnë një vend të Komunitetit Evropian për inseminim artificial. Provat e para dolën pa sukses. Ajo dhe bashkëshorti kërkuan ta zgjasnin lejen e qëndrimit, por ajo nuk mund të shtyhej përtej limiteve zyrtare. Arjana aplikoi për azil, në Shqipëri nuk kryhej shërbimi që ajo donte. Është në ankth nëse mund të ketë përgjigje pozitive.

A dini ta ndihmoni?

Mbi ç'bazë e mbështesni arsyetimin tuaj?

Pas disa javësh, Arjana hapi me ankth një letër nga autoritetet lokale. Aty njoftoheshin se Arjana dhe bashkëshorti kishin fituar të drejtën për të jetuar në atë vend.

Mbi ç'bazë mendoni ju se iu dha Ajanës e drejta për të qëndruar dhe jetuar në atë vend?

C'është ndjekja?

A mund të ndiqeshin nga ai vend Arjana dhe i shoqi?

A gëzojnë të njëjtat të drejta fëmijët që janë të sëmurë nga sëmundje të pashërueshme në vendin e tyre?

A ka të drejtë i sëmuri me një sëmundje që nuk shërohet në vendin e tij, pasi sëmundja mund të jetë e panjohur ose e pamundur për t'u trajtuar, të emigrojë diku ku sëmundja e tij mund të trajtohet?

A dini raste kur fëmijë apo të rritur të sëmurë kanë vuajtur pranë ambasadave për vizë?

Si e interpretoni qëndrimin e ambasadave të huaja?

A mund të behet diçka për të drejtat e tyre?

Një ditë në TV u dha një emision për një kriminel nga Britania e Madhe i cili ishte strehuar në Brazil që po organizonte një festë të madhe në Rio de Janeiro. Doli i qetë në kamera, përshëndeti ndërkohë që spikeri thoshte se vendimi i gjykatës britanike që e kishte shpallur fajtor është ende në fuqi. Krimineli për Britaninë jetonte i lumtur në Rio pa e kërcënuar kush. Vetëm që nuk mund të shkonte në vendet që nuk e mbronin nga shërbimet sekrete britanike. Alketi u kuriozua se si Brazili mund t'iu japë të drejtën të jetojnë të lirë qytetarë të dënuar nga vendet e tjera. Duke biseduar me një shok ai mësoi se edhe ish kriminelë të Luftës së Dytë Botërore, bile përgjegjës për holokaustin, ishin strehuar në vendet e Amerikës Latine. Ai donte të mësonte më shumë mbi këtë çështje.

A mund ta ndihmoni?

Ku gjendet informacioni?

Kërkoni në internet më shumë informacion.

Vështroni në mënyrë kritike historinë e botes dhe përpikuni të kuptoni pse disa vende të Amerikës Latine strehojnë persona të dënuar në Evropë?

## **Situata 1**

Një grua iraniane me një fëmijë të mitur arrin në aeroportin e Danimarkës ku aplikoi për azil. Ajo nuk kish vizë dhe asnjë dokument identifikimi. I kish shpenzuar edhe të gjitha të hollat për t'u larguar nga Turqia, ku familja e saj nuk ishte e sigurt. Ajo dhe familja e saj kishin shkuar në Turqi për t'u mbrojtur nga ndjekjet e forcave iraniane për shkak të aktivitetit politik që familja e saj kish në atë vend. Edhe në Turqi familja e saj nuk ndihej e sigurt, kështu kish vendosur të largohej së bashku me fëmijën e mitur për në Danimarkë, vendi ku ishte edhe vëllai i saj. Përgjatë udhëtimit për në Danimarkë gruaja kish qëndruar tranzit në Spanjë. Autoritet daneze vendosën që ta kthenin gruan në Spanjë, si shteti i tretë i sigurt. Autoritetet spanjolle pasi u njoftuan për këtë gjë refuzuan që të pranenin këtë grua si azilante në vendin e tyre. Gjasat ishin të shumta që gruaja të kthehej në Turqi e më pas në Iran. Ndërhyrja e UNHCR-së dhe e Këshillit të Refugjatëve Danez bëri që kjo grua të pranohej nga autoritet spanjolle (vend i tretë i sigurt). Më pas gruaja aplikoi për azil në Danimarkë dhe kërkesa e saj u pranua.

## **Neni 15.**

**1. Gjithkush ka të drejtën e një shtetësie.**

**2. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij si dhe as nga e drejta që të ndërrojë shtetësinë.**

### Trajtim ligjor

Neni 15 thekson se çdo njeri ka:  
të drejtën të ketë një shtetësi,  
të mos i hiqet shtetësia në mënyrë arbitrare, si dhe  
ta ndërrojë shtetësinë nëse dëshiron.

Duke përcaktuar si të drejtë të njeriut, të drejtën e shtetësisë, DUDNJ në të njëjtën kohë përcakton edhe detyrimin e shtetit që çdoherë t'i japë apo njohë shtetësinë individëve, të krijojnë mundësinë që ajo të jetë edhe në zgjedhjen e lirë të individëve, dhe detyrimin e shtetit që të mos ia heqë shtetësinë individit në mënyrë arbitrare. E para do të thotë që shtetet të parashikojnë rregulla të atilla që t'i japin shtetësinë individëve dhe pajisjen me shtetësi ta parashikojnë në dokumentet e tyre ligjore që rregullojnë çështje të të drejtave të njeriut. Po kështu, shtetet duhet të parashikojnë në ligjet e tyre edhe lirinë e individit për të hequr dorë nga shtetësia apo edhe për ta ndryshuar atë nëse dëshirojnë. Së fundi, shtetet nuk duhet të vendosin për heqjen në mënyrë arbitrare të shtetësisë. Të heqësh shtetësinë në mënyrë arbitrare do të thotë që të heqësh shtetësinë në kundërshtim me ligjet në fuqi, ose, nëse ka një ligj për heqjen e shtetësisë, ky i fundit është arbitrar dhe aspak proporcional me shkaqet që nxisin këtë veprim apo me qëllimin që duhet të arrihet. Pra, të ketë heqje arbitrare të shtetësisë do të thotë më shumë se sa thjesht heqje në mënyrë të paligjshme të saj. Arbitrariteti vjen edhe si pasojë e heqjes së shtetësisë në përputhje me një ligj që ekziston, por ligji vetë është arbitrar, jo proporcional.

Shtetet pjesëmarrëse në hartimin dhe diskutimin e DUDNJ-së pranonin se nuk mund t'i hiqet arbitrarisht shtetësia një personi apo edhe që personi duhet të jetë i lirë të ndryshojë shtetësinë, por pati shumë diskutime nëse shtetësia duhet konsideruar si e drejtë e njeriut apo jo. Sigurisht që para se lëvizja e njerëzve të bëhej një realitet i mundshëm dhe kontaktet mes njerëzve të shtoheshin, çështja e shtetësisë as nuk mendohej se ekzistonte si një çështje. Në këtë këndvështrim çdokush mund të mendojë që çështja e shtetësisë nuk mund të konsiderohet si çështje e të drejtave të njeriut. Në fakt koncepti klasik mbi shtetësinë e konsideron atë si çështje krejtësisht të brendshme të një shteti, pra që sjell pasoja në tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve të një individi brenda shtetit të vet. Që të konsiderohej si pjesë e të drejtës ndërkombëtare u deshën vite të kalonin dhe u desh që marrëdhëniet mes njerëzve të shtoheshin e të kalonin kufijtë e një vendi. Kështu filloi të konsiderohej që çdokush duhet të ketë shtetësi të caktuar sepse kjo sillte rregull në mënyrën se si personi do të trajtohej dhe konsiderohej edhe në të drejtën ndërkombëtare. Dhe me hartimin e DUDNJ-së madje diskutimi u çua edhe më tej, duke konsideruar që çdokush duhet të kishte të drejtën e një shtetësie. Pas diskutimesh të shumta të shteteve pjesëmarrëse në lidhje me këtë nen, ai u pranua me 38 vota pro, 1 kundër dhe 7

abstenime, duke pranuar pra kështu se shtetësia jo vetëm përmban aspekte të të drejtave të njeriut, por është një e drejtë e njeriut. Në fakt, DUDNJ mbetet i vetmi dokument ndërkombëtar që përfshin në të drejtat e njeriut, të drejtën e shtetësisë.

Shtetësia tregon një gjendje të caktuar ligjore të personit, si në vendin e tij, ashtu edhe në tërësinë e shteteve të botës. Një shtet përcaktohet si i përbërë nga disa elementë, që përfshijnë territorin, popullsinë dhe sovranitetin të marrë vendimet që dëshiron për popullsinë e tij në territorin e tij. Popullsia e një shteti është tërësia e individëve të cilët kanë shtetësinë e këtij shteti. Të kesh një shtetësi do të thotë të jesh i lidhur ngushtë me një gjendje të caktuar e cila së pari përcakton të drejta e detyrime për individin në shtetin përkatës dhe së dyti përcakton të drejta e detyrime për këtë individ në lidhje me shtetet e tjera. Shtetësia pra është një koncept juridik që ka lidhje së pari me ligjin e brendshëm të shtetit dhe së dyti me ligjin ndërkombëtar.

Shtetësia e një personi është pjesë e identitetit të tij. Sigurisht nuk është i vetmi aspekt i identitetit të qenies njerëzore. DUDNJ-ja njihë përgjatë tekstit të saj edhe familjen si një grup themelor natyral i shoqërisë me të cilën qenia njerëzore identifikohet. Po kështu DUDNJ-ja i referohet edhe të drejtave kulturore të cilat zhvillojnë personalitetin e një personi. Pra, shtetësia konsiderohet si element që përcakton identitetin e një qenie njerëzore. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në një prej rasteve të vendosura prej saj (Nottebohm), thekson se ‘shtetësia është një detyrim ligjor që ka për bazë faktin social të përkatësisë, lidhjen mes ekzistencës së individit dhe asaj që ai ndjen e dëshiron, si dhe thekson ekzistencën e të drejtave dhe detyrave reciproke.

DUDNJ kërkon që çdo person që vjen në jetë të ketë një shtetësi. Dhe kështu e shndërron të pasurit e një shtetësie në një të drejtë të individit. Në fakt shtetësia është shumë e rëndësishme për njeriun, sepse ajo bën të mundur realizimin e njeriut në shumë aspekte. Ajo është pjesë e identitetit të njeriut, është mundësi për lëvizje, për t’u shprehur, sidomos në nivelin politik, është mundësi për t’u punësuar e për të përfituar nga sistemi i mbrojtjes sociale, shëndetësore, e kështu me radhë. Nëse nuk ke shtetësi nuk mund të ushtrosh dot disa të drejta themelore për ty si qenie njerëzore si të drejtën për të përcaktuar se cilët të do të jenë zgjedhjet politike apo edhe ato që do të drejtojnë vendin, apo të drejtën për t’u punësuar në organe të shtetit, pra mungesa e saj të kufizon të drejtën për të zgjedhur lirisht punën, apo e drejta për të lëvizur lirisht sepse nuk do jesh i pajisur me një pasaportë dhe askush nuk do të lejojë të largohesh nga vendi në të cilin ke lindur apo edhe të shkosh në një tjetër vend.

Nuk ka rregulla të njëjta për mënyrën se si një shtet konsideron një individ si shtetasin e tij. Ka shtete që konsiderojnë shtetas të tyre vetëm ato individë të cilët lindin nga prindër që kanë shtetësinë e këtij shteti. Ka shtete të tjera të cilët konsiderojnë dhe i japin shtetësinë e tyre çdokujt që lind në territorin e tij. Shtetet përgjithësisht lejojnë edhe fitimin e shtetësisë nga individët në çfarëdo moshe të jetës së tyre në përputhje me kërkesat ligjore. Ky rast konsiderohet si fitimi i shtetësisë me ligj. Shtetet me ligjet e vendit të vet kanë përcaktuar kriteret që duhen plotësuar që një individ të gëzojë shtetësinë e këtij shteti. Ka shtete të cilat lejojnë dyshtetësinë si dhe shtete të cilat nuk e lejojnë këtë.

## Neni 19 i Kushtetutës

Në Kushtetutën tonë parashikohet që kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Po kështu, Kushtetuta lejon edhe fitimin e shtetësisë për shkaqe të parashikuara me ligj. Po kështu, shtetasit shqiptar për asnjë arsye tjetër përveç heqjes dorë nga shtetësia shqiptare, nuk e humbasin atë.

Me ligje janë përcaktuar edhe të drejtat apo detyrimet që shtetasit e një shteti kanë në këtë shtet. Kështu, përgjithësisht shtetet të drejtën për t'u zgjedhur e për të zgjedhur e lidhin me shtetësisë, pra ia njohin vetëm shtetasve të tyre, sic ka edhe shtete që votimin e konsiderojnë detyrim të shtetasve të tyre e këtë e kanë vendosur në ligj, gjë që do të thotë pagim i një gjobe të caktuar mos pjesëmarrje në votime. Po kështu, nëse kujtojmë të drejtën për të lënë e hyrë lirisht në vendin tënd kurdoherë, këtë të drejtë duhet të ritheksojmë e gëzojmë vetëm shtetasit e këtij shteti, ndërkohë të huajt përgjithësisht kërkohet të kenë marrë lejen e këtij shteti për të hyrë në të, pra të kenë një vizë në pasaportën e tyre dhe shpesh të paguajnë një detyrim të caktuar financiar për të hyrë në territorin e një vendi.

Edhe pse shtetet kanë rregullime të ndryshme të njohjes së shtetësisë, të drejtave e detyrimeve që lidhen me të, trajtimin të ndryshëm të personave që nuk kanë shtetësinë e një vendi, e drejta ndërkombëtare ka vendosur disa rregulla të detyrueshme për t'u pranuar nga të gjitha shtetet. Për të ritheksuar c'ka është thënë, DUDNJ me nenin 15 synon të konsiderojë që çdo qenie njerëzore të ketë një shtetësi, duke e konsideruar këtë si të drejtë të individit. Sigurisht nëse do të ishte lënë me kaq, rregullat e ndryshme që zbatohen shtete të ndryshme për njohjen e shtetësisë mund të pasjellin që një individ të mos ketë shtetësi. Mendoni për në çast sikur shteti shqiptar të njohë shtetësinë vetëm të personave që lindin nga dy prindër që të dy me shtetësi shqiptare. Ndërkohë një shtetas shqiptar martohet me një shtetase të Kroacisë e cila vjen të jetojë në Shqipëri. Fëmija i lindur prej tyre nuk do të kishte shtetësi shqiptare. Ndërkohë në shtetin Kroat mendojmë që zbatohet po i njëjti rregull e kështu fëmija i lindur nuk do të ishte as shtetësinë kroate, pra kjo qenie njerëzore nuk do të kishte shtetësi. Por shtetësia siç e theksuam lidhet me të drejta e detyrime, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, dhe mungesa e saj sjell jo pak kufizime në jetën e një individi, të cilat nuk janë të pranueshme për DUDNJ-në dhe konventat apo paktet ndërkombëtare apo rajonale.

Gjatë diskutimeve të nenit 15 ishte bërë shumë e qartë që veprime që kishin ndodhur përgjatë historisë në vende të ndryshme të botës sidomos për heqjen e shtetësisë të mos ndodhnin më. Kështu veprime të tilla si ato të ndërmarra nga regjimi Nazist në Gjermani ku njerëz të panumërt ishin zhveshur nga shtetësia e tyre në mënyrë arbitrare thjesht mbi baza racore (Ligji i Shtetësisë i Rajhut, 1941) dhe ishin përdorur si objekte të thjeshta për eksperimente nga më të ndryshmet, apo edhe nga Bashkimi Sovjetik që i hoqi shtetësinë afro 2 milion njerëzve që kundërshtuan regjimin bolshevik në 1924-1925, u konsideruan si krejt të patolerueshme dhe të papranueshme. Kështu, shtetet me shumicë për ta konsideruar shtetësinë si të drejtë të individit.



### ***Dokumente të tjera ndërkombëtare***

Kombet e Bashkuara kanë ndërmarrë veprime të shumta për rregullimin e çështjes së shtetësisë në të drejtën ndërkombëtare. Kështu, këtu mund të përmenden:

Konventa mbi statusin e e personave pa shtetësi, e miratuar në vitin 1954 dhe hyrë në fuqi në vitin 1960. Kjo Konventë zbatohet ndaj 'personave që nuk konsiderohen shtetas të ndonjë shteti, në përputhje me ligjet e shteteve'. Kjo Konventë parashikon disa të drejta bazë të personave pa shtetësi në vendet nënshkruese të Konventës. Kështu kjo Konventë kërkon që personat pa shtetësi të mos trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se sa të huajt në vendin në të cilin ndodhen, ose thënë ndryshe të gëzojnë statusin e të huajt kudo ku ndodhen.

Konventa mbi reduktimin e pashtetësisë, miratuar në vitin 1961 dhe hyrë në fuqi më 1975. Kjo konventë konsiderohet si një arritje e madhe në përpjekjet për të zbatuar parimet e nenit 15 të DUDNJ-së. Kjo Konventë parashikon që asnjë person nuk mund të privohet nga shtetësia nëse kjo do të pasjellë mungesën e shtetësisë. Më tej parashikohen rastet kur një personi mund t'i hiqet shtetësia, duke qartësuar se kjo nuk mund të ndodhë për shkak të shtetësisë, racës, etnisë, përkatësisë apo besimit fetar, apo politik të personave. Kjo Konventë përmban parashikime të shumta të detajuara në lidhje me çështje të shtetësisë.

Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor:

Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër Grave: miratuar në 1979. Në një prej neneve të saj theksohet se shtetet nënshkruese të saj garantojnë se do të garantojnë barabar të drejtën e femrave dhe meshkujve për të fituar, ndryshuar, mbajtur, apo hequr dorë nga shtetësia. Veçanërisht shtetet garantojnë që martesat me të huaj, ndryshimi i shtetësisë së bashkëshortit gjatë martesës nuk do të sjellin pasoja në shtetësinë e gruas.

Konventa mbi shtetësinë e femrave të martuara: miratuar në vitin 1957

Ndërkohë edhe në nivel rajonal janë miratuar konventa të posaçme që trajtojnë çështjen e shtetësisë. Kështu, mund të përmenden:

Konventa Ndëramerikane mbi të drejtat e Njeriut: e hyrë në fuqi në vitin 1978. Kjo konventë, në nenin 20 të saj parashikon që çdo njeri ka një shtetësi, specifikon që çdonjëri ka të drejtën e shtetësisë të shtetit në territorin e të cilit është lindur nëse nuk ka ndonjë shtetësi tjetër. Dhe së fundi konventa risiguron edhe njëherë parashikimin e nenit 15 të DUDNJ-së që asnjë nuk do të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij apo që ta ndryshojë atë.

Konventa evropiane mbi shtetësinë: miratuar në vitin 1997. Kjo konventë përfshin rregulla e parime që lidhen me shtetësinë e personave fizikë dhe rregulla që lidhen me detyrimin ushtarak në rastet e shtetësisë së shumëfishtë. Kjo Konventë ripohon ato parime të cilat edhe DUDNJ-ja parashikon në nenin 15 të saj.

Pavarësisht se janë miratuar disa dokumente ndërkombëtare mbi shtetësinë dhe rregullimin e aspekteve të ndryshme të saj, DUDNJ mbetet e vetmja e cila e konsideron shtetësinë si të drejtë të njeriut. Megjithatë, të gjitha Konventat që u përmendën më sipër kanë siguruar të gjitha elementët që përfshin e drejta e shtetësisë e parashikuar në nenin 15 të DUDNJ-së.

## Aspekte edukative

Në shkollë mund të sillen çështje të ndryshme lidhur me të drejtën e shtetësisë. Çështje të nevojës së regjistrimit të fëmijëve në Regjistrin Themeltar të Shtetasve po bëhet përherë e më shpesh një çështje e rëndomtë, pasi nënat, në varësi të rrethanave të lindjes së fëmijës, nuk bëjnë regjistrimin e tyre. Mosregjistrimi i fëmijëve nuk është vetëm shkelje e të drejtës së fëmijës, por edhe një portë e hapur për të shtuar rrezikun e trafikimit, të zhveshjes nga e drejta e trashëgimisë dhe pronësisë dhe shumë të drejtave të tjera. Fëmijët e paregjistruar vazhdojnë të ushqejnë kanalet bamirësie, programet e të cilave nuk janë të plota nëse nuk marrin përsipër edhe regjistrimin e fëmijëve të braktisur në regjistrin themeltar të shtetasve në përputhje me interesin më të lartë të fëmijëve.

### ***Aktivitete***

Ndaloni për të parë dimensionin e te drejtave lidhur me atë që parashikon neni 14:

a. Megi lindi në Amerikë. Prindërit e saj donin që ajo të kishte shtetësi amerikane, s'mendonin se kështu, kur të rrite, mund të kishte më shumë shanse. Megi jeton në Tiranë me prindërit, ka një pasaportë amerikane në shtëpi, po nuk është e qartë se ç'të drejta humbet duke qene qytetare amerikane me banim në Shqipëri.

Ndihmoheni Megin të mësojë më shumë mbi shanset e saj.

Duke kaluar kufirin për në Shqipëri, refugjatët kosovarë tregonin se ushtarët serbë iu merrnin pasaportat dhe ua hidhnin në një pirg që digjej pa pushim. Ju nuk jeni me shtetas të ish Jugosllavisë\_ iu thërrisnin ata në fytire. Vjosa e vogël strukej thelle në sedijen e pasme të makinës. Ajo kish dëgjuar se gjithkush e ka të drejtën të këtë shtetësinë e tij.

Alba u lind jashtë kurore. Nëna dhe babi i saj nuk ishin të martuar. Nëna kishte ikur nga qyteti i saj, kish filluar punë në Tiranë me emër te rremë. Me atë emër ajo u paraqit edhe në maternitet. Sot, ajo dhe Alba përpiqen të bëjnë regjistrimin, por u thinj se duhet te paraqiten në një proces gjyqësor. E ëma ka frikë mos paditet për përdorim të identitetit rremë.

Mësoni më shumë mbi fëmijët e paregjistruar, të drejtat dhe rreziqet që iu paraqiten atyre.

Erioni i bukur rritej i shëndetshëm në shtëpinë e foshnjës. Ai kish lindur në Shqipëri nga një nënë refugjate kosovare me një problem të madh shëndetësor, që nuk e lejonte të kthehej me prindërit për në Kosovë. Shtëpia e prindërve të tij ishte djegur dhe nëna u strehua në një fshat si kish mundur. Ajo nuk kishte asnjë mundësi të lidhej me personat të cilëve iu kish lënë në dorëzim djalin.

Një zonjë vizitoi një ditë shtëpinë e foshnjës. Sytë e saj u ngulën mbi Erionin e vogël. “*I braktisur është ai fëmijë?*,- pyeti ajo e interesuar për të birësuar .

“*Ai, në fakt i braktisur e në fakt jo! Ai për të nuk është interesuar askush për 14 muaj që jeton këtu, po në fakt është shtetas i ish Jugosllavisë he nuk mund të birësohet me ligjet e*

*shtetit shqiptar,*”- iu përgjigj kujdestarja “*Sa keq!*,- tha zonja duke e përkëdhelur për herë të fundit djalin.

Për shkak të shtetësisë së tij, si një e drejtë madhore, Erioni nuk e gëzonte statusin e fëmijës së braktisur, pavarësisht se për të për 14 muaj nuk ishte kujdesur kush nga familja. Shërbimet Sociale të Kosovës dhe institucioni ku strehohej Erioni bënë punën e tyre. Një dite ai u kthye pranë prindërve me shpresë se një dite jeta e tyre do të bëhej më mirë.

Altini dhe Albanës, të lindur në SHBA, me nënshtetësi amerikane iu vdes babai në një aksident automobilistik. E ëma vendos të kthehet në Shqipëri bashkë me ta. Ajo vendoset tek babai i saj i ve dhe fëmijët i regjistron në shkollë. Shumë shpejt ajo zuri një punë për të qenë. Gjatë verës ata shkuan për vizitë në USA. E ëma rregulloi edhe disa dokumente të një shtëpie që e kishin blerë bashkë me të shoqin jo shumë kohë para se ai të vdiste. Altini dhe Albana i kërkonin me ngulm të mos ktheheshin në Shqipëri. por biletat ajo i kish prere. Dhe kish vendosur që fëmijëve të saj t’iu jepte shtetësinë shqiptare.

Bisedoni rreth të drejtave të shtetësisë së fëmijëve.

A dini të tregoni se kush vendos për shtetësinë e tyre?

Cilat janë proceset përmes të cilave duhet të kalojnë ata?

f. Disa vende të Evropës Juglindore si Bullgaria dhe Kroacia, apo Izraeli kanë një politikë shumë liberale të dhënies së shtetësisë. “Gjithkush që e ndjen veten se është bullgar a kroat, pavarësisht se ku jeton, mund të aplikojë dhe të gëzojë të drejtën e shtetësisë” iu thotë një i ri bullgar në plazh shokëve të tij shqiptarë. “Si mund të jete kaq e lirë ceshtja e shtetësisë në Bullgari?,” pyeti njeri “Mire e kane,- i tha tjetri. “Njeriu një jetë ka dhe zgjedh se qytetar i cilit shtet dëshiron të jetë. Jo, po si greku! Janë me mijëra shqiptaret që jetojnë prej vitesh atje dhe as me leje qëndrimi nuk i pajisin, jo me pasaporta!”.

Kjo e futi në mendime Altinin

Pse disa vende zgjedhin të kenë politika kaq të hapura për dhënien e shtetësisë dhe disa të tjera të jene gati hermetike?

Si është situata sot në Bullgari në varësi të statusit të saj në Evropën e Bashkuar?

g. Po për një të huaj që kërkon të marre shtetësinë shqiptare, cilat janë procedurat? Kërkoni ndihmë nga një avokat për të organizuar bisedën.

gj. Një organizate si UNHCR ndihmon të huajt të ndjekin praktikat e marrjes se shtetësisë në Shqipëri.

Në internet mësoni me shumë për aktivitetin e saj në Shqipëri.

Në faqen zyrtare të Presidencës së Shqipërisë gjeni listën emërore të personave të kanë marrë dhe kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare.

Cili është bilanci?

h. Vironi shkoi me pushime në Himarë këtë vit. Ai zuri me qera një apartament në kalanë e Himarës në një familje ku familjaret flisnin greqisht gjithë ditën. Edhe në plazh

greqisht dëgjohej. Vironi ish rritur në Tiranë dhe nuk dinte asnjë fjalë greqisht. Shqipes së tij të gjithë i ktheheshin me një shqipe shumë të mirësjellje. “Po c’është kjo punë?,- pyeti Vironi një ditë komshiun: “Pse të gjithë këtu flasin greqisht kur e dinë shumë mirë gjuhën shqipe?” “Epo në ruajmë traditat tona!,-” iu përgjigj komshiu. “Ne jemi shtetas shqiptarë me kombësi greke.”. Vironit iu desh pak ta kuptonte këtë. “Kush e jep shtetësinë dhe kush e heq?”. “Po pse nuk merrni edhe shtetësinë greke meqë keni kombësinë?” pyeti Vironi pasi ndjeu se kjo punë ishte pak e ngatërruar. “Epo akoma nuk po lëviz greku!”, ishte përgjigja.

Vironi gjithë mbasditen bloi me mendjen e tij se c’domethënie kishte shtetësia shqiptare dhe kombësia greke e shkruar në pasaportën e komshiut.

Mendoni për në çast sikur shteti shqiptar të njohë shtetësinë vetëm të personave që lindin nga dy prindër që të dy me shtetësi shqiptare. Ndërkohë një shtetas shqiptar martohet me një shtetase të Kroacisë e cila vjen të jetojë në Shqipëri. Fëmija i lindur prej tyre nuk do të kishte shtetësi shqiptare. Ndërkohë në shtetin kroat mendojmë që zbatohet po i njëjti rregull e kështu fëmija i lindur nuk do të ishte as shtetësinë kroate, pra kjo qenie njerëzore nuk do të kishte shtetësi.

Gjykoni për situata analoge

### **Neni 16**

Burrat dhe gratë në moshë të pjekur kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkëputjes.

Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen.

Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

### Trajtim ligjor

Ky nen synon të mbrojë familjen, martesën dhe të përcaktojë parimet më kryesore të krijimit të saj. Në paragrafin e 3 të këtij neni thuhet se familja është njësi e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe duhet të ketë mbrojtjen e shoqërisë. Pra, neni përcakton detyrimin pozitiv të shtetit për të mbrojtur familjen.

### *Elementë themelore të nenit 16*

Për të kuptuar përmbajtjen e këtij neni është e nevojshme të dihet kuptimi i nocioneve: familje, moshë e pjekurisë, të krijosh familje etj.

Termi *familje* ndryshon nga varësi të kohës, të kulturës dhe traditave të një vendi. Familja është njësi e shoqërisë dhe themeli i saj. Ky nen nuk jep një përkufizim të këtij koncepti, nëse bën fjalë për familjen në kuptimin e ngushtë të fjalës apo në kuptimin e gjerë të saj. Në fakt, në vende të ndryshme ka përkufizime të ndryshme lidhur me familjen. Ky koncept ka evoluar. Dikur familja ishte shumë e gjerë dhe bazuar në lidhje gjaku, ose krijuar në bazë të martesës, ndërsa sot marrëdhëniet në familje krijohen edhe me forma të tjera: si birësimi i një fëmije krijon marrëdhënie mes prindërve birësues dhe atij, pavarësisht nga mungesa e lidhjes biologjike, marrja e fëmijëve në kujdestari, ose martesat e personave të së njëjtës gjini bëjnë që të krijohet një familje e ndryshme nga ajo që ka ekzistuar tradicionalisht, etj.

Në përmbajtje të nenit 16, paragrafi 3 pranohet që familja është njësi më e vogël grupore. Megjithatë dy janë kriteret kryesore për të përcaktuar atë që quhet familje: raportet biologjike dhe statusi (martesa dhe adoptimi). Çështja e kujdestarisë është çështje e hapur në shoqërinë shqiptare. Ligji për kujdestarinë u miratua vetëm pak vite më parë dhe deri më tani është punuar për të zhvilluar bazën ligjore të zhvillimit të programeve të kujdestarisë.

Një parim i rëndësishëm i përcaktuar në nenin 16 të DUDNJ *është e drejta për martesë pa asnjë lloj kufizimi*. Me fjalë të tjera, neni synon të parandalojë diskriminimin që mund të ketë ndaj njërit prej personave që lidhet në martesë. Barazia e personave ekziston jo vetëm kur lidhin martesë, por edhe gjatë martesës madje edhe kur vendosin t'i japin fund asaj (ose siç thuhet në Deklaratë: “martesa priset”). Pavarësisht nga theksimi i parimit të mosdiskriminimit në praktikë, në vende ku traditat dhe zakonet janë të forta, vazhdojnë të respektohen disa dallime ose ndalesa të martesës mes personave të feve të ndryshme ose të

krahinave të ndryshme ose ka rregulla lidhur me martesën e një shtetasi të vendit me një shtetas të huaj, qoftë përsa i përket rregullave dhe dokumenteve që duhen plotësuar dhe në lidhje me pajisjen me leje qëndrimi.

Nëse lexohet me kujdes e drejta për martesë, del se shteti ka *detyrime pozitive* dhe *negative*, pra deklarata i ndalon shtetit të ndërhyjë të diskriminojë dikë. Deklarata gjithashtu detyron shtetin të mbrojë familjen dhe martesën. Gjithashtu, shteti detyrohet të përpunojë një bazë të drejtë ligjore, e cila do të ndihmojë të vendosen e lidhjes martesore mes individëve. Në çdo vend, martesë rregullohet me ligj.

Në këtë nen mbrohet martesë e lidhur mes *personave të gjinive të ndryshme* (mes një burri dhe gruaje). Pra, DUDNJ nuk bën fjalë për lidhje të tjera të personave të gjinive të njëjta. Edhe e drejta për martesë mes personave me gjini të ndryshme nuk është e pakufizuar. Burri dhe gruaja duhet të plotësojnë dy kushte: të kenë arritur *moshën madhore* (të pjekurisë) dhe martesë të jetë lidhur *me pëlqim të lirë dhe të plotë të bashkëshortëve*. Megjithatë, vende të ndryshme në legjislacionin e tyre të brendshëm kanë vendosur edhe kushte të tjera. Moshë e pjekurisë ose mosha madhore janë dy nocione të ndryshme. *Moshë madhore* përcaktohet me ligj, ndërsa *mosha e pjekurisë* ka të bëjë me pjekurinë fizike të personit që e bën atë të aftë të lindë. Këto dy momente nuk arrihen në të njëjtën kohë. Në disa vende, pjekuria vjen më shpejt se sa në vende të tjera.

Përcaktimi i kufizimeve të tilla është bërë që të parandalohen martesat tek fëmijët dhe të parandalohet lidhja e martesave mes personave që janë të rinj dhe nuk janë në gjendje të kuptojnë vendimet që marrin dhe detyrimet që lindin në pas. Kushti që përcakton deklarata që mes burrit dhe gruas duhet të ekzistojë *vullneti i lirë* është një parim i rëndësishëm që ndalon martesat me dhunë ose me detyrim të vajzave ose fëmijëve, detyrimin që prindërit i bëjnë disa vajzave për t'u martuar kundrejt shpërblimit ose përfitimeve të tjera dhe jashtë dëshirës së tyre.

Që të vërtetohet *vullneti i lirë* ai duhet të shprehet *para një autoriteti publik*. Shteti ka detyrime të përcaktojë rregulla ligjore që ndalojnë lidhjen e martesës mes një personi që nuk është në gjendje të shpreh lirshëm vullnetin e tij për martesën ose nuk është i aftë mendërisht të kuptojë atë që dëshiron të bëjë. Përveç pëlqimit të lirë, ai *duhet të jetë edhe i plotë*. Deklarata nuk shprehet sesi do të veprohet nëse një nga personat e lidhur në martesë është i mitur. Kujdestaria prindërore në këtë situatë është e paqartë:

A duhet të shprehë prindi vullnetin e tij?

A merr ai përgjegjësitë e vendimit të fëmijës së mitur siç normalisht vepron për rrethana të tjera në të cilën gjendet fëmija?

Element tjetër i nenit 16 është se të gjitha të drejtat gëzohen *në mënyrë të barabartë* si nga burri ashtu edhe nga gruaja. Ata kanë të drejtë të barabartë ndaj martesës, si *moshës për martesë, mbajtjes së mbiemrit dhe shtetësisë*. Edhe gjatë martesës, bashkëshortët kanë të drejta dhe detyrime të njëjta në familje si për *kujdestarinë e fëmijëve, detyrimet për rritjen dhe edukimin e tyre*, dhe kur ajo merre fund për arsye të ndryshme si prishja e martesës për shkak të *divorcit*, vdekjes së njërit prej bashkëshortëve, *anulimit të martesës së lidhur apo të pakonsumuar*.

Në përmbajtjen e kësaj dispozite nuk del divorci, pasi shumë shtete nuk e pranonin atë në atë kohë, por ai flet mjaftueshëm për *prishje të martesës*. Megjithatë, ajo nënkuptohet kur thuhet se të drejtat gëzohen edhe kur martesë prishet.

Sipas legjislativi shqiptar mosha minimale për martesë është përcaktuar. Në rast se për një arsye objektive, për shembull një vajzë ka mbetur shtatëzanë dhe dëshiron të martohet me djalin, është gjykata që vendos për t'i lidhur ata me martesë.

### Aspekte edukative

Individi dhe familja paraqiten dendur në kutikulën e arsimit parauniversitar. Tablotë janë të larmishme: familja jepet në funksion e sipër, me rolet sociale, gjinore, me tipologjinë demografike ( fshat , qytet), etj. Procesi i krijimit të familjes është ende jo prezent në tekste. Familja paraqitet e krijuar, shpeshherë e fotografuar në detyrime tradicionale.

Rolet gjinore brenda familjes janë të stereotizuara. Në tekstet e shkollës fillore, del se stereotipat gjinore që e ngarkojnë burrin me shume me aktivitete jashtë familjes dhe me vendimmarrjen janë shume me të shpeshta dhe deformuese krahasuar me rolin e nënshtruar të gruas. Gjithmonë në role përkujdesese brenda familjes dhe me pune të rëndomta jashtë saj. Vendimmarrja, profesionet e kërkuara janë të meshkujve. Prindërit janë përherë në dihotominë: gruaja në punët brenda shtëpisë, burri në punët jashtë shtëpisë që duan vendimmarrje, forcë, kanë në themel sfidën.

Deformimet e martesës jepen edhe në raport me fëmijët. Shumë më shpesh del babi që është mbajtësi i buxhetit, i aftë e vizionar, drejtues dhe gjykatës të udhëheqë të birin drejt të njëjtave role, ndërsa nëna më e paaftë, gjithmonë në kushtet që duhet të kursejë dhe të kujdeset për të tjerët duhet të udhëheqë të bijën drejt roleve të tilla e deri edhe për t'u kujdesur për lulet në familje.

**a.** Evisi ishte në dasmën e një kushërirë. Atje mësoi se nusja që martohet ishte 17 vjeç. A pengohet martesat nën 18 vjeç në Shqipëri??

Edhe një herë procesi i pëlqimit për martesë nuk del në asnjë pjesë të kurikulës dhe në asnjë nga aktivitetet jashtëshkollore. Pak flitet në edukatën shoqërore klasa 6 për zgjedhjen dhe martesën. Në letërsinë e shkollës së mesme jepen shumë pjesë të ndjenjës idilike të dashurisë, por pak jepet se si dashuria çon në pëlqimin për martesë. As nuk njihen nxënësit me praktikën e martesës me detyrimet e saj, as me betimin para ligjit për besnikëri e qëndrueshmëri në martesë, as para priftit në kishë. Që familja është bërthamë e shoqërisë kjo është e qartë, por nuk është e qartë se cila është rruga e shëndetshme e gëzimit të kësaj të drejtë dhen c'rrethana ndërhyjnë shteti në martesë dhe me çfarë kompetencash.

**b.** Cila është formula e betimit në martesë?

Pse ka të varfër dhe cili është kufiri i varfërisë përtej së cilës shteti nuk lejon të jetohet.

Si i ndihmon shteti fëmijët e sëmurë dhe fëmijët pa prindër?

Si merren vendimet?

C'te drejta ka secili anëtar i familjes për tu mbrojtur nga shteti, si mbrohen fëmijët, gratë dhe pleqtë, cilat janë programet në mbrojtje të të rinjve?

c. Shumë fëmijë vendosen nga prindërit e tyre nëpërmjet shërbimit social shtetëror në institucione të përkujdesjes për fëmijët. Jeta e tyre është e ndryshme nga ajo e fëmijëve të tjerë.

Përpiquni t'iu sillni në klasë nxënësve realitete nga jeta e fëmijëve të institucionalizuar për shkak të vështirësive ekonomike të familjes.

Njihni programet që ndihmojnë familjet të p[ë]rmirësojnë situatën e tyre që të mund të marrin fëmijët sa më parë pranë familjes..

Këto janë të panjohura në programet e shkollës shqiptare dhe aktivitetet janë më shumë të natyrës bamirëse se sa të një natyrë që ka të bëjë me preokupimin e vërtetë për riciklimin e fuqisë punëtore, e sigurimit të një fillimi të mbarë në jetë për fëmijët e deprimuar dhe të sigurimit të vazhduar të cilësisë së jetës.

e. Komentoni mbi këtë thënie të Papa Benediktit XVI. Diskutoni mes jush për abortin.

“Kontinenti që demografikisht plaket me të shpejtë nuk duhet të bëhet edhe një kontinent shpirtërisht i plakur. Gjithashtu, Evropa do të jetë më tepër e vetëdijshme për veten e vet, nëse do të marrë përsipër në botë një përgjegjësi që i përgjigjet traditës së saj të veçantë shpirtërore, aftësive të saj të jashtëzakonshme dhe forcës së saj të madhe ekonomike. Bashkimi Evropian pra, duhet të ketë një rol udhëheqës në luftën kundër varfërisë në botë dhe në impenjimin në favor të paqes”.Ati i Shenjtë nuk lë pa përmendur edhe gabimet e Evropës, por thekson se ajo ka aftësi autokritike që duhen shfrytëzuar. Në Evropë, është formuar për herë të parë koncepti i të drejtave të njeriut. E drejta themelore është jeta, prandaj aborti nuk mund të konsiderohet “e drejtë njerëzore”, theksoi Papa, polemik me vendimin e fundit të organizatës Amnesty International.

Aborti është një “plagë e thellë shoqërore”, vazhdoi Papa, duke nënvizuar: “Duke thënë këtë, nuk shprehim ndonjë interes specifik kishtar. Bëhemi avokatë të një kërkesë thellësisht njerëzore e ndjehemi zëdhënës të të pabindurve, që nuk kanë zë. Nuk i mbyll sytë para problemeve dhe konflikteve të shumë grave dhe e kuptoj fort mirë se besueshmëria e fjalës sonë varet edhe nga ajo që bën vetë Kisha për të ndihmuar gratë në vështirësi”.

f. Erioni është prezent në debat të prindërve. Ata flasin për ndarje. Babai ka një lidhje jashtë martesore. Nëna nuk kursen asnjë detaj për ta thënë në sytë e Erionit. Ai ndjehet i dërrmuar dhe i hutuar; ka nevojë për ndihmë por nuk di si. Kujton ndonjë film a tregim ku të kish një gjë të ngjashme. Asgjë nuk e ndihmon,. Dita e divorcit po vjen. Ai gjendet në presionin e të dy prindërve. Të dy kërkojnë kujdestarinë mbi të. Ai nuk di si të veprojë.

A dini të ndihmoni Erionin?



### **Neni 17**

Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkësi me të tjerët. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.

### Trajtim ligjor

Neni 17 i DUDNJ-së është diskutuar shumë nga shtetet pjesëmarrëse dhe në fakt ka pësuar ndryshime të shumta përgjatë hartimit. Madje, shtetet diskutuan edhe nëse duhet një nen i tillë apo jo. Teksti i nenit 17 reflekton këto diskutime. Ai nuk i njeh secilit të drejtën për një pronë, por ky nen përqendrohet në mbrojtjen e institutit të pronës dhe të drejtave të veçanta që lidhen me të, siç është mos privimi në mënyrë arbitrare nga prona që dikush ka.

Ligjet e vendeve të ndryshme kanë trajtuar çështjen e pronës në mënyra të ndryshme. Kështu, duhet theksuar se çështja e pronës është një çështje që është trajtuar shumë nga këndvështrimi ideologjik dhe në varësi të sistemit politik të një vendi. Në sistemin socialist, dhe në lidhje me këtë mund të marrim shembull vendin tonë para vitit 1991, prona konsiderohej si e të gjithëve dhe nuk ekzistonte e drejta për të pasur pronë individuale me përjashtim të sendeve vetjake, si p.sh të themi veshje, objekte personale, sende dhe orendi shtëpie. Po kështu ka sisteme në të cilat prona është një çështje e komunitetit apo e thënë ndryshe konsiderohet si kolektive, ashtu siç ka vende në të cilat çështja e pronësisë zbehet jashtëzakonisht shumë në krahasim me çështje të tilla jetike si varfëria apo mbijetesa. Për shkak të zgjidhjeve të ndryshme që vende të ndryshme i bënin kësaj çështje dhe për shkak të kufizimeve që shkonin në nivele të ndryshme, pati shumë diskutime dhe kundërshti mes shteteve gjatë hartimit të DUDNJ-së. Megjithatë pavarësisht nga diskutime e shumta ka qenë një koncept **kapitalist** i trajtimit të çështjes së pronës që mbizotëroi dhe u pranua gjerësisht.

Megjithatë duhet theksuar se neni 17 nuk reflekton në vetvete ndarjen e shteteve që e miratuan në shtete kapitaliste, duke mos qenë kështu një nen që tregonte për ndarjen e shteteve pjesëmarrëse në shtete të lindjes dhe të perëndimit. Kjo sepse kishte shtete të perëndimit, si Franca që nuk kishte miratuar gjuhën e këtij neni. Gjithsesi duhet thënë që ky nen lë hapësira për zbatim, duke pranuar ushtrimin e të drejtës së pronës si në mënyrë individuale ashtu edhe kolektive, duke mundësuar kështu zbatimin e ideologjive të ndryshme në lidhje me këtë çështje.

Më tej duhet thënë që neni 17 thekson se kjo e drejtë nuk është absolute, duke pranuar që personave mund tu kufizohet kjo e drejtë. Por, ajo që neni 17 kujdeset të mbrojë është kufizimi arbitrar nga e drejta e pronës. Kjo do të thotë që kufizimet e saj të bëhen gjithmonë me ligj dhe që ligji të jetë i drejtë, jo arbitrar e proporcional me situatën që e imponon kufizimin.

Në të drejtën ndërkombëtare kjo e drejtë nuk është parë si e vetëkuptueshme. Madje dokumentet kryesorë të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat nuk e kanë të përfshirë këtë

të drejtë në nenet e tyre. Pra, kjo e drejtë nuk është përfshirë në Paktin Ndërkombëtar për të drejtat civile e politike apo në atë mbi të drejtat ekonomike, sociale e kulturore. Ka pasur shumë debate e diskutime nëse kjo e drejtë duhet njohur si e drejtë që shtetet detyrohen t'u njohin shtetasve të tyre apo jo, dhe për shkak të shumë diskutimeve nuk u përfshi një e drejtë e tillë në këto dy dokumente kryesorë të Kombeve të Bashkuara. Por kjo e drejtë është njohur gjithsesi në shumë dokumente të tjerë më specifike, si p.sh. në Konventën mbi Eliminimin e diskriminimit kundër Grave apo edhe në atë për Eliminimin e diskriminimit Racial. Ndërkohë që në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut kjo e drejtë është pranuar edhe pse jo që në tekstin e parë të kësaj Konvente (të vitit 1950), por me një protokoll që u miratua jo më larg se dy vite pasi u miratua teksti bazë i KEDNJ-së. Po kështu edhe në Konventën Ndëramerikane dhe në Kartën Afrikane mbi të drejtat e njeriut përfshihet e drejta e përdorimit dhe gëzimit të pronës dhe theksohet se për interesa publike shteti mund të vendosë për kufizimin e kësaj të drejte. Karta Afrikane është shumë e qartë kur thekson se kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm për interesa të publikut apo komunitetit dhe vetëm nëse ky kufizim është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

E drejta e pronës duhet kuptuar që nuk i referohet vetëm tokës po shtëpisë, sende këto që në gjuhën e ligjit njihen si sende të paluajtshme. Ajo përfshin edhe mbrojtjen e pronave të tilla si pasuritë intelektuale, si p.sh. shpikjet, patentat, prodhimet e ndryshme teknologjike, apo librat e ndryshëm. Për mbrojtjen e tyre, edhe pse jo të përmendura shprehimisht në DUDNJ janë miratuar një sërë konventash të cilat janë nënshkruar edhe nga vendi ynë.

Së fundi duhet përmendur edhe lidhja e ngushtë e çështjes së të drejtës së pronës me atë të zhvillimit të mbarë njerëzimit dhe përparimit njerëzor. Deklarata mbi përparimin shoqëror dhe zhvillimin kërkon që prona të shihet si e kufizueshme dhe përdorimi i saj si i kushtëzuar nga ekzistenca e të drejtës së pronësisë për të gjithë dhe krijimi i kushteve që do të sillnin barazinë e mbarë njerëzimit. Edhe pse kjo kërkon një ndryshim ideologjik të drejtimit të një shteti, gjithsesi edhe shtetet që mbështeten në konceptin e pronës private, pranojnë e miratojnë një aspekt të ndarjes së mirëqenies në vend.

Në Kushtetutën e vendit tonë e drejta e pronës është një e drejtë themelore e cila “është e garantuar”-Neni 41 i Kushtetutës, dhe që nuk mund të çënohet pa një proces të rregullt ligjor” – Neni 42 i Kushtetutës.

### Aspekte edukative

#### *Të drejtat e ish pronarëve në vendin tonë*

Për të kuptuar më tej e më mirë kuptimin e nenit 17 diskutoni mbi rastin e ish pronarëve në vendin tonë. Ish pronarët në vendin tonë, të cilëve u është marrë, konfiskuar apo shtetëzuar prona në mënyrë arbitrare nga ish regjimi komunist, kërkojnë që kjo pronë t'u kthehet. Madje disa prej tyre kërkojnë që kjo pronë t'u kthehet pa kufizime. A mund ta kenë këta ish pronarë DUDN-në si bazë argumentuese për kërkesën e tyre?

### **Shënim:**

Mos harroni që DUDNJ është një deklaratë në thelbin e saj, pra jo e detyrueshme ligjërisht për shtetet palë. Jo më kot janë miratuar dy Pakte Ndërkombëtare për të Drejtat civile e politike si dhe për ato ekonomike, sociale e kulturore. Megjithatë DUDNJ është shndërruar në të drejtë të të gjithëve e që e njohin edhe pse nuk e kanë miratuar me nënshkrim shtetet e botës. Por kjo gjithsesi nuk passjell ndonjë detyrim të prerë e të qartë për shtetet nënshkruese të DUDNJ-së.

Komentoni mendimin e mëposhtëm:

“Neni 17 i DUDNJ-së thekson që “gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri”, por ai nuk parathotë se kjo pasuri nuk mund të merret nga shteti. Neni 17 nuk vendos ndonjë detyrim mbi shtetet të mos shtetëzojnë, shpronësojnë, konfiskojnë apo sekuestrojnë pronën e shtetasve. Ajo që kërkon DUDNJ është që *“prona të mos i merret arbitrarisht dikujt, pra pa një ligj apo akt ligjor, apo vendim gjykate”*. Po kështu, ky nen nënkupton që ligji duhet të jetë i drejtë e proporcional, pra të mos jetë arbitrar në vetvete.

Më tej, ky nen nënkupton që të ketë edhe një shpërblim për rastet kur një personi i merret prona për shkak se e kërkon interesi publik. Gjithsesi, neni 17 nuk merret me rregullimin e pasojave në rastet kur prona merret. Ai as nuk i detyron shtetet t’iu kthejnë pronën personave të cilëve iu është marrë. Për më tepër, ai nuk e përcakton një detyrim të tillë sidomos kur ka ndryshime thelbësore në drejtimin politik të vendit, siç është rasti i kalimit nga një shtet socialist, i centralizuar, njëpartiak, ku nuk njihej e drejta e pronës apo ekonomia e tregut, në një shtet që mbështetet në parime diametralisht të kundërta, siç është shteti i ndërtuar pas vitit 1991 në Shqipëri.”

Parashikoni vështirësitë që do të njohë deri në fund ligji i kthimit dhe kompensimit të pronave ishpronarëve në Shqipëri.

E drejta e kthimit të pronave, e kompensimit për shpronësime të bëra nën një regjim tjetër nuk njihet si një e drejtë absolute apo, thënë ndryshe, një detyrim absolut i një vendi/qeverie të njohë e kthejë pronën e ish pronarëve.

A mund të abrogohet ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave në Shqipëri?

Kjo sigurisht është zgjedhje e vendeve dhe qeverive përkatëse dhe vendi ynë ka zgjedhur të kthejë apo kompensojë në rastet kur nuk është i mundur kthimi, pronën ish pronarëve të cilëve iu është marrë në mënyrë të padrejtë nga shteti komunist.

Parashikoni rastet kur kthimi do të jetë i pamundur/ konfliktual.

Ndaloni për të reflektuar mbi të drejtat e shtetasve të siguruar nga Neni 41 i Ligjit themeltar të Shtetit Shqiptar.:

### **Neni 41**

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.
4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.
5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Diskutoni mbi gjerësinë e së drejtës për të patur pronë dhe garancinë që jep sistemi ligjor në mbrojtje të paprekshmërisë së saj siç garantohen në nenin 42 të Kushtetutës së Shqipërisë..

Sillni raste të konflikteve ligjore me pronat

Sillni raste të njohura prej jush që janë zgjidhur drejt në gjykate/qe nuk janë zgjidhur drejt.

A mendoni se me ardhjen e një partie tjetër në pushtet ligji i kthimit dhe kompensimit të ish pronarëve mund të abrogohet? Merrni në konsideratë edhe të drejtat e garantuara nga neni 42 i Kushtetutës së Shqipërisë.

#### **Neni 42:**

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Diskutoni mbi pjesën e ligjit: Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkësi me të tjerët.

C'detyrime i lindin shkollës lidhur me edukimin ekonomik?

Analizoni kurrikulën e shkollës nëntëvjeçare. A përgatitën mjaftueshëm fëmijët mbi rrugët se si bëhet prona, si krijohen të ardhurat, si shtohen ato?

C'vend zë edukimi ekonomik në shkollë? A jeni të kënaqur me të?

A ka gjallëri në shkollën tuaj në lidhje me edukimin ekonomik, apo janë anemike?

Axhenda e edukimit ekonomik kërkon shumë krijimtari nga ana e mësuesve. A janë të trajnuar ata të udhëheqin aktivitete për edukimin ekonomik?

Në shumë shkolla ka projekte që synojnë të pasurojnë qeverinë e nxënësve, të krijojnë të ardhura që nxënësit vetë të kryejnë aktivitete që dëshirojnë. Mendoni në mënyrë krijuese se si mund të rriten të ardhurat e qeverisë së nxënësve në shkollë. Në bashkëpunim me nxënësit hartoni një plan aktivitete për ngritjen e fondeve në shkollën tuaj.

A është i plotë kuadri i rregullave mbi bazën e të cilave administrohet "prona" e qeverisë së nxënësve?

Çështjet e pronësisë kanë filluar të ndihen edhe në administrimin e shkollës. Mënyrat e rakordimit të pronësisë me të tjerët në kushtet e jetesës në komunitet janë ende të paqarta si realizohen.

A ka shkolla juaj konflikte me pronaret ë tokës ose me pronare ë tjerë të kufizuar me territorin e shkollës?

Sa përgatiten në shkollë nxënësit për jetesën e përbashkët në komunitet? Sa zë vend në aktivitetet e shkollës ruajtja e mjediseve të përbashkëta, e mira e përbashkët në kushtet e jetesës në komunitet?

E rëndësishme është që në shkollë të bëhet rutinë aftësimi i fëmijëve për të krijuar pasuri dhe jo vetëm për të konsumuar. Reflektoni mbi punën që bëhet në shkollën tuaj nëse ajo ndihmon për të prodhuar apo për të konsumuar?

Shpeshherë në shkolla nuk ka zë dhe aktivitete për të ngritur fonde, por vetëm për të konsumuar fonde. Sa e përgatit shkolla nxënësin që të jetë krijues i të mirave dhe jo vetëm konsumator i tyre?

E rëndësishme është që shkolla të krijojë fonde dhe jo vetëm t'i konsumojë ato. Nxënësit janë një fuqi e madhe ngritëse e fondeve në shkollë. Parashikoni forma të drejta të ngritjes së fondeve. Siguroni që keni një rregullore të përdorimit të drejtë të tyre.

Diskutoni mbi gjerësinë dhe drejtësinë e paraqitjes së pjesës së dytë të nenit 17 te DUDNJ në tekstet shkollore: ***Asnjeri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.***

Historia e Shqipërisë bën fjalë për shtetëzimin e pasurive pas Luftës së Dytë Botërore. Ajo që theksohet është se shtetëzimi ish arbitrar dhe mizor. Po kthimi i pronave pas viteve të përmbysjes se diktaturës nuk është pasqyruar ende në tekstet e historisë, pavarësisht së po bëhen rreth dy dekada.

Çështjet e shpronësimit apo pronësimit me të padrejtë apo me të drejtë duhen sjellë për më shumë trajtim në lëndë si historia, njohuri për shoqërinë dhe edukata shoqërore.

**Neni 18.**

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënies së mësimëve, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare.

Trajtim ligjor

Neni 18 trajton një çështje të rëndësishme për shoqërinë njerëzore. Historikisht njerëzimi ka ushtruar besimet dhe bindjet dhe nuk është penguar nga shteti t'i gëzojë ato. Madje, pretendohet se teoria e të drejtave të njeriut e ka bazën tek historia e gjatë e ekzistencës dhe mbrojtjes së besimeve fetare.

Puna për hartimin e këtij neni nuk ka qenë e lodhshme sepse shtetet në përgjithësi kanë qenë dakord për përfshirjen e një neni që t'i referohej të drejtës së besimit të individëve në deklaratë, por gjithsesi neni ka pësuar ndryshime gjatë punës përgatitore. Kështu, termi '*besim*' nuk ishte në projektin e parë të hartuar edhe pse në të theksohej karakteri absolut i së drejtës për të pasur mendim e bindje individuale. Bashkimi Sovjetik pati mendimin që neni të përfshinte edhe mundësinë e kufizimit me ligj të lirisë së praktikimit të ritualeve fetare dhe praktikave fetare të rrezikshme për shoqërinë, por ky propozim u hodh poshtë. Gjithashtu Bashkimi Sovjetik shtroi idenë e një teksti alternativ të nenit, i cili të përfshinte garanci më të gjera që të përfshinin edhe mbrojtjen e mendimit të lirë shkencor e përparimtar, përveç propozimit të kufizimit për ushtrimin e ritualeve fetare. Përfundimisht, BS votoi pro tekstit përfundimtar. Neni u votua në formën përfundimtare me 38 vota pro, 3 kundër e 3 abstenime.

**Elemente të nenit 18**

Neni 18 është një nen i cili përqendrohet tek *liria për të menduar atë që çdo individ dëshiron dhe për të besuar apo të ketë një ndërgjegje të caktuar ashtu siç vetë individi e mendon*. Pra, e thënë thjeshtë, neni thekson që në të gjithë kemi të drejtën të besojmë atë që duam të besojmë, të kemi një fe, apo ta ndryshojmë atë dhe besimet tona nëse dëshirojmë.

<i>Liri për të menduar, krijuar ndërgjegjen dhe besuar</i>	<i>Liri për ta manifestuar</i>	<i>Liri për të ndryshuar besimin, bindjet e mendimet</i>	<i>Liri të ta ushtruar bindjen e besimin</i>	<i>Liri për të patur e shfaqur besimin e bindjen vetëm apo me të tjerë</i>
------------------------------------------------------------	--------------------------------	----------------------------------------------------------	----------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------

**Neni 18 nuk jep ndonjë element sqarimi për termat që përdor: “mendim”, “ndërgjegje”, “besim”. Të tre këto terma kanë të bëjnë me *qëndrimet e individit përballë botës, shoqërisë dhe asaj që përcakton fatin e tij dhe të botës, qoftë perëndi apo qenie superiore, apo vetëm arsyeja apo racionalja, apo mundësia*. Neni 18 ka të bëjë me një çështje shumë të rëndësishme për njerëzit. Ai, sipas Cassin, anëtar i**

**Komitetit Hartues të DUDNJ-së, i referohet një të drejte me karakter të shenjtë e të pacenueshëm siç është e drejta e mendimit e besimit, të drejta këto që kanë ‘rëndësi metafizike’. në të gjithë, madje gjatë gjithë jetës, pyesim mbi arsyen e ekzistencës sonë, justifikimin e kësaj ekzistencë, fazat e zhvillimit, ekzistencën apo jo të një qenie të mbinatyrshme, vazhdimësinë, e kështu me radhë. Neni ka të bëjë me *kërkimin individual për të vërtetën dhe kuptimin e jetës*. Ky lloj aktiviteti është një aktivitet i lidhur më shumë me ndërgjegjen njerëzore dhe me *dëshirën për ta parë botën me sy individualë* dhe ashtu si vetë individi e percepton bazuar në inteligjencën e tij apo njohuritë që zotëron. Si e tillë, kjo e drejtë është ngushtë e lidhur me të gjitha aspektet e zhvillimit njerëzor.**

Ky nen prek një çështje e cila në vetvete nuk është problematike dhe, në fakt, për të nuk ka pasur shumë ankesa pranë Komitetit të të Drejtave të Njeriut në Kombet e Bashkuara. Problemi me këtë nen fillon atëherë *kur individëve u imponohet një besim i caktuar, atëherë kur sistemi ligjor i një vendi vendos një normë të përgjithshme e uniforme në lidhje me çështjen e besimit*. Pra, problemi i vërtetë në lidhje me këtë të drejtë nuk ka të bëjë me thelbin e së drejtës si e tillë, me gjendjen e brendshme mendore dhe me krijimin e një besimi të caktuar, por me rastin kur shfaqet, kur shprehet dhe kur mendohet se duhet të shprehet në bashkëveprim me të tjerët kjo e drejtë. Ai bëhet problem ngaqë është i lidhur ngushtë me një tjetër të drejtë të njeriut: atë të shprehjes dhe të organizimit. *Liria e besimit, e fesë është një e drejtë e cila nuk mund të konsiderohet e realizuar nëse nuk garantohet edhe liria e shprehjes apo edhe e organizimit*.

Neni 18 pra ka lidhje të ngushtë me nene të tjera të DUDNJ-së. Kjo lidhje nuk qëndron vetëm në *aspektin e realizimit të plotë të së drejtës së besimit, mendimit, apo bindjes, por edhe në aspekte të kufizimeve të mundshme*. Kështu, p.sh. sipas DUDNJ-së, neni 26, prindërit mund të përcaktojnë zgjedhjet e bindjet si dhe arsimimin e fëmijëve. Pra, liria e besimit nuk është krejtësisht në zgjedhjen e lirë të individëve, sepse individi mund në një shkallë të madhe të orientohet në zgjedhjet e bindjet e tij nga familja e tij, aspekt i rëndësishëm ky i të drejtës për të krijuar e pasur një familje.

### Aspekte edukative

Në Kushtetutën e Shqipërisë, liria e ndërgjegjes dhe e fesë garantohet qartë bashke me lirinë e zgjedhjes dhe ndryshimit të fesë apo bindjes si dhe shfaqjes së tyre individualisht apo në bashkësi me të tjerët. Kushtetua e vendit tonë respekton maksimalisht DUDNJ-në në garantimin e lirisë së besimit.

Komentoni të drejtat e qytetarit që burojnë nga neni 24 i Kushtetutës së Shqipërisë:

#### **Neni 24 i Kushtetutës garanton:**

lirinë e fesë dhe besimit

lirinë e zgjedhjes së fesë e besimit

lirinë e ndryshimit të fesë apo bindjes

shfaqjen individualisht apo në kolektiv të besimit apo fesë

shfaqjen në publik apo jetën private të fesë apo besimit  
lirinë e praktikimit të fesë e besimit nëpërmjet kultit, armimit, praktikave apo  
kryerjes së riteve  
se ndalohet kufizimi apo detyrimi i pjesëmarrjes në një bashkësi fetare apo  
praktikimin e saj  
se ndalohet kufizimi apo detyrimi i bërjes publike të bindjeve apo besimit.

(Duhet vënë re që ky nen nuk vendos dhe nuk kërkon barazi të feve. Neni i lë hapësira individëve të besojnë në cilëndo fe, apo edhe të mos besojnë në to. Duke qenë i tillë ai e lë në hapësirën e barazisë së feve, sepse asnjë besim apo bindje nuk mund të jetë më e rëndësishme se tjetra).

*A ka detyrim shteti në bazë të këtij neni të ndahet nga besimi fetar dhe organizmin e tij ta bazojë apo të mos bashkohet me besimin fetar?*

Në fakt neni 18 nuk përmend asnjë detyrim të tij. Shteti është i lirë sipas këtij neni të njohë një fe të caktuar si fenë që beson thellësisht dhe të veprojë. Këtë mund ta bëjë duke mbështetur në këtë fe, duke mbështetur një shkollë fetare, apo edhe duke ofruar udhëzime të caktuara fetare në një shkollë publike. Shteti një kufizim të shkruar në lidhje me këtë nuk e ka. Por, ajo që është shumë e rëndësishme e shteti duhet të mbajë parasysh dhe të respektojë, edhe nëse zgjedh të ketë një fe të vetën ‘të preferuar’, është respektimi i lirisë së opinionëve dhe lirisë së besimit. Një shtet nuk mund t’i imponojë individëve një besim të caktuar dhe nuk duhet pra të indoktrinojë individët në lidhje me zgjedhjet e tyre të besimit. Mos harroni që shteti Shqiptar është një shtet laik e shteti është asnjëherë në çështjet e besimit dhe të ndërgjegjes. Po kështu, shteti shqiptar garanton lirinë e shprehjes së besimit e ndërgjegjes në jetën publike.

Përshkruani detyrimet që i dalin shkollës nga neni 10 i Kushtetutës së Shqipërisë:

#### **Neni 10 i Kushtetutës**

s’ka fe zyrtare në Shqipëri (shteti nuk ‘preferon’ ndonjë fe të caktuar)  
ka asnjëherë të shtetit në çështjet e besimit e ndërgjegjes  
garantohet liria e shprehjes së besimit e ndërgjegjes edhe në jetën publike  
bashkësitë fetare njihen nga shteti si të barabarta, pra trajtohen njësoj prej tij  
bashkësitë fetare janë të pavarura në organizmin e veprimtarinë e tyre  
bashkësitë fetare e shteti respektojnë pavarësinë e njëri-tjetrit  
bashkësitë fetare e shteti bashkëpunojnë në të mirë të secilit e të gjithëve  
bashkësitë fetare me organizmin e veprimtaritë e tyre nuk cenojnë interesat e të tjerëve

*C’дини mbi aktet e tjera ndërkombëtare që garantojnë këtë të drejta si:*

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike: N. 18. E drejta e besimit, bindjes e ndërgjegjes gjendet e garantuar në një nen me të njëjti numër si neni i DUDNJ-së, por neni 18 i PNDKP përfshin jo vetëm përmbajtjen e nenit 18 të DUDNJ-së, por edhe përmbajtjen e nenit 26 (3) të DUDNJ-së si dhe të nenit 29(3) të saj.



Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial: neni 5.

Konventa e UNESCO-s kundër Diskriminimit në Edukim: ndalon diskriminim në bazë të fesë dhe mendimit politik apo tjetër: neni 1 si dhe nenin 5

Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës Nr. 11: Neni 1 ndalon diskriminimin në marrëdhëniet e punës mbi baza të fesë

Deklarata mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Jotolerancës dhe Diskriminimit të Bazuar në Fe apo Besim:

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve: Neni 14

KEDNJ: Neni 9(1) si dhe Protokolli 1

**Diskutoni termat** mendim, besim, e ndërgjegje.

Ndajeni klasën në dy grupe. Njëri grup është i tillë ku individët nuk mund të mendojnë apo besojnë atë që dëshirojnë. Përcaktoni një person si drejtues të grupit dhe ai vendos për atë që do të mendojë grupi. Në grupin e dytë individët janë të lirë të besojnë atë që duan të besojnë. Pasi i lini të diskutojnë për një periudhë të caktuar kohe, mblidhni nxënësit dhe pyetini se si u ndjenë në grupet e tyre. Organizoni një diskutim të lirë në lidhje me situatën.

Diskutoni çështje të besimit në situatat e mëposhtme:

Në shtetin e Finlandës parashikohej që një orë mësimore të ishte mbi fenë katolike ose për ata që nuk ndiqnin këtë besim kjo orë të zëvendësohej me një orë historie feje dhe etike. E.J., besimtar Protestant, kish djalin e vogël që ndiqte shkollën publike në të cilën ai detyrohej të mësonte mbi historinë e fesë dhe etikën. E.J. pretendon se një stisë e tillë është shkelje e lirisë së besimit, sepse një gjë e tillë ish përgatitur për t'i ofruar informacion me karakter fetar nxënësve, madje edhe librat për këtë shkollë ishin shkruar nga persona besimtarë të fesë katolike.

Shtetas Kanadez D.J., që jeton në provincën e Ontarios, është baba i dy fëmijëve të vegjël të cilët ndjekin shkollën. Ky shtetas ndjek besimin çifut dhe të dy fëmijët e tij i ka regjistruar në një shkollë private të besimit Çifut dhe për shkollimin e tyre paguan një shumë të konsiderueshme vjetore. Në provincën e Ontarios të vetmet shkolla që marrin mbështetje të drejtpërdrejtë financiare nga shteti janë shkollat romano-Katolike. Këto shkolla janë të hapura për këdo. D.J. pretendon se ai paguan një shumë jo të vogël për shkollim e fëmijëve të tij ndërkohë që ai paguan edhe të gjitha taksat e tatimet një pjesë e të cilave shkojnë për të mbështetur financiarisht një shkollë drejtimi fetar i së cilës ishte kreu i ndryshëm nga ai që dëshironte D.J. t'i jepte fëmijëve të tij.

Diskutoni a përbën një trajtim i tillë i diferencuar mes mbështetjes financiare të një shkolle me karakter fetar dhe publike, e hapur për do, dhe një shkolle e besimit çifut, private shkelje të lirisë së besimit?

Diskutoni për qëndrimet ndaj sjelljes së simboleve të besimit në shkollë. Argumentoni qëndrimet tuaja ndaj vajzave myslimane të mbuluara me shami, ndaj fëmijëve katolikë e ortodoksë që vijnë në shkollë me kryq.

Diskutoni rreth përfaqësimit të informacionit mbi fetë në kurikul.

Zbuloni vlera të përbashkëta të edukimit moral me edukimin fetar.

Argumentoni nëse mësimi i fesë do të lehtësonte edukimin qytetar demokratik të nxënësve në shkollë.

Kujtoni situata ku ju është dashur të trajtoni konflikte mes nxënësish me bazë intolerancën fetare. Përshkruani së c'keni ndjerë brenda jush!

Identifikoni strategji përmes të cilave mund të trajtoni stigmatizimit fetare mes nxënësish.

### **Neni 19.**

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.

### Trajtim ligjor

Liria e mendimit dhe shprehjes është ndoshta liria më e njohur në botë. Sipas një studimi të vitit 1978, nga 142 kushtetuta të botës 124 prej tyre e njihnin këtë të drejtë, pra 87.3 përqind, ndërkohë që ndonjë e drejtë tjetër nuk njihet kaq shumë si p.sh. ndalimi i torturës apo trajtimi jonjerëzor apo degradues njihet vetëm nga 66 prej kushtetutave, pra 46.5 përqind.<sup>9</sup>

Liria e mendimit dhe shprehjes është parashikuar në shumë akte ndërkombëtare, të miratuara si para DUDNJ-së ashtu edhe pas saj. Liria e mendimit dhe shprehjes ka qenë parashikuar në dokumente të vjetër mbi të drejtat si p.sh. Karta e të Drejtave të Anglisë (Bill of Rights) e vitit 1688, në të cilën theksohej e drejta e fjalës dhe debatit apo diskutimit në Parlament dhe madje në këtë Kartë u përfshi një doktrinë shumë e rëndësishme në lidhje me lirinë e fjalës, apo e shprehjes nga individit të mendimit apo gjykimit të vet dhe e mos cënimit për shkak të këtij gjykimi. Kjo sepse njeriu nuk mund të jetë shprehës i asnjë gjykimi përveç se atij të vetit. Më tej, mund të përmendet Deklarata Franceze e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit e vitit 1789 (e revolucionit liberal/borgjez Francez) në nenin 11 të së cilës theksohej se këmbimi i mendimeve e opinionëve është një ndër të drejta të më të çmuara për njeriun dhe mundëson që çdo qytetar të flasë, shkruajë apo botojë lirisht, dhe të jetë përgjegjës për keqpërdorimin e kësaj të drejte. PO kështu, në Amendamentin e Parë të Kushtetutës së SHBA-së thuhet se ndalohet çdo ligj i Kongresit i cili ndalon apo shkel lirinë e fjalës, apo të shtypit. Për të kaluar edhe në një shembull të një konvente rajonale, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut në nenin 10 thekson se çdo njeri ka lirinë e të shprehurit të opinionëve, përfshirë këtu zotërimin e mendimeve marrjen dhe dhënien e informacioneve dhe ideve pa ndërhyrjen nga autoritetet shtetërore dhe pavarësisht kufijve.

Thënë thjeshtë, neni 19 i DUDNJ-së na mundëson të themi atë që mendojmë, duke theksuar që ne të gjithë kemi të drejtën të arrijmë vetë në konkluzione, të mendojmë atë që na pëlqen, të themi ç'mendojmë, dhe të ndajmë mendimet apo idetë tona me të tjerët. Gjithashtu neni 19 thekson aspekte të rëndësishme të kësaj lirie siç është liria për të kërkuar, marrë informacion dhe për t'u informuar nga të tjerët. Pra, neni 19 përfshin disa liri apo të drejta:

lirinë e mendimit

lirinë e shprehjes

mosndërhyrje në ushtrimin e lirive të mësipërme

<sup>9</sup> Hence van Maarvseveen & Ger van der Tang, *Ërritten Constitutions: a computerized comparative study*, [Kushtetutat e shkruara: një studim krahasues i kompjuterizuar], 1978.

lirinë e kërkimit  
të drejtën e dhënies së informacionit,  
të drejtën e marrjes së informacionit  
të drejtën për t'u njoftuar për informacionin

PO kështu, neni 19 thekson se këto liri apo të drejta të përfshira në të, mund të ushtrohen pavarësisht nga kufijtë fizikë, gjeografikë apo edhe ato ideologjikë. Po kështu, njerëzit mund të përdorin mjete nga të ndryshmet për të shprehur këto liri apo të drejta.

#### *Liria e mendimit dhe e shprehjes*

Së pari, Neni 19 njuh dhe deklaron atë që është shumë e rëndësishëm për njerëzit, atë që ata janë krejtësisht të lirë të krijojnë mendimet e tyre. Sigurisht do të ishte absurde të mendohej se mund të mos jenë individët të lirë të mendojnë atë që duan të mendojnë, kjo sepse çdo lloj ndërhyrje do ishte e pavlerë, e paefektshme. Nuk mund të kontrollosh mendjen e asnjërit, duke ditur që procesi i të menduarit apo krijimit të ideve është një proces krejtësisht i brendshëm e njeriut. Në lidhje me këtë çështje është menduar gjithmonë që kështu duhet të jetë. Ndërkohë çështje ka qenë ajo e shprehjes së mendimit që bart individi në vetvete. Këtu mund të lindin probleme dhe ka pasur diskutime dhe kufizime madje jo të pakta në kohë të ndryshme e për çështje të ndryshme.

E drejta e shprehjes e thënë ndryshe është ajo e të bërit të ditur të ideve apo mendimeve. Ajo është një e drejtë e njeriut e cila sigurisht lidhet ngushtë me lirinë e mendimit por shkon përtej saj, sepse ka të bëjë me shfaqjen e mendimit tek personat e tjerë, në publik. Liria e shprehjes presupozon që mendimin e brendshëm individi ka mundësi ta shprehë apo thotë lirshëm ashtu siç e ka krijuar për së brendshmi. Kjo do të thotë që njeriu është i lirë të flasë atë që mendon. Sigurisht që jo gjithmonë ajo që thuhet nga një njeri pëlqehet nga të tjerët apo edhe nga vetë shteti. Ka raste kur ato që thuhet janë mendime apo ide të tilla që shkelin dinjitetin e dikujt tjetër, që mund të bëjnë thirrje për luftë, që nxisin urrejtjen, që promovojnë vlera aq të ulëta për shoqërinë, që kanë një vlerë të ulët morale, që nuk janë në përputhje me moralin shoqërisë e kështu me radhë. Në të tilla raste, liria e shprehjes mund të kufizohet. DUDNJ nuk thekson që liria e mendimit dhe shprehjes janë të pakufizueshme. Sigurisht ato, në përputhje me Nenin 29 të DUDNJ-së mund të kufizohen.

Liria e shprehjes nuk do të thotë vetëm që njeriu ka të drejtën të flasë atë që mendon lirisht. Kjo sepse njeriu nuk shpreh atë që mendon vetëm nëpërmjet fjalës, edhe pse fjala është ndoshta mënyra më e zakonitë për të shprehur mendimet. Sigurisht njeriu përdor mënyra nga më të ndryshmet për të shprehur atë që mendon, pra për të transmetuar mendimet tek të tjerët. Por, njeriu përdor edhe mënyra të tjera, si botimet, shprehjet konvencionale, të qenit pranë dikujt qoftë një grupi edhe pa shprehur me fjalë apo me të shkruar apo me konvencione mbështetjen për një ide apo mendim të caktuar, e kështu me radhë. DUDNJ duke garantuar të drejtën e shprehjes garanton edhe të drejtën për të botuar apo bërë të ditur mendimet që një individ ka tek të tjerët. DUDNJ jo më kot është e gjerë në përcaktimet që bën për mënyrën se si individi e shpreh mendimin apo idetë e tij, duke theksuar se shprehja e mendimit mund të realizohet me çdo lloj mjeti dhe pavarësisht kufijve. Neni 19 i DUDNJ-së ka pasur një version përgjatë hartimit sipas të

cilit përcaktoheshin mënyrat e shprehjes si diskutimi publik, përdorimi i medias, demonstrimet paqësore apo forma të tjera të shprehjes si shkrimet, botimet etj. Të gjitha këto pa dyshim që janë mënyra të shprehjes së njerëzve, por DUDNJ u kujdes që edhe nëse njerëzimi zhvillon mënyra të tjera shprehje ato do të konsiderohen po aq të ligjshme e do të garantohen sa edhe mënyrat tradicionale të shprehjes. Kështu p.sh, interneti apo telefonia celulare janë të tilla. Teksti jo më kot nuk përfshiu situata specifike të shprehjes së mendimit e ideve, për t'i lënë hapësirat e nevojshme njerëzve të shprehen.

Duhet thënë se liria e mendimit dhe e shprehjes janë të drejta themelore në një demokraci. Nëse individët nuk kanë të drejtën të mendojnë e thonë atë që mendojnë, demokracia nuk do të funksionojë. Nuk do të kishim një qeverisje të lirë e që reflekton mendimet e individëve që jetojnë në një shtet nëse nuk do të kishim liri fjale e shprehje. Në vendin tonë, para vitit 1990, nuk ekzistonte liria e fjalës dhe e shprehjes, sepse nëse dikush shprehej kundër mënyrës së qeverisjes ai dënohej rëndë (për agjitacion e propagandë) dhe madje jo vetëm ai por edhe familja e tij. Qeverisja në vendin tonë gjatë sistemit socialist nuk ka qenë një qeverisje demokratike.

### *E drejta e informimit*

E drejta për të pasur informacione është e drejtë themelore e njeriut. Kjo e drejtë edhe pse e njohur në shumë vende, mund të jetë e referuar me terma të ndryshëm, si p.sh.: e drejta për informacion, liria e informimit, e drejta për të ditur dhe të pasur akses në informacion, etj. Aksesit në informacion mund të shihet si një e drejtë elitare, apo si e dajret e cila është me interes për median elektronike apo të shkruar, apo për kërkuesit kryesisht. Sigurisht që këto kategori të shoqërisë mund të kenë një interes të veçantë për informacionet për shkak të natyrës së profesionit të tyre, por kjo e drejtë është po aq e rëndësishme për këdo. Neni 19 parashikon edhe të drejtën për të kërkuar dhe dhënë informacion lirisht, nëpërmjet çdo lloj mjeti e pavarësisht kufijve. Kjo e drejtë duhet kuptuar qartë që përfshin:

të drejtën për të kërkuar informacionin apo idetë  
të drejtën për të marrë informacionin apo idetë  
të drejtën për të transmetuar informacionin apo idetë

Këto të drejta realizohen nëpërmjet mjeteve nga më të ndryshmet, që përfshijnë fjalimet e lira në publik, median e shkruar dhe atë elektronike, tashmë edhe mjete të tilla si interneti, transmetimi nëpërmjet telefonisë celulare, dhënien e informacionit nëpërmjet simboleve të ndryshme konvencionale, apo nëpërmjet dhënies së kopjeve të dokumenteve, e kështu me radhë. Po kështu, ky informacion duhet të transmetohet edhe nga një vend në tjetrin, nga një pjesë e botës në tjetrën. Personat që e hartuan DUDNJ-në dhe që parashikuan këtë lloj sigurimi të së drejtës për informim, kanë qenë shumë mendje hapur duke parashikuar që njerëzit përherë e më shumë i intensifikojnë marrëdhëniet me njëri-tjetrin, që individët nuk qëndrojnë vetëm në shtetin shtetas të të cilit ato janë, që njerëzit duhet të shohin dhe të dinë se çfarë ndodh në një shtet apo tjetër të botës, duke lejuar kështu gazetarët e një vendi të shkojnë në një tjetër për të marrë lajme mbi atë që po ndodh atje e kështu me radhë. Kështu, DUDNJ vërtet është hartuar si një dokument i cili është aq i gjerë sa të mund ti qëndrojë kohës dhe zhvillimeve që ajo sjell.

DDUNJ kryesisht merakoset për të garantuar që individët të informohen mbi mënyrën se si ato qeverisen. Pra, kur flitet për të drejtën për t'u informuar, flitet kryesisht për të drejtën për të marrë informacion nga organet shtetërore. Baza e këtij vështrimi është që informacioni që mban shteti është pronë e publikut. Qeveritë janë shërbyesit e popullit dhe jo padronët e tij. Pra, informacioni që ata kanë i përket me të drejtë të gjithëve. Kjo e drejtë shndërrohet në një mjet të rëndësishëm për kontrollin e politikave të shtetit dhe ndikimin në ndryshime efektive të tyre, përfshirë këtu edhe garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo e drejtë ka shume avantazhe, përfshirë këtu:

eksponon korrupsionin, duke e bërë qeverisjen më eficiente: mendoni se sa e rëndësishme është të mund të kontrollojmë nëse personat që punojnë në administratën publike t'i dimë kush janë dhe të kemi mundësi të shohim vendimmarrjet e tyre nëse janë apo jo sipas ligjit dhe nuk favorizojnë në subjekt apo një tjetër për interesat vetjake

mund të zbulojë menaxhime të këqija të burimeve të natyrës apo njerëzore të cilat mund të çojnë në përkeqësim të situatave: mendoni situatën e menaxhimit të energjisë elektrike apo të burimeve të ujit ë pijshëm në vendin tonë dhe sa e rëndësishme është që ne të mund të marrim informacion për mënyrën si qeveria qendrore apo vendore i ka menaxhuar këto burime

mund të bëjë publike dhe shkelje apo abuzime të mundshme apo të ndodhura të të drejtave të njeriut.

mund të rrisë pjesëmarrjen e publikut në qeverisjen dhe zhvillimin e vendit: është shumë e rëndësishme për ne të gjithë të mund të marrim pjesë në qeverisje duke ndikuar kështu që zgjedhjet politike të bëhen sa më pranë interesave tona, dhe të mos e përfundojmë ndikimin tonë në të vetëm me hedhjen e votës në kutinë e votimit.

Megjithatë, pavarësisht nga sa u tha më lart, kjo e drejtë është e tillë që përfshin edhe detyrimin e privatëve kur ato kanë informacione të caktuara t'i bëjnë të ditura për publikun. Kështu, për shembull pavarësisht se transporti urban brenda një njësie të qeverisjes vendore si p.sh. bashkia mund të realizohet nga një person privat, ky person, për shkak se shërbimi që ai ofron është në interes të publikut të gjerë, të gjithë informacionin mbi mënyrën se si organizon dhe drejton këtë shërbim duhet ta ketë të hapur për do. po kështu, publiku duhet të ketë të drejtën të marrin informacion edhe nga kompanitë private nëse kjo është e nevojshme për realizimin e të drejtave të tyre.

Aksesi dhe shpërndarja e informacionit është shumë i rëndësishëm për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo sepse duke pasur të drejtën të marrësh e kesh akses në informacione të ndryshme mundesh të mbledhësh të dhëna, dhe mbash statistika për shkeljet e ndryshme të të drejtave të njeriut, botosh raporte mbi rregullat dhe praktikat e të drejtave të njeriut dhe kështu të kesh mundësi të kontrollosh qeverisjen dhe të ndikosh në një qeverisje më të mirë, si dhe të ndikosh për realizimin e të drejtave të të tjera të individit.

*A përfshihet në nenin 19 edhe e drejta për të pasur një radio apo televizion?*

Liria e shprehjes sipas nenit 19 garantohet nëpërmjet mjeteve nga më të ndryshmet, e nëpërmjet çdo lloj media, qoftë kjo e shkruar apo elektronike. Pra, njerëzit mund të transmetojnë apo bëjnë publike mendimet e tyre jo vetëm nëpërmjet të shkruarit por edhe nëpërmjet transmetimeve televizive apo valëve të radios. Kjo do të thotë që shteti duhet

të garantojë individët që të kenë akses në një radio apo televizion dhe të kenë të drejtë madje të kenë një radio apo televizion të vetën. Në fakt, kjo çështje është pak më e komplikuar se sa ajo e transmetimit të ideve apo mendimeve nëpërmjet fjalës apo të shkruarit. Kjo sepse njerëzit të gjithë flasin, ose shumë prej tyre mund të shkruajnë për shkak të një niveli shkollimi që të gjithë gëzojnë falë edhe programeve të arsimit të shtetit (madje kjo është një e drejtë njeriut më vete e përfshirë në DUDNJ), por jo të gjithë kanë mundësi të transmetojnë idetë apo mendimet nëpërmjet radios apo televizionit. Kjo sepse jo çdo kush mund të zotërojë një radio apo televizion, ashtu siç zotëron fjalën apo ndoshta të shkruarin. Ekzistenca e një radio apo televizioni ka qenë deri vonë një çështje e cila kërkonte shfrytëzimin e një të mire natyrore siç janë valët radio-televizive. Këto të fundit janë të kufizuara dhe deri vonë shtetet e kësaj toke i kishin ndarë ato mes tyre, si për të bërë një ndarje të së mirës së përbashkët. Pra, një shtet mund të kishte mundësi të kufizuara për të pasur vetëm disa radio e televizione në territorin e tij. Kjo do të thotë që jo çdo kush në shtetin përkatës mund të kishte një radio apo televizion. Dhe kështu, shtetet kanë kritere të caktuara që të lejojnë një individ apo grup individësh të kenë një radio e televizion. Madje edhe ato që e kanë disa kufizime, pra janë të detyruar të respektojnë disa kufizime që shteti u vë për ato që duan të shprehin apo transmetojnë tek publiku nëpërmjet televizionit apo radios. Megjithatë sot për shkak të zhvillimit të teknologjisë janë gjetur mundësi të ekzistencës së një televizioni pavarësisht atyre valëve radio-televizive që janë të kufizuara. Dhe kështu, edhe çështja e kufizimeve që vë shteti për transmetimet radio-televizive sot është shumë më e debatueshme.

#### *Garantimi i lirisë së mendimit dhe shprehjes nga shtetet*

DUDNJ duke përcaktuar si liri atë të mendimit dhe të shprehjes kërkon që shtet përkatës të i garantojnë ato. Kjo do të thotë që shtetet përkatëse të marrin masa që të mos kufizohen njerëzit të flasin lirshëm, të shkruajnë apo botojnë atë që mendojnë, madje edhe të shohin e të kenë akses në median elektronike lirshëm.

Të shprehesh do të thotë të kesh mundësinë të përdorësh ndonjë nga mjetet e të shprehurit. Njerëzit kanë fjalën si mjetin bazë për t'u shprehur dhe kjo mënyrë zakonisht është në duart e të gjithëve. Fjala është e para që lind me njeriun dhe njeriu e mëson natyrshëm nga prindërit dhe kushdo tjetër që e rrethon individin.

Ndërkohë, të shprehesh nëpërmjet të shkruarit sose do duhet të dish si të shkruash dhe për këtë nevojitet një shkollim i caktuar ose do duhet të përdorësh dikë tjetër për të shkruar një ide nëpërmjet të shkruarit, një person i cili zotëron një nivel shkollimi të caktuar. Sigurisht këtu vjen detyrimi i shtetit që të garantojë shkollimin e individëve. DUDNJ madje kërkon që arsimiti i njerëzve të jetë i detyrueshëm, duke e konsideruar atë një të drejtë themelore të tyre. Gjithashtu shtetet duhet të mos censurojnë botimet pra të mos pengojnë njerëzit që të botojnë mendimet apo idetë e tyre.

Gjithashtu, shteti duhet të garantojë edhe që individët të mund të transmetojnë nëpërmjet radios e televizionit. Por, për shkak se valët radio-televizive janë të kufizuara, shteti vendos shumë më tepër kufizime në lidhje me këtë mundësi të të shprehurit të individëve se sa me mënyrat e tjera.

Garantimi i lirisë së mendimit dhe shprehjes pra herë kërkon që shteti të mos ndërhyjë, e herë që të ndërhyjë. Kështu p.sh. shteti duhet të mos pengojë njerëzit të thonë fjalën e tyre, të shprehen si dëshirojnë, të shkruajnë apo botojnë atë që mendojnë, siç edhe kërkon që shteti të mundësojë arsimimin e njerëzve, të lejojë transmetime private radio e televizive, e kështu me radhë.

*Aktet ndërkombëtare që garantojnë lirinë e mendimit dhe të shprehjes:*

Siç u tha që në fillim, ka shumë akte ndërkombëtare që garantojnë lirinë mendimit dhe të shprehjes, që përfshijnë si dokumentet që janë përmendur tashmë ashtu edhe të tjerë, ndër të cilët mund të përmendim:

PNDKP, në nenin 19 të saj parashikohet e njëjta liri, edhe pse në nenin 19 të PNDKP parashikohen edhe kufizimet të cilat në DUDNJ janë në një tjetër nen

Konventa mbi Genocidin: ndalon shprehimisht nxitjen e gjenocidit, pra është një parashikim i cili kufizon lirinë e të shprehurit nëse shprehja nxit krimet kundër njerëzimit KEDNJ: neni 10 i saj parashikon lirinë e të shprehurit, marrjen e informacionit, etj.

*Garantimi i kësaj lirie në vendin tonë*

Në Kushtetutën e vendit tonë Neni 19 i DUDNJ-së reflektohet në disa nene. Kështu, në nenin 22 garantohet liria e shprehjes, e shtypit, e radios dhe e televizionit. Në nenin 23 garantohet drejta e informimit, ashtu siç garantohet edhe e drejta e informimit për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij në nenin 56 të Kushtetutës si një e drejtë që garanton informacion për një gjendje shumë të veçantë siç është ajo e mjedisit. Po kështu, neni 58 garantojnë lirinë e krijimit artistik dhe kërkimit shkencor. Për të garantuar këtë të drejtë në vendin tonë janë miratuar ligje të posaçme, siç është Kodi i Procedurave Administrative i cili kërkon që të gjitha organet e administratës Publike të jenë transparente dhe të informojnë në lidhje me vendimmarrjet e tyre. Po kështu, është miratuar një ligj mbi të drejtën për t'u informuar mbi dokumentet zyrtare të organeve të administratës publike, Ligji Nr. 8503, "Mbi të Drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", datë 30.6.1999.

### ***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë***

#### **Neni 22**

Liria e shprehjes është e garantuar

Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar

.....

#### **Neni 23**

E drejta e informimit është e garantuar.

.....



*ARTICLE 19 – Organizatë ndërkombëtare në mbrojtje të të lirisë së mendimit e shprehjes*

Për shkak të rëndësisë së nenit 19 të DUNDJ-së, në vitin 1987, u krijua *ARTICLE 19*, një organizatë ndërkombëtare, me bazë në Britaninë e Madhe dhe me personel ndërkombëtar në Afrikë, Amerikën Latine dhe Kanada. Kjo organizatë është e mirënjohur në botë dhe ajo vëzhgon se si kjo liri respektohet e garantohet në shumë vende të botës. Sipas kësaj organizate, gëzimi i plotë i kësaj lirie është forca më e madhe për të parandaluar represionin, konfliktet e luftërat, dhe është thelbësore për të arritur liritë individuale dhe zhvilluar demokracinë.

#### Aspekte edukative

Diskutoni termat “**mendim**” e “**shprehje**”. Tregoni situata nga puna e përditshme në shkollë kur jeni ndjerë të frustruar për shkeljen e të drejtës së mendimit dhe shprehjes.

Kërkojini nxënësve të sjellin shembuj nga njerëz që shprehen lirisht, shembuj që mund t’i marrin nga jeta politike, gazetatat apo nga jeta.

Kërkojini të mendojnë e diskutojnë se përse është më mirë të kesh të drejtë të shprehesh lirisht.

Diskutoni mbi dimensionin e të drejtës së mendimit dhe shprehjes në situatat e mëposhtme:

a. “Një shkrimtar ka përgatitur një libër i cili është shtypur dhe është gati të shpërndahet. Libri është menduar për fëmijët e shkollave deri në të mesme. Libri i jep atyre informacione në lidhje me seksin duke përfshirë seksione mbi përkëdheljet, penetrimin, masturbimin, kontraktivët, menstruacionet, ngacmuesit e fëmijëve, pornografinë, sëmundjet seksuale, abortin dhe mënyrat e tij. Libri ofronte edhe adresa ku mund të kërkohej ndihmë në lidhje me çështje të ndryshme seksuale. Gjithashtu libri nxit fëmijët të jenë vetvetja, e të mos ndihen të turpëruar për atë që janë, të bëjnë ato që pëlqejnë. Para se të shpërndahej ndaj botuesit nisi një çështje penale për shkak të shpërndarjes së informacioneve të turpshme dhe libri u sekuestrua.

Diskutoni a mund të pretendojë shkrimtari dhe botuesi se kanë të drejtën e tyre të shprehjes dhe se botimi nuk duhet të sekuestrohet?

b. A-ja, anëtar i një partie politike, kandidon për t’u zgjedhur si deputet për në parlament. Në gazetën X botohet një shkrim i gjatë për të, i cili trajton aspekte të ndryshme të jetës së tij private dhe politike si dhe historik të angazhimeve të tij përgjatë jetës. Në shkrim gazetari B flet edhe për të kaluarën e errët të kandidatit si bashkëpunëtor i flaktë i regjimit komunist dhe që ka kryer veprime monstruoze kundër njerëzve të ndryshëm. Artikulli

përfundonte me një kritikë në përgjithësi për partitë politike që kishin në anëtarësinë e tyre edhe persona të cilët nuk duhet më të angazhoheshin aspak në politikë dhe aq më tepër të ishin kandidatë për në parlament. Kandidati A për deputet i kërkon prokurorisë të nisë çështjen penale ndaj gazetarit B për shkak të shpifjes dhe fyerjes së figurës së tij. A mundet gazetari B të kërkojë mbrojtjen që ofron liria e mendimit dhe e shprehjes?

c. Në një të përjavshme që boton shkrime të ndryshme mbi kompanitë privatë në qytetin X dhe produktet e tyre boton reagimi i një konsumatorëve të produkteve kozmetike të prodhuara nga kompania A. Shkrimi duke përdorur fjalët e konsumatores tregon që pasi ajo kish provuar produktet e kompanisë dhe kish mbetur krejt e zhgënjyer e me to i kish kthyer duke pretenduar rimbursimin e plotë të sasisë së parave që kish shpenzuar për blerjen e tyre, por s'kish marrë asgjë nga kompania. Të njëjtin shqetësim sipas të përjavshmes ndanin edhe dy konsumatorë të tjerë. Kompania ankohet në gjykatë se e përjavshmja i kish prishur imazhin dhe gjykata vendit vendos që e përjavshmja kish shkelur legjislacionin vendas mbi respektimin e imazhit të kompanive konkurrencte dhe e gjobiti të përjavshmen, madje ndaloi edhe botimin e të tilla komenteve. E përjavshmja ankohet duke pretenduar se ajo mbrohej nga liria e shprehjes. Në fakt, gjykata analizoi të gjithë situatën për të kuptuar nëse një shkrim i tillë vërtet shkelte ligjin apo jo, duke pasur parasysh edhe të drejtën e botuesit për të shprehur mendimin e vet në lidhje me produktet e një kompanie.

Jepni mendimin tuaj.

Në këtë rast Strasburgu vendosi që nuk ka shkelje të lirisë së shprehjes sepse gjykatat e vendit kishin bërë një punë të mjaftueshme për të balancuar të drejtat dhe se ligjet që ndalonin veprime që prishnin imazhin e një kompanie ishin të lejueshme të miratoheshin nga një shtet dhe se ishte në vlerësimin e këtij të fundit të miratoheshin rregulla të tilla.

d. Z. B dhe Znj. D. janë shtetas të shtetit X, Provincës në të cilën flitet gjuha franceze. Të dy këta persona janë njëri piktor dhe tjetri dizajnues dhe kanë hapur bizneset e tyre. Gjuha e nënës të të dy personave është anglishtja, ashtu si dhe ajo e shumicës së klientëve të tyre. Komisioni për mbrojtjen e gjuhës franceze, një institucion shtetëror i provincës, u ka dërguar të dyve paralajmërim për të mos përdorur gjuhën angleze për qëllimet e reklamimit të punës së tyre, konkretisht të vënë tabelën e reklamës jashtë ambientit ku kanë biznesin e tyre apo edhe në emrin e firmës së tyre. Atyre u është kërkuar edhe që brenda 15 ditësh të dërgojnë informacion me shkrim për masat që kanë marrë për të korrigjuar situatën dhe për të parandaluar që një incident ti tillë të ndodhë në të kaluarën. Që nga kjo letër të dy personat kanë hequr tabelat e reklamës, por ndërkohë pretendojnë se ky ndalim është shkelje e të drejtës për t'u shprehur.

Jepni mendimin tuaj.

Liria e mendimit dhe shprehjes është ndoshta liria më e njohur universalisht. Sipas një studimi të vitit 1978, nga 142 kushtetuta të botës 124 prej tyre e njihnin këtë të drejtë, pra 87.3 përqind, ndërkohë që ndonjë e drejtë tjetër nuk njihet kaq shumë si p.sh. ndalimi i troturës apo trajtimi jonjerëzor apo degradues njihet vetëm nga 66 prej kushtetutave, pra 46.5 përqind.<sup>10</sup> Kjo e drejtë është parashikuar në shumë akte ndërkombëtare, të miratuara

---

<sup>10</sup> Hence van Maarvseveen & Ger van der Tang, *Written Constitutions: a computerized comparative study*, [Kushtetutat e shkruara: një studim krahasues i kompjuterizuar], 1978.

si para DUDNJ-së ashtu edhe pas saj, përfshirë këtu Deklaratën Franceze të të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit, Amendamentin e Parë të Kushtetutës së SHBA-së, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Neni 19 i thënë me fjalë të thjeshta na mundëson të themi atë që mendojmë, duke theksuar që në të gjithë kemi të drejtën të arrijmë vetë në konkluzione, të mendojmë atë që na pëlqen, të themi ç'mendojmë dhe të ndajmë mendimet tona me të tjerët.

Aksesi dhe shpërndarja e informacionit është shumë e rëndësishme për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo sepse duke patur të drejtën të marrësh e kesh akses në informacione të ndryshme mundesh të mbledhësh të dhëna, dhe mbash statistika për shkeljet e ndryshme të të drejtave të njeriut, botosh raporte mbi rregullat dhe praktikën e të drejtave të njeriut dhe kështu të kesh mundësi të kontrollosh qeverisjen dhe të ndikosh në një qeverisje më të mirë.

e. Kërkojini nxënësve tuaj të sjellin shembuj nga persona që shprehen lirisht në lidhje me idetë e tyre, p.sh gazetarë, shkrimtarë, persona publikë. Diskutoni me nxënësit tuaj nëse është më mirë të shprehesh lirisht apo të mos kesh mundësinë të shprehësh mendimet.

f. Në shkollë ka një praktikë të mirë të kultivimit të mendimit të pavarur. Ndonëse ky është proces i rëndësishëm dhe objektiv i të mësuarit, mendimi krijues dhe kritik e i pavarur ndjehet i tradhtuar në kushtet e testeve masive për zgjedhje alternativash të saktë, për dhënie përkufizimesh në provime dhe teste kombëtare siç mund të jetë edhe matura shtetërore. Nxënësve u kërkohet të riprodhojnë, duke vënë në punë vetëm mekanizmin e kujtesës. Forma të tilla të vlerësimit për çështje madhore të fëmijëve duket se sabotojnë kultivimin e mendimit të lirë dhe të pavarur. Organizoni një debat mbi format e testimit dhe vlerësimit të arritjeve në shkollë. Si mund të inkurajohen dhe maten liria dhe pavarësia e mendimit?

E drejta e marrjes së informacionit është interesant të shikohet tek fëmijët. Kjo e drejtë është gjithnjë e më shumë duke u realizuar, po jo rrallëherë praktikën e konsiderimit të teksteve shkollë si mjete të fundme të informimit dhe zhvillimit ka bërë që fëmijët të handikapohen në nevojën për më shumë informacion. Forma të tilla inkurajojnë konformizmin dhe nënshtrimin, krijimin e opinioneve dhe besimeve pa nevojën e fakteve dhe të detajeve informative.

Diskutoni rreth hapësirave që u krijoni nxënësve në përdorimin e burimeve të informacionit.

**Neni 20.**

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor. Asnjëri nuk duhet të detyrohet të bëjë pjesë në ndonjë bashkim.

***Trajtim ligjor***

Liria për t'u mbledhur dhe bashkuar paqësisht me të tjerët është një prej lirive mjaft të rëndësishme për individin. Individ sigurisht nuk jeton i vetëm, por si pjesë e shoqërisë. Ai krijon mendime, qëndrime, interesa e reagime të përbashkëta me të tjerët me të cilët natyrshëm dëshiron të jetë pranë dhe të mbështet e t'i mbështesë në krijimin, formimin, shfaqjen, mbrojtjen e këtyre mendimeve, qëndrimeve, interesave apo reagimeve të përbashkëta. Kështu, për individët është shumë e rëndësishme të jetë të lirë të mund të bashkohen e mblidhen me të tjerë individë për të realizuar këtë aspekt po kaq të rëndësishëm të jetës që është të qenit pjesë e një tërësie individësh.

Për këtë është konsideruar që e drejta e individëve për të krijuar grupe, për t'u organizuar, për t'u bashkuar duhet të jetë një e drejtë e njeriut e cila duhet të jetë e garantuar dhe e mbrojtur për individët. Sigurisht që kjo liri nuk duhet parë vetëm si e rëndësishme për individët, por edhe për shoqërinë në tërësi dhe shtetin sepse individët duke u mbledhur e organizuar kanë mundësi të ndikojnë në mënyrën e qeverisjes, në përzgjedhjen e politikave të vendit, në zbatimin sa më mirë të këtyre politikave e kështu me radhë. Kështu, kujtoni protestat masive që kanë organizuar shqiptarët, kujtoni që grupe të ndryshme mblidhen e kërkojnë hapur në rrugë mbrojtjen e interesave të tyre, apo që njerëzit kanë krijuar shumë shoqata, apo që janë krijuar sindikata për të mbrojtur interesat e punonjësve, apo që individët lejohen të krijojnë parti politike për të shprehur, zhvilluar mbrojtur bindjet e tyre politike deh për të drejtuar vendin duke zbatuar ato, apo që nxënësit nëpër shkolla mund të mblidhen në qeveri nxënësish për të diskutuar e ndikuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe drejtimit të shkollës, e kështu me radhë.

***E drejta për t'u mbledhur paqësisht***

Kjo nënkupton që gjithkush mund të mblidhet së bashku me të tjerë, edhe pse ka një kusht që duhet plotësuar: mbledhja duhet të jetë për qëllime paqësore. Pra, nëse siguria publike dhe ajo kombëtare mund të vihen në rrezik nga ky lloj organizmi apo mbledhje e individëve, e drejta nuk mund të ushtrohet. Pra, mbledhja që do të çojë në përdorimin apo tregimin apo ushtrimin e dhunës nuk është e lejueshme nga kjo e drejtë. Zakonisht kjo e drejtë për t'u mbledhur kontrollon. Pra edhe pse njerëzit kanë të drejtë të mblidhen, zakonisht ato duhet të njoftojnë organet përkatëse në vend për ditën, orën, vendin e mbledhjes si për qëllimin e saj. Nëse këto organe çmojnë se kjo mbledhje e tyre vë në rrezik sigurinë kombëtare apo publike, nuk e lejojnë të ndodhë. Ndërkohë edhe nëse mblidhen individët, gjithmonë organet e mbrojtjes së rendit apo sigurisë kombëtare në vend janë të gatshëm të përdorin forcën nëse organizmi kalon kufijtë e të qenit paqësor. Gjithsesi, këto organe janë të detyruara që të përdorin forcën vetëm si mjet të

fundit dhe në proporcion me rrezikun që kanoset nga njerëzit e mbledhur dhe duke minimizuar rrezikun apo dëmin.

Kushtetuta e vendit tonë, në përputhje të plotë me DUDNJ-në, garanton në Neni 47 të saj lirinë e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe të pjesëmarrjes në to. Gjithsesi, Kushtetua parashikon edhe që kjo e drejtë duhet të realizohet në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj. Në respektim të Kushtetutës, janë miratuar një sërë ligjesh të cilat rregullojnë në detaje të drejtën për t'u mbledhur paqësisht, apo të tubimeve siç Kushtetuta jonë e quan.

### ***E drejta për t'u bashkuar***

Kjo do të thotë që individët mund të mblidhen së bashku dhe krijojnë shoqata apo qendra apo klube, pra organizata të ndryshme të tyre. DUDNJ është shumë e hapur në ushtrimin e kësaj të drejte në këtë nen, por vende të ndryshme kanë kufizuar këtë të drejtë në mënyra të ndryshme (edhe DUDNJ e lejon këtë me anë të nenit 29?? ku theksohet se të gjitha të drejtat e liritë mund të kufizohen). Kështu, ka raste kur organizata që është e themeluar nga njerëzit nuk njihet si person juridik me personalitet që të mund të veprojë lirisht, apo ka raste kur organizatave i vihen detyrime të mëdha financiare dhe ato nuk kanë mundësi kështu të ushtrojnë veprimtarinë, apo kur nuk lejohet krijimi i disa llojve organizatave si p.sh ai atyre me karakter nazist p.sh. Megjithatë pavarësisht gjendjeve të ndryshme në vende të ndryshme, DUDNJ kërkon që e drejta për të krijuar organizata të jetë e drejtë e të gjithëve pa kufizim dhe organizata të veprojnë lirshëm dhe pa ndikimin e të tjerëve.

Të gjithë individët janë të lirë të bashkohen apo jo me një organizatë të caktuar. Askush nuk mund t'i detyrojë ato të bëhen pjesë e saj, ashtu si askush nuk mund t'i detyrojë ato të mos largohen prej saj. Kështu, nëse marrim si shembull sindikatat, askush nuk mund të detyrohet të jetë pjesë e tyre apo të largohet prej tyre dhe çyshtë më e rëndësishme askush nuk mund të ketë pasojë në lidhje me të drejtat apo interesat e tyre për shkak të të qenit pjesë apo jo e organizatës.

Kushtetuta e vendit tonë, në **Nenin 46 garanton të drejtën e kujt do që të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm**. Parashikohet një kuadër ligjor i përgjithshëm për krijimin e këtyre organizatave, që njihen me mera shoqata, qendra apo fondacione. Kushdo, pra edhe nxënësit apo mësuesit mund të krijojnë organizata të tyre për të përmbushur një qëllim të vetin. Kështu p.sh. nxënësit e një shkolle mund të krijojnë një shoqatë të vetën e cila synon të kërkojë një shkollim sa më cilësor nga shkolli, apo edhe të krijojë sa më shumë aktivitete argëtimi dhe edukuese për vetë nxënësit, apo edhe t'i ofrojë në mënyrë të bashkuar komunitetit për qark shkollës. Që kjo shoqatë të funksionojë sa më mirë duhet që të regjistrohet në gjykatë.

Sigurisht që nxënësit dhe kushdo mund të organizohen edhe pa krijuar një shoqatë sepse DUDNJ dhe Kushtetua e lejon këtë. Dhe ky është edhe kuptimi më i mirë i mundshëm i së drejtës për t'u organizuar e mbledhur, por duhet gjithmonë që këto organizime të jenë të atilla që të realizojnë qëllime të ligjshme e të lejueshme. P.sh. nuk mund të organizohet e mblidhet askush që mbështetet në metoda totalitariste, që dëshiron të nxisë e përkrahë

urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdor dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe në mënyrë të fshehtë e që nuk deklaron janë të ndaluara sipas ligjit. Kjo sepse Neni 9 i Kushtetutës nuk e lejon këtë.

### ***E drejta për të krijuar parti politike***

E drejta për t'u mbledhur e organizuar pa dyshim përfshin edhe të drejtë për të krijuar parti politike. Kjo sepse partitë politike janë organizata të krijuara për një qëllim i cili është me karakter politik. Sipas Kushtetutës sonë, Neni 9, partitë politike krijohen lirisht. Kërkoheq që, si për të gjitha organizata, organizimi i tyre të përputhet me parimet demokratike. Për organizimin e partive politike në vendin tonë është miratuar një ligj i posaçëm.

### ***E drejta për të krijuar sindikata***

Ekzistenca e një organizate në vendin e punës është shumë e rëndësishme. Kjo sepse interesat e punonjësve mbrohen më lehtë kështu. Me anë të një organizate mund të arrihet më thjesht në miratimin apo pranimin e rregullave në interes të punonjësve. Një grup e ka më thjesht se një individ të arrijë miratimin e këtyre rregullave. Këtë e njeh edhe Kushtetua jonë e cila në nenin 50 parashikon që të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës. E drejta për të krijuar organizata në vendin e punës do të thotë që:

- të gjithë punonjësit janë të lirë të formojnë sindikata, të jenë pjesë e tyre, të bashkohen me to për të mbrojtur interesat e tyre ekonomike dhe sociale. E drejta do të thotë jo vetëm liri zgjedhje për të qenë anëtar apo jo por edhe liri largimi nga sindikata. Kjo e drejtë zbatohet për të gjithë punonjësit në përgjithësi edhe pse ka kufizime të tilla si p.sh. nëpunësit civilë

- *sindikatat vendase mund të organizohen nga ana e tyre dhe të krijojnë konfederata. është thelbësore për grupet vendase të ndërveprojnë me njëri-tjetrin në nivele më të gjera.*

- *individët pjesëtarë të sindikatave nuk ndëshkohen për shkak të anëtarësisë së tyre në të. Kjo do thotë që individët nuk kanë asnjë pasojë negative për shkak të anëtarësisë në sindikata.*

### ***E drejta për grevë***

*Greva është një shprehje e organizuar e pakënaqësisë nga kushteve të punës e punonjësve. Njihet edhe nga Kushtetua jonë, në nenin 51 të saj. Por duhet kuptuar që greva nuk është absolute, ashtu si nuk është absolute asnjë e drejtë tjetër. Sidomos në rastet e punonjëse publike mund të kufizohet e drejta e grevës. Ligji mbi shërbimin civil në Republikës e Shqipërisë parashikon që punonjësit civilë nuk mund të ushtrojnë të drejtën e grevës. Kjo është në përputhje edhe me Konventën Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Po kështu greva rregullohet edhe me ligj të veçantë.*

### **Dokumentet ndërkombëtare**

E drejta për t'u mbledhur dhe bashkuar është një e dajret e garantuar nga shumë dokumente ndërkombëtarë. Duhet vënë në dukje që ka një , kryesisht kjo e drejtë është zhvilluar më shumë në drejtim të marrëdhënieve të punës. Kombet e Bashkuara për hir të

rëndësisë së madhe që ka për njerëzimin puna, garantimi i saj, garantimi i një mjedisi pune sa më në mbrojtje të punonjësve, konsideruar edhe historinë e njerëzimit ku njerëzit detyroheshin të punonin për të tjerët, apo ku punonin për një kompani private trajtoheshin si të ishin shërbëtorët e tyre, krijoi Organizatën Ndërkombëtare të Punës e cila ka miratuar një sërë dokumentesh në mbrojtjet të punonjësve. ONP ka miratuar një sërë dokumentesh për këtë të cilat edhe vendi ynë i ka bërë pjesë të së drejtës sonë. Mund të përmendim ndër aktet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e përfshira në nenin 20:

Konventa mbi të drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore: Neni 8 garanton të drejtën për të krijuar sindikata, të drejtën për grevë,

Paktin ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile e Politike, neni 21 parashikon të drejtën për tu mbledhur paqësisht e neni 22 të drejtën për tu organizuar

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve: Neni 15 parashikon të drejtën e fëmijëve për të krijuar organizata dhe për tu mbledhur paqësisht

Parime Kryesore të KB-së mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Zbatuesit e Ligjit: dokumenti parashikon që policia nuk duhet të ndërhyjë në mbledhjet e ligjshme dhe paqësore, dhe përshkruan kufijtë e mënyrat e përdorimit të armëve të zjarrit në organizimet e individëve.

Konventa e ONP-së mbi Lirinë e Mbledhjes dhe mbrojtjen e të drejtës për tu organizuar. (1948): parashikon të drejtën e punonjësve për të krijuar e bërë pjesë e organizatave të tyre.

konventa e ONP-së mbi Zbatimin e Parimeve të së drejtës për t'u organizuar dhe arritur marrëveshje kolektive (1949): marrëveshja ka si qëllim që të mbrojtë punonjësit ndaj diskriminimeve për shkak të organizimit e pjesëmarrjes në sindikata.

Deklarata e parimeve dhe të drejtave bazë në punë (1998): kjo deklaratë siguron që edhe nëse shtetet anëtare të ONP-së nuk kanë miratuar konventa specifike në lidhje me punën, kanë detyrimin që të zbatojnë parimet kryesore në lidhje me të drejtat e punonjësve, përfshirë edhe të drejtën për t'u organizuar lirisht e mbrojtur interesat e tyre.

Konventa Evropiane e të Drejtave të njeriut e Lirive Themelore (1949): Neni 11 parashikon të drejtën për t'u organizuar e mbledhur lirisht

Karta Sociale Evropiane (1961): Neni 5 e 6 i saj parashikon të drejtën e punonjësve për t'u organizuar. Gjithashtu punonjësit kanë të drejtë për t'u organizuar e arritur në marrëveshje me punëdhënësit që mbrojnë sa më mire interesat e tyre.

### *Aspekte edukative*

Diskutoni mbi lidhjen e elementeve të situatave të mëposhtme me të drejtën e për t'u organizuar dhe mbledhur të parashikuar nga neni 20.

a. Në Britani legjislacioni lejonte që të lidheshin marrëveshje mes punëdhënësit dhe sindikatave si kusht punësimi. Kështu, në këtë kuadër sindikata e hekurudhave kërkonte të të gjithë punonjësit e hekurudhave të ishin anëtarë të sindikatës së hekurudhave. A dhe B, punonjës të hekurudhave, nuk dëshironin të ishin anëtarë të sindikatës së hekurudhave sepse nuk ndjenin që kjo sindikatë përfaqësonte interesat e tyre. Bordi i sindikatës mohoi përjashtimin e tyre nga sindikata. A dhe B pretenduan se ky legjislacion dhe kjo situatë shkelte të drejtën e tyre për të mos u detyruar të ishin pjesë e ndonjë bashkimi.

***Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor.*** Kjo e drejtë është realizuar në shkollë në krijimin e një klimë të zgjedhjeve të lira në shkolle. Çdo vit shkollor fillon me zgjedhjet. Pjesëmarrja e fëmijëve në to është e lirë. Handikapi i vetëm deri me sot është ai i bashkimit të funksionit të të zgjedhurit me rezultatet akademike, apo me prejardhjen familjare.

Diskutoni mbi mënyrën e organizimit të zgjedhjeve në shkollën tuaj

Analizoni nëse në shkollën tuaj zbatohen të drejtat e nxënësve të parashikuara në Dispozitat Normative të arsimit parauniversitar.

Analizoni nëse në shkollën tuaj të zgjedhurit nga nxënësit iu shërbejnë interesave të nxënësve apo interesave të mësuesve dhe drejtorisë së shkollës.

A janë të zgjedhur në shkollë komplementarë të drejtimit në shkollë? Si realizohet kjo e drejtë?

***Asnjëri nuk duhet të detyrohet të bëjë pjesë në ndonjë bashkim.*** Nxënësit janë të lirë të marrin pjesë dhe detyrimi nuk është pjesë e jetës së shkollës. Familjet kanë zhvilluar ndjeshmërinë e lirisë së fëmijëve për të marrë pjesë ose jo në jetën e organizuar në shkolle dhe jashtë saj.

Nënshtrimi ndaj grupit mund të jete handikapi i momentit. Fëmijët mësojnë konformizmin dhe i nënshtrohen pranisë ose pjesëmarrjes në një grup për mungese alternativash të sjelljes.

Diskutoni edhe me gjatë mbi molën e procesit zgjedhor.

A mësojnë nxënësit vlerën e zgjedhjes, bashkimit dhe përfaqësimit? Lidhni aktivitetet që bëni në shkollë në këtë drejtim me lëndë të ndryshme si Historia, Edukata Shoqërore, etj.

Ftoni të zgjedhurit e zonës së shkollës tuaj për të folur për të drejtën e votës dhe të zgjedhjes



**Neni 21.**

Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

Gjithkush ka njëlloj të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e vet.

Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

Trajtim ligjor

Neni 21 është një nen që në të njëjtën kohë garanton një të drejtë të individit por edhe kushtëzon mënyrën se si një shtet do të krijohet. Kjo sepse duke përcaktuar që të gjithë kanë të drejtën të marrin pjesë në qeverisjen e vendit, neni 21 kërkon nga shtetet që të krijohen në bazë të dëshirës së individëve të tij. Neni 21 kërkon që qeverisja e vendeve të bëhet në mënyra demokratike, edhe pse një gjë e tillë mund të mos jetë e garantuar ende në vende të ndryshme të botës.

Koncepti që qëndron në themel të Nenit 21 është shumë i lashtë në fakt. Që në Greqinë e Lashtë (Athina e Lashtë), njerëzit mblidheshin të gjithë për të votuar rregullat që do të udhëhiqnin jetën e tyre, edhe pse koncepti i demokraci, pra i rregullit të shumicës, nuk ishte ndoshta krejtësisht demokratik sepse linte jashtë gratë apo edhe skllevërit. Ky koncept filozofik u bë themeli i revolucioneve borgjeze (liberale) dhe u përfshi në të gjitha dokumentet kryesore të revolucionit anglez, francez, apo edhe në luftën e pavarësisë së Amerikës.

Pavarësisht nga fakti që koncepti i qeverisjes me bazë të gjerë ka qenë kaq i lashtë, deri vonë ka pasur kufizime të shumta në ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, apo thënë ndryshe për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit. Vende të tilla si vendet veriore të Evropës, deri në vitet 70' të shek 20 kanë pasur kufizuar gratë që të votojnë e votohen. Megjithatë pavarësisht se ky nen i DUDNJ-së mund të mos ketë qenë respektuar nga shtet të ndryshme, ai synonte që të garantonte që qeverinë e çdo vendi zgjidhnin vetë individët lirisht dhe që të funksiononte si një nen që t'i bënte ballë shtypjes dhe tiranisë.

Në vendin tonë ky nen i DUDNJ-së është më se i respektuar. Kushtetua jonë parashikon që qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike (neni 1), që sovraniteti i përket popullit dhe që ushtrohet nga përfaqësuesit e tij ose drejtpërdrejtë nga populli (neni 2), dhe që çdo shtetas shqiptar 18 vjeç e sipër ka të drejtën të zgjidhet e të zgjedhë. (neni 45). Kështu, Kushtetuta jonë synon të garantojë përfaqësinë e çdokujt në qeverisje dhe që qeverisja krijohet nga një bazë e gjerë e vullnetit të popullit.

*E drejta për të marrë pjesë në qeverisje*

Paragrafi i parë i nenit 21 kërkon që çdokush të ketë mundësinë që të shprehë dëshirat e kërkesat e tij në qeverisjen e vendit. Kjo duhet realizuar nëpërmjet përfaqësimit apo

shprehjes së drejtpërdrejtë të vullnetit. Pjesëmarrja në qeverisje nëpërmjet përfaqësimit do të thotë që individët kanë mundësinë të zgjedhin persona të cilët të mund të përfaqësojnë interesat e tyre në qeverisje. Kjo realizohet nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së votës. Sigurisht kjo jo vetëm kërkon në vetvete që njerëzit të jenë të lirë të zgjedhin atë që duan si përfaqësues i tyre në qeverisje, p.sh. në parlament (Kuvend) por edhe që njerëzit të jenë të lirë të mund të deklarojnë veten e tyre si person që mund të zgjidhet nga të tjerët për të marrë pjesë në qeverisje. Ndërsa e drejta për të shprehur drejtpërdrejt vullnetin do të thotë që individët të mund të drejtpërdrejt t'i kërkojnë qeverisë të marrë vendime të caktuara. Kjo e fundit realizohet nëpërmjet të ashtuquajturave referendume. të dyja këto forma të pjesëmarrjes në qeverisje njihen dhe garantohen nga neni 2 i Kushtetutës sonë. Si e drejta për të marrë pjesë në qeverisje nëpërmjet përfaqësuesve ashtu edhe drejtpërdrejtë në vendin tonë rregullohet nga ligje të veçanta.

#### *Pjesëmarrja njëlloj në shërbimet publike të vendit*

Ky paragraf i nenit 21 kërkon që të gjithë të mund të marrin pjesë në shërbimet publike. Kuptimi i këtij paragrafi është mjaft i gjerë dhe mund të interpretohet në nivele të ndryshme. Ky paragraf nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë për t'u zgjedhur, por edhe si e drejtë për t'u emëruar apo caktuar në organe që kryejnë një shërbim publik. Ky paragraf në fakt kërkon që kjo e drejtë të njihet për të gjithë njësoj dhe të mos ketë diskriminime në lidhje me ushtrimin e saj. Më tej ky paragraf mund të kuptohet edhe si e drejtë e kujtdo që të marrë informacione dhe të japë mendime për organet që kryejnë shërbime publike dhe kjo t'u mundësohet njëlloj të gjithëve.

Kushtetua e vendit tonë i garanton të gjithëve të drejtën të marrin informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, si dhe të ndjekin mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive (Neni 33). Po kështu, ligje të ndryshme të vendit garantojnë edhe konkretisht këtë të drejtë. Kështu, Kodi i Procedurave Administrative kërkon që parimi mbi të cilin të organizohen e funksionojnë organet e administratës publike të jetë ai i pjesëmarrjes së kujtdo në veprimtarinë e tyre. Po kështu, në respektim të kësaj të drejte, të gjitha shërbimet publike ofrohen pa pagesë ndaj të gjithëve si parim, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

#### *Zgjedhje periodike e të lira*

Neni 21 kërkon që qeverisja të dalë nga zgjedhjet e lira e që të mbahen kohë pas kohe. Ky nen nuk kërkon që një shtet të ketë disa parti politike, por kërkon që njerëzit të zgjedhin lirisht ato që do t'i përfaqësojnë në qeverisje. Ky përcaktim ishte i tillë për arsye të ndryshmeve të mëdha ideologjike që kishin vendet pjesëmarrëse në Kombet e Bashkuara. Nuk kishte konsensus për pluralizmin partiak mes shteteve pjesëmarrëse kështu që u vendos që neni 21 të mos e përmendte këtë çështje. Duhet kuptuar që neni 21 vërtet nuk kërkon pluralizëm politik pra ekzistencë të shumë partive politike që individët të mund të zgjedhin mes tyre, por fjala zgjedhje në vetvete kërkon që të ketë disa mundësi për të zgjedhur mes tyre atë që konsideron zgjedhjen më të mirë.

Neni 21 kërkon edhe që zgjedhjet të realizohen në mënyrë periodike, pra një herë në disa vite. Kjo do të thotë që qeveritë të mund të ndërrohen periodikisht dhe qeverisja të mos jetë në duart e një qeverie, por të jenë individët ato që të përcaktojnë se cila do jetë qeverisja e tyre. Kështu DUDNJ-ja synon të garantojë një vullnet të lirë të individëve për të përcaktuar shtetin që do të rregullojë jetën e tyre e do përcaktojë rregulla që ato duhen të respektojnë.

Kushtetuta e vendit tonë kërkon që zgjedhjet për në Kuvend dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që janë Bashkitë e Komunat, të realizohen një herë në katër vjet (Neni 65 dhe 109 i Kushtetutës). Kushtetua kërkon që zgjedhjet të jenë të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.

#### *Një kuptim i gjerë i nenit 21*

Neni 21 i DUDNJ-së është kuptuar e interpretuar mjaft gjerë. Kështu, ai nuk është parë si neni që përcakton vetëm rregulla për organet shtetërore, por për të gjitha organet që krijohen për t'i shërbyer një interesi të publikut. Jo më kot, e drejta për pjesëmarrje është kërkuar që të gjejë zbatim edhe brenda organeve të tilla si në shkolla. Kështu, nxënësit kanë të drejtë të krijojnë qeveritë e tyre dhe të shprehin interesat e tyre nëpërmjet këtyre qeverive dhe këto kërkesa t'ia transmetojnë shkollës. Sigurisht ky rregullim i ligjit në vendin tonë duhet parë edhe si një edukim me një nga parimet kryesore të një shteti demokratik, atë që pjesëmarrjes sënë qeverisje.

#### *Vetëvendosja?*

Neni 21 ka të bëjë me të drejtën e individëve për të vendosur vetë në lidhje me qeverisjen e tyre. Por a përfshin ky nen edhe të drejtën e popujve për të vendosur vetë në lidhje me fatin e shtetit të tyre? Neni 21 nuk e përmend këtë çështje për arsye të debateve të shumta që kishin shtetet në lidhje me këtë çështje. Por, kjo çështje u garantua më pas me Paktet Ndërkombëtare të të Drejtave Sociale, Ekonomike e Kulturore si dhe të të Drejtave Civile e Politike të Kombeve të Bashkuara.

#### *Dokumente ndërkombëtare*

Parimet që përfshihen në nenin 21 të DUDNJ-së janë reflektuar edhe në shumë dokumente të tjera ndërkombëtare, qofshin këto edhe rajonale, si për shembull:

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Politike e Civile, N. 25

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Sociale, Ekonomike e Kulturore, Karta e Shteteve Amerikane (1948) kërkon organizim politik të shteteve mbi baza të ushtrimit efektiv të demokracisë përfaqësuese.

KEDNJ: fillimisht nuk përfshinte të drejtën për zgjedhje, por me Protokollin 1 të saj e përfshiu të drejtën e zgjedhjeve të lira, periodike, të fshehta

Akti Final i Helsinkit dhe shumë dokumente të OSBE-së: i referohen të drejtës së zgjedhjeve të lira, demokratike, të fshehta e periodike.

#### *Aspekte edukative*

Thelbi i Nenit 21 qëndron në shpalljen e barazisë së pacenueshme të individit në raport me shtetin si dhe parashtron kërkesat minimale për sistemin demokratik të shteti ku gjithkush shpreh mendimin e tij, nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje periodike dhe të lira. Sistemi i të drejtave dhe vlerave, në të gjitha nenet e deklaratës, është i ndërlidhur. Pra, të drejtat politike në kuptimin e gjerë lidhen me të drejtat e barabarësisë, të drejtat civile, të drejtën e mendimit dhe shprehjes së lirë, të drejtën e bashkimit dhe sigurimin e minimumit të të drejtave sociale dhe ekonomike.

Në këtë kontekst të gjerë kuptohet dhe interpretohet pacenueshmëria e individit në raport me shtetin dhe e drejta e tij për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur.

Siç është në natyrën e të gjitha neneve të deklaratës, edhe në këtë nen, Deklarata nuk sugjeron një sistem të caktuar qeverisjeje por jep parimet të cilat duhet të respektohen dhe të mbrohen për të siguruar një qeverisjeje që shpreh interesat e të gjithëve.

Në mjedisin e klasës, janë të shumta situatat që mund të diskutohen për të sjell më pranë kuptimin e këtij neni duke trajtuar çështje konkrete si: a duhet të të zgjidhen drejtpërdrejtë nga shtetasit përfaqësuesit e organeve të pushtetit qendror dhe vendor?

## **Veprimtari**

### **Tema: Zgjedhja e Qeverisë së nxënësve (QNx)**

**Objekti:** Ballafaqimi i mendimeve dhe ideve të nxënësve në lidhje me procesin e zgjedhjes së Qeverisë së Nxënësve si përfaqësuese e interesave të tyre.

**Përfundimi:** Nxitja e interesit të nxënësve për të marrë pjesë në këtë diskutim si e drejtë themelore e një të riu të përgjegjshëm sot për t'u bërë një qytetari i përgjegjshëm i një vendi demokratik në të ardhmen.

**Koha:** 1 orë mësimi

**Përgatitja:** Mirë është që një temë e tillë të trajtohet në periudha që i paraprinë zgjedhjes së Qeverive të Nxënësve.

Mësuesi krahas punës që do të bëjë vet, mbi baza vullnetare, cakton 2-4 nxënës të mbledhin fakte dhe informacion rreth mënyrës së zgjedhjes së "Qeverive të Nxënësve" në shkollën e tyre apo dhe në shkollat e tjera të qytetit. Informacioni duhet të ketë fakte dhe shifra në lidhje me praktikën e mëparshme të zgjedhjes së QNx, në shkollë dhe evoluimin apo përmirësimin e tyre në zbatim të një procesi *votim të barabartë, votim të fshehtë ose sipas procedurës ekuivalente të votimit të lirë.*

Qëllimi i veprimtarisë është në radhë të parë të ndihmojë kuptimin më të mirë të Nenit 21 të DUDNJ që nëpërmjet përvojave të drejtpërdrejta, nxënësit në vetë të parë të bëhen debatues aktiv të rolit të tyre pjesëmarrës në organet që shprehin dhe mbrojnë interesat e tyre në shkollës.

Materialet:

- Informacioni statistikor rreth procesit të zgjedhjes së Q.Nx. në shkollën tuaj
- Dispozitat Normative të Shkollës
- Dërrasë e zezë ose tabak letre e bardhë;
- Letër, lapsa ose stilolapsa për mbajtjen e shënimeve;

- Fotografie, poster apo mesazhi i përdorur në periudhën e zgjedhjeve të Q.Nx.

### **Hapi i parë**

Biseda zhvillohet duke i vendosur nxënësit në gjysmë rrethi ose në rreth. Fillojeni bisedën me pyetjet: “Kur keni zgjedhur për herë të parë Q.Nx.”; “A përbënte kjo një risi për ju dhe pse?”; “Cilat janë atributet e Q.Nx”; Është e rëndësishme që si fillim të ndaleni në vjeljen e një informacioni sa më të gjerë që lidhet me përvojat e para të nxënësve si pjesëmarrjes në zgjedhjen e Q.Nx. dhe çka është më e rëndësishme ndërgjegjësimin e tyre për zbatimin e një prej të drejtave themelore të njeriut që është ajo e pjesëmarrjes në qeverisje nëpërmjet ushtrimit të të drejtës të pjesëmarrjes në zgjedhje.

### **Hapi i dytë**

Më pas mund të vazhdoni me pyetje të tjera që lidhen me funksionimin e Q.Nx si psh:

- A ka sjell ndryshim në jetën e tyre shkollor ekzistenca e një instance përfaqësuese e vetë nxënësve dhe pse?
- A janë përfaqësuesit e Q.Nx. zëdhënës të interesave dhe vullnetit të të gjithë nxënësve të shkollës? nëse po, “Cilat janë disa nga drejtimit e punës së Q.Nx që shpreh më qartë përfaqësimin e të gjitha shtresave të nxënësve në veprimtarinë e shkollës?”
- Dëshironi të ndryshoni aspekte të veçanta të procesit të zgjedhjes së Q.Nx.?, nëse po, “Çfarë ndryshimesh dëshironi të propozoni dhe pse?”, nëse jo, “Cilat janë argumentet që mbështesin procedurat zgjedhore ekzistuese?”

Gjithçka që del nga diskutimi i nxënësve, sipas pyetjeve, shënohet në dërrasën e zezë. E rëndësishme që të gjithë të marrin pjesë në debat. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se *respektimi i vullnetit të popullit si bazë e pushtetit shtetëror*, siç parashtrohet në nenin 21, fillon qysh në parashtrimin e rregullave të zgjedhjes

### **Hapi i tretë**

#### **Diskutimi përfundimtar**

Në 10 – 15 minutat e fundit të kohës së diskutimit, mësuesja duke përfshirë vetë nxënësit përpiqet të bëjë një përmbledhje të diskutimeve duke ju referuar të gjitha shënimeve në dërrasën e zezë.

Duke u nisur nga një përvojë konkrete siç është Q.Nx. nxënësit e kanë më të lehtë të kuptojnë rëndësinë e konceptit të barazisë së pacenueshme të individit në raport me shtetin, e natyrshëm, gjatë diskutimit duhet të tërhiqet vëmendja se qytetarët e rritur të një shoqërie demokratike duhet të edukohen dhe mësohen me rregullat dhe parimet e kësaj shoqërie qysh sa ata janë në gjendje të kuptojnë dhe të zbatojnë të drejtat dhe detyrimet. Pra jo vetëm duke i mësuar por çka është më e rëndësishme duke i zbatuar ato mund të edukojmë qytetar ekzigjent dhe të ndërgjegjësuar për rolin që luajnë në një shoqëri demokratike si pjesëmarrës në qeverisjen e vendit drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

### **Diskutim**

Më poshtë po japim disa situata të treguara në vetën e parë që mund të shërbejnë si raste studimi.

*Rasti i një nxënësi:* Rreth dy javë pas fillimit të shkollës, mësuesja kujdestare na mblodhi ne, nxënësit e klasës dhe na komunikoi udhëzimin e drejtorisë së shkollës për të zhvilluar zgjedhjet e qeverisë së nxënësve. Takimi për zgjedhjet u la të nesërmen. E gjithë klasa ishte në ankth. Kishte disa nxënës që dëshironin të kandidonin. Mësuesja zgjodhi dy prej tyre. Si fillim të dy nxënësit kandidatë morën fjalën ku theksonin se çfarë angazhimesh do të realizonin gjatë vitit akademik 2007 – 2008. Në përfundim mësuesja na tha të votonim për secilin. Mësuesja numëronte duart e ngritura për secilin kandidat dhe deklaroi fitues nxënësin që kishte marrë më shumë vota.

*Rasti i një prindi:* Një ditë Fiona vjen me sy të skuqur nga shkolla. Ajo ndjek një nga shkollat jo-publike në klasën e tretë. Si zakonisht u interesova se si kishte kaluar në shkollë, pa i rënë në sy se e kisha kuptuar që dicka kishte ndodhur me të atë ditë në shkollë. Dalëngadalë filloi të më tregonte. Mësuesja i kishte thënë se në orën e fundit do të bënin zgjedhjet e klasës.

“ Tani do të bëjmë zgjedhjet. Që të gjithë do të merrni pjesë e do të jepni mendimin tuaj për nxënësin që do të zgjedhim senator. Ai/ajo duhet të jetë një nxënës i mirë në mësim, në sjellje dhe i dashur me shokët. Unë mendoj se Erindi i plotëson të gjitha këto kushte. Unë mendoj të zgjedhim Erindin, por ju mund të votoni për kë të doni”.

E kuptohet e gjithë klasa thanë “Erindi, Erindi” dhe u zgjodh Erindi kujdestar i klasës. “Erindi është nxënës i mirë, por aty ka plot më të mirë” më tha Fiona.

E kuptova se ishte mërzi shumë, jo aq pse nuk ishte zgjedhur ajo, por nuk ishte marrë fare në konsideratë si kandidaturë. E si ajo dhe disa të tjerë. Dyshoj se mund të guxojë vitin tjetër të futet në garë.


*Rasti i një mësuese:* Që në fillim të tetorit, u thashë nxënësve se brenda muajit duhet të zhvillojmë zgjedhjet për në senatin e shkollës. Shikoja një farë angazhimi të disa nxënësve të cilët kishin filluar një farë “fushate” për të grumbulluar sa më shumë simpatizantë rreth vetes. Kjo “fushatë herë merrte formën e “nismave për aktivitete” herë ndihmë në detyra e provime !? etj. etj. Në fund të muajit u mblodhëm me klasën time kujdestare dhe filluam të diskutonim se si do t’i zhvillonim zgjedhjet.

Kërkova që të ngrinin dorën të gjithë ata që dëshironin të kandidonin. 7 nxënës nga 47 veta. Sipas rendit alfabetik ata u ngritën dhe mbrojtën pozicionin e tyre e bënë thirrje për t’u mbështetur. Në përfundim të gjithë nxënësit në një letër të palosur mirë shkruan emrin e kandidatit për të cilin votonin dhe i hodhen në një kuti. Dy nxënës filluan të lexonin “fletët” e votimit duke i ndarë sipas kandidaturave. Ishte një garë e fortë. Në përfundim fitoi Tea e cila kishte marrë 7 vota. Nuk di , por vetëm 7 nxënës dhe Tea 8 u hodhën përpjetë nga gëzimi.

*Flet drejtoresha e një shkolle:* Zgjedhjet janë problem më vehte që kërkon shumë kujdes. Me një klasë e kam ende problem dhe nuk di si do ta zgjidh. Senator në këtë klasë është “zgjedhur” një nxënës shumë problematik në sjellje. Një vit më parë m’u desh të telefonoja forcat e rendit për të zgjidhur një incident mes tij dhe disa prinderve. Ai me sa duket u ka bërë presion nxënësve dhe ata votuan për të. Kuptohet se ai nuk është modeli më i mirë për të drejtuar klasën, ndërkohë që zgjedhjet e këtij viti u bënë dhe në qoftëse

nuk gjej një zgjidhje na duhet të tërëve mësues e nxënës ta “durojmë “ përgjatë gjithë vitit.

### **Çështje për diskutim:**

1. Si mendoni, në rastet e mësipërme, cilat janë shkaqet dhe pasojat përkatëse?
    - procesi,
    - kriteret,
    - individët,
    - rregullorja,
    - drejtuesit etj.
  2. Duke ballafaquar nenin 21 të DUDNJ, Kushtetutën e Shqipërisë dhe rregulloren e shkollës mbi zgjedhjet, cila mendoni do të konsideroheshin zgjedhje normale?
  3. Kur mendoni se duhet të fillojë edukimi mbi parimin e barazisë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur?
  4. Në familjen tuaj sa jeni/ndjeheni të përfshirë në vendimmarrje?
- 

## Neni 22

Si anëtar i shoqërisë, gjithkush ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për dinjitetin e vet dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti.

### Trajtim ligjor

Neni 22 i deklaratës është një nen ombrellë për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore që janë të rëndësishme për dinjitetin dhe zhvillimin e personalitetit. Qëllimi i përfshirjes së tij ishte hartimi i një neni të veçantë që ka të bëjë me masat që duhet të marrë një shtet për të siguruar të drejtat sociale dhe ekonomike por që edhe shoqëria të jetë e tillë që të sigurojë mbikëqyrjen e realizimit të këtyre të drejtave<sup>11</sup>. Në vijim të këtij neni, nenet 24-27 detajojnë disa prej këtyre të drejtave.

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore e kanë origjinën e tyre në përpjekjet që ka bërë shoqëria për të rritur mirëqenien e njerëzve dhe faktit që njerëzit krahas të drejtave civile dhe politike kanë nevojë të gëzojnë edhe të drejta të tjera në fushën e mirëqenies së tyre. Në momentin e hartimit të deklaratës, bota sapo kishte dalë nga Lufta e Dytë Botërore dhe krizat e kaluara shtruan nevojën që në këtë deklaratë dhe në konventat që do të miratoheshin më pas të parashikoheshin disa të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore. Në hartimin e tyre u mbajtën parasysh modele të mbrojtjes së tyre në vende të ndryshme, antëtare të OKB, kushtetuta të ndryshme etj.

Këto të drejta përfaqësojnë standardet ndërkombëtare të pranueshme për një minimum të parimeve të përbashkëta përmes të cilave mbrohen individët prej pasigurisë ekonomike dhe sociale dhe kërcënimit që ato paraqesin për lirinë dhe barazinë e tyre<sup>12</sup>. Edhe në preambulën e deklaratës theksohet nevoja e krijimit të kushteve më të mira të jetesës në një liri më të madhe dhe nevoja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe marrja e masave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Që në fillim të nenit theksohet e drejta për sigurim shoqëror. Nëse mbajmë parasysh qëllimet që ndjek skema e sigurimit shoqëror, ky nen mbron individët në rast se jeta e tyre është në rrezik, në raste papunësie, mungesës së aftësisë për punë dhe pleqërie. Neni 22 i DUDNJ përmban katër parime të rëndësishme të cilat në mënyrë të përmbledhur i paraqesim më poshtë:

- 1 Cilido person gëzon të drejtën e sigurimit shoqëror dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.
- 2 Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore janë të domosdoshme për dinjitetin e tij dhe zhvillimin e lirë të personalitetit të tij.
- 3 Të drejtat mund të realizohen duke bërë përpjekje brenda vendit dhe jashtë tij, pra në nivel ndërkombëtar.
- 4 Këto të drejta njohim edhe kufizime, në varësi të organizimit dhe mundësive ekonomike të vendit, por kuptohet dhe përmes përpjekjeve në nivel ndërkombëtar.

DUDNJ cilësohet si dokumenti iniciues për këto të drejta, por ato trajtohen më gjerësisht në dokumentet e tjerë ndërkombëtare, sidomos në Paktin për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (neni 11), në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në

<sup>11</sup> Bard - Anders Andreassen, lidhur me nenin 22 botuar në f. 479.

<sup>12</sup> Po aty f. 482.



Konventat për të Drejtat e Fëmijës. Ky nen ombrellë ka lidhje edhe me nene vijuese të DUDNJ., sidomos me nenin 25 dhe 29, por edhe me nene që i kanë paraprirë atij si neni 2 (mos diskriminimi, ose neni 17 (e drejta për punë). Organizata Ndërkombëtare e Punës (ODP), ka miratuar një sërë konventash për përmbushjen e këtyre të drejtave. Në nivel Evropian, dokumenti më me rëndësi është Karta Sociale Evropiane e Ndryshuar.

Një nga problemet më të vështira lidhur me zbatimin e këtij neni është **përcaktimi i detyrimeve që ka shteti dhe përcaktimi i kufijve minimal për sigurimin shoqëror**. Mbrojtja e këtyre të drejtave kërkon gjithashtu shumë mekanizma, politika publike në fusha të ndryshme si në arsim, në punësim, në shëndetësi. Vendet i bëjnë këto me përpjekje të shtetit dhe duke bashkuar në nivel ndërkombëtar.

***Ja si ka gjetur zbatim ky nen në disa prej dokumenteve rajonale dhe kombëtare.***

- Sipas kushtetutës të RSh, në kreun 4 të saj të titulluar Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore në nenet 49-58 sanksionohet të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.
- Sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, neni 11, çdo person gëzon të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit, duke përfshirë të drejtën e themelimit, më të tjerë, të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.
- Sipas Kartës Sociale Europiane e Ndryshuar palët pranojnë si synim të politikës së tyre që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e cituara më këtë kartë do të realizohen në mënyrë efektive. Konkretisht, Karta përmban 31 të drejta dhe parime. Ata janë cituar në pjesën e parë të saj. Në pjesët në vazhdim jepen detyrimet që duhen përmbushur për realizimin e këtyre të drejtave dhe parimeve.

Shqipëria ka nënshkruar Kartën Europiane Sociale më.....

### *Aspekte edukative*

Thelbi i kësaj të drejte qëndron në faktin që çdo shtet duhet të garantoj për secilin qytetar, një minimum standardi për ushqimin, shëndetin, strehimin dhe arsimin, duke e cilësuar këtë si të drejtë politike dhe jo si lëmoshë.

Sot në botë ka 840 milion njerëz që vuajnë nga uria. Afërsisht 11 milion fëmijë vdesin para se të arrijnë moshën 5 vjeç. Mbi 100 milion fëmijë (më shumë se gjysma e tyre janë vajza), nuk ju sigurohet arsimi fillor. Të tilla shifra nuk shprehin vetëm një realitet të pafat të jetës së këtyre njerëzve por njëkohësisht përbëjnë një mohim të paparë të të drejtave të njeriut. Pra bëhet fjalë për përgjegjësi të cilat i kanë rrënjët jo vetëm në dinjitetin njerëzor që duhet të sigurojë çdo shoqëri për njerëzit e vet por në përgjegjësitë ligjore detyruese të çdo vendi që ka nënshkruar DUDNJ.

Çdo njeri në shoqëri duhet të ketë një jetë të shëndetshme. Kjo është një ndër të drejtat që qëndron në themel të dinjitetit njerëzor. Një jetë e shëndetshme kontribuon dhe shkakton varfëri, shkatëron jetën, ulë aftësinë për punë, ulë arritjet në arsim dhe kufizon mundësitë për një jetë dinjitoze. Për shkak të varfërisë, aksesit ndaj shërbimit

shëndetësor është i ulët, njeriu është i ekspozuar ndaj rreziqeve mjedisore, kequshqyerjes madje munges e shëndetit jo rrallë është pasojë e varfërsisë. Në këtë kuptim mungesa e shëndetit është njëkohësisht shkak dhe pasojë e varfërsisë: njerzitë e sëmurë ka shumë gjasa të varfërohen dhe të varfërit janë më të ndjeshën ndaj sëmundjeve.

E drejta për një minimum standardi për shëndetin nuk duhet të kuptohet si e drejtë për të qënë i shëndetshëm. Çdo shtet nuk mund të sigurojë mbrojtjen e shtetasve të vet nga të gjitha shkaqet e mungesës së shëndetit. Por çdo shtet ka detyrë të sigurojë një sërë kushtesh dhe lehtësirash që mund të sigurojnë standarde të pranueshme të shëndetit. Kjo e drejtë përfshinë njëkohësisht shërbimin shëndetësor si dhe përcaktimin e të gjitha parakushteve të tjera që sigurojnë mbrojtjen e shëndetit publik siç janë uji i pishëm, ushim i përshtatshëm dhe i shëndetshëm, sistem shëndetësor i duhur, kushte të punës dhe kushte mjedisore të përshtatshme, akses ndaj informacionit për një jetë të shëndetëshme etj.

Si përgjigje ndaj ndërgjegjësimit gjithmonë e më të madh që shoqëria sot ka rreth varfërsisë njerëzore, në nivel ndërkombëtar dhe në nivel vendi, hartohen dhe zbatohen ligje të cilat janë mjete në duart e të varfërve për të mbrojtur të drejtat e tyre themelore. Zbatimi i këtyre ligjeve shoqërohet me hartimin dhe realizimin e politikave dhe programeve shtetërore që dora dorës synojnë të realizojnë standarde të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Madje që këto standarde të universalizohen hartohen dhe nënshkruhen një sërë marrëveshjes ndërkombëtare të cilat nuk ngelen vetëm në nivelin e marrëveshjes po shoqërohen edhe me krijimin e sistemeve botërore të monitorimit.

### ***Veprimtari:***

a. Në një rajon të shtetit të Nigerisë, në Afrikë që quhet Ogoni popullsia jetonte në harmoni me tokën e tyre prej qindra vjetësh. Në gjysmën e dytë të shekullit XX gjërat ndryshuan. Kompanitë e naftës zbuluan në këtë zonë rezerva të shumta të naftës të cilën filluan ta shfrytëzonin. Kjo gjë bëri që mjedisi të ndotej me pasoja të rënda për popullsinë e vendit duke shkaktuar sëmundje serioze, ndotje të frikshme të mjedisit dhe për rrjedhojë dhe kushte të të vështira për jetën e njerëzve. Në këtë periudhë Nigeria udhëhiqej nga një qeveri ushtarake e cila nuk shqetësohej për mirëqënien dhe jetën e sigurtë të popullsisë së këtij rajoni. Në vitet 80-të populli Ogonit i mbështetur nga Lëvizja për Shpëtimin e Ogonit filloj të organizonte lëvizjen paqësore nëpërmjet të cilës kërkonin të mbronin mjedisin e tyre natyror, kërkonin të drejtën e tyre për të ushtruar kontrollin politik mbi jetën e popullsisë së tyre si dhe të drejtën për të shfrytëzuar në mënyrë racionale pasuritë natyrore në dobi të zhvillimit të rajonit të Ogonit. Kjo lëvizje sensibilizojë opinionin botëror dhe u bë shkak për të ndryshuar rrjedhën e zhvillimit të Nigerisë një herë e përgjithmonë. Kjo lëvizje u shoqërua me represione të shumta kundrejt popullsisë së vendit dhe udhëheqësve të Lëvizjes për Shpëtimin e Ogonit. Vetëm pas 20 vjetësh, në vitin 1999 në Nigeri u zhvilluan të para zgjedhje demokratike në vend të cilat sollën më pas dhe ndryshimin e gjendjes në rajonin e Ogonit.

Gjatë 20 viteve, popullit të Ogonit ju mohuan një sërë të drejtash si: e drejta e minoriteteve, e drejta për zhvillim, e drejta për protestë paqësore, të drejtat ekonomike,

shoqërore, kulturore, të drejta këto të domosdoshme për njeriun. Por e gjithë lëvizja u organizua rreth një boshti të vetëm që kishte të bënte me të drejtën e njeriut **për të pasur një mjedis të sigurve dhe të shëndetshëm.**

### **Tema: Lidhja midis të drejtave mjedisore dhe të drejtat e njeriut**

Mjetet: letër me 3 ngjyra për secilin nxënës, lapsa ose lampustil, udhëzues për “Analizën e situatës:

#### 1. Përcaktimi i tematikës:

- Kërkojini nxënësve të diskutojnë dhe të listojnë një sërë problemesh të jetës së përditshme që ndikohen nga mjedisi. Përfshini këtu shtëpinë, vendin e punës dhe shkollën si dhe mjedise të tjera publike. Përgjigjet shënojeni në një letër.
- Përdor listën e problemeve për të përcaktuar nga vetë nxënësit përkufizimin e termit “mjedis”. Shkruajeni përkufizimin në dërrsaën e zezë në mënyrë të tillë që të jetë e dukshme.
- Pyeti nxënësit se çfarë kuptojnë apo dhe mendojnë se duhet të kuptojnë me termin “drejtësi mjedisore”. Përpiquni të jepni disa përkufizime për këtë term dhe shënojeni në dërrasën e zezë, posht termit “mjedis”.

#### 2. Raportimi:

a) Secilit nxënës shpërndajini 3 fleta letre (mundësisht me 3 ngjyra të ndryshme)

b) Për letrën e parë pyesni nxënësit: “Çfarë përbënë për ju një problem mjedisor dhe si ndikon në jetën tuaj personale”. Secili nxënës duhet të shkruaj një fjalë apo frazë në letrën me të njëjtën ngjyrë.

c) Për letrën e dytë pyesni nxënësit " Cili problemi mjedisor rajonal apo kombëtar ju shqetëson në vendin ?" Përgjigja do të jepet në letrën e dytë që ka të njëjtën ngjyrë për të gjithë

d) Për letrën e tretë pyesni nxënësit "cili është problemi mjedisor që ndikon në të gjithë planetin?" Përgjigja jepet në letrën e tretë që ka të njëjtën ngjyrë për të gjithë.

Shënim: Me gojë ju mund të shtoni pyetje të tjera.

#### 3. Analiza e përgjigjeve:

a) Ndaheni klasën në 3 grupe dhe secilit prej tyre jepni tufën e letrave me të njëjtën ngjyrë. Analiza e përgjigjeve të mbledhura paraqiten në tabelën si më poshtë:

Tabelë

Problemi	Shëndeti	Mirëqenie	Cilësi e jetës	Të tjera	Të drejtat që	Zgjidhjet e mundshme
----------	----------	-----------	----------------	----------	---------------	----------------------

					përfshihen	

b) Shpjegoni se si duhet të plotësohet tabela:

*Problemi:* lexoni të gjitha problemet që kanë dalë dhe renditini në kollonë. Për problemet që përsëriten në bri vendosni një shënjë.

*Pasojat:* Kontrolloni nëse problemet e renditura ndikojnë në shëndetin e njeriut, në cilësinë e jetës dhe kulturës së të jetuarit. Shkruajini pasojat e tjera në kollonën që shënohet “Të tjera” .

*Të drejtat që përfshihen:* shkruani të drejtën/at specifike që shkelen nga problemi i paraqitur. Nëse është e mundur nxirrin nga DUDNJ nenet e tjera që implikohen në këtë të drejtë.

*Shënim:* Duke ju referuar pjesës së parë të komentarit, ju mund të përdorni edhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe ligjet apo dokumentet e tjerë kombëtarë.

c) Pasi secili grup të ketë plotësuar tabelën vendosini në një vend që të shihen nga të gjithë. Kërkojini raportuesit të secilit grup të përmbledh shkurtimisht gjetjet.

4. *Krahasoni dhe analizoni:* Krahasoni dhe analizoni të dhënat e tabelës duke bërë pyetje të tilla:

- A ka probleme të përbashkëta në të tre lista? Cilat janë?
- Si ndryshon perceptimi i këtyre problemeve të para nga këndvështrimi personal, kombëtar dhe global?
- Në cilat aspekte të jetës së njeriut ndikojnë këto probleme?
- Sa nga problemet e renditura mbartin shkelje të të drejtave të njeriut?
- Cilat nga të drejtat shkelen më shumë? Këto të drejta duket se janë shoqërore-politike apo shoqërore – ekonomike?
- Kush i shkel këto të drejta? Renditini ato në një letër tjetër nën kokën “Shkelësit e të drejtave”
- Kush janë ata që mund të zgjidhin problemin? Renditini emrat e atyre që janë dhënë në kolonën “Zgjidhjet e mundshme”
- Sa të efektshme kanë qenë zgjidhjet? Cilat kanë qenë dhe cilat jo?

5. *Diskutoni rreth analizës:*

- Mbi bazën e analizës së bërë cilat rezultojnë se janë marrëdhëniet apo lidhjet midis të drejtave të njeriut dhe të drejtave mjedisore?
- Si evidentohen prioritetet e veprimeve nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe atyre të të drejtave të mjedisit? Përdorin strategji të ndryshme?

6. Diskutoni rreth lidhjes që ka midis të drejtave të njeriut dhe të drejtave mjedisore. Lexoni paragrafin e mëposhtëm dhe përdoreni për të përmbledhur pikat e përbashkëta dhe ftojini nxënësit të mendojnë për veprimet që duhet të ndërmerren.

“Fatmirësisht lëvizjet për të drejtat e njeriut dhe ato mjedisore kanë pika të përbashkëta. Veçanërisht të dyja, tradicionalisht janë fokusuar në realizimin e të drejtës për t’u informuar si dhe mbështesin fuqimisht të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrje për problemet që ndikojnë mirëqenien e njerëzve.

### **Neni 23**

Gjithkush ka të drejtën për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.

Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë.

Gjithkush që punon ka të drejtën për një shpërblim të drejtë dhe favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.

Gjithkush ka të drejtë të formojë sindikatë and të bëjë pjesë në të për mbrojtjen e interesave të veta.

### Trajtim ligjor

Gjithkush ka të drejtë për punë, që të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.

Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë.

Gjithkush që punon ka të drejtë për një shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.

Gjithkush ka të drejtë të formojë sindikatë dhe të bëjë pjesë në të, për mbrojtjen e interesave të veta.

### Aspekte edukative

Në thelbin e nenit 23 është ligjërimi i katër parimeve:

- Parimi i të drejtës në punë
- Parimi i pagës së barabartë
- Parimi i shpërblimit të drejtë, dhe
- Parimi i lirisë së bashkimit

Në përmjet këtij neni, çdo banorë, jo vetëm shtetas i një vendi, duhet të ketë qasje në tregun e punës. Kjo e drejtë nënkupton që çdo individ të jetë në gjendje të zgjedh punësimin pa ndërhyrje të autoriteteve. Puna e detyruar, në të gjitha format e saj, është e kundërshtuar. Megjithatë qasja në tregun e punës është pa vlerë nëse kushtet e punës janë të papranueshme; pagat dhe mjedisi i punës duhet të arrijnë një nivel të caktuar para se e drejta në punë të ketë kuptimin e vërtetë të nenit. E njëjta gjë mund të thuhet për zgjedhjen e lirë të punësimit kundrejt papunësisë. Nuk mund të ekzistojë zgjedhje e lirë e punësimit nëse të papunësuarit nuk mbrohen me ligj. Vlen të theksohet se formulimi i secilit parim të mësipërme ka sfondin e vet të zhvillimit historik.

E drejta për punë është përcaktuar në ligje ndërkombëtare. Në to kjo e drejtë nuk vlerësohet vetëm në aspektin e krijimit të të ardhurave për të përballuar nevojat minimale të jetësës por akoma më gjerë, si mundësi që i jepet çdo individ për të përmbushur nevojat sociale, intelektuale dhe personale si parakusht i rëndësishëm për një jetë dinjitoze. E drejta për punë është e një rëndësie të veçantë dhe qëndron në themel të përmbushjes së të drejtave të tjera të njeriut siç është e drejta për të pasur një shtëpi, e drejta për arsim kulturë etj.

Dispozita të rëndësishme për realizimin e të drejtës për punë gjenden në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe kulturore. Në këtë paktë përcaktohen elementët themelor të së drejtës për punë që janë:

Mundësia për punë

Liria e zgjedhjes së punësimit

Kushte dinjitoze pune

Mosdiskriminimi

E drejta për të krijuar dhe marrë pjesë në sindikata.

## Veprimtari

a. Në vitet 90-të të shekullit të kaluar, një pjesë e mirë e popullsisë, në Korenë e Jugut u prek nga kriza që përfshiu Azinë. Me thellimin e krizës, papunësia u rrit në nivele të papara, me mijëra njerëz u varfëruan. Në fund të viteve 90-të, shifrat zyrtare në Korenë e Jugut jepnin rreth 1.5 milion njerëz të papunë ndërkohë që shifra e dhënë nga sindikatat e punëtorëve dhe organizatat e të drejtave të njeriut deklaroni më shumë se 2 milion të papunë. Qeveria nuk ishte në gjendje të ofronte siguri sociale për njerëzit dhe mbijetesa e shumë të papunëve varej nga ndihma e të afërmeve dhe e disa organizatave. Në rrugët e Seulit dhe qyteteve të tjera numëroheshin me mijëra njerëz të pastrehë. Kriza ekonomike rëndojë më shumë në shtresat e marginalizuara.

Sindikatat më të fuqishme të punëtorëve filluan të organizonin protesta ndaj politikës ekonomike të qeverisë, por ndaj tyre u morën masa të ashpra duke arrestuar krerët e sindikatave dhe shkelur me dhunë protestat e punëtorëve. Këto masa represive mbartnin shkelje flagrante të të drejtave të njeriut gjë që çoj në rritje e tensionit dhe shumë më pak mbrojtje ndaj punëtorëve. Ligjet e sigurisë kombëtare u shfrytëzuan për të arrestuar njerëz duke ju dhënë në disa raste dënime shumë të rënda. Midis tyre u arrestua dhe presidenti i Konfederatës së Sindikatave të Koresë së Jugut një person karrizmatik i quajtur Dan Byung – ho. Arrestimi i presidentit u kthye në çështje ndërkombëtare dhe lufta e përbashkët që zhvilluan punëtorët korean së bashku me sindikatat e tyre të mbështetur fuqimisht dhe nga Organizata Ndërkombëtare padyshim shënoj një hap të ri në rrugën e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve në vendet e tyre të punës.

## **Tema: E drejta për punë dhe për të formuar sindikata.**

Duke filluar nga shekulli i XIX, sindikatat kanë qenë në ballë të luftës për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve. Rasti i arrestimit të Dan Byung – ho, në kohët moderne, nuk është gjë tjetër vetëm një formë e shprehjes se konfliktit të përhershëm midis punëtorëve nga

njera anë dhe qeverive dhe pronarëve dhe punëdhënësve nga ana tjetër. Në shumë raste të dy palët ankohen për shkelje të të drejtave të njeriut, zakonisht punëtorët kërkojnë të drejtën për të pasur një rrogë mesatare mujore dhe kushte të sigurta të punës dhe pronarët kërkojnë zbatimin e të drejtës së tyre ndaj pronës dhe punës së lirë.

Kërkojuni nxënësve:

- të diskutojnë raste të ndryshme (psh. greva e minatorëve të Bulqizës gjatë vitit 2007, greva e punëtorëve të ish metalurgjikut në Elbasan) dhe të përcaktojnë të drejtat e shkelura të punëtorëve
- kërkojuni nxënësve të parashtrojnë njëkohësisht vështirësitë dhe nevojën që këto debate të kornizohen në kontekstin e të drejtave të njeriut

1. Diskutim: A janë shkelur të drejtat e njeriut të punëtorëve

Fillimisht lexohet neni 23 i DUDNJ dhe mësuesi sigurohet që të gjitha paragrafët e nenit kuptohen nga nxënësit

a) Nëse nxënësit nuk kanë njohuri për sindikatat, mësuesi shkurtimisht i shpjegon funksionin që ato luajnë: pra janë bashkime të punëtorëve në vendin e punës që mbrojnë interesat e punëtorëve për çështje të tilla si kushtet e punës, pagat dhe përpiqen për të përmirësuar pozicionin e anëtarëve të tyre. Zakonisht përfaqësuesit e sindikatave dhe pronarët e fabrikave dhe uzinave nënshkruajnë një marrëveshje të përbashkët që rregullon marrëdhëniet në punës të punëtorëve si dhe jepen qartësisht hapat që duhet të ndërmerren nëse midis palëve ka mosmarrëveshje. Nëse këto nuk respektohen nga punëdhënësit, sindikatat mund të ngrihen në grevë, mund të bojkotojnë punën si dhe mund të ndërmarrin veprime të tjera.

b) Kur ka mosmarrëveshje në lidhje me “kushtet e mira të punës” dhe si mund të arrihen ato, një gjë është e qartë për të gjithë se asnjë punëtorë nuk duhet të trajtohet si skllav.

2. Vlerësoni gjendjen e punëtorëve: *Lexoni dhe diskutoni rreth të gjitha situatave që keni parashtruar për të përcaktuar se ku dhe si vërehen shkelje të të drejtave të njeriut. Më pas ndaheni klasën në 6 grupe dhe secilit grup jepini një nga rastet për të analizuar. Kërkojuni nxënësve të shpjegojnë rastin, në dritën e nenit 23 të DUDNJ*

A shkelen të drejtat e punëtorëve në rastet e mëposhtme?

a. Ka punëtorë që punojnë në vende pune me orar të zgjatur. Ata ngrihen herët në mëngjes për të shkuar në punë dhe kthehen vonë natën. Paga e tyre është shumë e ulët dhe e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat bazë për ushqim, rroba dhe strehë.

b. Zakonisht qeveritë i quajnë grevat të dëmshme për ekonominë e vendit. Në këto raste i nxjerrin grevat e punëtorëve jashtë ligjit dhe krijojnë një organizëm që përbëhet nga anëtarë të biznesit, qeverisë dhe përfaqësues të sindikatave për t'u dhënë fund mosmarrëveshjeve



c. Në një sektorë shërbimi punojnë burra dhe gra. Burrat angazhohen në punë që kanë të bëjnë me ngritjen e peshave të rënda më shumë se gratë. Gratë paguhen 20% më pak në or se burrat.

d. Një familje në fshat ka ekonominë e vet private. Prindërit nuk e lejojnë djalin 14 vjeçar të ndjek shkollën me pretekstin se duhet të kujdeset për të kullotur lopët e familjes.

e. Minatorët e minierës së Bulqizës, ju duhet të nxjerrin mineral në galeri që nuk janë të sigurta. Ata avancojnë në brendësi të tokës dhe galeria që hapin nuk përforcohet për të qenë e sigurt. Minatorët i kërkojnë pronarëve të kryejnë punime në galeri që sigurisht kushtojnë. Pronarët refuzojnë të kryejnë punime përforcuese në galeri pasi kushton shumë. Gjithsesi ata shfajësohen me faktin se paga e minatorëve është më e lartë pikërisht për rreziqet që kanë në vendin e punës.

f. Pronari i një dyqani nuk mori në punë një grua si shitëse pasi i mungoni dy gishta të dorës dhe për pronarin kjo gjë do të bënte që klientët të ndiheshin jo mirë kur t'u shërbente.

**Thellohuni më shumë në kuptimin e nenit 23 dhe veprimeve konkrete që mund dhe duhet të ndërmerren për zbatimin e tij.**

1. Veprimtari kërkimore për veprimtarinë e sindikatave në vend: Gjeni fakte të historisë se sindikatave të ndryshme në vendin tonë, veçanërisht për përpjekjet e tyre për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve. Mund të ndaleni në raste të tilla që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve, barazinë e gruas në punë dhe diskriminimi i punëtorëve në vendin e punës.

2. Intervista me përfaqësues të sindikatave: Intervistoni përfaqësues të sindikatave, psh të sindikatave të mësuesve apo dhe të tjerë për: punën e tyre, problemet që i shqetësojnë dhe gjetjet bëji pjesë të debatit të përgjithshëm në klasë e shkollë.

3. *Ftoni në klasë përfaqësues të sindikatave:* Kërkojuni përfaqësuesve të sindikatave të flasni rreth veprimtarisë së tyre dhe përpjekjeve që bëjnë për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve. Për të siguruar dy pamje të problemit mundohuni të ftoni në klasë dhe përfaqësues të biznesit për t'ju prezantuar këndvështrimin e tyre rreth problemit. Kjo veprimtari mund të organizohet në formën e debatit ku nxënësit të sjellin argumentet e tyre po ashtu siç do të bëjnë ekspertët.

4. Punonjësit e ndërmarrjeve shtetërore a duhet të kenë sindikatat e tyre? Në kushtet e klasës organizoni një debat rreth çështjes: “..a duhet të organizohen në sindikata punonjësit e sektorit publik siç janë policët, personeli shëndetësor, mësuesit, punonjësit e ndërmarrjes së pastrimit të qytetit etj...?”

5. Solidaritet më punëtorët? Në komunitetin tuaj ka probleme të cilat janë të rëndësishme dhe që nxënësit e shkollës mund të japin kontributin e tyre? Evidentoni situata në të cilat nxënësit mund të mbështesin realizimin e të drejtave të punëtorëve. A ka mundësi që

nxënësit të kërkojnë mbështetjen e sindikatave në përpjekjet e tyre për të mbrojtur bashkëmoshatarët e tyre në puna e fëmijëve

---

#### **Neni 24**

Gjithkush ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, duke përfshirë kufizimin e arsyeshëm të orarit të punës dhe pushimin e paguar periodik.

#### Trajtim ligjor

Neni 24 rregullon një të drejtë ekonomike e sociale të rëndësishme. Nëse analizojmë me vemëndje përmbajtjen e nenit 24 vihet re se ai përmban katër parime të rëndësishme:

E drejta për pushim

E drejta për kohë të lirë;

Kufizimi i arsyeshëm i orëve të punës;

E drejta për pushime periodike me pagesë.

Secili nga këto parime ka gjetur rregullim në konventa të ndryshme. Kur flitet për të drejtën për pushim fjala është për pushim javor. Disa vende kanë ditë të ndryshme pushimi. Deklarara nuk përcakton se sa duhet të zgjasë pushimi javor. Ato përcaktohen nga konventa të ndryshme të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP). Në disa vende për të siguruar punësimin e një numri më të madh njerëzish orët e punës janë shkurtuar (fillimisht ka qënë 48 orë punë në 6 ditë pune)

*Pse lindi ky rregulli dhe si ka ndikuar në hartimin e dokumentave të mëpasshëm ndërkombëtarë?*

Nevoja e rregullit lindi bashkë me zhvillimin e industrisë dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në shumë dokumenta të mëvonshme, parimet e mësipërme u rregulluan më me hollësi.

Pakti për të Drejta Ekonomike Sociale dhe Ekonomike, neni 7, pika ç sanksionon se shtetet njhin të drejtën që ka çdo person të gëzuar kushte pune të cilat të sigurojnë ..... *pushimin, lejet, kufizimin e arsyeshëm të kohës së punës dhe pushimet periodike të paguara si dhe shpërblimin e ditëve të festave.*

Konventa “Për të drejtat e fëmijëve” neni 31 sanksionon se “ Shtete Palë i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe të argëtohet, të praktikojë lojra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike”.

Karta Sociale Europiane, në neni 2 sanksionon kushtet e punës, “të eliminoje rreziqet në punë vetvetisht të rrezikshme ose të pashëndetëshme dhe ku nuk ka qënë akoma e mundur, të eliminojë ose ulin këto rreziqe mjaftushëm, të marrë ose për një shkurtim të orëve të punës ose për pushime shitesë të paguara për puntorët e angazhuar në këtë punë”

Karta Sociale Europiane e ndryshuar neni 2, pika 5 sanksionon të drejtën për kushte e punës. Ajo këkron nga shtetet që të marrin masa:

Për orar pune ditor dhe javor të arsyshëm.

Për ditë pushimi publike të paguara.

Për një leje vjetore të paguar prej një minimumi prej katër javësh.

Të sigurojë një periudhë javore pushimi e cila, sa të jetë e mundur, të përkojë me ditën e njohur nga tradita ose zakoni në vendin ose rajonin në fjalë si një ditë pushimi.

Sipas direktivës 93 neni 104 të Këshillit të Bashkimit European, miratuar në 1993 sanksionon se pushimi minimal ditor duhet të jetë 11 orë në 24 orë; kur punëtori punon më shumë se 6 orë ka të drejtë pushimi, koha e pushimit javor në minimum duhet 24 ore

të pa ndërprera.... Orari javor i punës (maksimumi 48 orë) përfshin orarin jashtë orarit. Pushimi vjetor të jetë të paktën 4 javë.

*Si rregullohet përmbajtja e nenin 24 në legjislacionin shqiptar?*

Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 49. paragrafi 2 sanksionon se “të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës.” Ndërsa në nenin 54 të saj sanksionon mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi nëpërmjet punës, veçanërisht punësimi i fëmijëve nën moshën e lejuar për punë.

Konventat ndërkombëtare dhe parimet kushtetuese për këto probleme gjejnë një rregullim të zgjeruar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Në Kreun e IX “Kohëzgjatja e punës dhe e pushimeve” trajtohen mjaft prej këtyre problemeve.

Konkretisht, sipas legjit shqiptar:

Kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë. Për punëmarrësit nën 18 vjeç kohëzgjatja ditore e punës është jo më shumë se 6 orë në ditë. Pushimi ditorë është të paktën 11 orë pa ndërprerje brenda ditës osë në rast nevojë dy ditë rresht (neni 78 i kodit të punës).

Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë (neni 83 i kodit të punës).

Pushimi javor është jo më pakë se 36 orë, prej të cilave 24 orë pa ndërprerje. Pushimi javor përfshin ditën e djelë. Pushimi javor nuk është i pagueshëm (neni 85 i kodit të punës).

*Si zbatohet neni 24 i deklaratës lidhur me fëmijët nën moshën 18 vjeç?*

Kodi i punës përmban disa rregulla për mbrojtjen e veçantë të të miturve. Moshë minimale e punës është 16 vjeç. Bëjnë përjashtim rastet kur të miturit nga mosha 14-16 vjeç punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre.

Të miturit nga mosha 16-18 vjeç mund të punësohen në punë të lehta që nuk dëmtojnë shëndetin e dhe formimin e tyre”. Vetëm personat madhorë, mbi 18 vjeç, mund të punësohen në punë të vështira ose që paraqesin rrezik për shëndetin ose personalitetin e tyre”.

Pavarësisht nga rregullimet ligjore në realitet ka një sërë problemesh. Në vendin tonë disa profesione punojnë në sektorin jpublik ku orari i punës është më i gjatë se 8 orë. Ka disa shërbime publike si mjekët, punonjësit e policisë etj që punojnë më shumë se 48 orë në javë.

Situata paraqitet më problematike në sektorin privat ku punonjësit punojnë më shumë se 48 orë në javë , pushimet vjetore janë më pakë se 4 jave në vit, pushimet javore nuk respektohen si dhe fund java në mjaftë raste është punë.

Aspekte edukative

Diskutoni me nxënësit se si i kuptojnë ata të drejtat e paraqitura në nenin 24: e drejta për pushim; e drejta për kohë të lirë; kufizimi i arsyeshëm i orëve të punës; e drejta për pushime periodike me pagesë. Ndaluni në situata e mëposhtme dhe diskutoni gjerësisht rreth tyre.

a. I riu X, 17 vjeç, në periudhën e verës punon në ekonominë e familjes. Meqenëse ata kanë tokën e tyre, veçanërisht në verë, punët në bujqësi janë të shumta. X-i është i detyruar të punojë nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 6 të paditës edhe pse puna që bën nuk është e vështirë. Ditët e javës gdhihen dhe ngrysen njësoj. Nuk ka të diel apo ditë pushimi. Prindërit e tij thonë: "... është mirë të punojë, nga puna nuk ka asnjë të keqe, kur nuk punon tani që ka fuqi kur do të punojë..."

- Diskutoni a është i drejtë pretendimi i prindërve që X të punojë gjatë gjithë ditës për të ndihmuar familjen?
- Sipas mendimit tuaj, cilat nga të drejtat e mësipërme janë më të cenuara për të riun X, renditin ato sipas rëndësisë
- A ka pasoja për të riun X dhe cilat janë ato

b. Prindërit e Agimit punojnë në një firmë private nga ora 7:00- 20: 00 të mbrëmjes, çdo ditë me përjashtim të ditës së diel.

- Diskutoni nëse ka shkelje të legjislacionit në fuqi?
- Cilat janë pasojat e punës me orar të zgjatur tek personat që punojnë dhe te pjesëtarët e tjerë të familjes? Rendisni disa prej tyre.

c. Babai i Vjollcës është punonjës policie. Prej tre vjetësh nuk merr lejen vjetore pasi stafi i zyrës është i vogël në numër. Për rrjedhojë familja e Vjollcës ka tre vjet që nuk bënë pushime.

- Diskutoni cilat janë të drejtat e shkelura?
- A mund të flasim për të drejtat të cenuara për pjestarët e familjes së Vjollcës

d. Një pjesë e moshës së aftë për punë është e papunë. Qeveria në këtë situatë merr vendim për të uluar orët e punës nga 35 në 30 orë në javë, duke mundësuar rritjen e numërit të të punësuarëve Gjithashtu, më këtë rast paga mujore e punonjësit ulet.

- Diskutoni si e vlerësoni këtë politikë punësimi?

e. Në shkollë tonë po behen punime rikonstruktuese. Duke mos pasur klasa për të gjithë nxënësit, u vendos që mësimi të zhvillohej me dy turne, paradite dhe mbasdite. Drejtori i shkollës që është njeri shumë strikt dhe për të cilin ora e mësimi është e shënjtë, vendosi që orët e mësimi të zhvillohen të plota 45 minuta, por shkurtoj pushimet midis orëve dhe hoqi fare pushimin e gjatë.

- Diskutoni nëse vendimi i drejtorit të shkollës bie ndesh me të drejtat që duhet të zbatohen sipas nenit 24 për nxënësit dhe mësuesit e shkollës

f. Puna e fëmijëve shfrytëzon shtresën më të dobët dhe të ndjeshme të shoqërisë, fëmijët. Dihet se më shumë se 246 milionë fëmijë në botë, nën moshën 18 vjeç, janë të detyruar të punojnë. Pothuajse  $\frac{3}{4}$  e tyre, pra 180 milionë fëmijë, janë në rrezik për jetën. Shumë

prej tyre u mohohet e drejta për t'u arsimuar, si dhe janë viktima të dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike. Për shkak të punës, disa prej tyre pësojnë trauma që i bëjnë invalidë për gjithë jetën, të tjerë vdesin para se të arrijnë moshën e të rriturit. Në 15 vitet e fundit puna e fëmijëve ka marrë përmasa të konsiderueshme edhe në vendin tonë. Gjithkush duhet të jetë pjesë e luftës që duhet bërë për të sensibilizuar shoqërinë ndaj kësaj page të rëndë për ta shkundur atë nga indiferentizmi dhe çka është më e rëndësishme për të ndërmarr veprime konkrete për të zhdukur punën e fëmijëve.

Fëmija X, 12 vjeç, punon gjithë ditën në një lavazh. Pronari i lavazhit mendon se është e drejtë që fëmija të ardhurat e tij ndihmojnë familjen të mbijetojë. Fëmija nuk ndjek shkollën, gjithë ditën është i ekspozuar ndaj të ftohtit në dimër dhe temperaturave të larta gjatë verës. Pra fëmija X nuk ka mundësi të shkollohet dhe të rritet normalisht si të gjithë fëmijët e moshës së tij. Puna e vështirë, gjithë ditën në lagështi, larg shokëve, shkollës, padyshim sjellin probleme në zhvillimin normal fizik si dhe në zhvillimin intelektual dhe emocional.

- Diskutoni rreth historisë së fëmijës X. Diskutimi duhet të orientohet nga mësuesi, që të mos trajtohet vetëm në planin e shkeljes së të drejtave. Gjatë diskutimi mund të evidentohet fakti që shumë fëmijë mund të punojnë për të ndihmuar familjet e tyre të mbijetojnë, po ajo që është shumë e rëndësishme në këto raste është diskutimi që mund të nxisni për masat mbrojtëse dhe kufizuese që duhet të ndërmerren për punën e fëmijëve. Pyesni nxënësit të përcaktojnë kushte të drejta pune ( të njëjta për djemtë dhe vajzat) dhe të përshtatshme për fëmijët (që paguhet me korrektësi, që është e sigurt dhe i jep mundësi fëmijëve të mësojnë në shkollë dhe të kenë kohë të lirë). Diskutimi rreth kësaj çështje duhet të nxis nxënësit të reflektojnë për rolin e tyre si konsumatorë të shërbimeve që ofron fëmija X.

**Neni 25.**

Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

Nënat dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martese, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale.

Trajtim ligjor

Neni 25 është një nen i cili ka lidhje të ngushtë me nenin 22 të DUDNJ-së. Neni 22 është neni bazë që i referohet të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për dinjitetin e njeriut dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit. Gjithsesi neni 22 është mjaft i përgjithshëm e i referohet në përgjithësi të drejtave të atilla që garantojnë një jetesë të përshtatshme për individët. Ndërkohë edhe pse neni 25 ka të njëjtin qëllim është më tepër specifik se sa neni 22 në deklaratimet e veta.

Neni 25 është një deklaratë e fuqishme në mbrojtje të një jetese normale të njerëzimit. Ai deklaron që çdokush ka të drejtën të gëzojë një jetesë të mirë: të ketë një strehë ku të strehohet, të mos i mungojë ushqimi e veshmbathja në jetë dhe të mund të gëzojë mbështetje në rastet kur ai vetë nuk e siguron dot me punën e tij jetesën normale. Kjo gjendje konsiderohet se është e drejtë e çdokujt dhe e familjes së çdokujt. Ka disa grupe në shoqëri që për shkak të gjendjes së tyre në nevojë, si fëmijët dhe nënat apo të papunësuarit dhe personat me aftësi të kufizuar, duhet të kenë më shumë kujdes dhe ndoshta një kujdes pak më të posaçëm. Pra në thelb, ky nen deklaron që çdokush ka të drejtë të gëzojë disa standarde minimale jetese edhe atëherë kur nuk është në gjendje të sigurojë vetë këto standarde apo kur shoqëria nuk ia mundëson. Neni në fakt ka një shtrirje shumë të gjerë sepse ai i referohet jo vetëm këtyre që u përmendën por edhe garantimit të barazisë mes fëmijëve të lindur brenda apo jashtë një martese duke garantuar kështu një jetë sa më normale edhe për atë që nuk lind në një familje të modelit tradicional të njerëzimit.

Neni 25 u hartua fillimisht si një nen që përfshinte jo vetëm të drejtat por edhe përgjegjësitë e shteteve përkatëse për realizimin e këtyre të drejtave. Përfshirja e përgjegjësisë së shteteve në DUDNJ do të thoshte që realizmi i këtyre të drejtave do të ishte edhe më shumë i mundur. Në fakt, të drejtat me karakter sociale, ekonomik e kulturor janë të atilla që kërkojnë ndërhyrjen e shtetit pa të realizohen, përndryshe ato mbeten vetëm të shkruara në letër dhe nuk shndërrohen në realitet. Këto të drejta janë të ashtuquajtura pozitive, që nënkupton domosdoshmërinë e ndërhyrjes së shtetit për realizimin e tyre. Megjithatë teksti përfundimtar i këtij neni u pranuar i tillë që i referohej vetëm të drejtave dhe jo edhe përgjegjësisë. Shtet e pranuan këtë si një kompromis që detyrimi i shteteve së pari është i përgjithshëm në tekstin e DUDNJ-së dhe së dyti do të përfshihej në një Konventë të posaçme. Dhe në fakt, u Miratua nga kombet e bashkuara

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Sociale, Ekonomike e Kulturore që përfshinte të specifikuarat të drejta e detyrime të shteteve. KA disa nene të këtij Pakti që i referohen të drejtave të nenit 25 të DUDNJ-së, duke qenë kështu pra edhe më shumë gjerësisht të përfshira në Pakt.

#### *Një nen deklarativ?*

Duket sikur neni 25 është më shumë deklarativ se nenet e tjera të DUDNJ-së. Kjo sepse të drejtat për të cilat neni flet nuk janë reflektuar gjerësisht në dokumentet e tjerë ligjorë apo në Kushtetutat e vendit. Përgjithësisht shtetet janë skeptike të pranojnë si të drejta të njeriut të drejtën për një strehim apo punë. Mund të përmendet rasti i Evropës si një rast shumë pozitiv në respektimin e të drejtave të tilla ekonomike, sepse Këshilli i Evropës ka miratuar Kartën Sociale e shndërruar më pas në Kartën Sociale të Rishikuar e cila jo vetëm që përmbledh të drejta të tilla, por edhe i bën ato të detyrueshme për zbatim për shtetet që e kanë pranuar këtë Kartë.

#### *Një nen tradicionalist?*

Ky nen gjithsesi ka pasur edhe kritika sepse mendohet që meqë përmend vetëm nënat për kujdesin e veçantë që duhet të gëzojnë, duket sikur miraton rolet tradicionale të sekseve. Duket sikur thotë që interesat e nënave nuk janë thjesht të njëjta me ato të baballarëve apo të njerëzve të tjerëve që vuajnë nga një kufizim i përkohshëm në aftësinë e tyre për punë. Edhe pse mund të ketë një këndvështrim të tillë, DUDNJ nuk ka pasur aspak si qëllim të theksojë rolet tradicionale në shoqëri. Duhet kuptuar që gjendja fizike, emocionale, apo kognitive, si dhe tradicionale e grupeve të shoqërisë që përmenden në nen ka qenë dhe është e tillë që kërkon një kujdes të veçantë për to. Fëmijët e nënat janë të 'dobët' dhe nuk mund të tregojnë aq kujdes dhe të kenë aq mundësi të mbrojnë të drejtat e tyre sa grupet e tjera të shoqërisë. Këto grupe të shoqërisë janë edhe më të favorshme për t'u shfrytëzuar nga të tjerët dhe kështu DUDNJ duke njohur këtë gjendje vulnerabel të tyre deklaroi që këto kanë nevojë për një kujdes të posaçëm nga shteti. Kjo është ajo që njihet me emrin diskriminim pozitiv që është përmendur edhe në lidhje me të drejta të tjera të parashikuar në DUDNJ.

#### *Një nivel jetese i mjaftueshëm*

Që individët të kenë një nivel jetese të mjaftueshëm duhet që të gëzojnë disa elementë bazë të jetës. Të kenë disa pasuri ndoshta që të mund të garantojnë ose strehimin ose gjenerimin e të ardhurave. Kjo patjetër që kërkon garantimin e të drejtës së pronësisë, e cila në fakt është e përfshirë nga DUDNJ. Njerëzit duhet të gëzojnë të drejtën për punë sepse duke gëzuar këtë atë kanë një bazë për pavarësi, duke siguruar që puna është zgjedhur në mënyrë të lirë nga individ, ai po siguron të ardhura të mjaftueshme nga puna e tij/saj dhe edhe që njerëzit mund t'i mbrojnë interesat e veta të punës nëpërmjet organizmave të ndryshme që krijohen për këtë qëllim. Po kështu, niveli i mjaftueshëm i jetesës kërkon që edhe nëse individët nuk kanë pronësi apo punë dhe nuk mund të gjenerojnë të ardhura të mjaftueshme për të, të mund të përfitojnë nga skema të ndryshme që shteti miraton për të ndihmuar këta persona që gjenden në situata në nevojë. Që individët të gëzojnë një nivel jetese të mjaftueshëm duhet që shteti të jetë mjaft aktiv në realizimin e të drejtave me karakter social, ekonomik e kulturor. Sigurisht që fillimisht është personi ai i cili ka detyrë të sigurojë jetesën e tij në nivel të mjaftueshëm, por shteti



është gjithmonë ai që siguron këtë. Sigurisht që shteti duhet së pari të mundësojë individët të realizojnë të drejtat e tyre dhe së dyti të ndihmojë ato në realizimin e këtyre të drejtave.

### *E drejta për ushqim*

Neni 25 flet për të drejtën për të pasur ushqim. Ky nen i referohet jo vetëm të drejtës për të siguruar ushqimin por edhe për të siguruar një ushqim me një cilësi të caktuar. Duke gëzuar këtë të drejtë individ i krijon baza për të gëzuar edhe të drejta të tjera. Neni sigurisht nuk flet për shkallëzime të plotësimi të kësaj të drejte, por mundet fare mirë thuhet që kjo e drejtë mund të realizohet në shkallë të ndryshme në varësi të kushteve të secilit individ, edhe pse qëllimi i nenit është sigurimi i plotë i ushqimit në çdo kohë. Duhet theksuar elementi kohë, sepse ka situata emergjence në të cilat ndoshta ushqimi nuk mund të realizohet në shkallën e duhur. Jo më kot në kësi situatash ekzistojnë dhe zbatohet programet shtesë për ushqimin dhe veshmbathjen. Jo më kot programe të tilla janë zhvilluar për vende të varfra të botës tek të cilat ka përqendruar vëmendjen edhe Kombet e Bashkuara. Kështu pra, sigurimi i ushqimit në kuptim të nenit 25 është kuptuar dhe zbatuar në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe vetjak i ushqimit.

### *Strehimi*

DUDNJ kërkon që individëve t'i sigurohet një strehim, konsideruar ky si element i domosdoshëm i një jete të përshtatshme. Dihet që gjendja është krejt ndryshe nga ajo që mund të synojë DUDJ-ja. Ka shumë individë në botë që janë të pastrehë. Kjo e drejtë nuk mund të interpretohet si një e drejtë që individ i gëzon në grup. Nuk mund të pretendohet që e drejta e strehimit është një e drejtë e familjes e më tepër e asaj tradicionale në krye të së cilës ndodhet mashkulli. Kjo është e drejtë që i përket individit, duhet t'i njihet grave si kryefamiljare apo edhe grupeve të ndryshme që dëshirojnë të ndajnë së bashku strehimin. Kjo është një e drejtë që i njihet individëve pavarësisht moshës, gjendjes ekonomike, grupimit të cilit i përkasin e kështu me radhë. Pra, askush s'mund të diskriminohet nga gëzimi i kësaj të drejte. Megjithatë, pavarësisht nga parashikimi i DUDNJ-së, kjo është një e drejtë e cila nuk është garantuar nga shumë vende, kjo sepse është një e dajret që kërkon burime jo të pakta financiare që të realizohet. Garantimi i kësaj të drejte varet shumë edhe nga politikat sociale që një shtet zhvillon dhe nga burimet e një shteti të cilat sigurisht ndryshojnë nga një shtet në tjetrin.

Së fundi, duhet thënë se kjo e drejtë nuk duhet kuptuar vetëm si sigurimi një banese nga ana e shtetit, por edhe garantime të tilla si njohja e së drejtës së pronësisë dhe siguria juridike në gëzimin e pronës banesë, pasja e shërbimeve, lehtësirave, infrastrukturës si uji, energjia elektrike, ngrohja, mjetet sanitare, kanalizimet, e kështu me radhë, hapësira publike për të pasur akses në banesë, përfshirë këtu edhe akses të përshtatshëm për personat e paafte fizikisht, afërsi të banesës me qendrat në të cilat mund të gjendet punë, ndihmë shëndetësore e shoqërore, të ketë akses në arsim, e të tjera si këto.

### *Marrëdhëniet e punës*

Ky nen i DUDNJ-së ka të bëjë me të drejta që lidhen me marrëdhëniet e punës. Ai flet për kushte të favorshme pune, edhe pse nuk i përcakton se cilat do të ishin këto lloj kushtesh. Neni kërkon që në vendet e punës të jenë pasqyruar dhe integruar elementët e

mbrojtjes së të drejtave të njeriut, pra elementë që sigurojnë mbrojtjen e “dinjitetit të njeriut” edhe në vendet e punës. Kjo është përkthyer në forma të ndryshmet në dokumente ndërkombëtare e kombëtarë. Organizata Botërore e Punës, krijim i Kombeve të Bashkuara ka punuar jashtëzakonisht shumë që të përcaktohen në mënyrë të detajuar të gjitha standardet e kërkuara për një punë në kushte të favorshme.

#### *Statusi i fëmijëve dhe nënave*

Neni 25 synon që grupet të cilat janë më në nevojë se të tjerët në një shoqëri të gëzojnë një mbrojtje dhe kujdes më të posaçëm nga shteti. Neni 25 është shumë i kufizuar në deklarimin e kësaj gjendje dhe nevoje për kujdes, dhe jo më kot u zhvilluan Konventa të posaçme për këto kategori dhe për detajimin e të drejtave që ato gëzojnë, siç është Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminim ndaj Gruas, e të tjera si këto. Në fakt theksimi i këtyre dy kategorive nga DUDNJ lidhet shumë me riprodhimin dhe vazhdimin jetës edhe pse aspak nuk duhet kuptuar se kjo është një gjendje që lidhet vetëm me nënën. JO më kot eksitojnë norma të posaçme mbi riprodhimin, mbi lehtësirat që ka një grua pas lindjes si p.sh. e drejta për të qëndruar në shtëpi pranë fëmijës dhe ruajtja e vendit e punës, etj.

Në lidhje me fëmijët, DUDNJ kërkon që edhe fëmijët të cilët lindin nga një nënë jo e martuar në përputhje me ligjet e një vendi të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe përfitime si dhe fëmijët të cilët kanë lindur nga një martesë. Kjo erdhi pa dyshim si rezultat i braktisjes së fëmijëve që lindin jashtë një martese dhe i keqtrajtimit të tyre si nga personat që i lindin ashtu edhe nga shoqëria. Pa dyshim që DUDNJ duke kërkuar gjendje të njëjtë nuk mund të ndryshojë qëndrimet shoqërore por ajo kërkon garanci ligjore për trajtim të njëjtë të këtyre qenieve njerëzore.

### Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Në Kushtetutën e vendit tonë ka një sërë nenesh që synojnë të garantojnë një nivel jetese të mjaftueshme. Ka disa nene të cilat janë pjesë e të drejtave të njeriut ashtu siç ka edhe ne të cilat janë pjesë e objektivave shoqërore që shteti ka marrë përsipër t'i realizojë sipas mundësive.

Në tërësinë e **të drejtave themelore** përfshihen:

- e drejta për të zgjedhur lirisht punën Neni 49
- e drejta e mbrojtjes shoqërore të punës. Neni 49
- E drejta për të pasur sigurim shoqëror sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë e shëndetësor sipas ligjit Neni 52 dhe Neni 54
- e drejta për të pasur ndihmë ekonomike kur individi ka mbetur pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij (në përputhje me ligjin) Neni 52
- mbrojtja e veçantë nga shteti e fëmijëve, të rinjve, grave shtatzëna dhe nënave të reja Neni 54
- barazi në të drejta mes fëmijëve të lindur jashtë martesë me ato të lindurit nga martesë. Neni 54
- mbrojtje e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal. Neni 54
- gëzim në mënyrë të barabartë i të drejtës për kujdes shëndetësor nga shteti. Neni 54

Shteti ynë, në nenin 59 të Kushtetutës, ka përcaktuar si **objektiva sociale**, ndër të tjera, edhe:

- a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;
- b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;
- c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;
- ç) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- dh) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;
- ë) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paafteve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës; .....

Duhet kuptuar se objektivat sociale shteti merr përsipër t'i realizojë brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon. Askush nuk mund të pretendojnë që shteti nuk ka realizuar një objektiv social dhe të kërkojë realizimin e tij me forcë dhe duke përdorur mjete ligjore, sepse këto janë thjesht qëllime që shteti i vë vetes por që varen nga mjetet që shteti ynë disponon, përfshirë këtu mjete financiare, burimesh natyrore apo njerëzore.

### **Dokumente të tjera Ndërkombëtare**

Neni 25, duke kërkuar një standard të përshtatshëm jetese, gjeti reflektim në shumë dokumente ndërkombëtare. Kështu mund të përmendim:

PNDESK, Neni 10 flet për mbrojtjen e familjes, neni 11 i referohet standardit të jetesës së njerëzve; neni 12 flet për të drejtën për përkujdesje mjekësore; etj  
Konventa mbi Eliminim e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Femrave, është një konventë e cila në tërësinë e saj kërkon një përkujdesje ndaj grave e nënave

## Aspekte edukative

Në të gjitha vendet ekziston pabarazia shoqërore e qëndrueshme, pavarësisht ngjyrimave politike dhe nivelit të zhvillimit të tyre. Shumë vende nuk janë në gjendje të sigurojnë për popullsinë e tyre nivelin minimal të ushqimit, të nevojës për ujë, arsim, sistem shëndetësor dhe shtëpi për të jetuar. Kjo gjë nuk ka të bëjë vetëm me mungesën e burimeve financiare por është rezultat i mungesës së vullnetit të mirë për të ndryshuar gjerat, i neglizhencës dhe diskriminimit nga pushtetarët dhe të tjerët. Shumë grupime shoqërore janë të detyruar të jetojnë në këto kushte për të vetmin fakt se i përkasin pikërisht këtij grupimi.

Plotësimi i të drejtave ekonomike, shoqërore dhe kulturore përfshinë në radhë të parë të drejtat për ushqim, për të pasur një shtëpi, për të pasur një sistem të kujdesit shëndetësor si dhe për t'u arsimuar. Mungesa apo kufizimi i resurseve financiare ende nuk përbën shkakun kryesorë të shkeljes apo mohimit të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore dhe aq më tepër, nuk mund të shërbejë si justifikim për t'u mohuar këto të drejta individëve të veçantë apo grupeve shoqërore. Sot në botë ka shumë grupime shoqërore siç janë minoritetet etnike, gratë, anëtarë të opozitës apo të feve të ndryshme, njerëzit që janë me HIV/AIDS, të sëmurët mendor e shumë të tjerë, janë apo rrezikojnë të jenë pre e diskriminimit dhe pabarazisë .

Në realizimin e këtyre të drejtave duket që kanë dështuar edhe qeveritë e vendeve më të fuqishme, pasi nuk kanë plotësuar detyrimet e tyre për të zhdukur urinë, për parandalimin e sëmundjeve të mundshëm, për të zhdukur analfabetizmin dhe për të siguruar strehë për çdo njeri në vendin e tyre dhe më gjerë. Pavarësisht shqetësimit që shprehin dhe deklaratave të qëllimeve të mira që kanë, komuniteti ndërkombëtar i përfaqësuar nga qeveri të ndryshme, nënvleftëson të drejtat e milionave njerëzve.

Të drejtat e njeriut janë të pandara, ato janë të barabarta dhe të njëjleftshme. Asnjë e drejtë nuk mund të realizohet e izoluar nga të drejta e tjera. Kështu psh. plotësimi i një prej të drejtave që është ajo e shprehjes së lirë nuk mund të arrihet pa plotësimin e të drejtës për arsim, po kështu e drejta për jetën realizohet kur hedh hapa konkrete për të ulur mortalitetin e fëmijëve, për të zhdukur kequshqyerjen etj.

Shkelja e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore nuk kushtëzohet vetëm me mungesën e mjeteve financiare, ajo është çështje e politikave të ndërmarra.

Cenimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore konstatohen në ato situata kur politikat dhe praktikat e një shteti anashkalojnë dhe neglizhojnë obligimet që rrjedhin nga DUDNJ. Një farë skepticizmi që është shfaqur në lidhje me përcaktimin e këtyre të drejtave ka qenë i lidhur me një farë paaftësie dhe nënshtrimi ndaj shifrave të frikshme

Të dhënat për shkeljet e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore janë alarmante. Madje ka qenë kjo arsyeja që ka pasur një farë rezistence për ti cilësuar këto si të drejta të njeriut. A mund që 840 milion njerëz që nuk kanë të siguruar ushqimin e përshtatshëm të kategorizohen si viktima të shkeljes së të drejtave të njeriut? Hezitimi i

parë për të njohur të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore lidhej me vështirësitë që paraqiste monitorimi dhe vlerësimi progresiv i realizimit të tyre.. Edhe pse janë bërë përpjekje për të përcaktuar këto tregues procesi ka qenë i avashtë. Përkundrajt kësaj ka pasur një progres të konsiderueshme në realizimin e “përjasjes bazuar në shkeljen e këtyre të drejtave” duke identifikuar gjendjen, dështimet ndaj detyrimeve apo ndaj një grupi minimum detyrimesh.

Shumë organizata që punojnë në fushën e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore kanë përqafuar këtë përjasje duke zbatuar shumë nga këto teknika të konceptuara për të monitoruar shkeljen e të drejtave civile dhe politike.

### **Çfarë përbënë shkelje?**

Kuadri i vlerësimit të shkeljeve të mundshme të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore përbën një situatë kur shtetet:

- dështojnë në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave apo që politikat e tyre pengojnë në plotësimin e tyre (psh. duke filluar nga dëbimet masive të popullsisë deri në dështimet që kanë në rregullimin e shërbimeve në sektorin privat)
- zbatojnë politika që mbartin diskriminimin e grupeve të caktuara
- dështojnë në realizimin e disa obligimeve themelore (psh. sigurimin e arsimit të detyruar fillore)
- në zbatim të ligjit përcaktojnë kufizime që nuk njihen nga ligjet ndërkombëtare
- vonojnë apo ndalojnë realizimin e vazhdueshëm të të drejtave ( për mungesë fondesh apo për ngjarje të paparashikueshme dhe të parkontrollueshme, (psh. mbyllja e shkollave në rastet e konfliktit të armatosur.

Shkelje përbënë dhe fakti kur një shtet nuk merr masa për të kapërcyer një vështirësi apo kur ndalon apo detyron të tjerët që të mos plotësojnë të drejtat.

Në rastet kur shteti nuk ka mundësi të plotësojë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, për arsye objektive, nuk mund të thuhet se shtetit shkel apo nuk plotëson detyrimet e tij ndërkombëtare.

Deklaratat për dështim në plotësimin e të drejtave nuk është e lehtë të vlerësohen veçanërisht për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore të cilat kushtëzohen nga burimet e disponueshme të një shtetit. Gjithsesi mund të veçojmë tre lloje shkeljesh të detyrimeve të shtetit për të përmbushur të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore:

- **Masa degraduese**, në të cilat përmblihen:
  - Hartimi dhe zbatimi i politikave të reja që të largojnë nga përmbushja e të drejtave
  - Mungesë e konsiderueshme e investimeve në shërbimet sociale që nuk justifikohen nga niveli i përgjithshëm i rënies ekonomike të vendit
  - Rialokimi i investimeve të pajustificuar në sektorë të tjerë, psh shpenzimet ushtarake, të cilat nuk kontribuojnë në realizimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.
- **Realizim diskriminues i të drejtave**
  - Mosdiskriminimi është detyrim i drejtpërdrejtë që përshkon të gjitha detyrimet e respektimit, mbrojtjes dhe plotësimit të të drejtave
  - Miratimi i ligjeve dhe zbatimi i praktikave të papajtueshme me parimin e mosdiskriminimit rrit probabilitetin e shkeljes së të drejtave të njeriut

- **Dështimi i përcaktimit të prioriteteve themelore** në ato raste shumë të prekshme kur ndërmerret një veprim për të plotësuar të drejta që në vetvete mbart shkelje të këtyre të drejtave.

Prej vitit 1980, militantë të të drejtave të njeriut kanë krijuar një rrjet ndërkombëtar për të advokuar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Qëllimi i kësaj nisme është evidentimi i praktikave të mira dhe shkëmbimi i përvojave pozitive në gjithë botën. Përpyekjet e kësaj lëvizje kanë shënuar disa suksese në njohjen e dhunimit të të drejtave të disa grupeve shoqërore si dhe kanë punuar për të sensibilizuar opinionin gjerë për rëndësinë e atyre të drejtave që kanë të bëjnë me arritjen e dinjitetit njerëzor. Lufta e tyre bëhet nën moton:

“Dinjiteti i individit nuk mund dhe nuk duhet të ndahet në dy pjesë – në të drejta civile dhe politike dhe në të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore. Qëllimi i fundit i sigurimit të respektit për dinjitetin e çdo individi nuk mund të arrihet nëse ky njeri nuk gëzon të gjitha të drejtat”

## **Veprimtari**

### **Tema: Nevojat e njeriut dhe të drejtat e njeriut.**

Materialet: Përgatisni një fletë për secilin nxënës ku jepet identiteti i një personi psh. Mashkull, 5 vjeç; Mashkull, 10 vjeç; Mashkull, 15 vjeç; Mashkull, 25 vjeç; Mashkull, 40 vjeç; Mashkull, 60 vjeç; Femër, 5 vjeç; Femër, 10 vjeç; Femër, 15 vjeç; Femër, 25 vjeç; Femër, 40 vjeç; Femër, 60 vjeç;

#### 1 Organizimi i aktivitetit

- a. Secili nxënës duhet të vizatojë një kartë ku të përcaktohet identiteti i tij.
- b. Kërkoji secilit të gjej partnerin dhe të ulen në bankë së bashku. Nxënësit duhet të diskutojnë midis tyre se çfarë i duhet një personi në këtë moshë që të jetojë. Shpjegojuni që nevojat mund të jenë: fizike, shpirtërore dhe emocionale apo mendore.

#### 2. Raportimi rreth atyre gjërave që janë të nevojshme për të jetuar.

- a. Pyet “Kush është më i vjetër?” Kur çifti 60 vjeçarë të jetë identifikuar, pyetini “Çfarë ju nevojitet për të jetuar?” Nxitini të futen në role duke folur me ton të avashtë të një burri dhe gruaje 60 vjeçare. Ndërsa ata flasin, një ndihmës shënon në dërrasë të zezë, poshtë titullit “E nevojshme për të jetuar”, përgjigjet që japin 60 vjeçarët.

- Për të gjitha çështjet që evidentohen pyet nëse kemi të bëjmë me “..nevoja fizike, shpirtërore, emocionale apo mendor?”
- Pyet gruan: “A keni ndonjë nevojë të veçantë pasi jeni grua?”. Të njëjtën pyetje bëjani “burrit”. Shënoni me një simbol të veçantë (burrë, grua) të gjitha çështjet që lidhen me gjininë.

#### **Nevoja fizike**

Të nevojshme për të jetuar

Të nevojshme për zhvillimin e plotë

Të kërkuara

### **Nevoja emocionale dhe shpirtërore**

Të nevojshme për të jetuar

Të nevojshme për zhvillimin e plotë

Të kërkuara

### **Nevoja intelektuale ose mendore**

Të nevojshme për të jetuar

Të nevojshme për zhvillimin e plotë

Të kërkuara

b. Pyet se “Cili është më i ri?”, Pyet çiftin 5-vjeçar të identifikojë vetveten. Vazhdoni të pyesni “Çfarë ju duhet për të jetuar?”, “Disa nga nevojat tuaja gjenden në listën e saposhkuar?”. Nxitini të interpretojnë rolin që kanë, të një fëmije 5 vjeçar. Shëno me një shenjë të veçantë nevojat që përsërisin nevojat e çiftit të parë.

c. Pyet “A keni ndonjë nevojë të veçantë meqenëse jeni kaq të vegjël?” apo “A keni ndonjë nevojë që është e ndryshme nga ajo e çiftit 60 vjeçar?”. Shtoni çështje të reja dhe shënoni ato nevoja të veçanta të fëmijëve nga të moshuarve.

- Për çdo çështje mos harroni të pyesni “Është nevojë fizike, shpirtërore, emocionale apo mendor?”
- Pyet “vajzën” “a ke ti ndonjë nevojë të veçantë meqë je një fëmijë vajzë?”. Të njëjtën pyetje bëjani djalit. Shënoni të gjitha çështjet gjinore me simbolin e veçantë për djemtë dhe vajzat.

Shënim: Zakonisht, çifti i fëmijëve përdor “dashurinë”, “familjen”, “nënë”, në përcaktimin e nevojave emocionale. Nëse në rastin e çiftit të moshuar nuk është përmendur “familja” pyeti “A i duhet familja një 60 vjeçari për të jetuar?”

d. Përsëriti të njëjtat pyetje, për të gjitha çiftet, sipas moshës duke bërë kujdes të nënvizosh me simbolet përkatëse çfarë është e ndryshme midis fëmijëve dhe të rriturve, midis grave dhe vajzave, midis meshkujve dhe femrave.

3. Raportim rreth asaj se çfarë nevojitet për zhvillimin e plotë.

a. Riktheju dhe pyeti të gjithë çiftet “ Çfarë ju duhet më shumë që të jeni të lumtur dhe të realizoni në maksimum veten?”

b. Vazhdo të pyesësh dhe shënoji dallimet moshore sipas nevojave (psh. gruaja dhe burri i pjekur kanë nevojë për këshillim në çështje të planifikimit familjar; vajzat dhe gratë kanë nevojë për mbrojtje nga dhuna seksuale; personat e moshuar kanë nevojë për kujdes të veçantë si psh. mbrojtje në raste emergjence).

c. Pyet për dallimet mbi bazë gjinie dhe shënoji ato sipas (psh. gruaja në moshën e pjellorisë ka nevojë për mbrojtje të veçantë dhe shërbime mjekësore gjinekologjike, obsektrike dhe shërbime për përmirësimin e ushqimit).

4. Raportoni për rubrikën “Të kërkuara”: Pyet “ përveç gjërave që ju nevojiten për të jetuar dhe janë të domosdoshme për zhvillimin e plotë , a ka gjëra të tjera që ju do të dëshironit ti kishit për të qenë më të lumtur?”. Përgjigjet më tipike janë: lodra, veshje të markave të njohura, biçikletë, lodra elektronike, produkte kozmetike, bizhu etj.

Shënim: Në këtë moment të zhvillimit të aktivitetit përgjigjet mund të jenë shumë zbavitëse pasi të gjithë janë futur në rol ( psh 60-të vjeçari do të dëshironte të kishte një

mike të re, ndërkohë që 60-të vjeçarja do të kishte dëshira të tjera krejtësisht të kundërta). Nxisini fantazinë e gjithkujt në përgjigjet.

5. Lidhini nevojat e njeriut me të drejtat e njeriut:

a. Ky aktivitet evidenton faktin që qeniet njerëzore kanë nevojë për të njëjtat gjëra për të jetuar dhe për tu zhvilluar plotësisht me disa dallime të rëndësishme që kushtëzohen nga mosha dhe seksi.

b. Nënvizoni faktin që të drejtat e njeriut bazohen në nevojat e njeriut. Këto gjëra ne na duhen jo vetëm për të jetuar por njëkohësisht për të jetuar me dinjitet dhe për të zhvilluar tërësisht potencialin tonë.

c. Rrethojini të gjitha çështjet që janë renditur nga nxënësit si “të domosdoshme për të jetuar” dhe “të nevojshme për të realizuar zhvillimin e plotë”, dhe shpjegojuni se të gjitha këto lidhen me të drejtat e njeriut. Të drejtat e njeriut përshkojnë të gjitha çështjet që janë renditur (psh. nëse nxënësit kanë shënuar ushqim dhe familje ju mund ti shpjegoni se “ju keni të drejtën për ushqim të mjaftueshëm”, “Ju keni të drejtë të martoheni dhe të krijoni familje. Kërkojuni nxënësve të lidhin nevojat e tyre me nenet e ndryshme të DUDNJ).

Shënim: Edhe pse nevojat e identifikuar nuk mund të parashikohen, gjithsesi ato mund të interpretohen nga disa nene të DUDNJ (psh. “paqja” dhe “siguria” ceken në nenin 3 dhe 28). Në këtë moment të diskutimit anashkaloni ato çështje që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me DUDNJ (psh, “pastërti mjedisore”. “spital”, apo “elektricitetit”, etj të cilat nuk janë të garantuara specifikisht në DUDNJ). Kthejuni këtyre çështjeve më vonë kur do të diskutoni për natyrën e ndërsjellët dhe gjithmonë në zhvillim të të drejtave të njeriut.

6. Diskutoni për marrëdhëniet që ekzistojnë midis nevojave të njeriut dhe të drejtave të njeriut.

a. Nxitini nxënësit të diskutojnë rreth të drejtës së njerëzve që të kenë të garantuar të drejtat e tyre bazë.

b. Pyetini nxënësit cili është përgjegjës për realizimin e të gjitha nevojave.

- Nënvizoni faktin që qeveritë, ligjërisht marrin përsipër për të plotësuar këto të drejta nëse nënshkruajnë dhe ratifikojnë dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve si dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të cilat, të specifikuar përmbajnë këto obligime.
- Nënvizoni gjithashtu faktin se organizata të ndryshme si dhe individë kanë përgjegjësi. Tregojuni nxënësve se cilat mund të jenë veprimtaritë që ata mund të ndërmarrin për të mbrojtur të drejtat e njeriut

7. Thellohuni më tej

Nxitin nxënësit të njihen me përmbajtjen e Konventave të Kombeve të Bashkuara për të drejtat dhe nevojat si psh. Konventa për të Drejtat e fëmijëve, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore apo Konventën Kundër të Gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave. Krahasoni dispozitat e tyre në lidhje me domosdoshmërinë e jetës dhe standardeve të përshtatshme për jetën me nenin 25 të DUDNJ.

## **Diskutim**



Objektiva : Në përfundim të diskutimit për nenin 25 nxënësit:

- Do të njihen dhe familiarizohen me problemet kryesore që trajtohen në të
- Do të qartësohen mbi mënyrën se si ky nen është përkthyer në dokumente kryesorë kombëtarë e ndërkombëtarë
- Do të kuptojnë pse ky nen ka karakter deklarativ dhe vështirësitë e realizimit të tij
- Do të mendojnë në mënyrë kritike lidhur me rrugët për mirërealizimin e tij
- do të ndërjegjësohen për nivelet e ndryshme të respektimit të këtij neni në kohë, hapësirë dhe individë.

### **Hapi i parë (10 min)**

Një nxënës lexon nenin 25 të DUDNJ

1. Cilat janë përshtypjet e para pas leximit të parë të nenit 25?

### **Hapi i dytë (15 min)**

2. Cilat janë problemet kryesore që trajton neni 25.

- a. Ushqimi
- b. Strehimi
- c. Punësimi
- d. Statusi i vecantë i grave dhe fëmijëve (dhe i atyre të lindur jashtë martese)

Të ndarë në grupe sipas secilës problematikë nxënësit diskutojnë mbi detyrimin e përcaktuar në nen për problemin përkatës. Duke iu referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, secili grup ballafaqon kërkesën e këtij neni, detyrimet përkatëse që rrjedhin nga Kushtetuta dhe situatën konkrete të realizimit të tij (edhe përmes sjelljes së rasteve konkretë).

### **Hapi i tretë (15 min)**

Zëdhënësit e grupeve raportojnë në grupin e madh mbi problemet e dala gjatë diskutimit në grupin e vogël. Secilit grup i jepet një kohë prej 3-4 minutash.

Në përfundim të cdo diskutimi mësuesja pyet grupet e tjerë për opinionin e tyre dhe sipas rastit bën përmbledhjen dhe komentet përkatëse i/e ndihmuar edhe me komentet e mësipërme.

### **Variacion**

Në përfundim të diskutimit ( në orën që vijon) mësuesja mund t'u kërkojë nxënësve:

1. Të shkruajnë poezi për njerëzit që jetojnë në varfëri, që nuk kanë shtëpi dhe nuk mund të përballojnë një jetesë normale.

2. Të tregojnë shembuj lidhur me ndihmën ndaj personave në kushte të vështira jetese ( të realizuar prej tyre apo miq e të afërm)
3. Të mbledhin nga burime të ndryshme informacioni forma/masa të ndryshme të ndërmarra nga aktorë të ndryshëm shoqërorë për zbutjen e problemit të varfërisë dhe të gjykojnë mbi efikasitetin e tyre.
4. Ese: Reflektim mbi thenien e Benjamin Franklin” Ka dy mënyra për të qenë i lumtur: Ose duhet të zvogelojmë kërkesat tona , ose të rritim mjetet për realizimin e tyre- të dyja janë të vërteta- rezultati është i njëjtë dhe i takon secilit të vendosë për vehten e tij dhe të bëjë atë që është më e lehtë për të”

## Neni 26

Gjithkush ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollat fillore dhe të ulta. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të zgjerohet e arsimi i lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në bazë të aftësisë.

Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

Të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre e kanë në rradhë të parë prindërit.

## Trajtim ligjor

Neni 26 rregullon një të drejtë të rëndësishme: të drejtë për arsimim. Elementë me rëndësi që theksohen në nenin 26 të Deklaratës janë:

Barazia në shkollim

Zgjedhja e shkollimit

Zgjedhja dhe mbajtja e shkollës

Zgjedhja e shkollimit fetar dhe moral

Deklarata njej të drejtën për arsim çdo personi.

Sipas statistikave zyrtare ndjekin arsimin e detyruar 94% e fëmijëve të grupmoshës përkatëse.

Cilat janë arsyet që kjo e drejtë shkelet? Diksutoni me njëri tjetrin çfarë masash duhet të marrë shteti dhe shoqëria që fëmijët të gëzojnë realisht të drejtën e arsimimit? Çfarë ndihme mund të ofroni ju në shkollën tuaj për fëmijët e komunitetit ku ju banoni që dua të shkollën në shkollë, por nuk kanë mundësi të realizojnë këtë të drejtë?

Sipas këtij neni, shtetet detyrohen të ofrojnë **shkollimin fillor kryesor falas**, pra çdo person të jetë i lirë për të mos paguar për shkollimin kryesor, për shëmbull për librat dhe paisjet shkollore etj. Deklarata nuk përcakton se sa vite është arsimi falas, por çdo shtet i përcakton shkollimin (arsimin bazë) me ligjet e veta.

Situatë praktike nga vendi ynë. Sipas ligjit shqiptar, librat shkollore për arsimin e detyrueshëm janë falas. Në fakt, nxënësit i kanë blerë librat me shpenzimet e tyre. A është kjo një shkelje e përmbajtjes së nenit 26 të deklratës dhe të ligjit? *(Vera të lutem cito ligjin, pasi nuk e mbaj mend mirë ?* Diskutoni me njëri-tjetrin dhe shprehni opinionet tuaja.

Përsa i përket arsimit teknik, profesional dhe arsimit të lartë, deklarata thekson se mundësitë për këto lloje arsimimi duhet tu krijohen të gjithëve në bazë të meritave. Shtetet me ligje e tyre nuk mund të vënë kufizime që nuk janë të arsyeshme.

Situatë praktike nga vendi ynë. Në fakt, praktika ka treguar se në vendin tonë jo gjithmonë është vlerësuar merita. Për disa të rinj janë krijuar mundësi të shkollohen pavarësisht nga merita, ndërkohë që të tjerë me rezultate më të mira nuk kanë patur këtë mundësi për arsye ekonomike ose të sistemit të konkurimit dhe pranimit në shkollat e larta.

Disa grupe shoqërore si fëmijët e policevë të varë në krye të detyrës kanë përfitur një trajtim më pozitiv se fëmijët e tjerë. Kjo politikë është ndjekur për ti ardhur në ndihmë familjeve të tilla.

Neni 26 rregullon edhe **përmbajtjen e shkollimit**. Shkolla duhet të synojë zhvillimin e plotë të personalitetit fizik, intelektual, psikologjik e social. Shkollimi duhet të synojë respektimin e lirive e të drejtave të njeriut, promovimin dhe nxitjen e tolerancës, mirëkuptimit, respektimit midis grupeve të ndryshme etnike, fetare, kombësive etj.

*Si mund të kuptohet në praktikë përmbajtja e këtij paragrafi të Deklaratës?*

Kjo kërkon që programet dhe tekstet mësimore në shkollat tona të përmirësohen. Temat që trajtojnë liritë dhe të drejtat e njeriut të zënë një vend më të madhe në tekstet tona, jo vetëm të edukatës shoqërore por edhe në tektet e tjera. Tekstet nuk duhet të përmbajnë terma që mund të stigmatizojnë individë ose grupe të ndryshme etnike, fetare , emigrantët ose të huaj që banojnë në vende të ndryshme.

Ndonjë grup etnike pretendojnë se tekstet e historisë në shkollat tona përmbajnë shprehje që krijojnë paragjykimet për grupe të caktuara. Merrni një tekst historie dhe lexojeni me vëmendje atë. A do të gjeni shprehje të tilla? Nëse po diskutoni me mësuesit e lëndës dhe drejtuesit e kurrikulës në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

Lexoni me vëmendje përmbajtjen e paragrafit të parë të nenit 26 të Deklaratës dhe vini në pah sesi është shprehur parimi i barazisë në shkollim. Diskutoni me njeri tjetrin elementët e kësaj të drejtë.

*Kush ka të drejtë të zgjedh shkollimin e fëmijëve?*

Prindërit kanë të drejtë të zgjedhin shkollimin e fëmijëve, por nuk kanë të drejtë të marrin vendime e të mos dërgojnë fëmijët në shkollë. Prindërit kanë të drejtë të zgjedhin nëse duan të shkollojnë fëmijën e tyre në shkollë publike ose private , po kjo nuk do të thotë që shteti detyrohet të financojë çdo dëshirë të prindërve për shkollimin e fëmijëve të tyre.

*A duhet të dëgjohet fëmija lidhur me shkollën dhe llojin e shkollimit që do të ndjekë?*

Sipas nenit 26 paragrafi 3 të deklaratës prindërit kanë të drejtë të zgjedhin shkollimin e fëmijës. Ndonëse deklarata nuk njeh të drejtën e fëmijës të shprehet lidhur me shkollimin e zgjedhur nga prindi në Konventën “Për të drejtën e fëmijës” nenin 12 të saj thuhet se shteti duhet ti garantojë fëmijës i cili është i aftë të ketë pikapamje të drejtën e shprehjes lirisht të pikëpamjeve për çdo çështje që ka të bëjë më të, duke i vlerësuar në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë.

Duke ju referuar praktikës së vendit tonë diskutoni për problemet e mëposhtme:

A ka të drejtë fëmija të shpreh mendimin ose pëlqimin e tij për zgjedhjen e bërë nga prindi/rit e saj?

Diskutoni me njëri-tjetrin nëse jeni pyetur për shkollën që po ndiqni?

A ju pëlqen zgjedhja që ka bërë prindi juaj. Argumentoni mendimin tuaj. Në cilën fushë do t’ju pëlqente të shkolloheshit?

Shqipëria ka ratifikuar konventën “Për të drejtat e fëmijës” në nenin 18 të konventës thuhet se:

E drejta e shkollimit ka evoluar në mënyrë progresive.

1. Shtetet Palë përipiqen me të gjitha mundësitë , për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në radhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës.

2. Për të garantuar dhe zhvilluar të drejtat e përmendura në këtë Konventë, Shtetet palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesëve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qëndrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët.

Karta Sociale Europiane e ndryshuar përmban dispozitat lidhur me shkollën. Neni 7 pika, Palët angazhohen „ të marrin masa që personat të cilët u nënshtrohen akoma arsimit të detyrueshëm nuk do të punësohen në punë të atilla që i do t'i pengonte ata nga përfitimi i plotë i arsimit të tyre. Po në këtë nen fëmijët mërren në mbrojtje përsa i përket moshës minimale 15 vjeç për punësim në punë të lehta që është e lidhur me moshën për shkollë, moshën minimale 18 vjeç për punë të konsideruara të rrezikshme. Etj. Neni 10 Kartës Sociale trajton të drejtën për trajnim profesional. Pika 2. Palët angazhohen: “të ofrojnë ose nxisin një sistem të punëtorëve nxënës dhe rregullime të tjera sistematike për trainimin e djemve dhe vajzave të reja në punësimin e tyre të ndryshme”. Po në këtë nen Shtete pale duhet të marrin masa për krijimin e lehtësive si për uljen apo heqjen e tarifave ose pagesave, përfshirja në kohën e punës nga punëdhënësi për kohën e shpenzuar për trajnim. Etj.

Karta Sociale Europiane në Neni 15 trajton rregullat për të drejtat e personave me gjymtime për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit. Me synimin për të siguruar këto të drejta Palët angazhohen për të marrë masa të nevojshme që tu japin personave me gjymtim, orientime, arsim dhe trajnim profesional në kuadrin e skemave të përgjithëshme kudo që të jetë e mundur, nëpërmjet organeve të specializuara, publike apo private. Të nxisin integrimin e tyre të plotë social dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit në veçanti nëpërmjet masave, përfshirë ndihmesë teknike, që synojnë të tejkalojnë barrierat e komunikimit dhe lëvizshmërisë dhe duke lejuar aksesin në transport , strehim, veprimtari kulturore dhe të kohës së lirë.

Konventa „Për të drejtat e fëmijës” njeh të drejtën e fëmijës për arsimim, duke bërë të mundur has pas hapi arsimin fillor të detyrueshëm për të gjithë (neni 28, paragrafi 1, pika a). Gjithashtu në konventë inkurajohen shtetet të zhvillojnë forma të ndryshme të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe profesional dhe të marrin masa t'i bëjnë të hapura për çdo fëmijë dhe falas dhe në rast nevojë të jepet ndihma financiare për të përballuar shpenzimet e tyre.

### ***Si ka gjetur zbatim përmbajtja e këtij neni të deklarëts në legjislacionin shqiptar?***

Neni 57 i kushtetutës (pragrafët 1-5) sanksion se:

Kushdo ka të drejtën për arsimim.

Arsimimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.

Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë.

Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.

Arsimi i detyrueshëm dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.

Krahasoni me vëmendje përmbajtjen e nenit 26 të deklaratës dhe nenit 57 të Kushtetutës sonë. Cilat janë të përbashkëta dhe dallimet mes tyre?

Sipas ligjit Nr.7952, datë 21.6.1995 për sistemin arsimor parauniversitar

### ***Zbatimi në praktikë tonë të nenit 26 të deklaratës***

1 Shumë fëmijë nuk ndjekin shkollën me argumentin se familja ka nevojë për punën e tyre. Mosndjekja e shkollës nga ana e fëmijës është një zgjedhje e prindit. A ka shkelje të të drejtave të tyre? Diskutoni me njëri-tjetrin situatën dhe shprehni mendimet tuaja.

2. Arbeni kërkon të shkollës në një shkollë private pasi edhe dy shkollët e tij të ngushtë do të ndjekin një shkollë të tillë. Pridnërit nuk janë dakort dhe nuk i plotësonë dëshirën e tij. Shprehni mendimin tuaj se kush ka të drejtë dhe nëse është shkelur e drejta e Arbenit të zgjedhe shkollën që ai dëshiron?

3. Një një shkollë publike mësuesja e historisë flet për rolin dhe vlerat më pozitive që ka besimi myslijan ndaj besimeve të tjera në vend. A e gjeni këtë situatë në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 26 të Deklaratës?

#### Aspekte edukative

Realizimi në praktik i nenit 26, i jep përgjigje shumë pyetje themelore të zhvillimit të njeriut dhe shoqërisë njerëzore:

- Si mundet të rrënjësim të kuptuarit e të drejtave themelore të njeriut?
- Si mund të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik?
- Si mund të zgjidhen konfliktet etnike?
- Si mund ti themi STOP pabarazive gjinore?
- Si mund të çrrënjësim punën e fëmijëve?
- Si mund të eliminohet përfundimisht shfrytëzimi seksual i fëmijëve?
- Si mund ti jepet shpresë gjeneratave të reja të fëmijëve që rriten në një shoqëri dhe botë gjithmonë e më shumë komplekse?

Natyrshëm përgjigja është: arsimim cilësor që përgatit fëmijët të jenë pjesëmarrës të ndërgjegjshëm të zhvillimit të vet në kontekstin e komunitetit në të cilin jetojnë dhe më gjerë në kontekstin global të zhvillimit. Arsimi është një e drejtë themelore që sanksionohet dhe në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve. Pa realizimin e tij, pak nga problemet e mësipërme mund të zgjidhen.

Pengesat për arsimim janë të njëjta me ato që minojnë zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi: varfëria ekstreme, mungesa e politikave inkurajues dhe burokracia në pushtet; mungesa e mësuesve të kualifikuar, pozicioni denigrues i gruas në shoqëri, rritja e përshpejtuar e popullsisë, shpërndarja e pabarabartë e fondeve për arsim, rritja e shpenzimeve ushtarake të një vendi e shumë arsye të tjera. Por në fund të të gjitha këtyre qëndron vullneti i pamjaftueshëm për të realizuar këtë të drejtë themelore.

Zhvillim i arsimit të një vendi, kërkon një angazhim tërësor të të gjithëve, mbi të gjitha arsimit nuk është një problem që mund të zgjidhet për një periudhë të shkurtër, ai është një angazhim afatgjatë. [Nëse ka një vullnet të mirë fondet gjenden. Sipas llogarive që kanë bërë ekspertë, në botë, nëse 3 – 6 miliardë USD nga 680 miliardë USD që vlerësohen shpenzimet ushtarake, do të alokoheshin në arsim, çdo fëmijë mund të kishte një vend në një shkollë të përshtatshme.](#)

Pas Konferencës Botërore të Edukimit për të gjithë, në vitin 1990, Jomtien, Tailandë, vendet në të gjithë botën bënë përpjekje për të siguruar arsimim për të gjithë fëmijët. Sigurisht pati arritje që matej me numrin e shkollave të hapura, me numrin e nxënësve të regjistruar në shkollë, me numrin e mësuesve të formuar dhe kualifikuar që shënuan rritje të konsiderueshme. Por sot, pas 17 vjetësh, Në një vlerësim global të realizimit të kësaj të drejte shumë vende kanë dështuar. Objektivi i Samitit Botëror për Fëmijët, në vitin 1990, që në vitin 2000 të arrihej arsimim fillor për të gjithë fëmijët ende nuk është arritur.

Ç'është e drejta për arsimim?

Sipas nenit 26 të DUDNJ, çdonjëri ka të drejtë të arsimohet. Arsimimi është një e drejtë e pamohueshme, është unikale pasi nëpërmjet ushtrimit të kësaj të drejte, individit ka mundësi të ushtrojë të drejtat e tjera siç janë ato civile, politike, ekonomike, kulturore. Për të realizuar këtë të drejtë, arsimi duhet të jetë i mundshëm, i arritshëm, i pranueshëm dhe i përshtatshëm. Në këtë mënyrë, arsimi e pajis individin me njohuri, shprehi dhe shkathësi që e ndihmojnë për të bërë zgjedhjet e duhura në jetë.

### Arsimi dhe varfëria

Është provuar se ekziston një lidhje e ngushtë midis nivelit të ulët të arsimit dhe varfërisë, si ajo e individit, ashtu dhe varfëria relative e shtetit. Përmes edukimit, individët kontribuojnë në lehtësimin e varfërisë, duke çliruar mendjen dhe duart për një jete me dinjitet.

Edukimi i vajzave ka veçanërisht efekte shumë pozitive. Studimet e kryera në shumë vende të botës kanë gjetur se ka korrelacion pozitiv midis arsimimit të vajzave dhe: rritjes cilësore të ushqimit në familje; planifikimit më të mirë familjar dhe shëndetit; uljes së varfërisë dhe një ekonomi më të mirë familjare; shanse më të mira dhe të suksesshme për jetën e gruas.

### Mos-diskriminimi në arsim

Arsimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe i arritshëm nga të gjithë, me ligj dhe në realitet. Asnjë institucion publik arsimor nuk mund të diskriminojë mbi bazën e gjinisë, etnisë, gjuhës, fesë, opinionit, pamundësisë fizike dhe statusit shoqëror dhe ekonomik. Qeveritë duhet të hartojnë, zhvillojnë dhe të zbatojnë politika kombëtare që adresojnë drejtpërsëdrejti cilësinë në arsim, privat dhe publik.

Në zbatim të nenit 26 të DUDNJ, çdo shtet ka detyrë dhe duhet të jetë prioritet sigurimi i arsimit të detyruar fillor falas si dhe garantimi i lirisë së arsimimit (duke respektuar të drejtën e prindërve për t'i siguruar fëmijëve të vet një arsimim në përshtatje me bindjet e tyre filozofike dhe fetare). Në përputhje me detyrimet që lindin nga zbatimi i DUDNJ, qeveritë duhet të sigurojnë kushte që arsimimi të jetë i mundshëm; i arritshëm (si nga pikëpamja financiare ashtu dhe fizike); i pranueshëm (duhet të respektojë të drejtat kulturore dhe të drejtat e njeriut për ata që mësojnë) dhe të jetë i përshtatshëm. Realizimi minimal i të drejtës për arsimim nënkupton arsim fillor falas për të gjithë fëmijët dhe siguron që përmbajtja e arsimit të jetë në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut.

E drejta për arsim plotësohet jo vetëm duke krijuar shkolla të mira që ju mësojnë fëmijëve aftësitë bazë por që gjithashtu ju mësojnë të drejtat e tyre dhe si ti mbrojnë ato.

## Diskutim

a. Komuniteti Romë në Evropë përballet me raste flagrante të shkeljes së të drejtës së fëmijëve romë për të pasur një arsimim cilësor. Në Kroaci vlerësohet se më shumë se 1/3 e fëmijëve romë janë të përjashtuar nga sistemi shkollor. Dendur fëmijët e komunitetit romë mësojnë në klasa të veçuara me një kurrikul të reduktuar krahasuar më fëmijët e tjerë kroatë. Autoritete Kroate e mbështesin këtë zgjidhje në kërkesë e prindërve të

fëmijëve jo romë që fëmijët e tyre të mos mësonin në një klasë me fëmijët romë. Prindërit romë u ankuan në Gjykatën e Kroacisë pasi një masë e tillë ishte thellësisht diskriminues për fëmijët e tyre, madje ankimin e tyre e çuan deri në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Gjykata Kroate e hodhi poshtë ankimin me arsyetimin se fëmijët romë nuk kishin njohuri të përshtatshme të gjuhës kroate për të mësuar me fëmijët kroate dhe kjo masë ju mundësonte fëmijëve romë të përparonin më mirë.

- Diskutoni a mund të flasim për shkelje të të drejtave të fëmijëve të komunitetit romë? Nëse po cilat janë të drejtat që shkelen? Cilat janë zgjidhjet e mundshme për këtë problem?

b. Shumë fëmijë nuk ndjekin shkollën me argumentin se familja ka nevojë për punën e tyre. Mosndjekja e shkollës nga ana e fëmijës është një zgjedhje e prindit. A ka shkelje të të drejtave të tyre? Diskutoni me njëri-tjetrin situatën dhe shprehni mendimet tuaja.

c. Arbeni kërkon të ndjek një shkollë private pasi edhe dy shokët e tij të ngushtë do të ndjekin një shkollë të tillë. Prindërit nuk janë dakord dhe nuk i plotësonë dëshirën e tij. Shprehni mendimin tuaj se kush ka të drejtë dhe nëse është shkelur e drejta e Arbenit të zgjedhe shkollën që ai dëshiron?

d. Në një shkollë publike mësuesja e historisë flet për rolin dhe vlerat më pozitive që ka besimi mysliman ndaj besimeve të tjera në vend. A e gjeni këtë situatë në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 26 të Deklaratës?

e. Sot, në shkollën tonë, të drejtat e njeriut studiohen në lëndë të veçanta, studiohen si elemente të kroskurikulës dhe ekstrakurikulës shkollor. Duke marrë shkas nga diskutimi dhe komenti i nenit 26 të DUDNJ, një ushtrim i mirë për mësuesit dhe nxënësit është konstatimi se si të drejtat e njeriut respektohen dhe zbatohen në kushtet e shkollës. Ushtrimi i mëposhtëm ndihmon mësuesit dhe nxënësit të matin nivelin e realizimit të të drejtave të njeriut në shkollën e tyre.

### **Tema: Zbatimi i të drejtave të njeriut në shkollë**

1. Diskutoni të drejtën për të njohur të drejtat e njeriut:

a. Lexoni me zë nenin 26 të DUDNJ-së ku jepet shprehimisht e drejta për arsim. Pyesni nxënësit:

- Sipas nenit 26, cili duhet të jetë qëllimi dhe cila duhet të jetë përmbajtja e shkollës?
- Në shkollën tuaj kush vendos për lëndët që do të studiohen?
- Mësohen të drejtat e njeriut në shkollën tuaj? Në cilën moshë dhe në cilat lëndë?
- A mësoni në shkollën tuaj rreth ngjarjeve që kanë të bëjnë me lëvizje të fuqishme të njerëzve në emër të “ ndërgjegjësimin të njerëzve për të qenë pjesëmarrës në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe që respekton të drejtat e njeriut”. A mësoni në shkollë rreth këtyre lëvizjeve.



- Pse disa Qeveri nuk duan që qytetarët e tyre të mësojnë për të drejtat e njeriut dhe qeveri të tjera duan që qytetarët e tyre të mësojnë për të drejtat e njeriut?"
- Cilat janë ato grupime të qytetarëve në komunitetin tuaj që kanë nevojë të mësojnë më shumë për të drejtat e njeriut?

2. Vlerësoni nivelin e zbatimit të të drejtave të njeriut në shkollën tuaj:

a) Nxirrni nga neni 26 fragmenti ku thuhet arsimi “duhet të synojë në zhvillimin e plotë të personalitetit të njeriut në respekt të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” Qëllimi i këtij aktiviteti është që vetë nxënësit të evidentojnë se në ç’masë në klasën apo shkollën e tyre është krijuar një mjedis ku respektohen dhe ku mund të realizohen të drejtat e njeriut.

b) Kërkoju nxënësve të plotësojnë një pyetësor për shkollën e tyre. Ata duhet të plotësojnë pyetësorin sipas mendimit që kanë pa diskutuar me të tjerë.

c) Krahas secilës pyetje vendoset numri i nenit që lidhet me të.

d) Shpërndani pyetësorin dhe jepini kohën e nevojshme për ta plotësuar.

e) Pyetësori

Vlerësimi

1. Kurrë
2. Rrallë
3. Shpesh herë
4. Gjithmonë
5. Nuk e di

1. Në shkollën tonë nuk ka diskriminim të nxënësve për shkak të racës, seksit, prejardhjes shoqërore, paaftësive të ndryshme, fesë apo stileve të jetës. (DUDNJ, nenet 2, 16)

2. Shkolla ime është një vend i sigurtë(DUDNJ, nenet 2, 5)

3. Të gjithë nxënësit marrin të njëjtin informacion dhe nxiten njësoj të mësojnë për arritjet e tyre. (DUDNJ, nenet 2, 26)

4. Shkolla siguron kushte të barabarta për të gjithë, për të marrë pjesë në procesin mësimor dhe aktivitete të ndryshme (DUDNJ, nenet 2, 7)

5. Komuniteti i shkollës reagon ndaj veprimeve diskriminuese, përdorimit të materialeve dhe fjalëve që mbartin diskriminim (DUDNJ, nenet 2, 3, 7, 28, 29)

6. Në rastet kur dikush shkel të drejtat e tjetrit, atij i mësohet të ndryshojë sjelljen e tij. (DUDNJ, neni 26)

7. Shokët dhe mësuesit interesohen për zhvillimin tim si njeri si dhe për përparimin tim në mësim, kur unë kam nevojë. (DUDNJ, nenet 3, 22, 26, 29)
8. Në raste konfliktesh ne përpiqemi ti zgjidhim ato në mënyrë paqësore dhe bashkëpunuese. (DUDNJ, nenet 3, 28)
9. Shkolla ka rregullore se si duhet të vepohet në raste të sjelljeve diskriminuese. (DUDNJ, nenet 3, 7)
10. Në shkollë, në rastet e marrjes së masave disiplinore ato janë të njëjta për këdo për të njëjtin faj. (DUDNJ, nenet 7.8.9.10).
11. Asnjëri në shkollën tonë nuk është objekt i trajtimit poshtërues dhe dhunimit. (DUDNJ, neni 5)
12. Nëse dikush akuzohet për diçka ai prezumohet i pafajshëm deri sa ti provohet fajësia. (DUDNJ, neni 11)
13. Në shkollë unë kam mjedisin tim që respektohet nga të tjerët. (DUDNJ, neni 12, 17)
14. Në shkollën tim respektohen të gjithë, mësues, nxënës, punonjës shërbimi pavarësisht prejardhjes së tyre shoqërore dhe kulturës që kanë. (DUDNJ, nenet 2, 6, 13, 14, 15)
15. Unë jam i lirë të shpreh besimin dhe bindjet e mija pa frikë. (DUDNJ, neni 19)
16. Nxënësit e shkollës tonë kanë të drejtë të kenë botimet e tyre pa çensur. (DUDNJ, neni 19)
17. Këndvështrime të ndryshme (në lidhje me racën, gjininë, etninë, ideologjinë) trajtohen në orët e mësimi dhe në tekstet e shkollës. (DUDNJ, nenet 2, 19, 27).
18. Unë marrë pjesë në veprimtari të kulturore që zhvillohen në shkollë dhe kultura dhe identiteti im respektohen. (DUDNJ, nenet 19, 27, 28).
19. Të gjithë në shkollë mësues dhe nxënës në mënyrë demokratike janë pjesë e vendmarrjes në shkollë (DUDNJ, nenet 20, 21, 23).
20. Të gjithë në shkollë kanë të drejtë të organizohen për të mbrojtur të drejtat e tyre. (DUDNJ, nenet 19, 20, 23).
21. Të gjithë në shkollë nxisin njëri tjetrin për të mësuar rreth çështjeve globale që lidhen me drejtësinë, ekologjinë, varfërinë dhe paqen. (DUDNJ, nenet 26, 29).
22. Të gjithë në shkollë nxisin njëri tjetrin për tu organizuar dhe ndërmarrë veprime konkrete ndaj problemeve që lidhen me drejtësinë, ekologjinë, varfërinë dhe paqen. (DUDNJ, nenet 26, 29)

23. Në shkollë, nxënësit dhe mësuesit kanë të drejtë të pushojnë dhe të qetësohen në mënyrë të arsyeshme dhe kanë kushte të mira pune . (DUDNJ, nenet 23, 24)

24. Punonjësit e shkollës kanë një pagë që i mundëson të kenë një standard të përshtatshëm të jetës për shëndetin dhe mirëqënien e tyre dhe të familjes (DUDNJ, nenet 22, 25).

25. Në shkollë unë kam përgjegjësi për të siguruar që njerëzit të mos diskriminojnë njëri tjetrin . (DUDNJ, nenet 1, 29)

3. Pasi nxënësit të kenë plotësuar pyetësorët përpunojini ato dhe diskutoni rezultatet:

- Në cilat fusha mendoni se shkolla respekton parimet e të drejtave të njeriut?
- Cilat janë fushat që mendoni se janë problematike?
- Si e shpjegoni ekzistencën e problemeve dhe cilat janë kushtet që i gjenerojnë ato? Këto probleme a janë të lidhura me diskriminimin?, Me vendimmarrje?
- Kush përfiton dhe kush vuan nga shkelja e të drejtave të njeriut?
- Ju apo pjesëtarë të tjerë të komunitetit keni ndikuar në klimën ekzistuese në shkollë duke e përmirësuar apo keqësuar atë?
- Çfarë duhet të bëni për të përmirësuar klimën e të drejtave të njeriut në shkollën tuaj? Hartoni një planë veprimi për klasën ku të përcaktoni qëllimet, strategjitë për ti arritur dhe përgjegjësitë.

**Neni 27.**

Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzojë artet dhe të përfitojë nga përparimi shkencor dhe dobisë e tij.

Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë.

Trajtim ligjor

Neni 27 në thelbin e tij është një nen i referohet si të drejtave kulturore ashtu edhe atyre civile e ekonomike. Ky nen përfshin pra aspekte të ndryshme të granatimit të të drejtave të cilët kanë të bëjnë si me të drejta kulturore ashtu edhe me të drejta civile e ekonomike, të cilat janë:

e drejta e çdonjërit që të marrë pjesë në jetën kulturore

e drejta për të gëzuar përfitimet e shkencës dhe të aplikimit të saj

e drejta për të përfituar nga interesat morale dhe materiale që rezultojë nga produkte shkencor, letrare, artistike të individit

liria për të kryer kërkime shkencore e aktivitete krijuese.

Neni fillimisht i referohej vetëm të drejtave kulturore e përfitimit nga gjetjet shkencore e aplikimet e tyre, por jo edhe të drejtës së autorit dhe të drejtave pasurore që rrjedhin prej prodhimit intelektual. Kjo e dyta u përfshi vetëm përgjatë diskutimeve madje jo nga Komisioni që ishte ngritur për hartimin e DUDNJ-së por nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e cila ishte organi që miratoi DUDNJ-në. Edhe pse kishte mendime që neni mbi pronësinë mbronte interesat pronësore e ekonomike të autorëve krijues qofshin këto artistë apo krijues në fusha të ndryshme të shkencës, Asambleja e Përgjithshme theksoi se ai nen i DUDNJ-së nuk i mbulonte qartë këto të drejta. Edhe pse pati diskutime të shumta madje edhe të llojit a janë apo jo të drejta të njeriut të drejtat e autorit dhe aspektet që lidhen me të, teksti i paragrafit 2 që i referohej të drejtës për të mbrojtur interesat ekonomike e morale që rrjedhin nga krijimtari shkencore, letrare dhe artistike u miratua nga Asambleja e Përgjithshme.

*E drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore*

Sipas UNESCOs kultura është një fenomen social që rezulton nga individët që bashkohen dhe bashkëpunojnë në aktivitete krijuese. Është ky organ i Kombeve të Bashkuara që ka bërë edhe përcaktime të kuptimit të pjesëmarrjes dhe pjesëmarrjes lirisht në kulturën e një vendi. Kështu theksohet se çdonjëri duhet që të shprehet lirisht, komunikojë, angazhohet në aktivitet krijuese për të zhvilluar plotësisht personalitetin e vet, për të pasur një jetë harmonike dhe përparim kulturor të shoqërisë, por edhe të ketë kushte të përshtatshme social-ekonomike që të sigurojë lirisht informacion, trajtim, njohuri, kuptim, dhe të gëzojë vlerat dhe pasuritë kulturore.

DUDNJ thekson se kushdo ka të drejtën të gëzojë e të jetë pjesëmarrës në jetën kulturore në zhvillimin shkencor duke mos e konsideruar aspak kulturën si privilegj të ndonjë pakice elitare, por një çështje të të gjithëve. Çdo formë e kulturës duhet të jetë e hapur për të gjithë e kushdo duhet të marrë pjesë në të. Çdokush ka të drejtën të shfaqë kulturën

individuale, ta zgjedhë atë lirisht, të jetë i lirë të ndërrojë këtë kulturë nëse dëshiron, të respektojë kulturën e çdokujt tjetër, të mos diskriminohet për shkak të kulturës apo përkatësisë kulturore, të ketë mbrojtje dhe mundësi zhvillimi të kulturës së vet.

Neni 27 pa dyshim që është një nene që mbron edhe kulturën e pakicave sepse qëllimi i tij është garantimi i drejtës për këdo. Pakicë mund të përbëjnë një grup personash të cilët kanë elementë të përbashkët që i dallon nga pjesa tjetër e shoqërisë në të cilën jetojnë. Kështu, pakicat mund të jenë kulturore, etnike, fetare, gjuhësore, mund të konsiderohen personat e paaftë, personat që jetojnë në varfëri, edhe femrat edhe pse nuk janë të pakta në numër. Pa dyshim që edhe individët që i përkasin këtyre grupeve gëzojnë të drejtën për të shfaqur kulturën e vet.

Aspekte të së drejtës për të gëzuar e shfaqur e marrë pjesë në kulturën që zgjedh apo ke janë të atilla që kanë të bëjnë me të drejta të tjera të përmendura veçmas në DUDNJ. Kështu, kultura s'mund të kuptohet pa gjuhën dhe e drejta të arsimohesh është një e drejtë e veçantë në DUDNJ. Të arsimohesh në gjuhën tënde kjo është çështja e cila është pjesë edhe e të drejtës së Nenit 27 edhe e Nenit ..... të DUDNJ-së. Neni 27 pa dyshim kërkon marrjen e masave të duhura që të mund të realizohet, pra kërkon veprime pozitive nga ana e shtetit. Së pari do të kërkohej që shteti të lejonte shkollimin privat cilëndo gjuhë që individët kanë dëshirë dhe së dyti edhe në sistem publik të arsimit që ofrohet nga shteti të mund të kishin pakicat të drejtën që të mësonin gjuhën e tyre. E dyta pa dyshim kërkon më tepër angazhim dhe burime nga shteti se sa e para.

#### *Aktet ndërkombëtare të tjera*

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve: përcakton që fëmijët kanë të drejta kulturore dhe të drejtën për identitet kulturor si dhe disa të drejta të tjera që kanë të bëjnë me emrin, identitetin, marrëdhëniet familjare -neni 8, kujdesit për etikën kulturore, gjuhësore të fëmijës (neni 20, se arsim duhet të përfshijë elementë të edukimit të respektit ndaj prindërve identiteti kulturore, gjuhës dhe vlerave të saj – Neni 29, fëmijët e pakicave të gëzojnë kulturën e tyre e të përdorin gjuhën e tyre – neni 30, etj

Konventa Kulturore Evropiane (miratuar në dhjetor 1954, në të cilët inkurajohet ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore

Konventa Evropiane Kornizë për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare synon që të promovohen kushtet e përshtatshme për individët që i përkasin pakicave që të zhvillojnë kulturën tyre, të ruajnë elementët e domosdoshëm për identitetin e tyre të tilla si feja, gjuha, traditat e trashëgimia kulturore.

Karta Evropiane mbi Gjuhët Rajonale apo të minoriteteve, ka si qëllim ruajtjen e promovimin e kulturës së pakicave

Deklarata Amerikane për të Drejtat Njeriut dhe të Popullit, Neni 13 mbron të drejtat kulturore

Karta Afrikane mbi të Drejtat e njeriut dhe të Popullit kërkon pjesëmarrje të individëve në jetën kulturore si dhe përcakton të drejtën për të gëzuar literaturën dhe punimet artistike e të ketë mundësinë që të zhvillojë talentin tij krijues intelektual e artistik

### ***Kushtetua e Republikës së Shqipërisë***

Kushtetuta e vendit tonë në disa nen i referohet të drejtës për të ruajtur e zhvilluar kulturën, lirisë së krijimtarisë dhe mbrojtjes me ligj të së drejtës së autorit apo edhe mbrojtjes së kulturës e trashëgimisë kombëtare, si për shembull:

Që në preambulën, pjesën hyrëse të saj thekson se kjo Kushtetutë po hartohet me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror ...

Neni 8 shprehet që “Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.”

Neni 58 thekson se ”Liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë”, si dhe që ’e drejta e autorit mbrohet me ligj.”

Neni 59 lexon: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: .... mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.”

### Aspekte edukative

Të drejtat kulturore janë pjesë e të drejtave të DUDNJ që së bashku, kontribuojnë në krijimin e një rendi botëror të drejtë. Por, deri më sot, të drejtat kulturore janë zhvilluar dhe kuptuar më pak krahasuar me të drejtat e tjera të garantuara në ligjin ndërkombëtar. Dy janë arsyt kryesore për këtë: së pari, kultura si koncept, ndërthyer një shumëllojshmëri aspektesh dhe, së dyti, vetëm së fundmi po i kushtohet vëmendja e duhur të drejtave social, ekonomike dhe kulturore duke i vlerësuar në tërësinë dhe ndërvarësinë e tyre.

Konceptimi i të drejtave kulturore është ngushtësisht e lidhur me shumëllojshmërinë e aspekteve që ndërthrin kultura dhe përkufizimet që japin për të ku përfshihen:

- Njohja e arteve të bukura, fushave humanitare, aspekte të gjera të shkencës në dallim nga aftësitë teknike dhe profesionale.
- Forma e integruar e sjelljes njerëzore që përfshin mendimin, fjalën, veprimin dhe artizanatin dhe varet nga aftësia e njeriut për të mësuar dhe transmetuar njohuri tek brezat që vijnë.
- Besimet, format shoqërore, tiparet materiale të zakonshme për një grup shoqëror, fetar apo etnie të caktuar.

Ndërsa elementë të përkufizimeve të mësipërme të kulturës, pasqyrohen në dispozita të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare, në praktikë, zbatimi i të drejtave kulturore janë perceptuar më shumë si e drejta për lirinë e shprehjes, lirinë e informimit dhe e drejta e minoriteteve të cilat përfaqësojnë më shumë me përkufizimin e dytë dhe të tretë. Por e drejta

kulturore është shumë më e gjerë, për rrjedhojë jo e lehtë për t'u konceptuar dhe realizuar.

Angazhimi ynë në kulturë, si një formë e mendimit, fjalës dhe veprimit, është tejet e pandërgjegjshme. Nga momenti kur lind, gjithkush rritet brenda një kulture të caktuar. Po të mos ekspozoheshim në mënyra të ndryshme, të rëndësishme ndaj kulturave të tjera, do ta kishim të vështirë të dallonim ato tipare të veçanta të kulturës “sonë” vetjake. Ato tipare thjesht janë “dhënë” ashtu. Kështu pra ka dhe një vështirësi të brendshme tek të drejtat kulturore. Kur duhet të mendojmë për të drejtat kulturore, ne na duhet të trajtojmë në mënyrë shumë të ndërgjegjshme diçka që është kaq e pandërgjegjshme për shumicën prej nesh.

Antropologë kulturorë tregojnë se kultura transmetohet përmes një procesi shumë kompleks që përfshin komponentë materialë dhe jo materialë. Kultura mund të pasqyrohet dhe të shprehet përmes mënyrës së jetesës që ne ndërtojmë, shtëpisë që ngremë dhe njerëzve me të cilët bashkëjetojmë; llojit të ushqimit që kultivojmë dhe konsumojmë dhe mënyrën se si e kultivojmë dhe e konsumojmë; llojit të muzikës që këndojmë, luajmë dhe dëgjojmë, dhe si e këndojmë, e luajmë dhe e dëgjojmë; besimin fetar që kemi dhe mënyrën se si e praktikojmë. Kultura pasqyrohet dhe shprehet në marrëdhëniet me prindërit, fëmijët, të afërmit, miqtë dhe të huajt si dhe me kulturat dhe botën materiale që na rrethon.

Të gjithë këto aspekte materiale dhe jo materiale të kulturës shoqërohen me vlera që përcillen brez pas brezi. Trajtimi i të drejtave kulturore mund të jetë i debatueshëm edhe pse të drejtat kulturore janë ngushtësisht të lidhura me vlera të tilla themelore për shoqërinë si: “çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe”. Për më tepër, për të kuptuar vlerat kulturore në kuadrin e një konteksti të caktuar (është e vështirë t'i konsiderosh vlerat kulturore jashtë një konteksti), është thelbësore të kuptohen dallimet, shpesh të vogla, ndërmjet vlerave kulturore dhe ideve fetare. Shpesh e kemi të vështirë të përcaktojmë nëse një abuzim vjen si pasojë e shkeljes së një të drejte kulturore apo të drejte fetare.

Vlerat kulturore janë të lidhura ngushtë me ndjeshmërinë dhe identitetin tonë. Sfidat ndaj kulturës sonë shndërrohen në sfida ndaj identitetit të secilit prej nesh si person dhe ndaj vlerave që i kemi më për zemër. Ato kërcënojnë të kuptuarit e vetes sonë e të botës sonë. Për pasojë, sfidat ndaj kulturës gjenerojnë reagime të fuqishme e të ngarkuara emocionalisht.

Së fundi, trajtimi i të drejtave kulturore është kompleks pasi kultura historikisht është lidhur e kushtëzuar nga problemi i pushtetit. Gjatë gjithë historisë njerëzore, kulturat dominuese, në vende të ndryshme, kanë imponuar ose tentuar të imponojnë format e tyre të mendimit, të fjalës, ndaj popujve të tjerë apo dhe ndaj anëtarëve më të dobët të shoqërisë së tyre. Është kjo arsyeja që trajtimi i kulturës dhe të drejtave kulturore, historikisht është karakterizuar nga ndjeshmëri të larta për popuj dhe grupe shoqërore të ndryshme.

Dukuria e globalizimit pa dyshim do të ketë një ndikim të thellë në vlerat kulturore dhe të drejtat kulturore.

## **Veprimtari**

*Mundësi për diskutim...*

- Si vepron globalizimi mbi të drejtat dhe vlerat kulturore?
- Si ndikojnë lëvizjet demografike mbi të drejtat dhe vlerat kulturore?
- Shkolla jonë dhe të drejtat kulturore të nxënësve: Sa tolerante jemi në nxënësit e shkollës?
- U kërkoni nxënësve të diskutojnë dhe të analizojnë raste konkretë të
  - o *Nxitje, kufizimi, mohimi*, të të drejtave kulturore.
- Ndhimojini të nxjerrin: Shkaqet dhe pasojat e rasteve të diskutuara.
  
- A-ja, një rome, jetonte në një karvan në shtetin X, gjë për të cilën shteti X e kish lajmëruar se nuk duhet të ndodhte. A-ja edhe pse kish kërkuar leje të jetonte në një karvan të tillë, nuk kish marrë përgjigje pozitive. Çështja shkoi deri në gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, e cila konsideroi se A-ja kish të drejtën e shtëpisë dhe privatësisë. Gjykata arsyetoi se A-ja, si një rome, kish nevojë të ndiqte stilin e jetesës tradicional së komuniteti të saj e kështu ajo duhet të merrte lejen për të banuar në një karvan. Diskutoni aspektin kulturor që e bëri Gjykatën të vendosë në këtë mënyrë.
- Në ditën botërore të Diversitetit - **21 Maj** - zhvilloni temën :“ **Vendlindja ime – gjithë Shqipëria**”
- U kërkoni nxënësve të sjellin objekte, foto, histori, këngë, vjersha etj. që informojnë për zonën ku kanë lindur ata apo prindërit e tyre.
- Nxënësit mund të punojnë në grupe sipas prejardhjes së tyre.
- Në ditën botërore të Diversitetit - 21 Maj: me punimet e nxënësve organizoni një ekspozitë me “kënde” të zonave që kanë përfaqësues në shkollën tuaj. Nxënësit përfaqësues referojnë për gjithë sa kanë mbledhur për të bërë të njohur vendlindjen e tyre.

### **Tema: Ruajtja dhe respektimi i identitetit kulturor**

Për çdo popull, aspekti me vital i ruajtjes së identiteti kulturor është gjuha. Një ndër problemet që shqetëson shumë vende të Afrikës është përdorimi i anglishtes apo frëngjishtes si gjuhë zyrtare dhe jo gjuha e vendit. Për rrjedhojë në shkollë nxënësit mësojnë në një nga gjuhët e mësipërme dhe jo në gjuhën e tyre, gjuhë me të cilën komunikojnë në shtëpi dhe në komunitetin ku jetojnë.

Organizoni një debat në klasë për këtë problem ku gjithsecili të shprehë mendimin e vet.

#### **1. Përgatitja e debatit.**

a. Kërkojuni nxënësve të informohen dhe të mbledhin informacion rreth gjuhës në të cilën mësojnë nxënësit në disa vende që kanë popullsi të etnive të ndryshme. Nënvizoni faktin që në këto vende ka komunitetet të ndryshme gjuhësh. Shpjegojuni se për këtë problem debatohet në të gjithë botën nëse në shkollë nxënësit duhet të komunikojnë në një gjuhë të vetme, veçanërisht në vendet me popullsi të ndryshme.

b. Ndajeni klasën në dy grupe. Grupit të parë jepini listën A që përmban argumentet që shkolla të bëhet në një gjuhë të vetme. Grupit të dytë jepini listën B që përmban argumentet kundër një gjuhe të vetme në shkollë. Secilit grup i kërkohet që të lexojnë



argumentet e paraqitura dhe po nga ky pozicion të shtojnë mendimet e tyre. Mendimet e tyre duhet të mbështeten në DUDNJ.

c. Secili grup, brenda 10 minutave duhet të evidentoj argumentet. Grupi mund të përfaqësohet nga një ose më shumë raportues. Kur njeri grup prezanton pozicionin e vet, grupi tjetër ka në dispozicion 5 minuta për të bërë pyetje nëse paraqitja nuk është e qartë. Të njëjtën gjë bënë grupi tjetër dhe pasi të jenë qartësuar pozicionet e të dy grupeve, secilit grup do t'i lihet kohë në dispozicion për të kundërshtuar argumentet e paraqitura.

### **Argumente pro arsimimit në një gjuhë të vetme.**

- Të lejosh që popullsia minoritare e një vendi të mësojë në gjuhën e vet shkaktonte përçarje dhe mungesë uniteti.
- Si mund të unifikohet një vend nëse popullsia e tij nuk flet të njëjtën gjuhë?
- Si mundet që anëtarë të një popullsie minoritare të kenë shancë për një punë të mirë në komunitetin që jetojnë pa përdorur të njëjtën gjuhë?
- Vendet nuk e kanë të lehtë madje e kanë shumë të vështirë të sigurojnë arsim universitarë në gjuhë të ndryshme. Nëse popullsia minoritare nuk flet gjuhën e shumicës, ata nuk mund të ndjekin universitetin.
- Si mundet që njerëzit e popullsisë minoritare të votojnë në mënyrë të ndërgjegjshme nëse nuk kuptojnë saktë informimin që bëhet në lidhje me procesin e zgjedhjeve në gjuhën e shumicës.
- Neni 26 i DUDNJ thotë se “ ... Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut...”. Fëmijët e minoriteteve nuk mund të zhvillohen tërësisht nëse ata nuk marrin pjesë tërësisht në jetën e vendit.

### **Argumente kundër arsimimit në një gjuhë të vetme.**

- Nëse një komunitet minoritar ka të drejtë të arsimojë dhe edukojë fëmijët në gjuhën e vet, të detyrosh të tjerët, jashtë këtij komuniteti, të flasin gjuhën e tyre mund të shkaktojë zemërim dhe nderinjtë.
- Nëse kjo situatë gjallon prej gjeneratash, mbijetesa e grupit minoritar mund të rrezikohet.
- Për herë të parë fëmijët mësojnë të lexojnë dhe shkruajnë në gjuhën me të cilën komunikojnë në shtëpitë e tyre.
- Neni 26 i DUDNJ thotë se: “Të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre e kanë në radhë të parë prindërit”  
Neni 26 i DUDNJ thotë se “ ... Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut...”. Fëmijët që i përkasin një popullsie minoritare mund të shkelen të drejtat e tyre nëse nuk shkruajnë dhe lexojnë në gjuhën e nënës.
- Neni 30 i Konventës se të drejtave të fëmijëve thotë se fëmijët e komuniteteve minoritare kanë të drejtë “ ... të përfitojnë nga kultura e tyre, të ushtrojnë fenë e tyre dhe të përdorin gjuhën e nënës”.

## **2. Zhvillimi i debatit**

- Para se të filloj debati kërkojuni nxënësve të secilit grup të shprehin me shkrim mendimin personal për çështjen, pavarësisht mendimit të grupit. Këto shënime mbahen për t'u shfrytëzuar me vonë.

- Organizoni debatin siç është përshkruar më sipër.
- Në përfundim të debatit kërkojuni nxënësve të shprehin mendimin personal. Lexojini rezultatet e debatit dhe për nxënësit që ndryshuan mendim, si rezultat i debatit pyetini se cili qe argumenti që i bëri të ndërronin mendim.

### **3. Përpiquni të arrini një konsensus**

Diskutoni rreth këtij problemi dhe se si mund të zgjidhet në kushtet reale. Ndhimoheni diskutimin me pyetjet e mëposhtme:

- Si ndikon në respektimin e të drejtave të nxënësve dhe prindërve të tyre, zgjedhja e shkollimit në një gjuhë të caktuar.?
- Sipas mendimit tuaj, çfarë roli duhet të luajnë qeveritë në zgjidhjen e këtij problemi?
- Nëse ju do të ishit përfaqësues të qeverisë të ngarkuar për t'u marrë me këtë problem, cilat do të ishin sugjerimet tuaj për zgjidhjen e tij?

## **Neni 28**

**Gjithkush ka të drejtë për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin mund të realizohen plotësisht të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë.**

### Trajtim ligjor

Siç është trajtuar edhe në temat e mëparshme, deklarata përmban shumë të drejta. Ato kanë nevojë të kuptohen dhe të zbatohen. Neni 28 i Deklaratës përcakton të drejtën e çdo personi për të rend shoqëror brenda vendit dhe ndërkombëtar që të mundësojë realizimin në praktikë të të drejtave të sanksionuara në këtë deklaratë.

*Çfarë do të thotë rend shoqëror dhe ndërkombëtar?*

Vendet duhet të ndërtojnë një rend politik, ekonomik dhe social që të krijojë një mjedis të përshtatshëm për të gëzuar të drejtat e njohura nga kjo deklaratë. Shteti detyrohet të marrë masa për të kapërcyer pengesat e ndryshme që mund të ekzistojnë dhe që pengojnë gëzimin e të drejtave. Që në vend të respektojë nenin 28 të Deklaratës kërkon të përmbushen disa kërkesa:

Të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë deklaratë të jenë të sanksionuara në ligjet e brendshme të një vendi.

Të drejtat të njihen dhe të gëzohen nga çdo person.

Shteti të marrë masa që të drejtat dhe liritë të realizohen plotësisht në praktikë.

Të drejtat e përcaktuara në deklaratë janë të përgjithshme dhe të lidhura mes tyre. Prandaj realizimi i tyre kërkon edhe zhvillimin e mënyrave për realizimin e tyre. Çdo vend ka zhvilluar instrumentat e tij të brendshëm për realizimin e këtyre të drejtave. Në nivel ndërkombëtar, janë hartuar dhe miratuar dokumenta merëndësi që zhvillojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në deklaratë.

Disa konventa janë hartuar nga Kombet e Bashkuara, të tjera nga Këshilli i Europës.

*Ja disa prej instrumentave të Kombeve të Bashkuara:*

Pakti për të drejtat politike dhe civile

Pakti për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit racial.

Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit ndaj grave.

Konventa për ndjekjen e tregëtisë së qënieve njerëzore dhe të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve.

Konventa “Për të drejtat e fëmijës”

*Këshilli i Europës ka hartuar instrumenta që veprojnë në vendet anëtare të tij. Ja disa prej instrumentave të keshillit të Europës:*

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore.

Konventa kuadër e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e minoriteteve

Karta Sociale Europiane e ndryshuar

Konventa europiane “për kompesimin e viktimave të krimeve të dhunshme”

Konventa europiane “Për marrëdhëniet me fëmijët”

*Organizata ndërkombëtare e punës ka hartuar një sërë dokumentash ndërkombëtarë si:*

Vera mendoj se këtu duhet të përmendim disa prej tyre (nese mendon se duhet mund tçi shtoj)

Për të kontrolluar realizimin në praktikë të konventave, këto të fundit kanë krijuar edhe mekanizma të monitorimit të tyre dhe disa prej tyre njohin edhe të drejtën e ankesave individuale dhe kolektive. Për shembull, nëse ndaj një personi të ndaluar nga policia përdoret dhunë, personi ka të drejtë të ankohet në gjykatat shqiptare dhe nëse mendon se e drejta e tij nuk është vënë vë vend, pas përdorimit të mjeteve brenda vendit, ai ka të drejtë të dërgojë çështjen në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut që ndodhet në Strasbourg.

Duke qënë se të drejta civile dhe politike nuk mund të arrihen pa gëzuar të drejtat ekonomike, kulturore dhe sociale, gëzimi dhe respektimi i këtyre të fundit i është dhënë prioritet kohët e fundit. Për realimin e të drejtave ekonomike sociale dhe kulturore janë angazhuar shtete, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile.

Dokument i parë i hartuar dhe miratuar nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara që synon të zhvillojë atë që është përcaktuar në përmbajtjen e nenin 28 është miratuar Deklarata për Zhvillim Shoqëror.

Shqipëria bashkëpunon me organizata ndërkombëtare të ndryshme si: PNUD, UNESCO, Këshilli i Europës, Bashkimi European, OSBE-ja, duke synuar zhvillimin e demokracisë, të të drejtave të njeriut, të kulturës dhe drejtave të tjera sociale dhe ekonomike.

Gjithashtu, në vendin tonë ka shumë organizata vendase që punojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, ofrojnë shërbime sociale ose promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe ato të grupeve më në nevojë në veçanti (fëmijët, femrat, minoritete, persona me aftësi të kufizuar etj).

### ***Aspekte edukative***

Përmendni disa organizata që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....

Disa organizatat që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut janë

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....

Përmendni disa organizata ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri për të promovuar dhe zhvilluar të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....

Shtetet bashkëpunojnë mes tyre për të arritur zhvillimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe zbutur problemet ekonomike dhe sociale, për shmëbull Shqipëria dhe Italia kanë nënshkruar dhe zbatojnë marrëdhëien për punësimin sezonal.

Ndonëse përmbajtja e deklaratës është e përgjithshme, ajo sanksion se këto të drejta duhen të gëzohen nga të gjithë. Kombet e Bashkuara kanë zhvilluar mbrojtje të veçantë për grupe të veçanta si fëmijët, gratë. Persona me aftësi të kufizuar, minoritetet,

### **Aspekte edukative të nenit 28**

Ne jemi në fillim të një mijë vjeçari të ri, në fillimet e një ere të re. Nëse 1000 vjet më parë mundësia e komunikimit midis njerëzve ishte shumë e kufizuar dhe shtrihej në disa dhjetra kilometra, nëse 200 vjet më parë, mënyra më e shpejtë e komunikimit kufizohej në shërbimin postar, sot gjithçka ka ndryshuar. Brenda pak minutave, falë internetit gjithkush mund të komunikojë me gjithë botën. Sot, potencialisht, gjithkush ka mundësi të ketë nëpër duar informacionin më të fundit dhe burimin e njohurive të shumta. Shoqëria e sotme zhvillohet dhe përparon bazuar në këtë univers virtual komunikimi. E drejta themelore e nenit 28 ku çdo njeri ka të drejtën për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar, ku të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë deklaratë të mund të gjejnë realizim të plotë mund të kthehet në një ushtrim interesant të nxënësve në klasë për të njohur si si kjo e drejtë realizohet.

### **Veprimtari**

#### **Tema: Të drejtat e njeriut në botë dhe në vendin tonë**

Realizimi i këtij aktiviteti i ndihmon nxënësit të mësojnë më shumë rreth zbatimit të të drejtave të njeriut në botë dhe në vendin e tyre. Në këtë mënyrë, nga njëra anë perceptohen më mirë arritjet dhe problemet e zbatimit të DUDNJ, në nivel global dhe vendi dhe, nga ana tjetër, nxënësit nxiten të jenë aktorë në ndërmarrjen e nismave të reja për realizimin e drejtave të njeriut.

#### **Pjesa e parë: Të drejtat e njeriut në botë**

Materialet: Kopje të një flete të të drejtave të njeriut në botë

#### **1. Krijoni grupe kërkimi:**

a. Ndajini nxënësit në grupe të vogla dhe jepuni nga një kopje të DUDNJ dhe fletën me “Të drejtat e njeriut në botë”.

b. Secilit grup caktojini 3 – 7 nga formulimet e fletës dhe jepini 15 – 20 minuta kohë për të përcaktuar se cili nen i DUDNJ aplikohet në këtë të drejtë, psh: “Trupat e qeverisë vranë mbrojtësit e demokracisë në Kinë gjatë një demonstrimi paqësor” - përfaqëson shkeljen e të drejtës së sanksionuar në Nenin 3 të DUDNJ ( e drejta për jetën) dhe një pohim të të drejtës së Nenit 20 (lirisë së grumbullimit). Mirë është që procesi kërkimor të filloj me një shembull.

## **2. Krijoni grupe të reja:**

a. Rigruponi nxënësit në grupe me 4 veta dhe caktojini, nga fleta e “Të drejtat e njeriut në botë” pikat 1-4. Më pas të gjithë që kanë pikën 1 mblidhen në një grup.

b. Nxënësit e këtij grupi duhet ti raportojnë njëri tjetrit rreth punës së bërë në grupin e kërkimit në mënyrë që të gjitha të drejtat e fletës të mbulojnë. Më pas ata duhet të veçojnë gjetje që mendojnë se janë më të rëndësishme dhe interesante.

### **Pjesa e dytë: Të drejtat e njeriut në vendin tonë**

1. Hartoni një listë me të drejta që plotësohen dhe që shkelen. Nxënësit që punuan në grupin e dytë mund të kenë nxjerr një listë të tillë me pohime dhe mohime të të drejtave që janë specifike për vendin e tyre.

2. Kërkojuni nxënësve të kthehen në grupet e tyre të kërkimit dhe të përjasin listën me nenet e DUDNJ

3. Diskutim në klasë: Kërkojuni nxënësve të identifikojnë ato pohime dhe mohime të cilat janë veçanërisht të ndjeshme për komunitetin ku jetojnë.

- Pse janë kuptimplotë për ju mohimet dhe pohimet e evidentuara.
- A ka njerëz të veçantë apo grupe njerëzish që mbrojnë të drejtat që ju tashëm i keni?
- A ka grupe që punojnë për të përmirësuar rastet e shkeljes së të drejtave?
- A keni mundësi të ndërmerri nisma konkrete ju si nxënës ? A janë shndërruar këto nisma në plane të vërteta veprimi?

### **Fleta: Të drejtat në botë**

1. Një person në Shqipëri regjistrohet për të votuar.
2. Qeveria kineze ndëshkon një çift që lindi fëmijën e dytë.
3. Qeveria turke dogji një fshat të tërë Kurd – minoritet etnik në juglindje të Turqisë dhe i detyroj të shpërnguleshin në një fshat të ri.
4. Një fëmijë brazilian nuk mund të shkoj në shkollë pasi familja e tij nuk mund të paguaj për librat e shkollës.
5. Në Salvador një kriminel është mbajtur me muaj të tërë në burg pa u gjykuar nëse ishte apo jo fajtor

6. Prindërit shitën vajzën e tyre 14 vjeçare të zonjës së një shtëpie publike me kusht që të punonte deri sa shlyente lekët që morën prindërit e saj.
7. Punëtorët e një ndërmarrje veshjes në Sri Lanka punojnë me orë të zgjatura në kushte shumë të këqija pune dhe ju duhet të presin me muaj të tërë për tu paguar.
8. Rrënjësit në Amerikë mbrojnë të drejtën për të mbledhur pendët e shqiptonjave për ceremonitë e tyre fetare.
9. Njerëzit që i shpëtuan konfliktit të armatosur në Haitit ju refuzohet hyrja në Amerikë si refugjatë.
10. Një person me të meta mendore u dënua me vdekje në USA për një krim që kishte kryer ku ishte 14 vjeç.
11. Në Afganistan gratë nuk kanë të drejtë të shkollohen apo të punojnë.
12. Gjatë luftës së dytë botërore, japonezët që jetonin në USA i detyruan të linin shtëpitë e tyre dhe të jetonin në kampe përqendrimi.
13. Studentët në Gjermani lexojnë në gazetat e tyre për zhvillimin politik të vendit dhe të drejtat e njeriut në vendet e tjera.
14. Gjatë fushatës elektorale, Qeveria Kroate lejoj vetëm kandidatët pro qeveritar të shfaqeshin dukshëm në media.
15. Në Guatemala, aktivistët kanë ngritur një strukturë në formën e kooperativës që i siguron ushqim dhe arsim fëmijëve të braktisur.
16. Në Pakistan fëmijët i detyrojnë të punojnë në ndërmarrjet e qilimave me orë të zgjatura. Ata nuk mund të ndjekin shkollën.
17. Këshilli i Bashkisë mori vendim të zbrazte bibliotekën e qytetit nga të gjitha librat që ata i konisederonin amoral dhe jopatriotik.
18. Populli Nikaraguas ka ngritur një Universitet për të ruajtur traditën kulturore dhe për të edukuar brezat e rinj.
19. Në rajonin e Çernobilit, prindërit e fëmijëve që kanë lindur me defekte si rezultat i shpërthimit atomik kërkojnë sqarime nga qeveria ruse.
20. Studentët në Evropën Perëndimore dhe në USA kanë bojkotuar përdorimin e topave të futbollit që prodhohen nga puna e fëmijëve dhe ata i kanë shkruar letra proteste në Pakistan dhe Indi për ti dhënë fund abuzimit të fëmijëve.
21. Popullsia rrënjëse në USA detyrohen të regjistrohen në shkolla shtetërore ku ju ndalohet të mësojnë gjuhën e tyre të nënës.
22. Në Poloni punëtorët kërkojnë të drejtën për tu organizuar në sindikata.
23. një punëtorë shqiptarë në Greqi paguhet më pak për të njëjtën punë se një punëtorë grek.
24. Një terrorist irlandez hodhi në një bombë në një restorant në Londër.
25. Në Iran një grua u rrah pasi nuk kishte mbuluar kokën me shall në një vend publik.
26. Në Australi popullsia vendase ka rimarrë tokën e vet dhe zyrtarisht ju lejohet ti emërtojnë me emrat tradicional.
27. Palestinezët kërkojnë të krijojnë shtetin e tyre.
28. Një mësues fyen nxënësin që nuk kishte mësuar mësimin.
39. Në Arabinë Saudite sipas fesë, hajdutit i pritet dora.
30. Në Filipine studentët kanë krijuar klubet e tyre ku debatojnë dhe diskutojnë politikat e ndërmarra nga qeveria.

Thelbi i nenit 28 fokusohet në të drejtën e çdo individi që të kontribuojë për realizimin në praktikë të të drejtave të sanksionuara në këtë deklaratë. Për të rritur ndërgjegjësimin e secilit nxënës për këtë obligim që ka ndaj vetes dhe të tjerëve, mësuesja mund të shrijë me tej aktivitet në klasë tashmë jo nga këndvështrimi i konstatimit të këtyre të drejtave por nga ai i veprimteve konkrete të gjithësecilit për të kontribuar në realizimin e tyre.

### **Tema. Krijimi i një modeli (Simulim)**

a. Përzgjidhni disa çështje që për nga rëndësia e tyre kanë vlerë globale (mund t'i përzgjidhni nga lista e mësipërme). Caktoni nxënës të veçantë apo dhe grup nxënësish që të përfaqësojnë vende të ndryshme që janë anëtarë të Kombeve të Bashkuar. Shpjegojuni që qëllimi i veprimtarisë së tyre është të përpiqen të njohin problemet e vendit dhe qëndrimin që ato kanë ndaj çështjeve të përzgjedhura.

b. Pasi nxënësi apo grupi i nxënësve ka përfunduar punën kërkimore, kërkojuni që të shkruajnë një rezolutë për një nga çështjet që është me interes për vendin që përfaqësojnë dhe ta paraqesin në "Asamblenë e Përgjithshme". Rezoluta duhet të përmbajë përshkrimin e qartë të problemit si dhe hapat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes duke përfshirë këtu dhe rolin që duhet të luajnë Kombet e Bashkuara. Nxënësi apo grupi duhet të bindin të tjerët që nga kjo rezolutë përfitojnë të gjithë dhe duhet të merret në konsideratë. Më pas nxitin nxënësit të krahasojnë rezolutat e tyre dhe të përpiqen të identifikojnë mbështetësit. Shpjegojuni që ata duhet të përgatiten për ndryshime që mund ti bëjnë rezolutës në mënyrë që të miratohet dhe të kalojë.

c. Ngrini një forum të OKB. Ulini nxënësit në rreth duke shënuar në një etiketë emrin e vendit që përfaqësojnë. Mësuesi apo dhe një nxënës i aftë do të jetë në rolin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB. Përcaktoni disa rregulla të forumit (psh përfaqësuesi i vendit do të quhet Ambasadori i \_\_\_\_; asnjë nuk mund të flasë pa i dhënë fjalën sekretari i përgjithshëm etj).

d. Sekretari i përgjithshëm fton përfaqësuesin të prezantojë rezolutën dhe drejton pyetjet, debatin, diskutimet dhe votimin. Pas diskutimit të rezolutës çdo përfaqësues mund të ftojë për votim. Për kalimin e një mocioni anëtari që e paraqet duhet të mbështete nga një ambasadorë tjetër. Për të kaluar një rezolutën duhet të kesh 2/3 e maxhorancës.

e. Mbylleni këtë seancë të simuluar me një vlerësim gojor ose të shkruar e cila të përmbajë njëkohësisht vetëvlerësimin dhe vlerësimin se çfarë mësuan nxënësit në këtë aktivitet për Kombet e Bashkuara, për rolin që luajnë në çështje të rëndësishme botërore.

Mësuesi mund të orientojë edhe veprimtari të tjera që kanë si qëllim të vlerësojnë ngjarje të ndryshme në kontekstin e të drejtave të njeriut. Një ndër qëllimet e edukimit të nxënësve me të drejtat e njeriut, në kontekstin e shkollës është ti edukojë nxënësit që të shikojnë dhe vlerësojnë njëkohësisht përvojat personale dhe më gjërë në aspektin historik dhe atë aktual në kuadrin e të drejtave të njeriut. Në këtë mënyrë ata mund të sjellin raste personale, të reja por mund ti drejtohen edhe historisë së vendit të tyre dhe më gjerë.



Në këtë kontekst, një vend të rëndësishëm duhet të zërë evidentimi i atyre njerëzve apo organizatave që janë bërë promotor të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në kuadër të këtij nenin dhe veprimtarive të mësipërme mund të zbulohen persona dhe organizata që llojnë dhe advokojnë fuqishëm për të drejtat e njeriut edhe në komunitetin e tyre.

### **Neni 29.**

Gjithkush ka detyrime vetëm ndaj asaj bashkësie në të cilën është i mundur zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.

Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, gjithkush do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë parashikuar me ligj, ekskluzivisht me qëllim që të sigurohet njohja dhe respektimi i nevojshëm i të drejtave dhe lirive të të tjerëve e që të plotësohen kërkesat e drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike.

Këto të drejta dhe liri nuk mund të zbatohen në asnjë rast kundër qëllimeve dhe parimeve të Kombeve të Bashkuara.

### Trajtim ligjor

Neni 29 flet për përgjegjësitë e individëve. Ky nen thotë që ne kemi detyrime ndaj të tjerëve dhe duhet t'i mbrojmë të drejtat dhe liritë e tyre si dhe ndaj shoqërisë në përgjithësi. Pra ky nen na tregon se kemi jo vetëm të drejta por edhe detyrime. PO kështu, edhe ato të drejta që gëzojmë nuk janë absolute por mund të kufizohen. Dhe gjithashtu neni 29 thekson që ato të drejta që gëzojmë nuk duhet t'i ushtrojmë në mënyrë të tillë që të jenë kundër qëllimeve apo parimeve të KB-së, pra thënë ndryshe nuk mund të abuzojmë në kurriz të parimeve të KB-së me të drejtat tona. Nëse nuk do të parashikoheshin këto kufizime për individët nuk do të mund të arrihej rregulli dhe harmonia në shoqëri.

### *Detyrimet*

DUDNJ-ja nuk na sqaron se cilat janë detyrimet tona ndaj shoqërisë në të cilën jetojmë, ashtu siç bën me të drejtat. Gjithsesi e rëndësishme është të kuptohet nga individët që ato kanë detyrime ndaj shoqërisë dhe se këto detyrime duke qenë të hapura e jo të përcaktuara do të përcaktohen nga politikat dhe rregullat normative të secilit shtet. Kuptohet që ajo që konsiderohet dhe nevojitet të vendoset si detyrim në një shoqëri mund të mos jetë e tillë në një shoqëri tjetër, e kështu DUDNJ-ja lejon shumëllojshmërinë e situatave që kanë të bëjnë me detyrimet.

Në Kushtetutën e vendit tonë parashikohet se individët kanë detyrime dhe këto detyrime vlejné njëlloj si për shtetasit shqiptarë, ashtu edhe për të huajt apo personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë - Neni 16 i Kushtetutës. Ashtu si në DUDNJ, edhe në Kushtetutën tonë nuk përcaktohet se ç'farë detyrimesh kemi në mënyrë të listuar, por ato gjenden në nene të ndryshme të saj drejtpërdrejt apo në mënyrë jo të drejtpërdrejtë të përcaktuara. Gjithashtu duhet kuptuar që edhe ato detyrime që janë në Kushtetutë përkrah të vetmet që ne kemi si individë në vendin tonë. Detyrimet tona i gjejmë në tërësinë e ligjeve apo akteve nënligjore që janë në fuqi në vendin tonë dhe që ne të gjithë jemi të detyruar t'i respektojmë e zbatojmë.

### *Kufizimet*

E njëjta analizë si më lart, vlen edhe për kufizimet e të drejtave e lirive. Edhe këto nuk janë parashikuar se cilat mund të jenë, por e rëndësishme është që DUDNJ ka parashikuar disa elementë të cilët duhen respektuar pa të mund të bëhen kufizime të të drejtave. Këto kufizime do të realizohen vetëm nëse:

realizohen me ligj

bëhen për të mundësuar njohjen e sigurimin e të drejtave të të tjerëve

realizohen për të plotësuar kërkesat e moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.

Vetëm nëse shtet justifikojnë me kriteret e mësipërme dhe e realizojnë me ligj, pra një akt zakonisht i miratuar nga parlamentet e vendeve (Kuvendi në rastin e vendit tonë). Thelbi është që kufizimi të bëhet për të garantuar të drejtat e liritë e të tjerëve ose se e kërkon interesi publik e garantimi i vlerave morale, sigurimi i rendit publik apo edhe mirëqenia që duhet realizuar në një shoqëri demokratike. DUDNJ nuk bën përcaktime se cili është kuptimi i secilës prej këtyre elementëve, por ato janë aq të rëndësishëm sa të mund të justifikojnë kufizimet e të drejtave dhe lirive të njeriut. Elementë të tillë për realizimin e kufizimeve të të drejtave kërkohen edhe nga dokumente të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kështu mund të përmendim Konventën Evropiane të të Drejtave të njeriut e cila kërkon që kufizimet të realizohen gjithmonë me ligj, për të mbrojtur të drejtat e liritë e të tjerëve apo për një interes publik dhe të realizohet nëse është i nevojshëm në një shoqëri demokratike.

Po kështu, edhe Kushtetuta jonë, në nenin 17 të saj, kur ka përcaktuar elementët që duhen respektuar pa të mund të kufizohen të drejtat, thekson se kufizimet bëhen:

vetëm me ligj

për një interes publik apo për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve

të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar kufizimin dhe të mos çënojnë thelbin e së drejtës (pra ta zhduke krejtësisht atë).

*Kufiri përfundimtar është tërësia e parimeve dhe qëllimeve të Kombeve të bashkuara*

Të gjitha të drejtat e liritë e përfshira në DUDNJ nuk mund të ushtrohen siç duam ne. Së pari ato ushtrohen për aq sa nuk janë kufizuar e deri në kufijtë që nuk janë kufizuar e së dyti ato ushtrohen në përputhje me qëllimet e parimet e organizatës së Kombeve të Bashkuara, organizatës në të cilën bëjnë pjesë të gjitha shtet e kësaj bote dhe ku të gjitha shtet e botës përcaktojnë vlerat, qëllimet e parimet së përputhje me të cilat ato veprojnë, apo vendosin të veprojnë.

*Akte ndërkombëtare të tjera*

Ka shumë akte ndërkombëtare, ndër të cilat kemi përmendur tashmë Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të cilat i referohen detyrimeve, kufizimeve apo edhe parimeve të përgjithshme të njerëzimit. Kështu, mund të përmenden:

Deklarata mbi të drejtat dhe detyrimet e individëve, grupeve apo organeve të shoqëroie për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e liritë e njohura universalisht: (1998).

Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popullit, e cila në një kre më vete përfshin detyrime një individëve ndaj shoqërisë si p.sh. ruajtja e zhvillimit harmonik të familjes,

respektimi i prindërve, shërbimi ndaj komunitetit, ruajtja dhe forcimi i solidaritetit social e kombëtar, ruajtja e forcimi i vlerave kulturore afrikane, komunikimi më i mirë sipas aftësive personale, pagesave e taksave dhe tatimeve të vendosura me ligj, e të tjera.

PNDCP dhe PNDSKE i referohen gjithashtu detyrimeve të individit ndaj individëve të tjerë dhe komunitetit në përgjithësi që në preambulën e tyre

## Aspekte edukative

Thelbi i nenit 29 vë në dukje se individit nuk ka vetëm të drejta por ka dhe detyrime dhe që kufizimi i të drejtave jo vetëm duhet të jetë por dhe të parashihet. Një njohës dhe mbrojtës i të drejtave të njeriut, i sheh këto të fundit ngushtësisht të lidhura dhe të pandashme nga detyrimet që ai ka si individ ndaj shoqërisë dhe ndaj çdo personi të veçantë. Në shoqërinë e sotme, gjithmonë e më shumë globale ky koncept, kapërcen kufijtë gjeografik të vendit në të cilin individit jeton. Në këtë kontekst është shumë e rëndësishme që zbatimi i të drejtave të individit, në vendin e vet të jenë të ekuilibruara me interesat e komunitetit botëror të cilat përfaqësohen nga Organizata e Kombeta të Bashkuara. Në këtë kontekst komenti rreth këtij neni mund të bëhet nga vetë nxënësit në klasë, në funksion të realizimit të një aktiviteti ku ata njëkohësisht do të ndihen aktorë dhe analistë të zbatimit të këtij neni si individ të një kombi dhe të një bote globale.

## Veprimtari

### Tema: Një botë globale dhe e ndërvarur

Ky aktivitet orienton të menduarin e nxënësve në ndikimin që ka tek njerëzit marrja e vendimeve për të ardhmen, në rrethana të ndryshme, në një botë gjithmonë e më shumë globale dhe të ndërvarur.

#### A. Ligjvënësit e të ardhmes

##### 1. Shpjegimi i aktivitetit

Kërkoju nxënësve të imagjinojnë sikur ata jetojnë në të ardhmen, 20 vjet më pas. Në këtë të ardhme për shkak të problemeve globale është vendosur që të ngrihet një këshill ndërkombëtar. Në këtë të ardhme, përderisa ekzistojnë shtetet dhe qeveritë që kalojnë ligje edhe ky këshill mund të kalojë ligje. Nxënësit duhet të imagjinojnë veten si ligjvënës të këtij këshilli. Në situatën e krijuar atyre ju duhet të mendojnë për të kaluar 12 ligje.

##### 2. Ndarja e detyrave

a. Klasa ndahet në 12 grupe dhe secilit grup i jepet një nga 12 ligjet e listës së quajtur “Ligjet për të ardhmen”.

b. Secili grup duhet të përgatis përmbajtjen e ligjit. Ata duhet të evidentojnë njëkohësisht efektet pozitive dhe negative të ligjit si për shoqëritë e industrializuara ashtu dhe për ato në zhvillim. Njëkohësisht duhet të marrin parasysh edhe ndikimin që ka ligji në të drejtat e njeriut: cilat nga të drejtat përfshihen? Si i plotëson apo i kufizon ky ligj të drejtat?

c. Duke i ballafaquar efektet pro dhe kundra të ligjit ata duhet të vendosin që ku ligj të kalojë apo jo.

d. Nxënësve ju shpjegohet se kanë dhe një mundësi tjetër, atë të rishkrimit të ligjit nëse mendojnë se në këtë mënyrë do të jetë më i dobishëm për njerëzit

### **Lista e ligjeve që propozohet**

1. Për shkak të problemeve të shkaktuar nga emigrimi i njerëzve në vende të tjera dhe për të mënjeluar konflikte e zgjidhur më mirë problemet ekonomike, propozohet një ligj botëror për të ndaluar migrimin dhe emigrimin e popullsisë për 5 vjet.
2. Me qëllim që të ruajmë burimet natyrore, propozohet një ligj për të gjitha kompanitë që prodhojnë energji të investojnë 35% të fitimit të tyre në fushën e kërkimit për shfrytëzimin e energjisë diellore dhe energjisë së erës.
3. Për të përmirësuar sistemin e sigurimit të shëndetit publik, propozohet një ligj që të gjitha qeveritë e botës të sigurojnë shërbimin shëndetësor falas për qytetarët e tyre.
4. Me qëllim që të ruajmë planetin tonë nga ndotja, propozohet një ligj në të cilin vendoset që të gjithë njerëzit që punojnë 30 km larg vendit të banimit, të përdorin mjetet e transportit publik.
5. Meqenëse zhvillimi i teknologjisë përparon me hapa të shpejta, propozohet një ligj që që arsimi i detyruar të zgjatet deri në moshën 18 vjeç.
6. Meqenëse varfëria dhe uria ende mbetet një problem seriozë për shumë vende, propozohet një ligj ku të gjitha vendet, që prodhojnë më shumë se konsumojnë prodhime bujqësore t'u dhurojnë 40% të këtij mbiprodhimi vendeve që vuajnë nga uria.
7. Me qëllim që të parandalohet vdekja infantile, propozohet një ligj që i detyron prindërit të vaksinonjë fëmijët ose të paguajnë një gjobë të konsiderueshme nëse nuk i vaksinonjë.
8. Propozohet një ligj që në rast se një vend sulmon një vend tjetër, vendi sulmues detyrohet të paguaj vlerën e shkatërrimeve që ka shkaktuar si dhe një kompensim për çdo jetë të humbur në luftë.
9. Për të shuar urrejtjen midis grupeve etnike, propozohet një ligj që i ndalon të gjithë qytetarët të bashkohen në një organizatë që diskriminon grupet etnike dhe racat e ndryshme apo që promovon konfliktin dhe diskriminimin midis grupeve.
10. Meqenëse rritja e popullsisë botërore po bëhet një problem, propozohet një ligj që kufizon çiftet të kenë vetëm një fëmijë.
11. Propozohet një ligj që të gjitha vendet të abrogohen të gjitha ligjet që kufizojnë liritë dhe të drejtat e grave.

12. Propozohet një ligj i cili kërkon që në 5 vjet, të gjitha fabrikat që prodhojnë makina të prodhojnë makina që nuk punojnë me naftë.

### **Efektet pozitive dhe negative të ligjit**

Të drejtat e njeriut që preken nga ligjet e propozuara për të ardhmen (pozitivisht ose negativisht) janë:

Ndikojnë pozitivisht për:

- Vendet në zhvillim
- Vendet e industrializuara

Ndikojnë negativisht për :

- Vendet në zhvillim
- Vendet e industrializuara

Mundësitë rekomandimeve për ligjet janë:

- Për të marrë një vendim për ligjin duhet të kemi informacionet e mëposhtme....
- Ne dëshirojmë të rishkruajmë ligjin në këtë mënyrë:

**3. Prezantimi i mendimeve:** Secili grup, me radhë, prezanton para klasës mendimin për ligjin që i është caktuar. Pas prezantimit i lihet koha e duhur pyetjeve dhe diskutimeve.

**4. Votimi i ligjit:** Pas secilit prezantim, pyetet klasa në cilësinë e këshillit ndërkombëtar të votoj për të kaluar apo jo ligjin

**5. Diskutimi i aktivitetit:** Pasi votohet për të gjitha ligjet, shtroni në formën e diskutim se çfarë mësuan nxënësit nga ky aktivitet duke ju drejtuar pyetjet e mëposhtme:

- Për cilat ligje ishte e lehtë të merrnit një vendim?
- Cilat ligje paraqesin vështirësi dhe pse?
- Cilat ligje janë veçanërisht të ndjeshme ndaj të drejtave të njeriut?
- Po ato me pak të ndjeshme?
- Cili është vizioni juaj për botën në 20 vitet e ardhme? Sa do të ndikojë vota që ju dhatë?
- Tek ne, a ka ndonjë ligj të përafërt me ligjet që diskutuat? Nëse po, si i vlerësoni ato?
- Mendoni se është një ide e mirë që të ekzistojë një këshill ndërkombëtar? Pse?
- Nëse do të ketë një këshill ndërkombëtar, cilat çështje duhet të merreshin në konsideratë nga ky këshill?

Në përfundim diskutoni me nxënësit moton “Bota nuk është ashtu siç duhet të jetë dhe gjithkush ka përgjegjësi të bëjë diçka për këtë? A mundet që diçka e tillë të ndodhi në shkollën apo komunitetin tuaj?

## Diskutim

a. Diskutoni përkufizimin e **detyrim**.

b. Diskutoni përkufizimin e fjalës **kufizim**.

c. Mblidhi të gjithë nxënësit në klasë dhe fillo një orë mësimi normale. Pa lajmëruar të tjerët, kërkoi njërit prej tyre, i cili del nga klasa duke kërkuar leje, të hyjë në klasë duke thërritur me zë të lartë e shumë seriozisht ‘zjarr’. Menjëherë udhëhiq klasën e cila është e çoroditur, të dalë nga salla.

Mblidhi përsëri nxënësit e pyeti nëse ishte korrekte për këtë nxënës të përdorë lirinë e tij të fjalës për të trembur të tjerët dhe të shkaktojë panik dhe edhe të bëjë që të tjerët në përpjekje për të shpëtuar të vriten. Kujto historinë e bariut që thërriste ‘ujku’ pa arsye. Ndihamoni nxënësit të kuptojnë që çdo njeri jo vetëm duhet të mbrojë të drejtat e njeriut por edhe nuk duhet të shkelë të drejtat e të tjerëve apo edhe të mos shkaktojë dhimbje me ushtrimin e të drejtave të veta. *Liria e kujtdo mbaron aty ku fillon liria e tjetrit.*

---

### **Neni 30**

**Asgjë në këtë Deklaratë nuk mund të interpretohet si e drejtë e një shteti, grupi apo personi për të kryer çfarëdo veprimtarie ose për të bërë një akt drejtuar kundër çdo të drejte ose lirie të shpallur në këtë Deklaratë.**

#### Trajtim ligjor

#### Aspekte edukative

Dy nenet e fundit të DUDNJ, 29 dhe 30, janë të një natyre të veçantë. Mënyra se si ato janë formuluar ka të bëjë me faktin se ju kujton të gjitha shteteve që zbatimi i DUDNJ do të bëhet jo duke prishur apo shkatërruar ato çka këto shtete kanë bërë deri tani por duke gjetur rrugë dhe mënyra për të siguruar apo rivendosur ekuilibrat që kanë munguar. Në DUDNJ, dy nenet e mësipërme janë në formën e mendimeve që pasojnë parashtrimin e neneve të mëparshme. Rëndësia e tyre shfaqet më vonë në rrugën e obligimeve që kanë shtetet për zbatimin e tyre.

Dhunimi i të drejtave të njeriut jo vetëm është i besueshme por ndodh çdo ditë, në propagandë dhe në praktikë. Neni 30 ka detyrën e shpjegimit që të drejta jo vetëm duhet të kufizohen por njëkohësisht nuk duhet të lejohet dhunimi i tyre. Kjo ide përkufizohet qartë në moton "Jo liri për armiqtë e lirisë". Kjo ide, në pamje të parë, duket e logjikshme dhe e pashmangshme por mund të jetë dhe e rrezikshme. Referimi në këtë nen i shtetit por dhe i grupit apo individit, shënon kufizimin. Shteti mund të përdor kufizimet me qëllim shkatërrimin e opozitës politike për ushtrimin e të drejtave të saj. Nga ana tjetër, grupi opozitar mund të keqpërdor lirinë e shprehjes nëpërmjet "demonstratave" të dhunshme të cilat kërcënojnë procesin demokratik. Terroristi është një person që mbron aktet e tij të papranueshme në emër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në parim, neni 30 i përjashton të gjitha këto pozicione, por ka një dilemë ligjore dhe politike në lejimin e partive, qoftë ato që janë në qeveri ashtu dhe ato që janë në opozitë, që të jenë gjykatës në rastin e tyre. Aplikimi i parimit të shprehur në këtë nen fiton vërtetësi nëse zbatohet nga një palë e tretë.

Për këtë arsye, zbatimi i DUDNJ, në botë monitorohet nga organizma të ngritur posaçërisht për këtë qëllim. Këto organizma janë shtetërorë, të një vendit dhe ndërkombëtar. Sot, sfida për mbrojtjen e të drejtave të njeriut qëndron në zbatimin e standardeve që tashme janë hartuar. Në të gjitha rastet, vendet që kanë nënshkruar DUDNJ dhe të gjitha traktatet duhet të përgatisin raporte periodike ku evidentojnë zbatimin e DUDNJ në bazë të standardeve. Për vlerësimin e këtyre raporteve ekziston një strukturë e tërë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe instrumentet përkatëse. Këto të fundit janë procedurat dhe mekanizmat e Komisionit të të Drejtave të Njeriut të OKB.



Sot, krahas DUDNJ ka 6 traktate shumë të rëndësishme që i adresohen të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale, diskriminimit racor, diskriminimit të gruas dhe të drejtat e fëmijëve. Janë të shumta vendet që i kanë ratifikuar këto traktate, midis tyre Konventa për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është pothuajse ratifikuar nga të gjitha vendet përveç Somalisë dhe Amerikës.

## **Veprimtari**

**Tema:** Sistemi rajonal i të drejtave

Siç u tha më sipër, krahas sistemit të OKB për të drejtat e njeriut ka dhe dokumente rajonal që mbështeten në parimet e DUDNJ. Këto janë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e adaptuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1950; Konventa Amerikane e të Drejtave të njeriut e adaptuar nga Organizata e vendeve të Amerikës në vitin 1969; Karta Afrikane e të Drejtave të Njeriut, e miratuar nga Organizata e bashkimit Afrikan në vitin 1981.

Realizimi i këtij aktivitetit kërkon njohuri të konsiderueshme të nxënësve të DUDNJ. Qëllimi i aktivitetit është që ti ndihmojë nxënësit që nëpërmjet krahasimit të identifikojnë vetë dallimet dhe ngjashmëritë që ka midis DUDNJ dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo Kartës Afrikane të të Drejtave të Njeriut.

## **Krahasimi i sistemit të të drejtave rajonale dhe ndërkombëtare**

**Mjetet:** Kopje të DUDNJ dhe Kartës Afrikane të të Drejtave të Popujve dhe të Njeriut KADPNJ (Të dyja mund të gjenden në internet)

1. Prezantimi i dokumentit rajonal të të drejtave të njeriut: Ju shpjegohet nxënësve se këto dy dokumente janë të ngjashme por jo identike. Secila pasqyron historinë, kulturën, traditën, ideologjinë dhe strukturën politike dhe ekonomike të vendit që e shkruan. Ndodh që të drejta në shkallën e renditjes sipas prioriteteve të ndryshojnë nga vendi në vend. Nxënësi duhet të kuptojë pse të drejtat nuk shikohen në të njëjtën mënyrë nga vende të ndryshme. Për të arritur në këtë pikë nxënësit duhet të kuptojnë se si këto vende vlerësojnë përvojën e tyre historike

2. Krahasimi i preambulave. Nxënësve ju shpërndahen kopje të DUDNJ dhe kopje të Kartës Afrikane të të Drejtave të Popujve dhe Njeriut . Ata lexojnë preambulën e të dy dokumenteve dhe mbi këtë bazë fillon diskutimi.

- Cilat janë ngjashmëritë në të dy preambulat?

- Cilat çështje ngrihen në preambulën e KADPNJ por jo në DUDNJ (psh. e drejta për zhvillim, eliminimi i kolonializmit, neokolonializmit, aparteidit, çmontimi i bazave të huaja ushtarake dhe diskriminimi racial)?

-Kujt i referohet UDHR kur flet për “akte barbare që kanë dhunuar ndërgjegjen njerëzore”? - Si mendoni, cilave fuqi të huaja ju referohet KADPNJ në preambulë?(fokusoni diskutimin në fjalitë që fillojnë me fjalën “...i vetëdijshëm.”

- Si mendoni, pse KADPNJ përfshinë të drejtat e popujve dhe të drejtat e njeriut?

3. Krahasoni përmbajtjen: Ndaheni klasën në grupe të vogla dhe secilit prej tyre jepi detyrë të krahasojnë dy dokumentet. Duke përdorur KADPNJ si pikë referimi, nxënësit duhet të shënojnë në të të gjitha të rejtat që gjenden e në DUDNJ. Nxënësit duhet të veçojnë ato të drejta që gjenden vetëm në KADPNJ dhe të diskutojnë për to. Në një hap të dytë diskutohen gjetjet e secilit grup.

4. Fokusimi në të drejt të veçanta: Vazhdohet diskutimi duke u mbështetur në të drejta të veçanta

- Liria e mbledhjes dhe bashkimit paqësor (Neni 20);
- E drejta për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit (Neni 21);
- E drejta për sigurim shoqëror dhe realizim të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore (Neni 23).

5. Diskutimi i KADPNJ:

- Pse duhet të jen në KADPNJ nenet 20 – 22? Si pasqyrojnë ato këndvështrimin e vendeve afrikane në lidhje me historinë e tyre, veçanërisht kolonializmin? Si e pasqyrojnë ato mendimin e një afrikani në lidhje me neokolonializmin?

6. Krahasimi i dokumenteve të tjerë. Mësuesi në bashkëpunim me nxënësit mund të përzgjedhin dokumentet të tjera për ti krahasuar.

## Aneks 1

### **DEKLARATA E PERGJITHSHME MBI TE DREJTAT E NJERIUT**<sup>13</sup>

#### HYRJE

Meqenëse njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë;

mbasi mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut ka çuar drejt akteve barbare, të cilat kanë ofenduar ndërgjegjen e njerëzimit, dhe mbasi krijimi i botës në të cilën njerëzit do të gëzojnë lirinë e fjalës, të besimit dhe lirinë nga frika e skamja është proklamuar si dëshira më e lartë e çdo njeriu;

mbasi është e nevojshme që të drejtat e njeriut të mbrohen me dispozita juridike, kështu që njeriu të mos jetë i shtrënguar që në pikën e fundit t'i përvishet kryengritjes kundër tiranisë dhe shtypjes;

mbasi është e nevojshme që të nxitet zhvillimi i marrëdhënieve miqësore midis kombeve; mbasi popujt e Kombeve të Bashkuara vërtetuan përsëri në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e personit të njeriut dhe barazinë midis burrave dhe grave dhe mbasi vendosën që të nxitin përparimin shoqëror dhe të përmirësojnë nivelin e jetës në liri të plotë;

mbasi shtetet anëtare u detyruan që, në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, të sigurojnë respektimin e përgjithshëm dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore;

mbasi kuptimi i përbashkët i këtyre të drejtave dhe lirive është më i rëndësishëm për realizimin e plotë të këtij detyrimi;

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME shpall Këtë DEKLARATE TE PERGJITHSHME MBI TE DREJTAT E NJERIUT si ideal të përgjithshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, në mënyrë që çdo njeri dhe çdo organizëm shoqëror, duke pasur parasysh gjithmonë këtë Deklaratë, të përpiqet që, me anë të mësimin dhe edukimit, të ndihmonte në respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive dhe që, me anë të masave progresive kombëtare dhe ndërkombëtare, të sigurojë njohja dhe zbatimin e tyre të përgjithshëm dhe të vërtetë, si midis popujve të vetë shteteve anëtare, ashtu edhe midis popujve të atyre territoreve që janë nën administrimin e tyre.

---

<sup>13</sup> Marrë nga adresa zyrtare në internet e Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, <http://ëëë.unhchr.ch/udhr/lang/aln.htm>

#### Neni 1

Të gjithë njerëzit linden të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi.

#### Neni 2

Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përse i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.

Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjindet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit.

#### Neni 3

Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.

#### Neni 4

Asnjëri nuk duhet të mbahet si skllav ose çifçi; skllavëria dhe tregtia e skllavëve janë të ndaluara në të gjitha format.

#### Neni 5

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet mundimit, veprimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtëruës.

#### Neni 6

Gjithkush ka të drejtë që t'i njihet kudo personaliteti juridik.

#### Neni 7

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë.

#### Neni 8

Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet.

#### Neni 9

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose internimit.

#### Neni 10

Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

#### Neni 11

Kushdo që është i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit dhe në një proces publik në të cilin ka pasur të gjitha garancitë e duhura për mbrojtjen e vet.

Asnjëri nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk përbëjnë një vepër penale, sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, në kohën kur janë kryer. Gjithashtu nuk mund të vendoset një dënim më i rëndë nga ai që ka qenë zbatuar në kohën kur është kryer vepra penale.

#### Neni 12

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtën të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla.

#### Neni 13

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti.

Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.

#### Neni 14

Gjithkush ka të drejtë të kërkojë dhe gëzojë në vende të tjera azil nga ndjekjet.

Këtë të drejtë nuk mund ta gëzojë askush në rast se ndiqet për krime jopolitike ose për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 15

Gjithkush ka të drejtën e një shtetësie.

Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij si dhe as nga e drejta që të ndërrojë shtetësinë.

#### Neni 16

Burrat dhe gratë në moshë të pjekur kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi.

Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen.

Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

#### Neni 17

Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkësi me të tjerët.

Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.

#### Neni 18

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi

me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënies së mësimëve, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare.

#### Neni 19

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.

#### Neni 20

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor.  
Asnjëri nuk duhet të detyrohet të bëjë pjesë në ndonjë bashkim.

#### Neni 21

Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

Gjithkush ka njëlloj të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e vet.

Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

#### Neni 22

Si anëtar i shoqërisë, gjithkush ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për dinjitetin e vet dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti.

#### Neni 23

Gjithkush ka të drejtën për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.

Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë.

Gjithkush që punon ka të drejtën për një shpërblim të drejtë dhe favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.

Gjithkush ka të drejtë të formojë sindikatë and të bëjë pjesë në të për mbrojtjen e interesave të veta.

#### Neni 24

Gjithkush ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, duke përfshirë kufizimin e arsyeshëm të orarit të punës dhe pushimin e paguar periodik.

#### Neni 25

Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale,

si edhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

Nënat dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martesë, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale.

#### Neni 26

Gjithkush ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollat fillore dhe të ulta. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të zgjerohet e arsimi i lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në bazë të aftësisë.

Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

Të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre e kanë në rradhë të parë prindërit.

#### Neni 27

Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzojë artet dhe të përfitojë nga përparimi shkencor dhe dobitë e tij.

Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë.

#### Neni 28

Gjithkush ka të drejtë për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin mund të realizohen plotësisht të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë.

#### Neni 29

Gjithkush ka detyrime vetëm ndaj asaj bashkësie në të cilën është i mundur zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.

Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, gjithkush do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë parashikuar me ligj, ekskluzivisht me qëllim që të sigurohet njohja dhe respektimi i nevojshëm i të drejtave dhe lirive të të tjerëve e që të plotësohen kërkesat e drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike.

(3)Këto të drejta dhe liri nuk mund të zbatohen në asnjë rast kundër qëllimeve dhe parimeve të Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 30

Asgjë në këtë Deklaratë nuk mund të interpretohet si e drejtë e një shteti, grupi apo personi për të kryer çfarëdo veprimtarie ose për të bërë një akt drejtuar kundër çdo të drejte ose lirie të shpallur në këtë Deklaratë.

**LISTA E TË DREJTAVE E LIRIVE TË PËRFSHIRA NË DUDNJ**

Ju lutemi që nxënësit tuaj t'i drejtoni gjithmonë tek teksti i plotë i Deklaratës . Ky variant i 'thjeshtuar' i tekstit të DUDNJ-së është përgatitur për lehtësi e thejshësi kuptimi, studimi e diskutimi të DUDNJ-së. Mësuesit mund ta përdorin këtë listë të thjeshtuar si referencë orientuese dhe nxitje për diskutime.

Të drejta e liri civile e politike	Neni 1	liri, barabazi, vëllazëri
	Neni 2	mosdiskriminimi: të gjithë të barabartë në gëzimin e të drejtave pa kufizim përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër
	Neni 3	e drejta për një jetë të lirë e sigurim vetjak
	Neni 4	ndalimi i skllavërisë dhe tregtisë së skllavëve
	Neni 5	mos trajtimi i egër, jonjerëzor ose poshtëruës
	Neni 6	e drejta e personalitetit juridik
	Neni 7	barazia para ligjit
	Neni 8	e drejta për mjete të frytshme juridike
	Neni 9	ndalimi i arrestimit, ndalimit ose internimit arbitrarisht
	Neni 10	e drejta për një proces të rregullt gjyqësor
	Neni 11	prezumimi i pafajësisë; jo prapveprueshmëri e ligjit penal
	Neni 12	e drejta e privatësisë; mos ndërhyrja arbitrare në jetën private, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake; mbrojtja e dinjitetit personal
	Neni 13	liria e qarkullimit dhe banimit; e drejtë të largohesh nga cilido vend përfshirë edhe tëndin, si dhe të kthehesh në vendin tënd.
	Neni 14	e drejta të kërkosh dhe gëzosh azil në vende të tjera nga ndjekjet
	Neni 15	e drejta e shtetësisë; mos privimi arbitrarisht nga shtetësia e mos ndërimi arbitrar i shtetësisë
	Neni 16	e drejta për të lidhur martesë dhe formuar familjen
	Neni 17	e drejta për të patur pasuri; jo privim arbitrar nga pasuria
	Neni 18	liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit
	Neni 19	liria e mendimit dhe e shprehjes liria e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit
	Neni 20	liria e mbledhjes dhe bashkimit paqësor
	Neni 21	e drejta për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit vetë ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; e drejta për të hyrë në shërbimet publike



Neni 22	e drejta për sigurim shoqëror dhe realizim të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore
Neni 23	e drejta për punë, për të zgjedhur lirisht profesionin; e drejta për të qenë i mbrojtur nga papunësia; e drejta për një rrogë të njëjtë për punë të njëjtë; e drejta për të formuar sindikatë
Neni 24	e drejta për pushim dhe kohë të lirë
Neni 25	e drejta për një nivel jetese të mjaftueshëm; nënat dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme; gëzim i njëjtë mbrojtje sociale për të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martese
Neni 26	e drejta e shkollimit
Neni 27	liria e pjesëmarrjes në jetën kulturore të bashkësisë; liria e gëzimit të arteve dhe e përfitimit nga përparimi shkencor; e drejta e autorit
Neni 28	e drejta për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin mund të realizohen plotësisht të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë
Neni 29	detyrime të secilit ndaj bashkësisë, por duke mundësuar zhvillimin e lirë dhe të plotë të personalitetit; kufizime të të drejtave e lirive vetëm me ligj

## FJALORTH

### **Abuzim**

Trajtim mizor apo I dhunshëm. të përdorësh diçka për një qëllim të keq apo në mënyrë të gabuar.

### **Avokat**

Dikush që publikisht mbështet apo thotë gjera të mira për diçka.

### **Azil**

Një vend ku dikush është i sigurt.

### **Përballoj**

Të kesh mjaftueshëm para që të mund të lësh ca mënjane. Gjithashtu të kesh mundësi të blesh – të kesh mundësi të paguash për koston e diçkaje.

### **Deklaratë**

Thënie publike, njoftim.

### **Demokraci**

Qeverisje në të cilën njerëzit kanë pushtetin e marrjes së vendimeve, zakonisht duke ia dhënë këtë përfaqësuesve të cilët i zgjedhin për të bërë ligjet dhe drejtuar qeverinë.

[Greqisht, Demos (popull) dhe kratos (rregull, sovranitet)] Një sistem politik i bazuar në pjesëmarrjen e njerëzve. Ai parashikon, ndër të tjera, **ndarjen e pushteteve** ndërmjet **gjyqësorit, legjislativit dhe autoritetit ekzekutiv** si dhe **zgjedhje të lira dhe të rregullta**. Demokracitë reflektojnë **rregullin e shumicës**, duke mbrojtur të drejtat e pakicave.

### **Dinjtet i brendshëm/i lindur**

*Termi "dinjtet i lindur" gjendet në fjalinë e parë të DUDNj, e cila thotë "duhet pasur parasysh se njohja e dinjitetit të lindur...". Dy Konventat e përdorin termin dinjtet në preambulat e tyre. Preambula e Kartës së Kombeve të Bashkuara në fjalinë e dytë pohon: "për të riafirmuar besimin në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e qenies njerëzore . . .". Termi është i pranishëm edhe në një numër instrumentesh të të drejtave të njeriut dhe në traktatet e së drejtës humanitare. Dinjteti është një koncept jetik i të drejtave të njeriut dhe është thelbësor në kuptimin e të drejtave të njeriut.*

*Megjithëse nuk ekziston një kuptim formal ligjor për termin "dinjtet i lindur", kuptimi i zakonshëm i termit "dinjtet" është "i çmuar dhe i respektuar". I lindur do të thotë "që ekziston si pjesë e natyrshme dhe themelore e diçkaje; nuk mund të hiqet ose të ndërrohet". (Fjalori Ndërkombëtar i Kembrixhit).*

*Sikurse ka vërejtur një studiues, hartuesit e DUDNj druheshin se njëfarë mbështetjeje në të drejtën natyrore dhe në ekzistencën e një zoti nuk duhet të përbënte parakusht për*

*besimin ose respektimin e të drejtave të njeriut. Prandaj, më tepër përdorej termi “i lindur” se sa termi “e drejtë natyrore” ose “Zot”. Në sqarimin e këtij komenti, J. Morsink theksoi se “njerëzit e kanë këtë të drejtë morale si rezultat i anëtarësisë së tyre në familjen njerëzore dhe jo si rezultat i ndonjë force apo agjenti të jashtëm.”*

Kuptimi i këtij termi parësor për të drejtat e njeriut, garanton që mbrojtja e vlerave njerëzore dhe respektimi i të drejtave nuk mbështetet detyrimisht në teologji apo besimin në zot. Me fjalë të tjera, kjo e laicizon teorinë e të drejtave të njeriut. Ndërsa një komentues tjetër vërejt (J Zajadlo 1999): “Për sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, “dinjiteti i lindur njerëzor” përbën njëkohësisht **parim** dhe normë . . . një qëllim për gjithë sistemin ndërkombëtar . . . Si normë, termi është i prejardhur dhe specifik për interpretim.”

### **Diskriminuj**

Të trajtosh një person apo grup më keq se të tjerët apo më mirë se të tjerët, zakonisht për shkak të paragjykimeve racore, përkatësisë etnike, grupmoshës, fesë apo gjinisë.

Diskriminimi është akti i të bërit apo i njohjes së dallimeve ndërmjet njerëzve. Me diskriminim zakonisht në kuptojmë akte të dyshimit apo të urrejtjes irracionale, të drejtuar ndaj grupeve të veçanta të njerëzve, të tilla si gratë apo **grupet e pakicave, racore** apo **fetare**.

### **Detyrë**

Diçka që një person duhet të bëjë për shkak se mendohet se ajo gjë është gjëja e drejtë, që duhet bërë apo e moralshme.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), 1948

**Padyshim**, Deklarata Universale **mbahet si një arritje e shkëlqyer në “respektin universal për dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.”** Ky instrument i të drejtave të njeriut **i hartuar nga** Komisioni i të Drejtave të Njeriut i KB-së **dhe i miratuar nga** Asambleja e Përgjithshme si **“standard i përbashkët i arritjeve për të gjithë popujt dhe kombet” ka frymëzuar hartimin e kartave të të drejtave kushtetuese, traktateve të të drejtave të njeriut dhe mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Është argumentuar se shumë të drejta të përfshira në tridhjetë nenet e saj kanë marrë karakterin e “së drejtës zakonore ndërkombëtare.”**

### **Barazi**

Të kesh të njëjtat të drejta, aftësi apo mundësi si të tjerët.

Drejtësia për të mitur

Drejtësia për të mitur është tërësia e ligjeve mbi fëmijët. Ligjet duhen **miratuar** për t'u garantuar fëmijëve të drejtat e parashikuara në **Konventën e të Drejtave të Fëmijëve** dhe në **instrumente të tjera ndërkombëtare**. Shumë vende kanë ose janë duke ndërmarrë një reformë legjislative duke siguruar kështu mbrojtje edhe për fëmijët e akuzuar për vepra penale apo për sjellje jo të mira. Tani Kosova është duke përgatitur një kod të ri për të miturit.

### **Sindikata**

Një grup i organizuar punonjësish të një fushë të caktuar për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e interesat e tyre.

### **Gjykime**

Akti i dëgjimit të një rasti në një gjykatë për të vendosur nëse një pretendim apo akuzë është e vërtetë. Gjithashtu një shqyrtim formal i provave nga gjyqtari për të vendosur fajësinë apo jo në një rast.

### **Të Bashkuar**

Të bashkuar së bashku në një, të kombinuar. Gjithashtu të bashkuar së bashku për një qëllim të përbashkët, apo me ndjenja të përbashkëta.

### **Universale**

E njerëzve, nga njerëzit, apo për njerëzit; pra që ka të bëjë me të gjithë.

### **Rrogë**

Para të paguara një punonjësi për punën e bërë.